

Dalan Shaplo

BIBLIOTEKA E

854: 08

SH 22

SH 22

GJIROKASTER

**LETERSIA
DHE
REALITETI YNE**

SSH. 09

SSH. 09

SH 22

DALAN SHAPLLO

2

R

LETËRSIA DHE REALITETI YNË

(Artikuj kritikë)

48248
35423

LIBRARI E SHTETIT
TIRANE

SHTËPIA BOTONJËSE «NAIM FRASHËRI»

PROBLEME IDEORE DHE ARTISTIKE TË POEZISË SONË

1

Poezia jonë e këtyre katër vjetve të fundit, që do të marrim në shqyrtim, pa e shkëputur nga tërë krijimtaria jonë poetike, ngre disa probleme të rëndësishme, të njohura edhe më parë, ose të reja. Problemet janë të shumta, qoftë në përmbajtjen estetike, qoftë në realizimin artistik; dalin çështje që lidhen me gjënitë dhe format e ndryshme të pasqyritit poetik të realitetit, çështje të traditës dhe të novatorizmit, të individualitetit të poetëve, të evoluimit të çdo poeti që ka formuar një personalitet brenda mënyrës së krijimit të tij e mjaft të tjera. Po, në këtë grumbull problemesh me rëndësi ideore dhe estetike, duhet gjetur problemi kyç, ai që shfaqet në çdo hap dhe shpjegon shumë fenomene të reja, ai që përcakton kriterin kryesor të vlerësimit. **Dhe ky problem është i lidhur me marrëdhënjet e poetit me realitetin tonë, me botën, me kohën.** Në shtrimin e kësaj çështjeje nuk ka ndonjë gjë të re, gjithmonë ky ka qënë orientimi kryesor i vlerësimit të artit; gjithmonë kritikët, mbrojtës të artit realist, i kanë matur veprat artistike me problemet, fenomenet, me njerëzit, me realitetin e kohës së tyre, me tendencën kryesore të zhvillimit të shoqërisë, duke përkrahur të renë, po duke e marrë këtë të lidhur ngushtë me traditën. Gjë e re këtu është realiteti i transformuar i Shqipërisë, ndryshimet politike, ekonomike, shoqërore dhe morale të shoqërisë sonë, formimi i karaktereve të reja dhe i

një gjendjeje të re shpirtërore të masave që lidhet me psikikën, me konceptimin më materialist dhe revolucionar të botës. Këto fenomene shoqërore pasqyrohen në poezi në një trajtë ose në një tjetër, në një formë të përshtatshme apo jo krejtësisht të përshtatshme, me më shumë ose me më pak talent, po e vërteta është që këto pasqyrohen në veprat e poetëve dhe përparimi duhet parë si një fenomen pak a shumë i përgjithshëm, duke çmuar të gjitha ato forca serioze që e përfaqësojnë, në lidhje të ngushtë dhe jo të shkëputur nga e kaluara. Doemos, çdo përparim ndesh në disa vështirësi, në pengesa të llojeve të ndryshme, ndesh në rutinën që kërkon ta mbajë në vend. Veç asaj, egziston edhe rreziku i «zellit» të tepëruar të «së resë» që mund të shpjerë në formalizëm. Kritika jonë, megjithëse disa herë i është larguar së vërtetës objektive, metodës dialektike në analizën e fenomeneve letrare, prapë i ka vënë në dukje këto probleme dhe shtruarja e tyre mendoj se ka sjellë dobinë e vet, i ka bërë poetët të mendohen dhe të përpiqen të përparojnë në rrugën e tyre.

Nëqoftëse do të nisemi nga ndryshimet shoqërore tek ne, nga konceptimi gjithmonë e më socialist i jetës prej njeriut të sotëm, që ndërton socializmin, nga shija estetike e përparuar që përfaqësohet në një numër gjithmonë e më të madh njerëzish, nga disa kërkesa objektive, duke marrë për bazë perspektivën, zhvillimin, pa rënë në një konceptim empirik dhe primitiv, — atëhere mund të çmohet drejt fenomenet letrare dhe mund të ndihmojmë, me kritikën tonë, për zhvillimin e mëtejshëm të poezisë.

Duke qenë e gjithanshme, jeta ka pamje dhe ngjyra të shumta; sipas veçorisë së saj, poezia do të gjejë burimet e frymëzimit me stilet dhe individualitetet më të ndryshme. Studimi i fenomeneve të poezisë gjatë kësaj periudhe duhet bërë duke u nisur nga ndryshimet e realitetit, nga kërkesat e reja të kohës sonë, të jetës që ndryshon, por poezia duhet parë në specifikën e vet, duhet të përcaktohet çfarë ka të bëjë me stilet, me mënyrat e ndryshme të shprehjes, gjë që tregon zhvillimin

e poezisë, dhe çfarë nuk ka të bëjë me veçoritë, por me prapambetjen, me dobësitë e njerit apo tjetrit poet dhe kjo jo për të vënë nota, por për të ndihmuar sado pak në përparimin e përgjithshëm.

Në vendimin e KQ të PPSH mbi zhvillimin e mëtejshëm të letërsisë dhe arteve, botuar në qershor të 1961, flitet gjerësisht për një lidhje të ngushtë të artistit me jetën, për t'i hyrë më thellë njeriut dhe realitetit «... dekadat e ardhshme do të sjellin një përparim cilësor të dukshëm, karakteristika e të cilit duhet të jetë hyrja në thellësi në proceset e ndryshimeve që po bëhen në vendin dhe në njerëzit tanë», thuhet në këtë vendim.

Mbledhja e korrikut të 1961-së me shkrimtarët dhe artistët, fjala e ngrohtë, që zbulonte të vërtetën objektive, mbajtur nga shoku Enver Hoxha në këtë mbledhje, lojti gjithashtu një rol të rëndësishëm për orientimin e drejtë të njerëzve të artit, duke e përqëndruar vëmendjen jo te probleme sekondare, po te thelbi i çështjes, te rezultati i veprave letrare, të cilat duhet të nisen nga jeta, nga proceset komplekse të saj, nga niveli i vetë realitetit, që mund të shprehet me format më të ndryshme, mjafton që ato të pëlqehen nga populli. «Kudo ka poezi, kudo ka novatorizëm, tha shoku Enver Hoxha, dhe askush nuk ka të drejtë dhe nuk mundet ta pengojë atë. Vetëm se duhet që ky novatorizëm të ecë në rrugën e drejtë, duke respektuar parimet e realizmit socialist, duhet që vepra të jetë e thjeshtë, e qartë, madhështore, mobilizuese, t'i edukojë e t'i hapë popullit perspektivën».

Problemi i novatorizmit i ka dalë përpara në mënyrë të veçantë poezisë sonë gjatë kësaj periudhe. Dhe ky problem, në përgjithësi, për artin, dhe në mënyrë të posaçme për poezinë, — sepse ajo, ndofta, reagon më shpejt ndaj së resë, — lind veçanërisht në kushtet e ndryshimeve revolucionare, kur jeta ecën përpara me ritme të pandalshme.

Teorikisht është rrahur problemi i traditës dhe i novatorizmit dhe mund të themi se është sqaruar. E

keqja është se ne ngatërrohem nganjëherë në vlerësimin konkret të procesit letrar; nuk e marrim atë gjithmonë të lidhur dhe nuk e shohim sa duhet novatorizmin, në radhë të parë, si një çështje të brendisë. Natyrisht, këtu na intereson fenomeni, rruga e krijimtarisë poetike. Mbrojtja e traditave nuk do të thotë aspak të mbrojmë gjithshka që është shkruar qoftë edhe nga autorë të njohur, ashtu sikundër mbrojtja e novatorizmit në asnjë mënyrë nuk lidhet me përkrahjen e çdo vjershe apo poeme që ndryshon vetëm nga forma dhe nuk sjell asnjë material jetësor të rëndësishëm, asnjë mendim të ri. Është pohuar mendimi se, në përgjithësi, tërë poezia jonë e realizmit socialist, për vetë natyrën e saj, është novatore. Ky mendim është i drejtë, vetëm se nuk mund të thjeshtësohet dhe, duke u nisur nga ky pohim parimor që përcakton një tipar të rëndësishëm të artit tonë, të quajmë a priori novatore çdo vepër, të mbyllim sytë para të qëndruarit në vend dhe të shikuarit të botës, në disa raste, me një konceptim të vjetëruar, anakronik, që rrjedh nga ngadalësia e të kapurit të së resë ose nga një rutinë formale, kundër së cilës duhet bërë luftë e ndër-gjegjshme dhe e ndershme.

Por problemi i novatorizmit lidhet edhe me formën, me zhvillimin e saj brenda trajtave të vjetra ose në trajta më të reja. Edhe forma e re, — pasurimi i gjuhës, i figurave, i mjeteve artistike, duke lindur nga jeta, mund të kthehet e të veprojë në mënyrë aktive për lëvizjen përpara të vetë përmbajtjes; disa herë kjo formë mund të ndihmojë për ta kapur më shpejt brendinë e re. Duke theksuar këtë lidhje dialektike të gjërave, nuk harrojmë asnjëherë se **materiali i jetës, idetë e kohës, mendimi revolucionar janë primare në unitetin e përmbajtjes me formën.**

Poezia jonë e re ka qenë dhe është revolucionare me tingëllim të drejtë politik dhe qytetar. Kjo lidhet me vetë realitetin tonë, me burimet e frymëzimit, me traditat, me frymën e partisë që e ka udhëhequr gjithmonë letërsinë e realizmit socialist. Që nga fillimet e veta, poezia jonë e re ka lindur si një jehonë e drejt-

përdrejtë e gjendjes shpirtërore revolucionare të komunistëve, të popullit, ajo është shquar për tiparet realiste dhe notat e një romantike të re.

Në përgjithësi, poetët tanë kapin tema të rëndësishme dhe i trajtojnë ato sipas parimit të partishmërisë, nga pozitat e transformimit moral dhe shoqëror. Poezia jonë, në tërësi, është shembull i qartë se si mund të ecë në rrugë të drejtë arti kur i ka vënë vetes për qëllim t'i shërbejë popullit, të pasurojë botën e tij shpirtërore, të ndihmojë për revolucionarizimin e shoqërisë.

Ne kemi ndjekur disa shfaqje të poezisë revizioniste dhe kemi vënë re se në ç'rrugë të shtrembër mund të çojë revizionizmi në politikë e në art, se si ai mund të bëhet nxitës i fenomeneve antirealiste në letërsi, i trajtimit formalist të temave të vogla, të shkëputjes së njeriut dhe të mbylljes në vetvete, të krijimit të një poezie subjektiviste dhe shpesh të errët, të pakuptueshme nga populli.

Me pasurimet në përmbajtje e në formë, me nuancat e reja dhe depërtimin më të thellë në jetë e në shpirtin e njeriut tonë të socializmit, drejtimi i poezisë duhet të jetë gjithmonë revolucionar dhe asnjë novacion, asnjë zell për figura e për ndjenja të holla nuk duhet ta largojë poezinë nga perspektiva e revolucionit, e ideve të marksizëm-leninizmit, të marra këto në vështrimin më të gjërë dhe në veçorinë e artit poetik.

Poezia jonë ka bërë një rrugë njëzetvjeçare. Doemos, ka pasur e ka edhe sot vepra të dobëta, të parealizuara, skematike apo deklarative, po ne duhet të shohim zhvillimin e saj si një proces të lidhur e kompleks, larg çdo fryme nihiliste, që në të vërtetë do të ishte e dëmshme dhe antishkencore. Poezitë e bukura, të frymëzuara, të realizmit socialist nuk lindën vetëm dje ose sot; ato kanë lindur bashkë me revolucionin; janë zhvilluar krahas shoqërisë sonë. Sigurisht, do të ishte gabim po ta përfytyronim zhvillimin si një rrugë të drejtë që i ngjitet vazhdimisht një të përpjete. Dihet se në rrugën e letërsive të çdo kombi (kam parasysh letërsinë e pasqirimit) mund të ketë vepra të një periudhe të hershme,

që qëndrojnë më lart se disa vepra të një periudhe, që, në tërësi, karakterizohet nga një pjekuri më e madhe. Këto janë fenomene normale dhe të kuptueshme. Por poezia duhet shikuar, në radhë të parë, si një pjellë e kohës, doemos pa e ndarë nga individualiteti i artistit, nga aftësitë dhe talenti i tij. Duhet pasur gjithmonë parasysh shkalla e zhvillimit të realizmit socialist tek ne, ndryshimi në konceptimin e botës, pasurimi i mjeteve artistike. Në qoftë se do të nisemi nga një kriter historik, e sigurisht edhe estetik, ne do të arrijmë, pa dyshim, në përfundime të drejta dhe do të çmojmë ato vepra që duhen çmuar.

Në çmojmë këngët e para revolucionare, të singerta, të thjeshta dhe komunikative, poemat si «Epopeja e Ballit Kombëtar», «Prishtina», «Ashtu Myzeqe» e mjaft të tjera. Duhet të vlerësojmë edhe poema të mëvonshme të llojit epik si «Heronjtë e Vigut» etj., të cilat kanë kontribuar e kontribuojnë edhe sot me rikrijimin epik të disa tablove të luftës ose me karaktere burrnore që ngjallin ndjenja heroike. Një vend të rëndësishëm zënë në periudhën e ndërtimit socialist të vendit këngët kushtuar punës, heronjve të saj, ndonjë vjershë e poemë që i kushton vëmendje më tepër njeriut, shpirtit të tij, që mundohet të lidhë problemet shoqërore me anët më intime, individuale të karakterit njerëzor. Me gjithë zigzaket, ngjitjet apo zbritjet, në tërësi, në poezinë tonë vjen duke u forcuar realizmi; poetët, si edhe prozatorët e dramaturgët e, në përgjithësi, të gjithë artistët tanë, — sepse kjo është një kërkesë e kohës, e vetë zhvillimit të artit socialist, — po hyjnë më thellë në fenomenet e jetës, në shpirtin e njeriut, po e lidhin më mirë veten me kohën, me shoqërinë. Prej disa vitesh del më e theksuar nevoja për ta dhënë realitetin në më shumë ngjyra, për një depërtim më të thellë te njeriu, te ndjenjat e tij; ka dalë detyra e përgjithësimeve të reja më të thella të luftës midis së vjetrës e së resë, e nënvizimit, me mjete më të pasura, më të shumta, të thelbit pozitiv, të bukur, të jetës. Koha jonë socialiste kërkon që poetët të jenë më mendimtarë e më të na-

tyrshëm, duke e bashkuar në një lidhje më të harmonishme njerinë me kohën.

Cilat janë, në përgjithësi, sukseset kryesore të sotme të poezisë? Mendoj se, në radhë të parë, është ajo që u përmend më lart: **rruga drejt një pasqyrimi më të thellë të jetës sonë dhe të njeriut, gjithmonë e shprehur përmes specifikës së poezisë.** Janë arritur disa sinteza të goditura të jetës së sotme, të mendimit të sotëm; poezia është pasuruar me detaje nga jeta. Është arritur në një shkrirje më organike të së përgjithshmes me të veçantën. Poezia qytetare, duke ruajtur tonet e veta madhore, është pasuruar edhe me nuanca të tjera, ku idetë e rëndësishme pleksen me emocionet e poetit, edhe me botën intime. Pa nënçmuar mënyrat dhe llojet e tjera, kjo lidhje organike shpesh e freskon poezinë, e bën më të këndshme e më të afërt dhe dëshmon për zhvillimin e mëtejshëm në rrugën e realizmit socialist. Përveç kësaj, në këtë periudhë, ka një përpjekje për të hyrë, me mjetet e poezisë, më mirë në psikologjinë e njeriut të sotëm, për të krijuar figura lirike dhe për të zbuluar kënde intime të shpirtit, gjë që dëshmon për pasurimin e ndjenjave, për zgjerimin e sferës së poezisë dhe pasqyrimin e jetës në shumanshmërinë e saj.

2

Në gjinitë më të gjata të poezisë ka, natyrisht, disa forma e lloje për të pasqyruar realitetin ose ndjenjat subjektive të njeriut, të lidhur me këtë realitet. Gjatë kësaj periudhe, që marrim në shqyrtim, një vend të konsiderueshëm ka zënë poema liriko-epike ose lirike (por më rrallë e gjejmë këtë lloj të veçuar). E kam fjalën më tepër për atë poemë që nuk ka një subjekt të caktuar, në kuptimin që i japin teorikisht subjektit, për poemën që, ndofta, mund ta quajmë poemë-sintezë, e cila lidh faktet, detajet me mendimin, e shkrin materialin konkret të jetës objektive me ndjenjat e poetit, i lidh në një mënyrë më të lirë faktet sipas idesë krye-

sore, duke ja nënshtuar gjithshka një kompozicioni që nisët nga mendimi themelor. Në këtë kuptim flasim këtu për poemat-sintezë, pa dashur të kufizojmë aftësinë sintetike të poezisë vetëm me këtë lloj, sepse, në tërësi, poezia, edhe nëpërmjet disa analizave, karaktereve — aq sa i përshtaten natyrës së saj — ka për detyrë, siç dihet, të arrijë në disa përgjithësime, në sintezë.

Për këto poema jo tregimtare, në plenumin e vitit 1959, kushtuar problemeve të poezisë, Andrea Varfi thoshte atëhere në referatin e tij se nuk janë zhvilluar sa duhet, se kjo është një formë e përshtatshme për kohën dhe se duhet shkruar edhe në këtë mënyrë. Kishite një periudhë kur poema tregimtare përdorej më shumë, megjithëse edhe gjatë këtyre viteve janë shkruar disa të tilla. Kjo ndofta lidhet me kohën, me traditat e poezisë sonë epike, me detyrën që shtronin poetët për të krijuar karaktere njerëzorë. Mund të themi se në këto katër-pesë vjet poema-sintezë është zhvilluar më tepër dhe ka pasur rezultate më të mira. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se edhe në poemat tregimtare s'kemi pasur disa suksese, lidhur me konsolidimin e përgjithshëm të realizmit socialist tek ne.

Karakteristike për këtë periudhë ka qenë pasurimi i poezisë me material konkret jetësor dhe me një mendim më të zhvilluar. Poezia jonë, me subjekt ose pa subjekt, qytetare ose intime, ka nevojë të domosdoshme të marrë gjak të ri nga jeta, nga ndërtimet e mëdha, nga veprimtaria dhe ndjenjat e njeriut aktiv të sotëm. Në poemën e tij «Mirë!» Majakovski thoshte:

*Me buzë të shkrumbuar,
thith ujë
nga lumi
që quhet «Fakt».*

Poezia realiste duhet ta kërkojë patjetër detajin konkret, detajin apo faktin e ri, të dijë ta zgjedhë atë dhe ta lidhë organikisht me mendimin poetik, ta vërë në funksion të tij. Në poezinë tonë ne kemi shëmbuj të

shkëlqyer të poemës sintetike ose tregimtare që materialin konkret, tablotë e gjalla të jetës, tablotë e fuqishme ose të thjeshta, por të shprehura me mjeshtëri e me koncizion, i lidhin me mendimin ose me ndjenjën e poetit, që përshkon dhe organizon gjithshka. Le të kujtojmë, p.sh. «Poemën e mjerimit» të Migjenit, e cila na habit gjithmonë me forcën e mendimit të ngjeshur me copëra të vrazhdëta jete. Në poezinë tonë të re unë përmenda «Prishtinën» e Ll. Siliqit apo «Ashtu Myzeqe» të A. Çaçit, të cilat me tema të ndryshme dhe në mënyra krejt të ndryshme, bëjnë përgjithësime të aspekteve të jetës sonë revolucionare. Kështu mund të përmendej edhe cikli i K. Jakovës «Lama», ku jepen detaje të reja, realiste, nga ndryshimet në fshat, duke vizatuar me vërtetësi edhe prapambetjen, varfërinë që nuk mund të shkulej menjëherë.

Gjatë kësaj periudhe ka pasur një tok poemash që japin disa sinteza të goditura të realitetit të sotëm ose nga lufta nacionalçlirimtare, si poemat e Ismail Kadarese «Shënime për brezin tim», «Ëndërr industriale», «Përse mendohen këto male», poema «Ringjallje» e Lllazar Siliqit, «Republikës» dhe «Drashovica» e Fatos Arapit, «Poemë malore» e Dritëro Agollit, «Dhe thonë se paqë ka në botë», «Përsëritje shokëve të mi dhe qytetit tim» të Agim Gjakovës dhe disa të tjera. Në përgjithësi këto vepra janë të frymëzuara, u përgjigjen kërkesave të kohës si për mendimet, për konkretësinë e tyre, ashtu edhe për forcën e ndjenjave, për figurat dhe për vargun, në përgjithësi të realizuar. Këta poetë, siç është e natyrshe, kanë interesat dhe mënyrat e tyre të veçanta: Ismail Kadareja tregon shumë vëmendje, në poemat e tij, për kohën, për ndryshimet e saj, për psikologjinë e brezit të ri, për jetën në lëvizje, për forcën e atdheut dhe botën intime të lidhur me detyrat qytetare. Lllazar Siliqi, me tone madhore e me intonacione më të larta, duke ecur në rrugën e vet dhe duke u pasuruar me mjete artistike, kap më shumë anët heroike të jetës, të sotmen të lidhur me traditat si edhe frymën e re revolucionare të shekullit tonë. Fatos Arapi, që në këto

vite debutoi me librin e tij të parë, ka një prirje për të kapur me mjeshtëri disa anë kontradiktore të jetës, për të pohuar me optimizëm forcën e Republikës ose për të dhënë dhimbjen e luftës, pa rënë në melankoli, po duke u frymëzuar nga idetë revolucionare. Një ton më lirik, si në një bisedë me vetveten, me detaje të shumta e hera-herës me humor, ka Dritëro Agolli në vargjet e tij. Poeti i ri kosovar Agim Gjakova shquhet për një vrull të brendshëm, për realizmin me të cilin përshkruan jetën e rëndë të Kosovës dhe për ndjenjat e ngrohta të dashurisë për popullin dhe të urrejtjes për armiqtë titistë.

Forcës së atdheut, gatishmërisë së popullit për të mbrojtur fitoret e arritura, udhëheqjes së partisë u këndohet në këto poema si në shumë lirika të poetëve të tjerë.

Duke folur për lidhjen e ngushtë të poetit me shoqërinë, me vargje të frymëzuara e me një përfytyrim të pasur, I. Qadareja e mbylli kështu poemën e tij «Shënime për brezin tim»:

*Dhe, po ta lypte Shqipëria,
Unë këto vargje
Si metal do t'i shkrija,
Binarët prej tyre do të krijoja,
Me rima,
Si me vidha t'i montoja.*

*Dhe më i lumtur në botë
Do t'isha unë
Sikur vargjet-binarë
Të mbarthin trena mbi shpinë,
Trena që bukë punëtorëve t'u shpinin,
Që, nga bot' e madhe,
Miq të na sillnin udhëtarë
Dhe që n'alarme drejt kufive
Të çonin në mesnatë ushtarë.*

Në poemën «Ringjallje» të Ll. Siliqit lidhen disa episode, përshtypje dhe mendime të autorit, që tregojnë forcën e atdheut dhe të komunizmit në botë. Me varg të shkathët e energjik flet ai për shekullin tonë:

Mendoj
t'parin agim
të njerëzimit
dhe këtë agim të ri
të shekullit t'njizetë!
Se ç'andërr profetike
o vigaj,
që malin
vutë mbi mal
n'atë kohë të lashtë,
Zeusin me e flakëru
prej qiellit jashtë;
Ç'ka ju dishruet, vigaj,
sot un' e baj!
Jam Unë,
jam Unë,
jam i Njizeti shekull!
Rrëzoj tiranët,
zhduk çdo shfrytëzim!
S'besoj unë perëndi,
as dreq,
as mrekull, —
në pafundsi
Unë sulem fluturim.

Me ndjenjë, me figura shprehëse u këndon Fatos Arapi partizanëve të rinj njëzetvjeçarë që dhanë jetën në luftën e Drashovicës:

Çfarë? Popujt e vegjël?
Popujt janë liri,
janë stuhi lirie.
Dhe liritë kanë
gjak — një oqean.

Nëpër gjak lirie...
Mbyten armiqt' tanë
Netëve mbi ne — vetëm një grusht yje,
Korbë Drashovicë,
Shamizeza lidhur, labja Drashovicë.

Në «Poemën malore» të D. Agollit kuptohet drejt lidhja e traditës me të sotmen, dhe poeti mundohet ta shohë fshatin, të cilin e ndjen me të gjitha nuancat, të ndryshuar edhe më shumë akoma, sipas kohës sonë, sipas ligjeve të socializmit.

Në cilin kapitull,
në cilën faqe
Homeri ka folur për ju?
Janë po ato gryka,
po ato caqe,
Veç era ka ndëruar këtu.
Një fill elektrik kalon mbi borigë
Dhe dy shkëmbinj të fjetur shkund,
Në lumë shpatullat ka vënë një digë,
Nj'ushtimë turbine në zgavra humb.

Me emocion, herë të përmbajtur e herë më të hapur, me ndjenjat që jepen në lëvizjen e tyre, flet A. Gjakova në poemën e tij:

Asht vjeshtë, Kosovë,
Dimni ka me hy tufane tue përdredhë
E ngjyrat kanë me ndërrue,
E atje
Këto vargje era ka me i hjedhë.
E fillova kështu këte vjershë,
Po ju lajmëroj ma parë,
Se shpirti m'asht ba vjeshtë.
Në doni, mos i lexoni këto vargje,
Me mundë
Nji stuhi kisha shkruet me një rrjesht,
E kisha zbrazë të gjitha këto ngjyra,

E e kisha shkundë deri në rrajë
 Nga mbrenda nji tërmet me nxjerrë,
 Të fortë,
 Me përmbysë këte jetë skaj më skaj,
 Që mandej të vijë në këto anë
 Nji pranverë.

Citova këto vargje nga disa prej poemave më të mira e më të frymëzuara që janë shkruar këta vjet për të rikrijuar sadopak atmosferën poetike që kanë dhënë këta autorë e për të ilustruar mendimin. Po, doemos, vargje të frymëzuara me këto ide mund të përmendeshin edhe nga poetë të tjerë.

Poema «Ëndërr industriale» e I. Kadaresë, me disa kontraste e ngjyra të forta, jep bukur realitetin tonë socialist dhe ëndërrën romantike të poetit, për të cilin industrializimi i vendit, ndryshimi në ndërgjegjen e njerëzve përbën objekt të vërtetë poezie. Kundër mentalitetit mesjetar, që të ndrydh në vetvete, kundër mbeturinave feudale në jetë e në ndërgjegje, ai vë përballë qytetin e përfytyruar industrial, ku do të shkëlqejë morali i proletarëve. Edhe në poemën e fundit «Përse mendohen këto male» ka një sintezë të rëndësishme të gjendjes shoqërore të popullit tonë në të kaluarën, duke e parë çështjen nga ana e brendshme, me realizëm, kundër vellos romantike, në kuptimin e një romantizmi që mbulon të vërtetën. Po kryesore për poemën është ideja e forcës së popullit, e heroizmit të tij, e gatishmërisë për të sprapsur çdo armik. Këtë shpirt luftarak populli e ka fituar gjatë historisë, duke u rrahur në përpjekje me armiqtë, për të mbrojtur nderin dhe lirinë. Mendoj se poema do të kishte dalë më e plotë sikur të jepej më mirë personaliteti i popullit, ndërgjegjja patriotike që ai fitonte dalngadalë e që u shfaq në disa momente të historisë gjersa u formua partia, e cila krijoi ndërgjegjen revolucionare të popullit. Nuk është puna për një kërkesë skematike, për t'i dhënë poemës një karakter tjetër historik, po, në formën që ka, ideja mund të dilte më qartë e të plotësohej. Shpirti i popullit përshkruhet

bukur e me forcë poetike, po kjo më tepër me një ton lirik e më ngjan se do të duhej vende-vende mendim më i thelluar, megjithëse poema është, pa dyshim, një nga krijimet më të mira të autorit; ajo dëshmon për pjekurinë e tij, për qartësi më të madhe të vargut e për një lidhje më të mirë kompozicionale.

Ndër krijimet e parealizuara të I. Kadaresë vitet e fundit, më duket «Poema e blinduar», e cila ka një ide të drejtë e të fuqishme, idenë e madhështisë së kohës, e rrugës së vështirë dhe luftarake që bëjmë drejt komunizmit. Po ideja nuk çohet gjer në fund, disa fragmente duken si copëra nga poemat e tjera të autorit, ka figura të paqarta, të pagjetura, një prirje të tepëruar pas figurave që e rëndojnë poemën. Me gjithë idenë dhe pasazhet e bukura, poema mbetet abstrakte, fragmentare dhe nuk krijon dot një tërësi artistike.

Llazar Siliqi në «Ringjallje» e në vjersha të tjera të gjata tregon seriozitet pune dhe, siç thashë, ka pasuruar mjetet artistike. Po mendoj se vrejttja që bënte R. Brahimi në artikullin e botuar në «Drita», «Shënime për poezinë» se shpesh autorit i mungojnë përshtypje më të gjalla, të drejtpërdrejta nga jeta, në përgjithësi, është me vend. Unë nuk e kuptoj vrejttjen se ai duhet të bëhet tashti një detajist, të ndërrojë stil, etj. Ai e ka pasuruar sferën e interesave të tij gjatë kësaj periudhe dhe ka kapur me sukses edhe tema shoqërore. Po disa herë, kjo ngjet edhe te «Ringjallja», që është një vepër e frymëzuar. Ndonëse nuk mungon mendimi, në këtë poemë ky mbetet pak në sipërfaqe dhe, veç asaj, ka më tepër se ç'duhet thirrje, drejtime vargut, gjë që e rëndon poezinë dhe e ngarkon me fjalë. Do të ishte, ndofta, vrejttje e padrejtë që në një poemë-himn, siç e quan autori «Ringjalljen», të kërkonim anë negative të shoqërisë. Kjo mund të krijonte mungesë uniteti në stil. Po megjithatë mendoj se në këtë poemë autori mund ta shihte më tepër jetën në transformim, në lëvizje, duke kapur përsëri tablo të asaj që është e re dhe heroike dhe që do të plotësonte më mirë idenë e ringjalljes së atdheut. Në ndonjë vjershë të gjatë si,

p.sh., «Këngë entuziaste» nuk gjejmë sa duhet përshtypje dhe mendime të reja, na duket sikur i kemi lexuar edhe herë tjetër dhe nuk na ngjallin atë dinamizëm shpirtëror që ndjejmë nga krijimet më të mira të Ll. Siliqit.

Kështu mund të bëheshin vretjtje edhe për autorët e tjerë të poemave-sintezë. Vetë lloji i kësaj poeme të lejon të jesh i shkathët, të bësh fluturime të lira dhe të japësh pamje nga më të ndryshmet. Po kjo mënyrë të shkruari mund të paraqesë edhe të keqen e fragmentarizmit që vihet re nganjëherë te F. Arapi, të lidhjeve të dobëta kompozicionale, me pjesë të zgjatura, pa pasur nevojë organike, siç ndodh, p.sh., te «Shënime për brezin tim» të I. Kadaresë, etj.

3.

Problemi i realizmit në poezi, i përforcimit të metodës së realizmit socialist, nuk mund të merret shkëputur nga gjithë letërsia dhe artet tona. Prirja është po ajo — sa më tepër lidhje me jetën, të interpretuar thellë e me emocion, sa më shumë ngjyra të gjalla. Dhe, duke filluar që nga poemat, te lirika qytetare e gjer te vargjet me karakter intim, realizmi në poezi po gjen e duhet të gjejë edhe më tepër pasqyrim. Nganjëherë mund të duket sikur poezia, me ndjenjat dhe sfumaturat e saj të holla, me karakterin subjektiv të lirikës, me pejsazhet etj., nuk lidhet aq drejtpërdrejt me kërkesat e realizmit. Kjo nuk mund të jetë e vërtetë, po të kemi parasysh se problemi duhet shikuar gjerë në plan estetik dhe se realizmi në poezi duhet të kuptohet me kërkesat dhe veçorinë e saj dhe jo ndryshe. Mendoj se në periudhën e sotme të zhvillimit të poezisë, kjo kërkesë lidhet me konceptimin e jetës në lëvizje, në transformim, me futjen më thellë në proceset e jetës, me pohimin e fuqishëm me plot gojën të realitetit, duke e bërë këtë jo me stil emfatik dhe retorik, po me thellësi më të madhe mendimi dhe me një paraqitje më konkrete të jetës. Pohim i realitetit, në radhë të parë, do të thotë mbrojtje dhe

nënvizim i anëve pozitive. Por, veç asaj, pohim i realitetit socialist do të thotë edhe të ngrihesh kundër fenomeneve negative dhe t'i goditësh ato me forcë poetike në emër të ideve të socializmit. Po të nisesh nga jeta dhe nga konceptimi dialektik-materialist, do të krijosh art të vërtetë.

Po le të bëjmë menjëherë një rezervë dhe të themi se nuk mund të jenë të drejta kërkesat, sipas të cilave realizmi kërkon edhe në poezi thujse po ato që kërkon në prozë e dramë: konflikt të thelluar, ndeshje karakteresh, luftë të kundërtave thujse në çdo vjershë, etj. Këtu kemi të bëjmë me një konfondim të gjinive, me kërkesa që nuk lindin objektivisht. Kjo do ta largonte poezinë nga specifika e saj dhe shpesh do të prishte atë përshtypje të harmonishme të së tërës poetike. Poezia është gjithmonë më sintetike se proza; ajo kap kulmet e jetës, mendimin e ngjeshur e të figurshëm emocional, apo tablotë konçize epike. Në poezi shpesh janë më të theksuara notat romantike, po të lëmë mënjanë rastet kur zotëron kjo romantikë dhe përcakton stilin e veprës.

Realizmi në poezi lidhet edhe me konkretësinë e figurave, me një shprehje më të pasur dhe më të materializuar të botës subjektive (në lirikë).

Kështu pra: realizëm në specifikën e poezisë. Ky problem më duket se duhet diskutuar, pasi ndodhin keqkuptime.

Realizmi, si një kërkesë e kohës, përveç në poemat-sintezë që përmendëm më lart, është shprehur edhe në disa poema, ku krijohet një figurë lirike e vetë poetit që përfaqëson një tip të caktuar, të pasqyruar në momente poetike, ose ku jepet portreti poetik i një bashkëkohësi aktiv. Kjo shfaqje shpesh tregon edhe thellimin psikologjik të poezisë, pasurimin në detaje. Kam parasysh, p.sh., poemën e D. Agollit «Devoll, Devoll!» që u prit aq mirë nga lexuesit e që është një thirrje e sinqertë, e natyrshme dhe e ndjeshme e dashurisë për vendin, për baltën ku ke lindur, një thirrje për të qenë qytetar dhe komunist, sepse komunizmi përbën thelbin e karakterit të poetit. Edhe në poemën tjetër të D.

Agollit «Dhjetë sy» janë krijuar me ngrohtësi figura lirike të kufitarëve.

Notat e realizmit janë ndjerë edhe në disa poema tregimtare, të shkruara gjatë kësaj periudhe. Këto kanë pasur më shumë karakter epik, po janë shkruar edhe poema tregimtare të llojit lirik-psikologjik, gjë që ka lindur gjithashtu si një kërkesë e kohës, e nevojës për trajtimin e temave shoqërore dhe morale. Poema të tilla tregimtare janë «Qiriu i fundit» i K. Jakovës, «Këngë e re për dashurinë e vjetër» e D. Siliqit, «Proletarët» e L. Qafëzezit, «Mjeku i rojes» e M. Gurakuqit, etj.

Në qoftë se gjatë kësaj periudhe është zhvilluar më me sukses poema-sintezë, siç e thashë edhe më parë, kjo s'do të thotë se nuk ka bërë rrugën e vet — e nuk do ta bëjë edhe në të ardhmen — poema me subjekt. Ne nuk duam të bëjmë asnjë profeci për të ardhmen, po, duke u nisur nga përvoja poetike e gjertanishme, mund të themi se të dyja mënyrat janë të përshtatshme kur shërbejnë për zbulimin poetik të realitetit ose të un-it të poetit, që përfaqëson shoqërinë.

Një gjë është e rëndësishme: narracioni në poezi nuk mund të jetë i ngjajshëm me narracionin në prozë. «Proletarët» e L. Qafëzezit, me gjithë meritat në rikrijimin e atmosferës së luftës e në dhënjen e disa figurave e pasazheve lirike, mendoj se ka të metën e shtrirjes së subjektit, të mungesës së plotë të një konceptimi poetik të ngjarjes, të nisjes nga disa plane. Poeti, duke i vënë vetes detyrën të jetë realist, nuk duhet të synojë në krijimin e karaktereve me mjetet e prozës, sepse kështu nuk bëjmë tjetër veç se mbetemi në shembujt e një poezie epike të vjetëruar, të një trajtimi empirik të temës, të rënjes në prozaizëm. Në shumë vepra tregimtare me famë botërore, që nuk kanë vetëm vlerë historike, po që na emocionojnë e na pasurojnë shpirtërisht edhe sot, linjat e subjekteve, shpesh, janë më të thjeshta se ato të prozës. Poeti e përdor subjektin për të dhënë në mënyrë lakonike e poetike figurën dhe për të shfaqur ndjenjat, mendimet, filozofinë e tij për kohën, për njerëzit. Le të kujtojmë, p.sh., poemën romantike të

Bajronit «Çajld Haroldin» dhe «Eugjen Onjeginin» e Pushkinit. Po ne kemi më afër veprat tona klasike si «Milosaon» e De Radës, «Andrrën e jetës» të Mjedës, që shquhen për sintezë, për ndjenjën e jashtëzakonshme të masës. Një konceptim më të përshtatshëm për poezinë tregimtare, duke u nisur nga disa kulme, nga shtjellimi i një momenti kryesor, gjejmë te K. Jakova, sidomos në «Heronjtë e Vigut».

Epika ka rrugën e vet të zhvillimit në poezinë botërore e në poezinë tonë. Vlerat e poezisë epike ne nuk mund t'i hedhim poshtë ose t'i përbuzim pa i studjuar thellë, pa i shikuar në prizmin historik dhe estetik. Me këtë frymë mendoj se duhet t'i shohim poemat tona të një karakteri më të theksuar epik që janë shkruar rreth dhjetë vjet më parë, si «Herojt e Vigut» e Kol Jakovës, «Gjeto Plaku» e M. Gurakuqit, «Komunisti» i L. Qafëzezit, «Gjaku i falun» i V. Balës. Është e qartë se niveli i tyre nuk mund të jetë i barabartë, po ato kanë diçka të përbashkët, shprehin atë shkallë të zhvillimit të realizmit socialist në poezinë tonë që ishte ahëre. Ndonëse ka një të vërtetë, mendimi i R. Brahimit për primitivizmin dhe naivitetin e tyre, ashtu siç është thënë, tingëllon në mënyrë kategorike dhe të njëanshme. Ndofta mund të tregohem subjektiv, por edhe unë nuk kënaqem aq shumë nga ana artistike kur rilexoj sot këto poema. Po, ku më shumë e ku më pak, ndjej në të frymëzim, (sidomos te «Heronjtë e Vigut») ndjej tipparet e kohës, notat burrnore epike dhe ndryshimin në jetë e në shpirtin e njerëzve. Primitivizmi vihet re në mjetet artistike që shpesh imitojnë mënyrën folklorike dhe nuk ngrihen më lart, në një konceptim jo sa duhet plastik dhe realist të figurave.

Poezia epike e kohës sonë, po ta kuptojmë epikën si një mjet për pasqyrimin e jetës objektive, nuk mund të përsërisë një konceptim të vjetëruar me zana e shtojzavalle, me një admirim të papërligjur gjer në fund të çdo gjëje të lashtë, tradicionale, me një karakter deskriptiv dhe, në disa raste, empirik. Epika e kohës sonë duhet të jetë realiste në të kuptuarit e jetës, të ndry-

shimeve që ndodhin, në depërtimin te shpirti i njeriut, te psikologjia e sotme jo më tregime të vargëzuara e pa nerv, po me subjekte që të jenë të ngjeshura me mendim, me filozofinë e poetit, që ta zbulojnë njerinë në anët e veta poetike, që të nisen nga një ide e rëndësishme, së cilës t'i nënshtrohet kompozicioni unik i veprës. Duke u mbështetur në traditat, në folklorin, poetët e sotëm duhet të thonë fjalën e tyre të re dhe jo të kënaqen me mënyrën krejt folklorike të të treguarit.

Më duket, se një nga veçoritë e epikës sonë të sotme është afrimi i saj, ku më shumë e ku më pak, me lirizmin. Kjo veçori ka qënë edhe përpara, por tani bëhet më e qartë dhe më e nevojshme, sepse poeti lidhet gjithmonë më ngushtë me shoqërinë, sepse ndjenjat e tij subjektive shkrihen më mirë me realitetin objektiv.

Evoluimi i poezisë tregimtare ndihet në poemat që përmenda më lart. K. Jakova te «Qiri i fundit» kap një problem shoqëror e psikologjik dhe mundohet të thellohet në të; poema «Këngë e re për dashurinë e vjetër» e D. Siliqit shquhet për lidhjen e ngjarjes me mendim e për frymën lirike; në poemën e tij «Proletarët» L. Qafëzezi jep disa karaktere në kompleksin e vet; te «Mjeku i rojes» M. Gurakuqi hyn në botën shpirtërore të njerëzve.

Po disa poema tregimtare kanë shpesh të meta jo të parëndësishme, të cilat ilustrojnë mendimet e përgjithshme që shfaqë më lart. Në «Qiri i fundit» përqëndrohet shumë vëmendja te plaka dhe, ndonëse zbulohet bota e saj, nuk ndjejmë me forcë poetike kohën, sfondin, ku ndodhin këto ndryshime dhe kjo rrjedh nga që tregimi është i rënduar, poema vende-vende bëhet prozaikë dhe ne nuk e gjejmë sa duhet mendimin e autorit që i kupton këto fenomene nën dritën e së resë. Subjekti, sidomos lidhja e të birit me një vajzë nga familja me të cilën kishin pasur hasmëri, më ngjan i kërkuar dhe si i vënë me dorë. Nuk është puna se autori duhet të jepte figura të plota të të rinjve, — kjo mund të ishte detyrë e një novele, — po koha jonë, ndryshimet që sjell hidrocentrali, kërkonin disa tablo

të goditura poetike të së resë si sfond i temës kryesore të autorit. Të mbeten në mend, p.sh., detaje të varfërisë në fshat, të varrezave, që bashkë me jetën e kaluar, me kujtimet dhe hidhërimin, mbulon liqeni në gjirin e tij, ose detaji i qiriut të fundit, si simbol i jetës patriarkale. Po duhet të kishte më tepër imazhe poetike, pa vargje të tepërta të një narracioni të zbetë.

Përveç atyre që thashë për «Proletarët», vihet re se prirja drejt realizmit nuk shkon gjer në fund. Duke treguar një tip anarkist, që shkëputet nga shokët për arësye sentimentale (miqësi e fëminisë me Lik Sinën, spiun, të cilin ai nuk e di për të tillë), autori nuk i përligj mirë veprimet e personazhit dhe, padashur, kritika ndaj tij shndërrohet në një farë romantizimi të heroit individual, i cili vepron larg shokëve e pastaj edhe në burg mban qëndrim të denjë. Një njeri, që shkëputet aq lehtë nga shokët për sedër të sëmurë, zor se mund të ketë një karakter aq të qëndrueshëm.

Poema «Mjeku i rojes» ka meritat e saj për ato që thashë e për pasqyrimin e njeriut në poezinë e punës, po megjithatë nuk mund të mos përmendim një lloj naiviteti në thurjen e subjektit (thjeshtësia nuk kërkon naivitet), që vihet re në ngushëllimin e menjëhershëm të dhimbjes së mjekut, i cili pati një dështim në dashuri dhe pastaj doemos iu gjend pranë infermierja. Mënyra si është menduar e paraqitur kjo vjen nga një konceptim që nuk është gjer në fund realist. Një farë naiviteti në thurjen e subjektit ka edhe poema e M. Xhaxhiut «Ujëra pranverore», gjysmëlirike, gjysmënarrative, e cila megjithatë ka freskinë e saj dhe një poetizim në përshkrimin e ambienteve të zakonshme.

Jeta jonë jep mundësi të mëdha për zhvillimin e poemës me subjekt, po të mundohemi të përcaktojmë mirë objektin e poezisë, atë material jetësor që përshtatet për artin poetik e po t'i japim atij, me tërë seriozitetin e punës, një mvëshje të vërtetë artistike.

Vjershat me karakter qytetar e politik, vjershat që trajtojnë tema shoqërore, mbi ndryshimet në vendin tonë, zënë një vend të konsiderueshëm në krijimtarinë e këtyre viteve. Lirika qytetare është një lloj tipik për poezinë e realizmit socialist, e cila lind për t'i kënduar revolucionit, për t'i ngritur njerëzit në luftën për çlirim, për t'u zgjuar emocione të forta dhe për të mbajtur gjithmonë gjallë qëndrimin luftarak dhe aktiv ndaj ngjarjeve politike dhe shoqërore.

Lirika qytetare tek ne ka qenë mjaft e zhvilluar dhe ka lojtur rol në mobilizimin e masave. Ajo, në përgjithësi, ka qenë e frymëzuar, po, doemos, ka pasur, ashtu siç ka edhe sot, edhe vargje të përgjithshme e deklarative, vargje që nuk shquhen për krijim origjinal. Vetë lloji është shumë i vështirë dhe i rëndësishëm; trajtimi i mendimit politik që ka brenda diçka emocionante, kërkon forcë, konkretësi dhe vrull poetik jo të sipërfaqshëm e manifestativ.

Natyrisht, edhe këtu stilet janë të shumta; gjithkush e trajton temën në mënyrën e tij. Megjithatë vjersha me karakter të caktuar qytetar nuk janë shkruar sa duhet dhe, mund të themi, se nuk u janë përgjegjur plotësisht nevojave të kohës, problemeve të mëdha dhe të ndërlikuara që dalin çdo ditë, prapë mund të pohojmë individualitetet e ndryshme në këtë fushë, zgjerimin e tyre, dhe një evoluim të vetë llojit të lirikës qytetare. **Ky qëndron në një konkretësi më të madhe, gjë që lidhet me realizmin, në një shkrirje të motiveve, si edhe në një karakter, hera-herës më të theksuar filozofik e meditativ.**

Koha jonë ngre probleme të rëndësishme, ndaj të cilave vendi ynë, i udhëhequr nga partia, mban qëndrimin e tij të vendosur revolucionar. Poetët u janë përgjegjur këtyre kërkesave; vargjet e tyre përshtohen nga fryma revolucionare. Po ata kanë detyra të mëdha që të shkruajnë edhe më shumë e më mirë, duke kryer kështu rolin e tyre fisnik të edukatorit dhe të frymëzo-

njësit të masave. Gjithë temat e rëndësishme të forcës së partisë, të luftës kundër imperializmit, kolonializmit dhe revizionizmit, faktet e shumta që i lexojmë në gazeta, ato që përmbajnë në vetvete momentin estetik apo idetë e mëdha që dalin nga fakte dhe nga botëkuptimi ynë, janë burim frymëzimi për poetët tanë, të cilët janë dhe do të bëhen më shumë akoma tribunë të komunizmit dhe të patriotizmit. **Gjinia që u është përgjegjur më mirë këtyre detyrave, qoftë si ide, qoftë si realizim, gjatë kësaj periudhe kanë qenë poetat, të cilat ngrenë në vetvete probleme politike dhe kanë tingëllim qytetar.**

Lirika jonë qytetare ka traditë të pasur. Në periudha të ndryshme para çlirimit, gjatë luftës e pas çlirimit poetë të brezit më të vjetër kanë shkruar vjersha revolucionare, këngë partizane, vargje kushtuar partisë, vargje për miqësinë, këngë për ndërtuesit e socializmit. Kjo dëshmon për rrugën luftarake të poezisë sonë, për faktin se breza të ndryshëm u janë përgjegjur, me mënyra të ndryshme, kërkesave të kohës, kanë shprehur shpirtin revolucionar të popullit.

Edhe brezi më i ri i poetëve ka sjellë zërin e tij dhe ka ndihmuar në pasurimin e lirikës qytetare me tinguj të rinj e të ndryshëm.

Gjatë kësaj periudhe poetët tanë i kanë kënduar partisë; janë frymëzuar nga ngjarje të rëndësishme ndërkombëtare ose nga aktet heroike dhe nga fundi tragjik i figurave të shquara antiimperialiste. Kështu p.sh., Ll. Siliqi shkruan për Lumumbën duke vazhduar rrugën e tij të njohur dhe me sukses të lirikës qytetare. Vargu është i ndjerë, i fuqishëm dhe i përshtatshëm për temën:

Patris!

Me ty marshojnë të vdekurit e gjallë,

Afrika nanë

të mban ty yll në ballë.

Nana trimnon në varret e dëshmorëve

Vështron i rreptë nga bustet e skulptorëve.

*Me ne ti flet në qetësinë e netëve.
Me pllambën e zezë godet,
buçet,
për luftë thërret në vargjet e poetëve.*

Ll. Siliqi i kap mirë këto tema, sidomos kur mbështetet në çaste konkrete dhe arrin pastaj në përgjithsimin poetik. Po ka raste kur vjershat e tij mbeten të përgjithshme, pak emocionante, dhe me epitete të njohura e të përdorura edhe më parë. Kështu, p.sh., këtë përshtypje të lënë vjersha si «Ma i zjarri hymn», «Në poligonin e qitjes» e ndonjë tjetër.

Ismail Kadareja, me një gjuhë të figurshme, me ndjenjë, flet për shpirtin kryengritës të Afrikës:

*Afrikë, kaçurrelja Afrikë!
Negrit e tu duket sikur lëkurën e natës shqyen
Në mijëra copa të zeza,
Midis tyre e ndanë,
Mbuluan trupat me to,
U sulën nën tufanë.*

Poetët tanë kanë shkruar të frymëzuar nga ndjenja e internacionalizmit proletar.

Vargje të goditura me temë patriotike, të përshkruara nga fryma e partisë dhe të rrjedhshme janë, p.sh. ato të N. Bulkës të «Vlora, Vlora!», të M. Xhaxhiut të «Atë ditë nëndori, të A. Gjakovës të «Grave të Drenicës» dhe «Ngrohtësi», të M. Gurakuqit të «Poetët», të P. Çukës të «Në kasollen e barinjve», të A. Mamaqit të «Unë dhe femënia ime» e shumë të tjera.

Ka raste kur vargjet me tema të përgjithshme nuk kanë origjinalitet, mbeten të zbeta dhe nuk lënë ndonjë përshtypje, ndonëse mendimet janë të drejta. Këtë gjë, p.sh. mund ta thoshim për disa vjersha të M. Gurakuqit si «Ti hovi je i shqipeve krenare», «Për ty, atdhe» si edhe për poemën «Me ballin lart» që mbeten të përgjithshme me disa pohime dhe epitete të shfrytëzuara.

Edhe L. Qafëzezi ka shkruar disa vjersha politike,

me raste të ndryshme, mjaft të dobëta, pa ndonjë mendim të ri.

Aleks Çaçi i ka kushtuar mjaft vjersha miqësisë me Kinën. Hera-herës ndihet në to frymëzimi i vetvetishëm, disa figura të thjeshta që dalin pa mundim dhe mund të kapen me lehtësi. Ai ka botuar gjatë kësaj periudhe edhe një poemth «Mbi krahët e hapësirës», që është një vepër e realizuar, e pasur në ndjenja dhe në sensacione. Po mendoj se është e rëndësishme t'i themi autorit se krahas vargjeve të mira, ka edhe shumë të shkruara pa kujdes, me një gjuhë e ritmikë të varfër, me mendime e detaje të palidhura mirë. Kam përshtypjen se, duke u nisur nga kriteri i thjeshtësisë, shpesh autori nuk i punon sa duhet vargjet.

Vjersha me një karakter të përcaktuar shoqëror kanë shkruar D. Agolli, i cili i kushton vëmendje luftës kundër meskinitetit, kuptimit të ngushtë të jetës, Ll. Siliqi që ngrihet kundër zakoneve dhe paragjykimeve të vjetra si të vjersha «Mjegullinë», M. Vyshka, i cili shquhet për ndjenjën lirike etj.

Poeti Ali Asllani ka krijuar në këtë periudhë vargje me kolorit për ndryshimet në vendin tonë.

F. Arapi ka shkruar vjersha të gjata me karakter qytetar, mediativ e filozofik si «U dola përpara agimeve», «Vargje për Halidën» etj., ku ndihet një mendim i gjallë, ndjenjë revolucionare, botë intime e lidhur me këto ndjenja e mendime, megjithëse jo gjithmonë autori është i qartë sa duhet dhe jo gjithmonë e shpreh gjer në fund mendimin.

Në këto vite edhe poezia satirike ka dhënë kontributin e vet, duke trajtuar temën shoqërore e politike, temën me kuptim moral dhe etik. Spiro Çomora dallohet për mprehtësinë e vargut, për shprehjen konçize të mendimit dhe për saktësinë e detajit. Tonin Miloti në vëllimin e tij ka sjellë një tematikë të pasur, ka humor të këndshëm dhe varg të punuar me kujdes. D. Bubani është i rrjedhshëm dhe i ka goditur sidomos disa vjersha me tema nga jeta dhe njerëzit e artit apo me tema morale. A. Banushi ka krijuar portrete satirike si edhe disa

vargje që shquhen për humor. Natyrisht, për këtë lloj kaq të rëndësishëm të poezisë sonë duhet të flitej gjatë e të trajtohej veçanërisht, për vetë specifikën e satirës e për nevojat që kemi. Mund të them vetëm se nga leximi i veprave tona satirike më ra në sy, krahas vargjeve të realizuara, edhe një mungesë e zbulimit të komikes. Nuk kuptohet sepse mund të quhen satirike disa vjersha dhe ka raste kur kontradikta midis asaj që duket, që shtiret dhe që është me të vërtetë, gjë që përbën bazën e komikes, nuk zbërthehet si duhet. Gjithashtu më ra në sy se ka raste kur ideja është shumë e vogël dhe e parëndësishme ose se temat shoqërore kanë një diapazon të kufizuar dhe nuk përfshijnë aq shumë çaste esenciale të jetës sonë. Përveç këtyre, ndodh që detajet nuk janë të mprehta e të holla, po gjërat thuhën shumë aqik, hera-herës në mënyrë pak vulgare. Megjithatë, duke u mbështetur tek ata të paktë poetë satirikë që shkruajnë vazhdimisht dhe të tjerë që mund t'u shtohen, ne duhet të shpresojmë në një zhvillim më të madh të kësaj poezie kaq të vështirë, që kërkon aftësi të veçantë për të kapur komiken në jetë dhe trajtim shumë serioz me mjetet e veta artistike.

5.

Llojet e ndryshme të lirikave nuk i gjen në formën e tyre «të kulluar» dhe kjo është e natyrshme: gërshe-tohen fenomenet e jetës, shtohen lidhiet e tyre. Po megjithatë ka disa tipare që mund t'i dallojmë nga njeri-tjetri dhe që na ndihmojnë për të kuptuar domethënjen e një vepre apo profilin e një poeti.

Lirika intime, lirika që i kushtohet ndjenjës së dashurisë, pejzazhit etj. është zhvilluar mjaft tek ne, si-domos duke filluar nga një periudhë e caktuar, kur u bë më i qartë personaliteti i njeriut të ri me shpirtin luftarak dhe me ndjenjat e holla. Ishte një kohë kur po-thua se nuk shkruhej për dashurinë, sepse kishim probleme të tjera. Pasurimi i poezisë me lirikën intime tregon

pra përparim, zgjerimin e sferës poetike, aftësinë e artit poetik për të edukuar njerëzit në mënyrë të gjithanshme dhe të harmonishme. Dhe kjo lirikë është gjithashtu një lloj shumë i vështirë, të cilin, disa herë, të rinjtë e marrin pak lehtë dhe kështu nuk ja arrijnë dot qëllimit.

Nga eksperiencia dimë se të paktë janë ata poetë që merren vetëm me lirikën intime. Zakonisht, përdorin lloje të ndryshme, dalin në tema të mëdha shoqërore. Duke qëndruar lirikë, mundohen t'i kalojnë kufitë e intimes, po, sigurisht, mbeten edhe të tillë që shquhen më tepër në këtë fushë.

Ne kemi vjersha të bukura për dashurinë, për natyrën, vjersha që shprehin ndjenja delikate dhe lëvizje shpirtërore. Kemi vjersha që japin me ngjyra të holla pejsazhin, që u largohen shablloneve libeske dhe që e marrin frymëzimin nga jeta jonë, nga natyra shqiptare.

Si të tillë mund të numërojmë disa poetë, po, në radhë të parë unë do të përmendja Dhori Qiriazin, një poet i ëmbël, me ndjenjë pak të përmbajtur e me gjuhë të bukur. Ai ka krijuar disa vjersha, ku vizatohet me mjeshtëri natyra dhe ku poeti me finesë shpreh vetveten. Dhe përpara nesh del një poet i lidhur me jetën e fshatit, me ngjyra dhe me meloditë e tij.

*Unë erdha në fshat të këndoj,
si një lule e hershme me gonxhe,
erdha unë këtu të dëgjoj
fërshëllimën e kosës në jonxhe.*

.....
*Sa kujtime të heshtura ke,
Fshati im plot rrugë dhe qoshe,
që fëmijë frymëzimin më dhe
si një tufë me lule baloshe.*

Ai mund të ecë përpara në këtë rrugë, duke u pasuruar me material të ri nga jeta, duke e lidhur botën e tij shpirtërore me realitetin e transformuar, me përshlyetje të tjera të reja dhe origjinale.

Vargje të punuara lirike për natyrën dhe dashurinë ka edhe M. Xhaxhiu. Po në disa vjersha të tij konceptimi është i ngushtë dhe të kujton një romantizëm të kaluar, si, p.sh., kur thotë «pres të vijë nata që të të shoh në ëndërr».

Botëkuptimi nga i cili nisen poetët tanë kur trajtojnë temën e dashurisë e të martesës, në tërësi, është i drejtë, po ka pasur raste, siç është thënë disa herë në kritikën tonë, kur janë vënë re pozita të papërcaktuara mirë, të lëkundura ose edhe të padrejta.

I. Kadareja ka shkruar lirika intime shumë të bukura, të cilat tashmë janë pranuar nga të gjithë, por me të drejtë ne e kemi kritikuar atë për disa mendime të përcipta e për një thjeshtësim të problemit të moralit. Kjo ka ndodhur më tepër për arësye të një kuptimi pak të njëanshëm e të thjeshtësuar të dashurisë. Duke u nisur nga ideja e drejtë se koha jonë ka kërkesa të tjera, se dashuria e sotme nuk mund të jetë si dashuria mesjetare, me psherëtima, me betime e me hakmarrje (kjo ide është shumë e rëndësishme), ai më ndonjë rast, kalon në anën tjetër dhe vjen te katër numurat e telefonit si i vetmi kujtim nga e dashura, etj., harron se nuk e shpreh si duhet ndjenjën e madhe dhe tronditëse të dashurisë, pavarësisht nga ndryshimet rrënjësore të botëkuptimit të njerëzve. Po kjo, si duket, ka qenë për të një fazë kalimtare. Një vrejtitje e tillë për thjeshtësim të ndjenjës mund t'i bëhet edhe poemës «Dashuri dhe ferrobeton» të D. Agollit, i cili gjithashtu na ka dhënë lirika të bukura me karakter intim.

F. Arapi, M. Gurakuqi e poetë të tjerë kanë shkruar vargje për dashurinë, ku problemi konceptohet drejt dhe dashuria merret si një mjet për t'u lidhur dhe jo për t'u ndarë nga bota. Vargje të këndshme për dashurinë, për natyrën ka shkruar edhe M. Vyshka, Sh. Karadaku (një i ri i talentuar, me aftësi për të përceptuar poetikisht botën, po që nuk e gjen gjithmonë shprehjen dhe qartësinë e plotë).

Është shtruar problemi i të rinjve që disa herë nisen nga një botëkuptim i ngushtë në konceptimin e

dashurisë, të miqësisë, të martesës. Ky problem është real dhe disa poetë të rinj, megjithëse kanë vjersha të bukura e të ndjera për dashurinë, duhet të mundohen të dalin nga ajo botë e mbyllur dhe minore që i kap nganjëherë. Ata duhet të përpiqen të zgjerojnë horizontin, të formojnë më mirë botëkuptimin, sepse kjo u duhet për t'u dhënë përmbajtje dhe kuptim më të madh vjershëve të tyre. Në qoftë se ne i drejtohem një vajze dhe i themi: «të kam sjellë lule, po në daç merri; po s'i more ti, unë do t'i shkel me këmbë», — natyrisht, padashur, ne nuk tregojmë tjetër veçse një shfaqje egoizmi. Ose, po të ngushullohem me mendimin se ajo vërtet është martuar, po netve do të lagë jastëkun duke qarë për mua, natyrisht ne prapë kënaqim sedrën tonë. Gjithashtu kur «fikim mallin e vajzës që duam me flokët e një tjetre» (M. Vyshka) kjo s'mund të jetë një ndjenjë e vërtetë dashurie dhe ka në vetvete diçka mikroborgjeze. Gjejmë te ndonjë poet i ri një shprehje të romantizmit të kaluar, kur njeriu mbyllet në vetvete. Kjo vjen nga ndikimi i librave dhe nga botëkuptimi i paformuar. Detyrë e kritikës, e diskutimeve tona krijuese, është të vënë në dukje, me taktin e nevojshëm, këto të meta dhe të ndihmojnë në zgjerimin e horizontit të talenteve të reja.

Këtu nuk u fol në mënyrë të posaçme për të rinjtë, (siç dihet, për ta bëhen mbledhje të veçanta), po, me gjithë të metat, vështirësitë që u dalin, mungesën e formimit, ka midis tyre shenja talentesh që patjetër do të zhvillohen; ndihet tek ata një përpjekje për të gjetur tema të reja, me rëndësi shoqërore, për ta shikuar realitetin me syrin e tyre, me ato nuanca të reja që sjell çdo brez i ri poetësh. Disa prej tyre kanë një përfytyrim të pasur poetik dhe, me një punë serioze, ata duhet t'i sjellin në të ardhmen, ashtu si gjithmonë, nota të tjera, të freskëta poezisë sonë, që gjithnjë përtërihet.

Çështja e formës, e mjeshtërisë së poetëve tanë është një temë më vete, që do të kërkonte trajtim të veçantë dhe të hollësishëm. Duke folur për gjinitë kryesore në raport me kërkesat e kohës, nëpër të, përmenda edhe disa probleme të formës, sepse ato dalin përpara të lidhura me brendinë, me vlerën konkrete të veprave. Do të mundohem të shfaq shkurtimisht disa mendime që, ndofta, mund të ndihmojnë në hapjen e diskutimeve.

Gjatë kësaj kohe bie në sy pasurimi i mjeteve artistike të poetëve tanë më të mirë, një përpjekje e përgjithshme për larmi ritmike dhe figurative. Poetët janë mbështetur në traditat tona e, ndofta, në radhë të parë, kanë pasur si nxitje Migjenin, pa lënë mënjanë klasikët tanë të tjerë dhe burime folklorike, si edhe në traditat e poezisë së re botërore. Nevoja e konkretizimit të mendimeve me figura të reja, e zbulimit të krahasimeve, e raporteve midis të veçantës dhe të përgjithshmes, e simboleve që shprehin një ide të rëndësishme e detajeve që rikrijojnë atmosferën e gjallë të jetës, — lind nga domosdoshmëria e pasqyrit të realitetit në ngjyrat e tij të shumta, nga dëshira për të pasuruar intonacionet për të ndjerë në poezi sa më bukur, sa më poetikisht kohën dhe njeriun tonë. Prandaj, zhvillimi i formës është i domosdoshëm dhe mjetet janë të shumta e të ndryshme. Po, siç dihet, forma e vjetër, e vendosur prej kohësh, ndonëse pëson evoluimin e vet të brendshëm, mund të përdoret fare bukur për të dhënë përmbajtjen e re, mendimet e reja. Ky raport i formës me përmbajtjen është i pranuar teorikisht në tërësi e, në mënyrë të veçantë, për artin. Prandaj, në përgjithësi, ka vargje të mira ose të dobëta, të ndjera ose të zbata, ka konceptim të ri ose anakronik që shprehet në këto vargje. Megjithatë duhet pasur parasysh se ka gjini që në një kohë të caktuar humbasin rëndësinë e tyre; ka forma që bëhen më të përshtatshme për të shprehur brendinë. Ky problem, pra, është kompleks dhe nuk mund të thjeshtësohet.

Duke e kuptuar formën në një mënyrë të gjerë dhe të drejtë, çdo poet i mirë në rrugën e tij, në mënyrën që i shkon më tepër, bën përpjekje për të pasuruar mjetet, gjë që lidhet me zgjedhjen e fjalës, të figurës, të ritmeve e rimave, etj. As pozitat konservatore mbi formën nuk janë të drejta, as pozitat pseudonovatore, sipas të cilave mund të shkruhet vetëm në disa mënyra të caktuara, nuk i përgjigjet së vërtetës. Koha jonë kërkon forma të ndryshme po nuk duron dot shprehjet sentimentale, figurat tipike për një romantizëm të kaluar, prapambetjen folklorizante, pompozitetin dhe mënyrën klasikegjante që ngrin dhe kthen në pamje, statujash të ftohta gjërat e gjalla e plot lëvizje; ajo nuk duron as eksperimentet e papërligjura formale, që nuk nisen nga një ide e rëndësishme. Dhe kjo jo vetëm për poezinë, po për të gjitha llojet e arteve tona dhe ka të bëjë drejtpërsëdrejti me forcimin e realizmit, tipar i domosdoshëm i artit tonë të realizmit socialist. Si problemi i rutinës, i prapambetjes në kuptimin më të gjerë të fjalës dhe në kuptimin më të ngushtë, lidhur me punën e çdo poeti, ashtu edhe problemi i pseudonovatorizmit, i ekstravagancave, i tepërimit me figura të panevojshme, i paqartësisë në emër të «thelësisë» — që të dy janë të rëndësishëm dhe na preokupojnë. Po ne duhet të gjejmë gjithmonë atë që është kryesore në lidhjen e fenomeneve. Dhe unë mendoj se tani më kryesore është pikërisht lufta kundër rutinës së vjetër dhe të re, lufta e sigurtë dhe parimore për përparimin e të gjitha forcave tona të shëndosha. Në zhvillimin e tanishëm ne kemi më shumë të drejtë të mos pajtohemi me medio-kritetin.

Përmenda rutinën e vjetër dhe të re, sepse ndodh që edhe disa mjete të reja që zbulon një poet përdoren aq shumë sa bëhen bajate dhe zënë vendin e rutinës së vjetër. Duke pasur kujdes për formën, artisti asnjëherë nuk niset nga forma, po nga frymëzimi, nga materiali konkret, nga mendimi.

Një nga poetët, që gjatë këtyre vjetëve ka pasuruar poezinë tonë të re me mjete të reja figurative, është

pa dyshim Ismail Kadareja, ashtu siç e kanë pasuruar më përpara të tjerë poetë. Llazar Siliqi edhe në periudhën që kemi parasysh, e ka pasuruar poezinë me ritme të reja. Poetë si Dritëro Agolli kanë sjellë pasurimin me detaje konkrete. Kështu mund të përmendeshin edhe poetë të tjerë, siç fola edhe më parë, kur u mora me veprat e tyre të veçanta.

Ajo që thashë për I. Kadarenë dhe D. Agollin për ta është kryesore dhe pozitive, që, në përgjithësi, duhet përsëritur. Por, siç është thënë disa herë në kritikën tonë, ata kanë të metat e tyre përse u takon mjeteve artistike. I. Kadareja, në disa raste, i ka ngarkuar tepër me figura vargjet e tij, sa që ato të duken si qëllim në vetvete; ai ka pasur ekstravaganca dhe paqartësi, nga të cilat ka ardhur duke u çliruar si, p.sh., në poemën «Përse mendohen këto male». Këtë të metë e përmenda jo për të recensuar veprat e I. Kadaresë, po sepse lidhet me problemin e tepërimeve, që në disa të rinj merr përpjesëtime të mëdha. Vargu i lirë i shkon I. Kadaresë, po ka raste prozaimi, raste kur ndihet se rima do ta organizonte vargun, do t'i jepte ngjyrë dhe muzikalitet. Ne kemi disa të rinj të talentuar, që shkruajnë me ndjenjë, po që nuk e përdorin dot mirë vargun e lirë dhe që nuk shquhen për një punë serioze. Të shkruash në këtë lloj nuk do të thotë të bësh prozë, po të krijosh varg me ritëm të brendshëm, origjinal, që shpesh është më i vështirë. Kjo duhet kuptuar mirë dhe duhet dhënë shëmbull, në radhë të parë, nga poetët tanë më të njohur që shkruajnë në këtë mënyrë. Pa hequr dorë nga përkrahja e talenteve të reja, ne që punojmë në redaksitë e organeve letrare, duhet të kemi më shumë kujdes që të këshillohen të rinjtë, të ecin në rrugë të drejtë, të kuptojnë vështirësitë e artit dhe të mos e marrin atë si një gjë të lehtë.

Pjesë prozaike, jo shumë të qarta gjejmë edhe te poetët si A. Gjakova, F. Arapi, të cilët, në përgjithësi, shquhen për varg të ngjeshur me emocion dhe me mendim. Figura të tepëruara, që mund të bëhen qëllim në vetvete ka F. Arapi, p.sh., kur thotë te «Drashovica»

«Brofin gjith' në këmbë ëndrrat partizane» ose «Mirrin gjumë ëndrrat» e në raste të tjera. Nuk do të ishte më mirë të thoshte thjesht: «Brofin gjith' në këmbë partizanët» ose «mirrin gjumë partizanët»? Nuk besoj se bukuria varet nga figurat simboliste ose të paqarta, që nuk kanë pastërtinë dhe llogjikën e tyre.

Edhe përdorimi i detajit nuk duhet të çojë në prozaizëm, në vargje pa ngjyrë e në një shkujdesje për formën, siç ndodh nganjëherë me D. Agollin. Ai shkruan zakonisht me varg të rregullt, me një ritëm të caktuar dhe, kur frymëzimi është i plotë dhe puna serioze, poezia del e bukur dhe emocionante. Prirja për të kapur gjërat e thjeshta, të zakonshme nuk duhet të çojë në thjeshtësim, siç ndodh gjithashtu me disa poetë, më tepër të rinj e të paformuar akoma.

Ka poetë që ecin dhe kërkojnë në rrugën e tyre, duke përpunuar vargun dhe duke e pasuruar me nuanca të reja që u përshtaten. Por nganjëherë vihet re se, duke kërkuar rrugë të reja, disa poetë dalin nga mënyra e stili i tyre dhe hidhen në forma që s'u përshtaten, që nuk janë organike për ta. Me këtë nuk dua të them se ka norma të ngurta dhe s'mund të dalësh prej tyre, po formimi i stilit, konsequenca e rrugës poetike, në vijat e përgjithshme, është e rëndësishme për çdo artist. P.sh., Mark Gurakuqit i shkon vargu i rregullt, me prirje nga detajet konkrete e nga meditacioni. Vargu i lirë që ka përdorur në disa vjersha të vëllimit të tij të fundit, sistemi i figurave në to, më duket se nuk i përshtatet është një largim nga mënyra e tij kryesore. Ai i drejtohet vajzës së dashur, në vjershën «Kangë për ty» dhe i thotë:

*Ti erdhe si reja e ngarkueme me shi,
që sulet të freskojë një tokë të zhuriturun,
erdhe si treni,
që gjallëron
një stacion
të braktisun*

Ose te «Kangë dashunie» për Kubën:

Lule për lulet që ranë,
e kangë përcjellë me kitarë.

Dhe kangët mund të ngrihen në post si bajonetë
e lulet —

raketë.

* * *

Duke folur për çështjet dhe veprat e ndryshme, dalin disa konkluzione mbi zhvillimin e poezisë sonë gjatë kohëve të fundit, të cilat u përmendën edhe në fillim. Po të përmbledhim mendimet, mund të themi se në këtë periudhë poezia jonë ka ecur më tutje në rrugën e realizmit socialist, duke u mbështetur në parimet e kësaj metode dhe duke përpunuar më mirë formën. Suksesi i parë dhe kryesor është lidhja më e ngushtë me jetën, me vijën e partisë, me kohën e sotme në vendin tonë, pasurimi i mendimit, shkrirja më organike e poetit me realitetin. Në poezinë tonë ka hyrë e po hyn më shumë material i gjallë nga jeta; është futur dhe po futet më me forcë njeriu i popullit, qoftë në shprehjen e tij objektive, qoftë në mënyrë subjektive, përmes figurës së natyrshme dhe reale të vetë poetit. Kemi të bëjmë me një proces të rëndësishëm zhvillimi që e gjallëron poezinë, e bën më realiste, më konkrete, sjell freski e ngrohtësi, duke e larguar nga deklarativizmi, nga shprehja vetëm e jashtme e ndjenjave, që, ndonëse më pak, po vihet re akoma tek ne.

Përparimi i poezisë nga pikëpamja e realizmit nuk mund të kuptohet për artin tonë, pa frymën e partisë, pa karakterin revolucionar të poezisë, që përmban në vetvete botëkuptimi socialist. Kur flasim për realizëm, si në poezi ashtu edhe në llojet e gjinitë e tjera të artit, nuk mund të kemi parasysh një nocion abstrakt e të përgjithshëm, po pikërisht realizmin e ri, të lindur në kushtet historike të revolucionit socialist, realizmin që

niset nga jeta dhe nga botëkuptimi marksist-leninist. Po të shprehemi më qartë, mund të themi se, në analizë të fundit, të shkruash sipas realizmit socialist, do të thotë, po të përmendim fjalët e Stalinit, të shkruash të vërtetën dhe e vërteta vetë është socialiste, revolucionare. Çështja është ta studjosh mirë dhe ta kuptosh këtë të vërtetë. Ne e theksojmë çështjen e realizmit edhe sepse në vendin tonë, për arsye që dihen të prapambetjes ekonomike dhe kulturele në të kaluarën, të prapambetjes në konceptimin e jetës dhe të rutinës formale, jemi ndeshur dhe ndeshemi me disa elementë që nuk mund të quhen realiste dhe që pengojnë zhvillimin. Prandaj, lufta për afirmimin gjithnjë më të plotë të realizmit të ri është shumë e rëndësishme për artin tonë dhe një kërkesë e domosdoshme e kohës. Kjo kërkesë, siç mund të kuptohet lehtë, s'do të thotë aspak se përpara nuk ka pasur realizëm dhe se ai po zhvillohet vetëm këto vjetër e fundit.

Në përparimin cilësor të poezisë sonë, në një thellim më të madh brenda fenomeneve dhe shpirtit të njerëzve, ne shohim të realizuara fjalët që thuhën në vendimin e Komitetit Qëndror të 1961-së, vërejmë në praktikë vërtetësinë e tyre dhe kuptojmë mirë se sa drejt e ka përcaktuar partia perspektivën e artit tonë për gjendjen e tanishme dhe të ardhme.

Në poezinë tonë zotëron një frymë e shëndoshë partie, një frymë revolucionare dhe patriotike, te të gjithë poetët, me përjashtime, ndofta, të vogla, ose në rastet e temave intime, të trajtuara ngushtë, cekët, gjë që shkaktohet më tepër nga mungesa e një botëkuptimi të formuar mirë, po edhe nga disa ndjenja mikroborgjeze, që vijnë si rezultat i mbeturinave mikroborgjeze në ndër-gjegjen e njerëzve.

Poezia jonë e këtyre viteve duke vazhduar traditën më të vjetër e më të re, si rezultat i pasurimit të temave, të mendimit dhe të formimit më të qartë të disa personaliteteve poetike, ka pasuruar edhe ritmikën e saj, gjuhën, megjithëse në këtë drejtim duhet punuar gjithmonë e më me ngulm.

Poezia jonë duhet të luftojë, siç thashë, kundër rutinës së vjetër dhe të re. Dhe kjo është rruga normale e zhvillimit të çdo arti, rruga e luftës, e përpjekjeve, e kërkimeve të vazhdueshme.

Konceptimi jo gjer në fund realist i brendisë dhe i formës duhet t'i shqetësojë disa poetë, ashtu sikundër çështja e një qartësie më të madhe në shprehje, e nisjes nga ideja, nga qëllimi kryesor dhe jo nga figura duhet të preokupojë disa të tjerë. Këto momente janë të rëndësishme për përparimin e poezisë, për ta bërë atë me brendi më të thellë, si edhe sa më shumë të masave, që të përvetësohet më shpejt nga lexuesit. Poezia jonë ka qenë në përgjithësi e qartë, e kuptueshme, po akoma duhet luftuar për thjeshtësinë artistike, për t'i shprehur sa më qartë mendimet. Dhe kjo nuk duhet të ketë asgjë të përbashkët me kuptimin vulgar të një qartësie të sipërfaqshme, që nuk u hyn thellë fenomeneve dhe nuk shpreh mendime të rëndësishme gjoja në emër të qartësisë e të thjeshtësisë. Lexuesi sot di të kuptojë dhe të dallojë atë që është e qartë dhe e bukur, nga ajo që nuk të pasuron mendimin dhe nuk ta zgjon fantazinë.

Poezia jonë ka qenë gjithmonë militante. Edhe gjatë këtyre viteve, sidomos mjaft poema, kanë pasur frymë luftarake, mobilizonjëse dhe janë pritur mirë nga lexonjësit. Ka pasur doemos edhe vjersha mjaft të realizuara. Po desha ta theksoj edhe një herë në fund, duke shprehur një kërkesë të vetë jetës, që poetët tanë ta ngrenë zërin gjithnjë më shumë për t'iu përgjegjur temave të ditës, ngjarjeve të rëndësishme politike, parullave luftarake të partisë, detyrave të luftës kundër revizionizmit, pa lënë të depërtojë asnjë element i estetikës borgjeze dhe revizioniste. Zëri i poetëve luftarakë ka qenë dhe është gjithmonë një zë që emocionon dhe mund të emocionojë më shumë akoma njerëzit, në luftën për triumfin e plotë të ideve revolucionare, kundër frymës kapitullante të revizionizmit modern, kundër pseudohumanizmit, që nisët nga ndjenja e një ngushëllimi të rremë të njeriut dhe jo nga dashuria e vërtetë për ata njerëz që e meritojnë dashurinë. Poezia jonë e re,

duke shtuar forcat e veta, ka të gjitha mundësitë t'u përgjigjet më mirë, më shpejt e më një nivel të ngritur artistik detyrave të rëndësishme që shtron partia për artin e realizmit socialist.

Para poetëve del detyra e trajtimit më të gjerë e më me art të jetës së sotme dhe të së kaluarës heroike të popullit, e paraqitjes më të thellë të njeriut me mjetet e poezisë, me gjithë bukurinë e ngjyrave dhe të nuancave që mund të japë poezia; del detyra që poetët t'u përgjigjen më shumë dhe më mirë çështjeve të ndërtimit të socializmit dhe ngjarjeve të mëdha ndërkombëtare, në emër të atdheut, të revolucionit e të komunizmit.

1964

ZHVILLIMI I MËTEJSHËM I POEZISË, FORCIMI I PËRMBAJTJES SË SAJ

Poezia jonë shqipe ka qenë gjithmonë në radhët e para të jetës, fjala e saj e zjarrtë dhe e kumbueshme ka jehuar në tokën tonë si kushtrim e këngë, me vrull optimist, më tingëllim të gjerë epik dhe me ëmbëlsi lirike; kjo fjalë, në shprehjet më të plota dhe më të bukura, ka qenë e thellë dhe e menduar, ka qenë e thjeshtë dhe depërtonjëse, ka hyrë në zemër të njerëzve dhe ka lënë gjurmë të vërteta. Njerëz të thjeshtë të vendit tonë janë rritur me fjalën poetike, me këngën popullore, me vjershat e poetëve tanë më të mëdhenj e më të mirë, që trashëgojnë nga brezi në brez.

Poezia jonë e realizmit socialist ka lojtur dhe po lot një rol të rëndësishëm për edukimin e njerëzve, për të krijuar tek ata një gjendje shpirtërore optimiste dhe revolucionare, për të formuar ndjenjën e së bukurës, për të zbuluar dhe rikrijuar poezinë e jetës sonë, të njeriut të ri që ndërton socializmin, të njeriut me vetija të larta morale. Populli ynë është një popull që priret nga poezia. Ai këndon në punë, në udhëtim, në dasma, kur është me shokë e kur është vetëm. Kënga dhe poezia atij i bëhet shok dhe ja mban zemrën të ngrohtë. Shqiptarët thurin lehtë vargje. Dhe ky popull me shpirt poetik që ka sot në jetën e tij, në punën heroike, më shumë poezi se ndonjëherë tjetër, është i denjë për një art poetik të bukur dhe të thellë, që ta pasqyrojë zemrën popullore në pasurinë e mahnitshme të ndjenjave, që të pasqyrojë veprën e popullit jo përciptazi, po në kuptimin e saj të madh dhe me dinamikën që e përshkon.

Punët që bëhen sot në vendin tonë, vrulli revolucionar që ka përshkuar masat punonjëse, qëndrimi heroik dhe vetëmohonjës i punëtorëve, fshatarëve dhe intelektualëve popullorë janë një burim i pashtershëm për vepra të fuqishme poetike, ku të mos zotërojnë nota të përqara dhe të përrallshme, po zëra të larta që ngrenë peshë njerëzit, që të gjallërojnë dhe entuziazmojnë duke pasuruar ndjenjat dhe mendimin, atë mendim që vjen gjithmonë duke u bërë më i pjekur, më i thelluar dhe prandaj ka të drejtë të kërkojë më shumë letërsi, më shumë vepra që të pasqyrojnë jetën dhe punën e tij në të gjitha aspektet; ka të drejtë të kërkojë përmbajtje të lartë, cilësi gjithnjë më të mirë.

Poezia jonë e re gjatë gjithë zhvillimit të saj ka ndihmuar mjaft në edukimin e njerëzve me frymë partie, me dashuri për atdheun dhe për punën, me ndjenjën e internacionalizmit proletar. Sot jeta jonë po ecën përpara në të gjitha fushat me një ritëm të pandërprerë, jeta del para nesh gjithmonë e më shumë në shfaqjet e veta poetike, të cilat nuk ngjajnë aspak me një bukuri të lustruar, të sipërfaqshme, po me një bukuri të vërtetë, të brendshme, që presupozon lëvizjen, luftën e të kundërtave, epërsinë e vetijave të larta të moralit komunist. Dhe poezia nuk duhet të qëndrojë prapa kësaj jete, po të ecë në radhët e para të revolucionit socialist. Është e domosdoshme që këtë nevojë ta ndjejnë më mirë poetët tanë, të cilët janë thirrur nga shoqëria për ta thënë më shpesh e me zë më të lartë fjalën e tyre.

Krijimtaria poetike e kohëve të fundit, megjithëse jo sa duhet, ka zënë vend në letërsinë tonë dhe ka ndihmuar për të përhapur poetikisht idetë e partisë, për t'i rrënjosur ato në zemrat dhe në mendjet e njerëzve. 25-vjetori i themelimit të partisë ishte një nxitje e madhe për vepra poetike të frymëzuara, me mendim të rëndësishëm, me përmbajtje të shëndoshë dhe me frymë militante që i shërben qëllimit të përgjithshëm, përpjekjeve që bëhen në atdheun tonë, që i shërben vijës së partisë. Poezia e shkruar kohët e fundit u përgjigjet kërkesave të kohës; ajo ka brendi të drejtë ideo-tematike.

Duke ecur në rrugën e zhvillimit të saj, ajo është bërë më komunikuese me masat, më e qartë dhe më e kuptueshme. Përmbajtja ideo-tematike ka ardhur duke u pasuruar, por duhet pranuar se mbetet ende shumë për të bërë; koha ka nxjerrë probleme të përmbajtjes dhe të formës, të cilat lidhen edhe me zhvillimin e vetë poezisë, që pasqyron jetën dhe botën e brendshme të njeriut të sotëm. Në këta dy vjetët e fundit kanë shkruar vepra me vlerë poetike, sidomos disa poema, poetët tanë të njohur. Emra të rinj u janë shtuar atyre. Janë dukur në faqet e shtypit ose kanë ardhur duke u formuar më tepër poetë të rinj, ndër krijimet e të cilëve gjen gjëra të bukura, nota të reja dhe, disa herë, kërkime interesante poetike. Botimeve tona poetike u janë shtuar edhe këngë a vargje popullore, vjersha folkloristike, të cilat dëshmojnë entuziazmin e punonjësve, shpirtin poetik të popullit, dhe shpesh janë të këndshme në gjininë e vetë folklorit. Duke trajtuar ngjarje të kohës, ata rrisin frymën revolucionare të masave në jetë dhe në punë. Në këtë drejtim, mendoj se ne duhet të marrim shembull nga populli.

1

Kongresi V i partisë shtron detyra të rëndësishme për letërsinë dhe artet, pra edhe për poezinë; ai ngre me forcë problemin e pasqyrimit të heronjve të kohës. Poezia e ditëve tona kuptohet me ngjyrat e shumta; edhe në vrazhdësinë e ngjyrave dhe të toneve qëndron e bukura, e cila nuk është gjithmonë e lëmuar dhe e ëmbël. Ngrihet problemi i pasurimit të përmbajtjes, i thellimit në jetë dhe në ide — sepse, për artin, të dyja këto shkojnë bashkë e janë të lidhura. Problemi i përmbajtjes lidhet ngushtë me luftën për pastërti ideologjike në krijimet tona, me luftën kundër çfarëdo ndikimi të ideologjisë dhe estetikës së huaj borgjeze dhe revizioniste. Ngrihet gjithashtu edhe çështja për të mos e kuptuar artin si diçka vulgare dhe skematike, po për të luftuar për një art me ide të thellë dhe formë të lartë siç tha shoku Enver në Kongresin V të partisë. Në unitetin e për-

mbajtjes dhe të formës dihet se përmbajtja është primare se, kur themi kështu, nuk e kuptojmë përmbajtjen vetëm si qëllim, si intencion apo si temë, po si diçka më të thellë që lidhet me qëllimin, me temën dhe sidomos me idenë, e cila ka rëndësi përcaktuese në drejtimin e përmbajtjes. Por marksizmi na mëson t'i lidhim të dyja aspektet dhe të luftojmë për një art të partishëm me formë të bukur.

Duke u nisur nga përcaktimi që i bën partia dhe nga detyrat që ushtron ajo para njerëzve të letërsisë dhe të arteve, do të shohim se në ç'drejtime kryesore zhvillohet përmbajtja e poezisë sonë e kohëve të fundit, ku janë sukseset dhe dobësitë e saj, si edhe çështje që lidhen me formën.

Poezinë tonë e ka preokupuar tema e atdheut, e ndërtimit socialist dhe e transformimit shpirtëror të njerëzve, tema e luftës nacionalçlirimtare, e hovit revolucionar të popullit, të rinisë, e punës së të rinjve nëpër aksione, e bukurisë së vendit tonë dhe e qëndrimit internacionalist të Republikës. Këto tema të rëndësishme herë-herë kanë gjetur shprehje të mirë artistike në vepra poetike, janë mishëruar në përmbajtje dhe në formë, por ka pasur edhe raste kur, me gjithë dëshirën dhe qëllimin e mirë të autorëve, përmbajtja ka qenë e cekët, vjersha, apo poema, ka mbetur e përgjithshme, pa momentin konkret-emocional, ka pasur pak material jetësor ose mendimi ka kaluar shkarazi dhe nuk ka lënë gjurmë.

Poetët tanë më të njohur, ndonëse mund të kishin kontribuar më shumë gjatë kësaj periudhe, kanë ecur në rrugën e përgjithshme poetike të realitetit tonë dhe kanë forcuar karakterin epik të poezisë, duke e lidhur shpeshherë edhe me momente lirike, të domosdoshme për të treguar qëndrimin emocional ndaj fakteve dhe ngjarjeve. Pa u shkëputur nga përvoja përparimtare botërore, poezia jonë është zhvilluar në truallin amtar, me ngjyra kombëtare, ajo flet për njerëz të tokës sonë dhe ka shfrytëzuar mirë edhe gjuhën e folklorin tonë shumë të pasur poetik.

Në poemat e I. Kadaresë, Ll. Siliqit, A. Arapit, S.

Gerës, A. Gjakovës, P. Çukës, F. Krajës, të poetëve të tjerë më të rinj si M. Vyshka, L. Dede, S. Mato, V. Qurku, H. Meçaj, Sh. Karadaku, e mjaft të tjerë, që shkruajnë vazhdimisht në organet e shtypit letrar e në organe të tjera, vihet re një përmbajtje e drejtë, përpjekje për t'u thelluar në fenomene të rëndësishme, në ngjarje, në kuptimin historik dhe filozofik të gjërave, në botën e njeriut të kohës sonë, për të dhënë fytyrën morale të komunistit, apo për të treguar me ndjenjë çaste nga ditët e paharruara të luftës. Te poetët e rinj, që sjellin përvojën dhe zërin e tyre, ndihet preokupacioni i brezit të tyre — patriotizmi i të rinjve, i lidhur me aspekte konkrete të jetës, perceptimi poetik i njeriut (ndonëse shpesh ky perceptim mbetet fragmentar dhe nuk lidhet në një të tërë), apo përfytyrimi i ngrohtë i natyrës shqiptare, që bëhet tek ata një shprehje e patriotizmit. Disa poetë të rinj u përgjigjen më shpejt ngjarjeve aktuale. Shumë vjersha u shkruan për heroizmin e Adem Rekës dhe shpesh kishte në to ndjenjë të thellë.

Në poemat që janë botuar kohët e fundit vihet re prirja për përgjithësime me karakter politik dhe historik, vrehet përpjekja për të shpjeguar fenomene të rëndësishme, si ç'janë kuptimi dhe rrënjët e partisë, detyrat e komunistit, bota e tij e brendshme dhe kalitja e vazhdueshme në kudhrën e zjarrit të partisë. Kjo temë, e trajtuar nga I. Kadareja, nga D. Agolli, A. Gjakova, K. Spahivogli etj. është shumë e gjerë e do të përbëjë edhe në të ardhmen objekt poezie të thellë dhe të frymëzuar. Tani nuk është puna të përsërisim të vërteta që janë thënë shumë herë në poezi, të qëndrojmë në sipërfaqe, apo të bëjmë deklarata të përcipta. Dihet se vetëm gjetja e temës nuk është gjithshka, megjithëse ajo të shtyn drejt anëve të rëndësishme të jetës dhe të orienton drejt një përmbajtje të shëndoshë. Është e domosdoshme të gjenden e të zbulohen raporte të reja të poetit me fenomenin, të dalë qartë kuptimi i gjërave dhe, pa mbetur vetëm në detajime të veçanta që e thyejnë përshtypjen e përgjithshme, të ruhet karakteri konkret i poezisë, të ndihen gjithmonë anë të reja, të freskëta,

të pathëna ndonjëherë të atij fenomeni ose realiteti që duam të përshkruajmë. Dihet se konkretësia presupozon unitetin e mendimit, pathosin që i lidh gjërat në një të vetme dhe krijon emocione të lexuesi.

Poema e I. Kadaresë «Shqiponjat fluturojnë lart», që ka në qendër temën e formimit të partisë, është në përgjithësi një realizim i goditur. Autori mundohet të hyjë në thelbin e gjërave; mendimi marksist atë e ka ndihmuar për të dhënë poetikisht burimin e partisë, karakterin e lavdisë kombëtare në të kaluarën, vlerën e saj dhe kufizimin që përcaktohej nga kushtet historike dhe shoqërore; poeti ka mundur të shprehë thelbin popullor dhe demokratik të partisë, lidhjen e saj me tokën amtare, pastërtinë e radhëve, kujdesin e udhëheqjes që në ndërtesën e partisë të mos hynë elementë të dobët dhe të kalbur si edhe gëzimin që zgjon lajmi i formimit të saj. Këto janë mendime të rëndësishme që përcaktojnë boshtin e poemës dhe që, të shprehura me gjuhë figurative, me elegancë vargu dhe ritmi, arrijnë të na emocionojnë dhe, përgjithësisht, të na kënaqin. Poema ka një përmbajtje të pasur, ndonëse ajo nuk e shteron këtë temë shumë të madhe, dhe përsëri, në të ardhmen, mbetet detyrë e poetëve tanë që të mundohen të japin sin-teza edhe më të rëndësishme, më të gjëra e më konkrete lidhur me këtë temë.

Me gjithë efektin pozitiv që bën kjo poemë, mendoj se ka diçka që i mungon, të duket pak e kërkuar dhe abstrakte. Në fillim, ndofta, nuk di ta shpjegosh se ku qëndron e meta, po pastaj mendimi sikur kthjellohet. Është fjala për një konkretizim jo vetëm figurativ, po edhe jetësor të ideve, për të futur në poemë, duke ruajtur natyrën e saj dhe tiparet e stilit të autorit, disa momente konkrete, nga historia e formimit të partisë ose nga lufta e saj. Kuptohet se kompozicioni përcakton mjaft, po autori ka dhënë momente të bukura të kapërcimit figurativ në të ardhmen (kam parasysh më tepër pasazhin me llambën e vajgurit, me përfytyrimin e ditëve të sotme) dhe mund të ngërthente në subjekt organikisht çaste konkrete edhe për të shkuarën. Kjo do

ta shtonte forcën emocionante të veprës. Dhe kjo kërkonte jo vetëm meditim dhe fantazi, po edhe njohje më të afërme me materialet, me luftën, me njerëzit që e kanë jetuar atë. Këtë problem nuk e shtrojmë vetëm për I. Kadarenë; kjo lidhet me të gjithë shkrimtarët, me detyrat që u shtron atyre partia. Për poezinë tonë është e domosdoshme që mes vargjeve, fjalëve, figurave, të ndihet gjithmonë e më shumë mendimi i thellë, po pa u shkëputur kurrë nga faktet e gjalla, nga njeriu, i cili përbën objektin kryesor të letërsisë. Dhe nuk është puna që të arrijmë në uniformitetin e stileve dhe të gjinive; edhe në një poemë mediative-filosofike, duhet të ndihet midis radhëve njeriu i kohës që del objektivisht apo përmes personalitetit konkret të poetit, që përfaqëson kohën.

Po të marrim një poemë tjetër që ka po këtë temë, poemën «PPSH». të K. Spahivoglit, do të vëmë re përsëri përpjekjet për përgjithësimin historik dhe politik të rrugës së partisë, do të vëjmë pasazhe të vullshme dhe me temperament, po do të shohim gjithashtu edhe karakterin pllakat të saj, do të shohim se mendimi shpesh kalon në sipërfaqe dhe autori disa herë mbetet në një enumeracion prozaik ngjarjesh ose krijon figura të pasigurta.

Tema e partisë, e rrugës së saj, e veprës dhe e luftës që bën ajo sot kundër imperializmit dhe revizionizmit ka preokupuar edhe poetë të tjerë. Kështu A. Gjakova ka shkruar «Poemë bregdetare për partinë», ku gjen momente të goditura dhe një meditacion publicistik të thelluar, po ku nuk arrihet në një unitet dhe ka pasazhe të palidhur; Sh. Karadaku ka shkruar poemën «Dielli», ku gjen freski dhe ndjenjë, po nuk arrihet në një tërësi dhe poema nuk qëndron më vete. Autorit nuk i kanë mjaftuar, si duket, faktet dhe përvoja poetike për të krijuar në këtë gjini epike të rëndësishme. Vargje të mira dhe të sigjerta gjen edhe në «Poemë për diellin» të P. Perlalës.

Prirja për t'u thelluar në karakterin e një komunisti të ditëve tona, të një njeriu të dalë nga populli, për të pasqyruar anë të ndryshme të tij, për të theksuar mendimin se partia, në zjarrin e kritikës dhe me da-

shurinë e një nëne, i rrit dhe i edukon njerëzit, është një shfaqje e drejtë e thellimit në përmbajtje, e mishërimin poetik të detyrave aktuale që shtron partia. Të tilla portrete lirike ka shkruar D. Agolli me «Baladë për komisarin» ose edhe me «Devoll, Devoll» dhe, kur realizohet mirë, kjo është një formë e këndshme që komunikon shpejt me lexuesin.

Portrete poetike me ngjyrë ku më lirike e ku më epike kanë krijuar edhe V. Qurku në poemthin «Pavdekësi», H. Meçaj në «Unë, montatori». Te të dy poetët e rinj ndihet mendimi i kohës dhe fytyra konkrete e njeriut të realitetit tonë. Kur poetët e rinj i hyjnë gjinive më të mëdha dhe mundohen të japin përgjithësim, vihet re frymëzim dhe detaje të bukura, po ndihet disa herë edhe mungesa e materialit, e aftësisë për t'i lidhur gjërat dhe e unitetit ideor që krijon boshtin e poemës dhe pathosin e saj (kjo gjë bie në sy p. sh. në poemën e H. Meçajt që zëmë ngoje, si edhe në raste të tjera). Kjo, natyrisht, nuk duhet t'i dekurarojë ata, po duhet t'i nxitë për të punuar më seriozisht, me pasion e me dashuri, siç e kërkon puna e artistit.

Ndonëse më pak, poetët tanë kanë trajtuar edhe temën e transformimeve shoqërore dhe morale të realitetit tonë. Kjo temë shumë e rëndësishme do të tërheqë gjithmonë e më shumë vëmendjen e poetëve që njihen dhe e të rinjve që po vijnë në radhët e letërsisë. Këtu është puna që të zbulohet poetikisht jeta jonë, që të përshkruhen më shumë aspekte të reja të realitetit; në qindra raste, fenomene të shkëputura, raporte njerëzore, qëndrime të njeriut ndaj punës, ndaj atdheut, ndaj problemeve të mëdha politike dhe shoqërore, ndër një mori faktesh konkrete që në thelbin e tyre dhe në potencë përmbajnë elementin e së bukurës, — duhen qëmtuar, zgjedhur dhe ngritur në art ato që poeti i quan më të afërme, që mund të lidhen në një të tërë dhe të emocionojnë lexuesit. Në shkrimet tona për aktualitetin, për temat e mëdha të kohës, të cilat janë më të denjat për poezinë, nuk duhet të ndihet kurrsesi monotoni, as karakter deklarativ dhe cerebral dhe as të mbetemi

në konstatime të përgjithshme që nuk prekin askënd. E them këtë, sepse, disa herë, vrehet një prirje e tillë dhe nuk kapet realiteti i sotëm në shumanshmërinë e shfaqjeve të veta më të rëndësishme. Një shembëll tipik negativ i tillë më duken tekstet e disa këngëve të festivalit të fundit në radio, të cilat, me monotoninë e tyre dhe me varfërinë e mendimit e të ndijimeve të drejtpërdrejta nga jeta, mund të zgjojnë një ndjenjë antipoe-tike e të dëmtojnë si idenë, ashtu edhe krijimin muzikor. Dobësi të tilla vihen re edhe te disa poezi të botuara në shtypin letrar.

Temat politike aktuale nuk kapen sa duhet nga poetët; ata merren më shumë me gjini të mëdha dhe fare pak me gjini të vogla, me vjersha, me cikle vjershash. Poetë si Dh. Qiriazit, M. Vyshka, S. Gera etj. kanë dhënë një kontribut në shtyp duke rrahur tema të lirikës qytetare dhe kjo ka qenë një gjë e mirë. Tema qytetare poetike është rrahur në lirikë edhe nga disa më të rinj, tek të cilët ndihet ngrohtësi rinore dhe vrull, ndonëse disa herë vargjet e tyre mbeten të përgjithshme, nuk kanë sa duhet qartësi mendimi ose mbizotërojnë në to figura të tepëruara, që bëhen qëllim në vetvete, ose padashur fshehin mungesën e një ideje të vërtetë.

Sot ka rëndësi të madhe që të shkruhet më shumë dhe në mënyrë luftarake për ngjarje të kohës, duke u nisur nga faktet dhe idetë politike e shoqërore, nga orientimi që jep partia. Poezia jonë ka tradita të mira në këtë fushë. Vjershat me temë politike e shoqërore të Ll. Siliqit, Dh. Shuteriqit, A. Çaçit, A. Varfit, L. Qafë-zezit, D. Agollit, I. Kadarese, F. Arapit, V. Zikos e shumë poetëve të tjerë, në periudha të ndryshme kanë lojtur rol në edukimin e masave, në krijimin e atmosferës luftarake për të rritur njerëz me ide të shëndosha, revolucionarë të vërtetë, për të zgjuar ndjenja optimiste. Disa nga këta poetë janë hedhur më shumë në gjini të gjata (dhe kjo është gjë e mirë) ose shkruajnë më rrallë vjersha; ne presim prej tyre dhe prej shumë të tjerëve vjersha që t'i përgjigjen më shpejt kohës dhe të botohen në faqet e shtypit letrar e të shtypit tjetër. Shokët që

kanë përvojë letrare mund të japin ndihmë të madhe për të plotësuar këtë nevojë.

Fjalimi i fundit i shokut Enver Hoxha në mbledhjen e disa organizatave bazë të partisë të kryeqytetit, shtron detyra të rëndësishme që lidhen edhe me krijimtarinë letrare e artistike. Këtej ne nxjerrim edhe detyra për zhvillimin e poezisë, si një gjini luftarake, si një tribunë e fjalës së fuqishme politike e shoqërore. Poezia jonë duhet t'u këndojë masave, energjisë së tyre të pashtershme; ajo ka mundësi të shkrumbojë në zjarrin e kritikës të metat dhe dobësitë në shoqërinë tonë, të luftojë burokratët, të luftojë kundër zakoneve dhe normave të vjetra që lidhen me botëkuptimin feudoborgjez, për mbrojtjen e personalitetit të gruas, ta shohë realitetin në unitetin moralo-politik (gjë që duhet ta bëjë poezia), por gjithmonë në prizmin e luftës së klasave, të luftës për fitoren e së resë. Kjo do ta bëjë poezinë më luftarake, më aktuale dhe do ta ngrrejë vlerën e saj politike dhe shoqërore

Karakterit epik i poezisë sonë është një fenomen që ka lindur nga vetë jeta, nga lufta që bën populli ynë, nga qëndrimi burrëror i Republikës dhe, në anën tjetër, nga vetë rëndësia e madhe shoqërore që merr bota objektive, vepra e popullit, realiteti i ndryshuar, faktet e panumërta reale. Poeti ynë, pa u larguar nga subjekti, nga bota subjektive, nuk mund të mbyllet kurrë në këtë botë të ngushtë, sepse ai nuk bën dhe nuk duhet të bëjë një jetë të kufizuar, individuale, të shkëputur nga njerëzit dhe nga shoqëria. Lidhja me masat, me jetën e gjallë, me madhësinë e gjerësinë e punëve që bëhen tek ne, përcakton edhe karakterin epik të poezisë. Për epizmin e tyre bien në sy dy poema të kohëve të fundit, që kapin tema të ndryshme dhe që janë shkruar në mënyra të ndryshme: poema e Ll. Siliqit «Borizanët» dhe poema «Alarme të përgjakura» e F. Arapit.

«Borizanët» e Ll. Siliqit është një vepër që flet mbi ndryshimet e sotme në ndërgjegjen e njerëzve, mbi luftën që duhet bërë për të qenë gjithmonë gati ndaj thirrjes së borisë, të borizanëve, mbi vrullin e të rinjve dhe

mbi ndonjë aspekt nga kontradiktat morale e shoqërore në gjirin e fshatarësisë. Qëllimi ka qënë për të përfshirë shumë anë të jetës e për t'i lidhur në një mendim militant. Poema, e shkruar me varg të shkathët e të sigurt, me gjuhë të pasur, ka fragmente të bukura dhe është një përpjekje për ta kapur gjerësisht realitetin, duke kapërcyer lirish nga njeri moment te tjetri. Prirja e autorit për t'u thelluar në karakteret që vizaton, si p.sh. kur krijon figurën e brigadierit që sakrifkohet për të mirën e përbashkët, për të dhënë aspekte nga kontradiktat morale të njeriut të sotëm, është një prirje pozitive që lidhet me kërkimet realiste të poezisë e të gjithë letërsisë sonë. Por, megjithatë, duhet thënë se poema vuan mjaft nga fragmentarizmi; qëllimi i autorit për t'i lidhur pjesët dhe aspektet e ndryshme në një unitet ideor dhe kompozicional, nuk përgjigjet gjithmonë dhe disa herë përshtypja thuhet dhe kështu emocioni sikur copëtohet. Prirja e autorit ndaj konkretësisë është pozitive, po si tek ai, ashtu edhe te poetë të tjerë, duhet të ndihet më tepër uniteti i mendimit dhe i ndjenjës, duhet të ndihet më shumë personaliteti i poetit që i lidh gjërat në një bosht të vetëm dhe arrin të krijojë një pathos të vetëm.

Epizmi bie në sy edhe në poemën e F. Arapit «Alarme të përgjakura», e cila është shkruar me ndjenjë dhe, në përgjithësi, përshkohet nga një pathos që e mban të gjallë interesin dhe emocionin e lexuesit. Më të forta në poemë më duken momentet konkrete kur autori flet për vrasjen e komisarit, të Margarita Tutulanit, për luftën e Drashovicës si dhe momente të tjera. Poetin e kanë prekur shumë ato që do të tregojë dhe shpesh arrin t'ja komunikojë edhe lexuesit këtë ndjenjë si edhe mendimin që i ka lindur. Them shpesh, sepse jo gjithmonë vargu i tij është shprehës dhe i rrjedhshëm, megjithëse duhet pohuar që ai ka bërë përparime edhe nga kjo pikëpamje, poema është e qartë, me një qëndrim ideo-emocional të përcaktuar mirë dhe me një ide të rëndësishme që mund ta shprehim kështu: ne fituam me sakrificë; unë do të jepja edhe jetën për idealin tonë; ne

do t'i përgjigjemi gjithmonë thirrjes «para partizanë».

Edhe për poemën e F. Arapit lind problemi që, përveç emocioneve të lira dhe të vetvetishme, megjithë lirinë poetike të zgjedhjes së momenteve dhe ngjarjeve, duhet mendur më tepër për arqitekturën e veprës, për të pasqyruar më plotësisht temën që zgjedh dhe për të qenë edhe më logjik në shtjellimin e subjektit. Poema e F. Arapit p.sh., megjithëse flet për luftën në tërësi dhe bën përgjithësime, nuk kuptohet, sepse ngjarjet konkrete që merr lidhen me një rreth të kufizuar të Shqipërisë; veç asaj poema mund të kishte atë mbyllje të fortë, po para se të arrihej atje, mendoj se duhej dhënë në mënyrë sintetike fitorja mbi armiqtë, që të tregohej fundi i gjithë atyre përpjekjeve dhe sakrificave.

Edhe poema të tjera që u paraqitën në konkurs e që janë botuar kapin tema heroike të jetës ose trajtojnë çështjen e gatishmërisë së qytetarit të republikës për t'i shërbyer thirrjes së partisë, për t'u lidhur me jetën, kapin tema të ndryshme socialiste. Kështu p.sh. kanë shkruar poema ose vjersha dhe kanë kontribuar në trajtimin e këtyre temave A. Çaçi, T. Miloti, Z. Sako, A. Mamaqi dhe ndonjë i ri që shkruan thuajse për herë të parë e që duhet të ndihmohet, si Gjok Becaj etj.

Fola më tepër për poemat sepse më duket që në këtë gjini kemi pasur më shumë sukses kohët e fundit dhe disa probleme mund të sqaroheshin më mirë përmes vlerësimit të tyre. Në vëllime me poezi kemi qenë më të dobët, megjithëse ka pasur krijime të mira, me individualitet poetik, me larmi stilesh e tematike dhe me lirizëm të hollë ose me pathos luftarak si të Dh. Qiriazit, P. Çukës, apo të poetit të ri, që ka bërë përparim, L. Deda, ose të F. Krajës, etj.

Përmbajtja e poezisë sonë ka tingëllim të drejtë. Përpara janë kritikuar disa raste kur botoheshin poezi me një diapazon të ngushtë, që përshkruanin botën intime ose kur vëreheshin prirje formaliste, ku rëndësi kishte vetëm figura, mënyra si thuhej mendimi dhe jo vetë mendimi. Disa të rinj merreshin më shumë me tema të vogla dhe horizonti i tematikës së tyre ishte i

ngushtë. Tani mund të themi se kjo fazë, në përgjithësi, është kapërcyer. Të rinjtë merren me tema dhe ide më të rëndësishme; ka filluar të fryjë në poezitë e tyre një erë më e pastër dhe revolucionare. Megjithatë, përta i takon përmbajtjes, duhet thënë se nuk është një problem që zgjidhet menjëherë dhe largimi nga ndikimet, nga formalizmi, nga qëndrimi subjektivist, etj. nuk është një proces i shkurtër. Vihen re aty-këtu, në disa poezi, vargje të errëta, një konceptim i paqartë i idesë, nota objektiviste për hir «të artit», i cili duhet të kuptohet vetë. Është e qartë se këtu kemi të bëjmë edhe me mungesë përvoja, po nuk përjashtohen edhe ndikimet e huaja, kundër të cilave duhet luftuar. Figura të çoroditura e të pamenduara gjen p.sh. te F. Haliti, i cili ka shkruar edhe vjersha të mira dhe është me talent. Në një vjershë, p.sh., ai thotë: «Perëndimi në vitrinën e mbrëmjes var copën e kuqe të qiellit» etj.

Poezia jonë, në përgjithësi, po bëhet më e qartë dhe më e kuptueshme. Kështu I. Kadare, me të dy poemat e tij «Përse mendohen këto male» dhe «Shqiponjat fluturojnë lart» ka përparuar nga kjo pikëpamje si edhe në trajtimin epik të temës. Por, megjithatë, te poema e fundit, vihet re një prirje drejt figurave të tepëruara, që janë një ndikim simbolist si, p.sh. kur thotë «n'atë lavë skuqin mijëra rubinë plagësh» ose gjokset leshatore të erërave, apo ndonjë figurë tjetër, e shfrytëzuar prej tij edhe më parë. Edhe te F. Arapi ka ndonjë figurë të pagjetur mirë dhe ekstravagante, si p.sh. kur e krahason globin me pjeprin dhe me thelat e pjeprit ose natën që hesht me peshkun. Kur flasim për këto figura të egzagjeruara, sipas mendimit tim, kuptohet se nuk e kemi fjalën për të varfëruar poezinë nga mjetet figurative. Puna është për ta përdorur me vend figurën, për t'u mbështetur sa më shumë te folklori ynë, për t'i ndërtuar figurat shpesh sipas këtij trashëgimi të madh e të pashtershëm. Është gjë shumë e mirë që përveç poetëve si Kol Jakova etj., edhe poetë si Ll. Siliqi, I. Kadareja, D. Agolli, F. Arapi, etj. brenda stilit të tyre, mbështen në disa motive e figura të folklorit. Natyrisht,

gjithmonë në mënyrë krijuese, duhet të ndihet më shumë tradita popullore, mënyra e të konceptuarit konçiz të jetës, fjalët e gjetura që godasin në shenjë, filozofia popullore. Puna nuk është për të rënë në primitivizëm e folklorizëm, po për një krijim më të guximshëm e më të gjerë, për përpjekje të vazhdueshme që të krijohet edhe më mirë fytyra kombëtare e artit tonë poetik.

Ndërsa poezia jonë e realizmit socialist zhvillohet në rrugë të drejtë, kap probleme të rëndësishme dhe nisat nga qëllimi për t'i shërbyer popullit, shumë poetë sovjetikë e të vendeve të tjera, ku sundojnë revizionistët, zhyten gjithmonë e më shumë në hermetizëm, në pacifizëm e humanizëm borgjez, ata kanë krijuar dhe po krijojnë kultin e botës intime, të lumtërisë së vogël dhe shkëputen gjithmonë e më shumë nga problemet shoqërore. Disa poetë si Jevtushenko, edhe me figurën e tyre morale, e tregojnë hapur se janë shërbëtorë të borgjezisë, duke u përlur para agresorëve imperialistë dhe duke lënë në heshtje krimet e tyre në Vietnam. Gjithshka konceptohet në mënyrë mikroborgjeze: lufta vetëm me tmerrin e saj, me frikën që u lind këtyre njerëzve, bota, sipas filozofisë së individit që kërkon një copë «vend të ngrohët».

Poezia jonë është e pastër ideologjikisht, po gjithmonë duhet ruajtur nga ndikimet e mundshme, nga depërtimi i ideologjisë së huaj. Poezia qytetare duhet të tingëllojë më e fortë. Më shpejt dhe më mirë duhet t'u përgjigjen poetët tanë të brezave të ndryshme, të rinjtë letrarë, ngjarjeve të rëndësishme dhe emocionante të kohës.

Duke përfunduar, desha të përmbledh mendimin mbi detyrat aktuale që dalin para poezisë sonë. Në radhë të parë koha kërkon krijime më të shumta poetike, nga poetë të brezave të ndryshëm; kërkon jehonë më të shumtë e më të shpejtë të ngjarjeve politike dhe shoqërore; na duhet një poezi me përmbajtje të thellë ideologjike, që t'u hyjë brenda fenomeneve të jetës, të zbulojë të bukurën, të godasë të shëmtuarën, ta marrë realitetin në luftë dhe në lëvizje. Poezia duhet të luftojë për formë të lartë

artistike, për gjuhë të bukur, të qartë dhe koncize; të luftojë çdo ndikim formalist e çdo manierizëm, të luftojë shprehjen e paqartë të ideve dhe çdo lloj shfaqje të huaj. Poezia jonë duhet të pasurohet me elemente të reja, prandaj duhen shtuar me guxim radhët e poetëve, duhen edukuar ata me dashamirësi, po edhe me qëndrim parimor. Poetët tanë duhet të mësojnë shumë nga populli, nga mprehtësia e tij politike, nga mënçuria dhe nga fjala popullore, aq e pasur e plot ngjyra.

Ne besojmë se fjala poetike, duke pushtuar një horizont më të gjërë, duke forcuar tingujt e vet revolucionarë, do të ngrihet në nivelin e kohës dhe do të plotësojë më mirë nevojat për të ndihmuar më shumë në pasurimin e mendimit dhe të ndjenjës poetike të masat e lexuesve, për t'i frymëzuar dhe mobilizuar ato në luftën për socializmin, për revolucionarizimin e mëtejshëm të jetës sonë.

1967

LETËRSIA DHE REALITETI YNË

Plenumi i KQ të PPSH kushtuar zhvillimit të letërsisë dhe arteve që u mbajt në tetorin e vitit të kaluar, ngriti problemet themelore që preokupojnë sot artin tonë socialist. Ai është bërë një nxitje e madhe për gjallërimin e jetës letrare e artistike, për krijimin e veprave të reja, për t'u afruar më tepër me jetën. Udhëheqja e partisë në këtë fushë të rëndësishme dhe të posaçme të veprimtarisë për edukimin komunist të punonjësve, mobilizimi më i madh i shkrimtarëve dhe artistëve do t'i japin një hov të ri artit tonë.

Ashtu sikurse theksonte plenumi, rëndësi të dorës së parë ka njohja më e thellë dhe e gjithanshme e jetës, e realitetit të ditëve tona dhe e realiteteve të kaluara, futja në proceset komplekse të ndërtimit të shoqërisë së re, të kuptuarit e tendencës kryesore të kohës.

Arti realist dhe përparimtar ka qënë gjithmonë një pasqyrë e vërtetë e realitetit (duke nënkuptuar shkallët e ndryshme të kësaj vërtetësie) dhe metri kryesor me të cilin janë matur veprat, nuk mund të ishte veçse realiteti, fenomenet e gjalla të tij. Njohja e jetës, e filozofisë dhe e shkencës së përparuar të kohës, botëkuptimi i shkrimtarit, ka qënë gjithmonë edhe një detyrë e domosdoshme për kritikën serioze, realiste. Kritikë të njohur dhe të mëdhenj botërorë janë nisur gjithnjë nga kriteri i vënjes përballë të veprës me realitetin, kanë dalë jashtë faqeve të librit dhe kanë shpjeguar fenomene të rëndësishme shoqërore, tipa dhe karaktere që haseshin në jetën e përditshme.

Realiteti është fusha e madhe e veprimtarisë njerëzore, janë marrëdhënjet e njerëzve, faktet ekonomike, politike, shoqërore që i lidhin ata midis tyre, realiteti është vetë njeriu i një kohe të caktuar, me botën e tij të brendshme, me ndjenjat e tij, me dëshirat dhe pasionet e tij, me gëzimet dhe hidhërimet, me brendinë kryesore të karakterit dhe me kontradiktat që përçaktohen nga raportet shoqërore. Realiteti ynë është si një tablo e madhe e shumë ngjyrshme, ku zotërojnë anët e forta, të bukura, në kuptimin estetik të fjalës, po ku ka ende edhe fenomene negative, kundër të cilave luftohet. Sado forcë imagjinatë dhe emocioni që të ketë shkrimtari, sado i talentuar të jetë, jeta, si një rrjedhë e pandalshme, dinamike, është burimi i frymëzimit. Ajo gjithmonë duhet njohur në thellësi, në faktet e shumta dhe të papërsëritshme, në detajet e panumërta që nuk mund të trillohen dot po të qëndrosh larg lëvizjes madhështore të jetës. Talenti vetë shtyn drejt njohjes, drejt njerëzve. Ata që mbyllen në vetvete dhe që nuk e kuptojnë nevojën e të jetuarit me popullin, shpejt ose vonë shterojnë, sajojnë vepra të cekëta, të cilat nxijnë ose llustrojnë realitetin, nuk kanë shpirt dhe prandaj nuk e gjejnë dot rrugën për në zemrën e lexuesit.

Nuk ka asnjë dyshim se veprat tona më të mira të realizmit socialist janë nisur nga realiteti i gjallë, e kanë shprehur atë në anët e veta esenciale. Po procesi i njohjes nuk është i thjeshtë. Ka ndodhur që në veprat letrare realiteti pasqyrçej me përceptësi, që shquanin vetëm disa ngjyra të trasha, disa pohime që sot do të tingëllonin pak naive, ndonëse të sinqerta. Ka pasur krijime me një romantizëm të nevojshëm, që shërbente për të thënë një të vërtetë me ngjyra më të forta emocionale, po ka pasur edhe vepra të tjera me një tepërim të panevojshëm romantik e sentimental, vepra që u kalonin fakteve sipër e sipër dhe nuk e zgjidhnin drejt problemin e lidhjes së harmonishme midis botës reale dhe shkrimtarit, ku kishte më tepër elemente subjektive, ose ku idetë delnin në formë deklarative, pa

ngjallur dot emocion të lexuesit. Tem ka pasur jo se nuk ka sot të tilla, po se, mendoj, që në përgjithësi e kemi kaluar këtë fazë dhe ecim drejt pjekurisë, drejt trajtimit më të thellë dhe më dialektik të fenomeneve të jetës. Arti ynë i realizmit socialist nuk mund të pajtohet kurrsesi me personazhe që shprehin ide të thata, që thonë disa të vërteta të njohura në mënyrë artificiale, jashtë jetës, jashtë marrëdhënjeve reale të njerëzve. Ne s'pajtohemi me këtë art dhe as me atë që nuk shpreh ide të rëndësishme, që nuk hyn në fushën e gjërë të jetës, po që zgjedh disa hije të errëta, disa qoshe të veçuara e të shkëputura nga bota dhe nga qëllimi i madh.

Sidomos për gjinitë e mëdha të prozës e për dramën plenumi shtroi problemin e kapjes së gjerë të realitetit, të konflikteve jetësore. Arti realist duhet të hyjë, doemos sipas temës dhe individualitetit të çdo autori, në raportet shoqërore ekonomike, politike e morale, t'i marrë ato në kompleksin e tyre. Të hyjë në këto fenomene shoqërore dhe t'i shohë ato në mënyrë revolucionare — kjo është detyra kryesore e artit të realizmit socialist, i cili trashëgon anët pozitive të rrymave përparimtare letrare në të kaluarën, po ndryshon prej tyre kualitativisht dhe nuk është as klasicizëm e sentimentalizëm, as romantizëm e realizëm kritik, megjithëse, siç dihet, cilido prej tyre ka qënë i nevojshëm në kohën e vet dhe hyn në thesarin e kulturës kombëtare.

Kështu që idetë tona patriotike, revolucionare, mbrojtja e moralit socialist mund ta bëjnë punën e tyre të madhe edukuese përmes artit vetëm nëpërmjet pasqyrimin konkret historik të jetës, pasqyrimin të figurshëm, poetik të saj dhe, me gjithë larminë e formave, nëpërmjet karaktereve tipike që veprojnë në rrethana tipike. Kjo e vërtetë e njohur marksiste mbi tipikën nuk është aspak e vjetëruar: përkundrazi, sot, me shtrembërimet estetizante të teorisë dhe të artit borgjez e revizionist, merr një rëndësi të madhe e nandihmon për interpretimin e drejtë të realitetit tonë.

Pritja për t'u hyrë thellë fenomeneve të jetës, për ta marrë realitetin në kompleksin e vet, ka ekzistuar që në

fillim të letërsisë sonë dhe vjen duke u bërë më e qartë. Kohët e fundit janë botuar vepra si «Lumi i vdekur» i Jakov Xoxes dhe vëllimi i parë «Para agimit» i Shefqet Musarajt. Romani i J.Xoxes paraqet kotradiktat klasore në Myzeqenë e paraqirimit. Ngjarjet vijnë të gërshetuar në plastikën e tyre, jeta del me hidhërimin dhe gëzimin e saj. Rrugët njerëzore, në përgjithësi, përcaktohen në roman nga raportet shoqërore dhe kjo lidhet ngushtë me fatin e personazheve, me individualitetin që kanë. Ndonëse në një plan të theksuar publicistik, në raportet më tepër politike, personazhet e librit të Shefqet Musarajt shquhen për vërtetësi, realiteti i një periudhe të shkurtër të Shqipërisë së paraqirimit dhe i kohës së luftës nacionalçlirimtare zbulohet te kjo vepër në disa aspekte të reja.

Realiteti i Shqipërisë së sotme ose të kaluar ka shumë fenomene të rëndësishme, të cilat nuk janë trajtuar ende në letërsi, ose janë prekur përciptazi. Njohja e vërtetë dhe këmbëngulëse me njerëzit, me qëndrimin e tyre ndaj punës, njohja me dokumentat e së kaluarës, përgatitja serioze, kultura dhe aftësia për të kapur fenomenet, do të japin patjetër rezultate më të mira në punën e shkrimtarëve. Kjo u theksua me forcë në plenum. Në kemi disa vepra të gjinive të ndryshme që kanë trajtuar temën e punës, po këto janë ende të pakta në krahasim me problemet e mëdha që shtron jeta dhe me kërkesat e lexuesve. Proceset e transformimit të jetës, të kalitjes së ndërgjegjes, rruga e punëtorit të ri të formuar nëpër kantieret e fabrikat tona, lidhja e ndërlikuar psikologjike e fshatarit që u bë punëtor me traditën e tij, me njerëzit, ndeshja e normave të reja morale me normat e vjetra, ndryshimi i psikologjisë së fshatarit, qëndrimi ndaj femrës, konceptimi i jetës nga pozitativ e socializmit, në kundërshtim me mbeturinat e shoqërisë së vjetër në ndërgjegjen e njerëzve, — të gjitha këto e të tjera, të shikuara në frymën revolucionare, në frymën e përpjekjeve heroike të njerëzve tanë për të realizuar e tejkaluar planet, janë objekt i rëndësishëm për vepra të reja, plot dinamizëm e me ngjyra të fres-

këta. Po, doemos, kjo nuk është një punë fort e lehtë dhe kërkon mund, studim të fenomenit, njohje të detajeve konkrete, aftësi interpretimi, aftësi për t'u orientuar drejt në grumbullimin e fakteve dhe të ngjarjeve.

Format e njohjes dhe të pasqyrimit të realitetit, siç dihet, janë të shumta, sepse realiteti ka shumë anë, shumë sfera që mund të trajtohen në mënyra të ndryshme. Kriteri i gjykimit nuk mund të jetë krejt njëlloj për të gjitha gjinitë, duhet marrë parasysh specifika e tyre, sado që kërkesat e përgjithshme janë të njëjta. Po në qoftë se nisesh nga parimi i pasqyrimit konkret historik të jetës, i zbulimit të kontradiktave shoqërore, i konflikteve të thella dhe i kërkon çdo tregimi, vjershe ose poeme po ato që i kërkon romanit, novelës së gjatë, dramës, s'ka dyshim se do të gabosh dhe do ta thjeshtësosh problemin. Ka vepra, sidomos poetike, që mund të kapin disa momente kulminante, çaste sublime, natyrisht të trajtuara me gjuhë të ngrohtë njerëzore dhe jo deklarative. Disa herë mund të ndriçohet një tipar, një aspekt, me qëllim të caktuar; dhe kur autori është i pasur me mendime, në figura, në fantazi (që buron prej realitetit), vepra mund të luajë rol dhe të emocionojë lexuesin me atë emocion të vrullshëm që është në gjëndje të krijojë poezia. Kështu, p.sh., një efekt të tillë bëjnë disa vepra të Ismail Kadaresë, të Llazar Siliqit, ndërsa mjaft poezi të Dritëro Agollit e kapin jetën me një intonacion më të shtruar, më realist, në kuptimin e stilit.

Por stilet e ndryshme dhe veçoria e gjinive nuk duan të thonë se poetët, p.sh., mund ta njohin edhe përciptazi jetën dhe mund të merren vetëm me çaste solemne të jetës, pa u futur më thellë në ndjenjat dhe në mendimet e kohës. S'ka dyshim se edhe këtu problemi duhet të kuptohet në mënyrë dialektike: vetëm njohja e thellë e jetës dhe aftësia për të kapur fenomenet, japin mundësi për një trajtim të lirë, duke zgjedhur ato që i përshtaten stilit dhe duke rifreskuar gjithmonë poezinë me fakte të reja, të interpretuara poetikisht. Për poezinë tonë mendoj se shtrohet gjithmonë e më shumë nevoja e përgjithësimeve më të mëdha, e pasqyrimit të jetës nëpërmjet

sintezave poetike, për të dhënë heroizmin e kohës, thellësinë e ndjenjave të njeriut të sotëm, momentin politik që po kalojmë, qëndresën e popullit tonë, të udhëhequr nga partia. Përveç kësaj, shtrohet detyra edhe e pasqyimit të ndjenjave të holla njerëzore, të fisnikërimit të shpirtit të njeriut që ndërton socializmin, pa i marrë këto ndjenja si detaje të ndara nga e përgjithshmja, po, përkundrazi, si rezultate të gjendjes së përgjithshme shpirtërore, të optimizmit të shoqërisë sonë.

Një aspekt i rëndësishëm i problemit të lidhjes së letërsisë me realitetin është, pa dyshim, ai i interpretimit të botës, gjë që kërkon të jesh i pajisur me botëkuptimin marksist-leninist dhe me kulturë të gjithanshme. Nevoja e interpretimit të drejtë, e zgjedhjes së momenteve tipike të jetës, u theksua me forcë në plenum. Ky parim përbën një nga tezat kryesore të estetikës marksist-leniniste. Interpretimi është diçka inherente me vetë qëllimin e artit dhe s'mund të ketë vepër të vërtetë pa gjykim, pa një qëndrim të caktuar, cilado qoftë forma e shprehjes së këtij qëndrimi. Ndodh kështu sepse arti lind për të mbrojtur diçka, për të luftuar diçka me mjetet e veta specifike.

Në veprat tona të realizmit socialist është interpretuar drejt realiteti. Ato vepra të pakta që kanë pasur gabime ideore, u kritikuan me të drejtë dhe janë bërë mësim si për autorët e tyre ashtu edhe për gjithë letërsinë tonë.

Përveç veprave të gabuara ideologjike, ka edhe vepra të tjera që nuk mund të thuash se e interpretojnë gjithshka drejt, qoftë për arsye të njohjes së pakët të fenomenit, të thellimit në realitet apo të aftësisë për interpretimin e tij. Kështu, p.sh., fenomenet e dashurisë dhe të martesës, të luftës kundër paragjyqimeve, kundër meskinitetit hera-herës gjejnë zgjidhje të drejtë, po ka edhe raste që nuk shpjegohen mirë motivet që i shtyjnë njerëzit në veprime të caktuara, që nuk ka interpretim klasor dhe gjërat merren të shkëputura, kthesat mbeten të përpëlligjura. Ka raste që, nga dëshira për të luftuar paragjykimet, nxihet e vërteta, ekzagjerohen anët negative dhe

del sikur shumica e kolektivit është e zhytur në paragjykimet të cilat vetëm dy-tre veta janë në gjendje t'i kapërcejnë. Lufta le të tregohet e ashpër, e mprehtë, le të luftohen elementët negative, ata që dalin sheshit dhe ata që mbulohen me hipokrizi, po populli, masa, si një forcë e tërë, nuk mund të shihet me mospërfillje dhe me sy të ftohtë. Fryma popullore, dashuria për njerëzit e thjeshtë duhet të jetë në themel të çdo vepre letrare.

1966

PËRMBAJTJE E THELLË DHE FORMË E LARTË

Në raportin e shokut Enver Hoxha, mbajtur në Kongresin e 5-të të PPSH, i jepet një rëndësi e madhe thellimit të mëtejshëm të revolucionit ideologjik e kultural. Në të shtrohen detyra për sektorin e letërsisë dhe të arteve, detyra që kanë të bëjnë me drejtimet kryesore në këtë fushë të veprimtarisë shoqërore; ngrihen probleme esenciale që nisen nga politika e partisë në gjendjen e sotme, që mbështeten në parimet e estetikës marksiste-leniniste dhe i konkretizojnë këto në kushtet e realitetit tonë.

Njerëzit e letërsisë dhe të arteve, institucionet kulturele dhe artistike gjejnë në raportin e shokut Enver programin e punës së tyre, orientimin kryesor se ku duhet ecur, çfarë duhet pasur parasysh në krijimtari dhe në botimin e përhapjes së letërsisë. Parimet dhe detyrat që shtrohen në të nisen nga një analizë e thellë marksiste, nga gjendja reale e krijimtarisë sonë artistike dhe e punës së institucioneve. Kritika që i bëhet punës në këtë sektor, kërkesat e drejta që shprehin mendimin dhe dëshirat e gjithë punonjësve dhe besimi i shfaqur për punën e mëtejshme të shkrimtarëve dhe artistëve janë një nxitje e madhe, që do të përcaktojnë zhvillimin dhe revolucionarizimin e mëtejshëm të artit dhe të kulturës sonë.

Problemet që u ngritën në Kongresin e 5-të për kulturën dhe artin lidhen me të shikuarit në prizmin klasor të këtyre fenomeneve të veprimtarisë shpirtërore, me tematikën kryesore, me pasqyrimin e heroit të ditëve tona, me karakterin popullor dhe kombëtar të artit

e të kulturës, me raportin e drejtë midis përmbajtjes dhe formës, me luftën kundër influencave të huaja, kundër artit borgjez, dekadent dhe revizionist, me vlerësimin e traditës sipas parimeve të marksizëm-leninizmit, me dënimin e kozmopolitizmit dhe të ksenofobisë, si tendenca që nuk pajtohen me frymën tonë.

Revolucionarizimi i mëtejshëm i letërsisë dhe i arteve është i lidhur me gjithë revolucionarizimin e jetës sonë, me luftën kundër burokracisë, me mobilizimin e madh të punonjësve për të realizuar planet, me luftën heroike të popullit tonë kundër imperializmit dhe revizionizmit. Ky revolucionarizim mbështetet thellësisht në interesat e popullit, në mbrojtjen e fitoreve të revolucionit dhe niset nga parimi i partisë sonë se lufta e klasave, dhe pas likuidimit të klasave shfrytëzuese, mbetet një nga forcat kryesore lëvizëse të shoqërisë. Kjo shtron para letërsisë dhe arteve detyra të mëdha të lidhjes më të ngushtë me masat, të njohjes në thellësi të punonjësve, të shpirtit dhe të veprimtarisë së tyre, të njohjes së rrethanave dhe ambienteve ku punojnë ata; kjo kërkon, gjithashtu, një interpretim më të thellë revolucionar të ngjarjeve dhe të heronjve, kërkon të shikohet gjithshka thellësisht në prizmin e luftës së klasave, kërkon të zbulohen kontradiktat, qofshin këto antagonistë ose joantagonistë.

Fryma popullore ka qenë gjithmonë një tipar dallues i letërsisë sonë të realizmit socialist. Veprat më të mira të shkrimtarëve tanë e shprehin bukur dashurinë për popullin; kjo përbën pasionin kryesor të shumë vepërave, momentin e frymëzimit. Në letërsinë tonë janë pasqyruar njerëz nga gjiri i popullit, të cilët, me punën dhe botën e tyre shpirtërore, shërbejnë për edukimin e masave të lexuesve. Por shumë më tepër duhet të dalë në veprat letrare njeriu i sotëm, puna madhështore e popullit, thjeshtësia e tij, lidhja me të shkuarën dhe ëndërra për të ardhmen; duhet të dalë si në gjini të shkurtëra, të shpejta, që u përgjigjen aty për aty kërkesave të kohës, ashtu edhe në gjini më të mëdha, me konflikte e tipa më të thelluar.

Shkrimtarët dhe artistët tanë e kanë ndjerë thellë fjalën e partisë; disa janë duke jetuar aktivisht në gjirin e popullit dhe po punojnë për vepra të reja, por, sidoqoftë, një punë më e vrullshme, më revolucionare, një përpjekje më e madhe për të ecur me kohën, për të krijuar më shpejt, është e domosdoshme. Këtë e kërkon vetë koha, e kërkojnë lexuesit, e kërkojnë vrulli dhe dinamizmi i aktualitetit tonë. Dhe shkrimtarët e partishëm e kanë për nder që ta vënë talentin e tyre në shërbim të popullit, që të bëhen edhe më shumë poetë dhe shkrimtarë qytetarë, militantë, që nuk merren me «qëndizma» dhe me kërkime të zbrazëta e formaliste, por që duan të thonë fjalën e tyre emocionante, të bëjnë «propagandën dhe agjitacionin» e tyre, aspak të thatë dhe skematik, por të frymëzuar, të përshkuar nga ide të mëdha. Kështu kanë vepruar gjithmonë artistët popullorë me zemër të madhe si Naimi, Migjeni, etj; kështu kanë vepruar kudo gjithë ata që e kanë kuptuar thellë popullin dhe interesat e tij.

Koha ka nxjerrë dhe po nxjerr në pah tema të reja, të rëndësishme, themelore për jetën tonë. Jeta duhet marrë në tërësinë e vet. Për këtë nuk mund të kemi asnjë dyshim, sepse s'ka arësye të kthehemi prapa në pasqyrime primitive dhe skematike, por puna është që të mos zotërojnë gjërat e vogla, lulkat dhe sheqerosjet, të mos mbyllemi në lirikën ngushtësisht intime dhe personale, pa brendi shoqërore, të mos lejojmë influenca të huaja që kanë si bazë pikëpamjet objektivistë, të humanizmit abstrakt apo të një tendencioziteti që nuk niset nga perspektiva revolucionare e jetës dhe që në fakt mbahet në pozita mikroborgjeze, regresive.

Duke folur për kulturën tonë socialiste, për karakterin e saj kombëtar dhe për problemin e përmbajtjes dhe të formës, shoku Enver në raportin e tij thotë:

«Arti dhe kultura jonë socialiste duhet të mbështeten fort në tokën tonë amtare, në popullin tonë të mrekullueshëm, ato duhet të burojnë nga populli dhe të jenë plotësisht në shërbim të tij, të qarta e të kuptueshme për popullin, por aspak «banale e pa ide». Par-

tia është për një krijimtari artistike e kulturele në të cilën përmbajtjes së thellë ideologjike e frymës së gjerë popullore t'i përgjigjet një formë e lartë artistike, që të prekë thellë ndjenjat dhe zemrat e njerëzve, t'i frymëzojë e t'i mobilizojë ata për vepra të mëdha».

Filosofia marksiste-leniniste i kupton në mënyrë dialektike raportet e përmbajtjes me formën, i kupton këto të lidhura organikisht, në një unitet të harmonishëm, pa të cilin nuk mund të flasim për shprehjen e plotë dhe të bukur të ideve. Në këtë unitet dihet se kryesore është përmbajtja dhe, kur flasim për përmbajtje të artit, kuptojmë materialin jetësor, temën dhe detajet tematike konkrete emocionale, të lidhura ngushtë me idenë, me qëndrimin e autorit, me qëllimin për të cilin ai e ka shkruar veprën, me botëkuptimin e tij. Pa këtë bashkim organik të ideve emocionale me jetën, me faktet konkrete, nuk mund të kemi përmbajtje artistike. Po t'i marrim këto të shkëputura, kur ka vetëm fakte, do të flasim për një fotografim naturalist, ose për paraqitje empirike, që nuk çon në asnjë mendim. Po të merrim vetëm ide abstrakte, pa material nga jeta, nga njeriu, nuk do të kishim të bënim me art, por me parulla të thata, ose me mendime, ndofta edhe të thelluara, por që nuk gërshetohen me jetën dhe kështu mbeten jashtë sferës së artit. Të dyja këto janë të dëmshme dhe është e domosdoshme të luftohen si vulgarizime, si tendenca që e varfërojnë artin dhe e largojnë nga jeta e vërtetë, ose i zhveshin faktet nga mendimi, nga filozofia jonë, pa të cilën nuk mund të ketë interpretim të drejtë të realitetit dhe nuk mund të arrihen suksese të ndjeshme në lëmin e krijimtarisë.

Natyrisht, përmbajtja shprehet përmes një forme konkrete, që në letërsi ka të bëjë me subjektin e gjetur nga autori, me kompozimin, me gjuhën si mjet themelor të formës, me dialoget, me detajet artistike, figurat, etj. Këto të vërteta elementare nuk ka nevojë të shpjegohen. I përmendëm vetëm për të kujtuar se sa i drejtë është mendimi i lidhjes së ngushtë të formës me brendinë, se si edhe forma nuk duhet lënë mbas dore kurrsesi,

sepse ka të bëjë me ata komponente që zëmë ngoje, mungesa e të cilave e dëmton paraqitjen e përmbajtjes, mi-shërimin e saj konkret.

Kështu e shtron partia jonë problemin e artit, të parimeve të estetikës; vënja e theksit te përmbajtja, te qëndrimi ideopolitik, te ideologjia nuk është në kundërshtim me këtë shtruarje të problemit, sepse kryesore është përmbajtja, jeta, realiteti ynë dhe idetë revolucionare. Është shumë e drejtë kërkesa për të pasuruar përmbajtjen e veprave tona, për të hyrë më thellë në jetë, në raportet njerëzore, në fenomenet e reja, për të njohur dhe pasqyruar heronjtë e ditëve tona, jo në mënyrë «banale dhe pa ide», por ashtu siç janë, të fortë dhe të guximshëm, në tërësinë e tyre organike, duke bashkuar realitetin me perspektivën, faktin me ëndërrën që ka bazë reale.

Në pasurimin e përmbajtjes së veprave letrare ka rëndësi shumë të madhe, si për anën e temës aktuale ashtu edhe të interpretimit të saj, problemi i luftës klasore, si një nga forcat kryesore lëvizëse të shoqërisë. Ky parim i të shikuarit të jetës dhe kjo temë kanë gjetur shprehje në mjaft vepra tona dhe kjo ka përcaktuar drejtimin ideoemocional të veprave. Kështu, p.sh., mund të përmendim romanet «Lumi i vdekur» i J. Xoxes, dhe «Para agimit» i Sh. Musarajt, tregime si «Zot e rob» të Dh. Shuteriqit, etj., që e trajtojnë këtë temë.

Lidhja më e thellë dhe organike e përmbajtjes së veprave me problemin e luftës së klasave duhet ta shqetësojë seriozisht letërsinë tonë, e cila do të bëhet kështu më e gjallë e më e thellë, më realiste dhe më luftarake. Është e qartë se ka vepra, sidomos poetike, që merren më shumë me unitetin moralo-politik të popullit, me luftën kundër armiqve, që hymnizojnë Atdheun dhe punën, popullin dhe partinë. Kjo është e domosdoshme për artin tonë dhe ka tingëlluar në poema të kohëve të fundit, si «Shqiponjat fluturojnë lart», e I Kadaresë, «Borizanët», e Ll. Siliqit, «Alarme të përgjakura», e F. Arapit, etj.

Kur flasim për pasurimin dhe thellimin e përmbaj-

tjes, kemi parasysh zgjerimin e tematikës, futjen e letërsisë në sfera të mëdha të jetës, në pamje të reja dhe plot dritë, në pasqyrimin e heronjve të rinj, sepse jemi ende prapa dhe nuk u jemi përgjegjur sa duhet kërkesave të kohës. Kemi parasysh gjithashtu pasurimin e mendimit që do të jetë boshti i veprave dhe do t'i mbajë ato në këmbë, luftën për t'u shkëputur nga ideologjia borgjeze, nga qëndrimet mikroborgjeze e sentimentale, nga të shikuarit me syrin individualist, nga konservatorizmi e rutina patriarkale dhe feudale. Kjo është një luftë e madhe, që do të zhvillohet parimisht e konkretisht, me durim e këmbëngulje, pasi vetëm kështu mund të ecim në rrugën e revolucionarizimit të arteve.

Kërkimet serioze dhe të gjalla në përmbajtje, pa dyshim, do të shpien edhe në pasurimin e formës, të mjeteve artistike, të gjuhës. Kontakti i gjallë me jetën, njohja e gjuhës së pasur, plot ngjyra e nuanca të popullit, të shprehjeve e mënyrave të ndërtimit të figurave koncize si të të folmes popullore, që shfaqet aq bukur në folklor, do të gjallërojnë edhe gjuhën e veprave letrare, do të ndihmojnë për t'u dhënë këtyre më shumë jetë. Kujdesi për formën është diçka e domosdoshme, që lidhet ngushtë me përparimin e artit tonë. Veprat që përmendëm kanë arritur të zgjojnë interes për brendinë e tyre dhe për shprehjen artistike.

Fjala e partisë, porositë e shokut Enver, vendimet e Kongresit të 5-të janë një nxitje e madhe për shkrimtarët dhe artistët. Ato i frymëzojnë dhe i gjallërojnë ata për të krijuar vepra që të zgjojnë emocione të vërteta, vepra që të prekin mendjen dhe zemrën e popullit.

1967

TEMAT E MËDHA TË AKTUALITETIT

Duke pasqyruar jetën në zhvillimin e vet revolucionar, kohët e fundit letërsia ka ngritur probleme që lidhen me transformimet shoqërore dhe morale, me luftën e klasave në fushën ideologjike, si dhe probleme të heronizmit që ka lindur nga masa. Këto dy aspekte të rëndësishme të realitetit tonë, të veprimtarisë së masave, që drejtohet nga partia, janë burime të mëdha temash dhe idesh. Revolucionarizimi i mëtejshëm i jetës sonë i ka shtruar këto probleme në mënyrë më të mprehtë dhe më intensive, prandaj është e natyrshme që të pasqyrohen edhe në letërsi me nota më të qarta e më të theksuara.

Përpjekje nga shkrimtarët janë bërë, po nuk janë të mjaftueshme në krahasim me nevojat që ka masa për më shumë vepra letrare të vërteta dhe të bukura, për atë ushqim shpirtëror estetik të domosdoshëm në edukimin e njerëzve, në krijimin e ndërgjegjes estetike të shoqërisë. Vepra më të shumta dhe më të mira do të krijohen, sepse vetë realiteti krijon kushte të tilla, po është e nevojshme që edhe subjektivisht, nga ata që drejtojnë dhe organizojnë aktivitetin letrar të ketë shumë më tepër nxitje, inkurajim, dashamirësi, theksim të gjërave të reja pozitive, revolucionare dhe luftë kundër të metave dhe koncepteve që pengojnë ecjen përpara. Kjo është detyrë e madhe që shtrohet para njerëzve të frontit të artit, sidomos tani, në praktikë të kongresit të 2-të të shkrimtarëve e artistëve dhe përgjithësisht në procesin e revolucionarizimit të gjithanshëm të jetës sonë.

Në këtë proces të revolucionarizimit të jetës mendojmë se shtytje përpara u ka dhënë letërsisë dhe artit lëvizja e gjerë amatore e masave. Kjo lëvizje luan një rol të dyfishtë: artin e ekspozon gjerësisht, si në një ekspozitë të madhe e të larmishme, dhe freskon me mendim të ri krijimtarinë profesioniste. Me këtë fenomen del në pah tipari i kulturës socialiste, që vjen e bëhet më i theksuar dhe më i qartë me zhvillimin e jetës. Në krijimtarinë e amatorëve, në lojën skenike dhe në aktivitetin masiv ka elemente të reja, të gjalla të jetës së përditshme. Kjo u pëlqen njerëzve pikërisht për origjinalitetin dhe largimin nga rutina, për ruajtjen e specifikës së artit. Prandaj, për të mos humbur këto vetija të larta të artit amator, është e domosdoshme të përkrahet gjerësisht ajo që është me të vërtetë e bukur dhe të pastrohet ajo që është vulgare dhe e rëndomtë. Dhe që të arrihet kjo, shkrimtarët, kompozitorët, piktorët e skulptorët duhet ta ndihmojnë e ta përkrahin artin amator dhe të mos e shohin atë si një fenomen të dorës së dytë e të parëndësishëm, sepse, duke e ndihmuar e përkrahur, do të jetojnë afër krijimtarisë masive dhe, rrjedhimisht, do të mësojnë prej saj shumë gjëra të dobishme.

Kohët e fundit letërsia jonë është marrë më shumë me transformimet socialiste, me botëkuptimin dhe psikologjinë e klasës punëtore, me të ardhmen dhe poezinë e saj, me konfliktet, sidomos morale, etj. Një ndër veprat me vlerë që trajton aspekte të rëndësishme aktuale të klasës punëtore është romani «Dasma» i I. Kadaresë, i cili e paraqet bukur realitetin në mënyrën e tij, do të thotë, poetike-pamfletiste. Vepra të tilla kërkon koha; natyrisht, ajo kërkon edhe shumë mënyra të tjera origjinale, pa mbetur në rutinë e anakronizëm, po ku të theksohen më shumë karakteret, rrugët e zikzaket e tyre, konflikti, ndeshja e botëkuptimeve. Kështu, p.sh., kanë dhënë dhe japin kontributin e tyre me tregime për jetën e sotme edhe shkrimtarë të tjerë, si T. Laço, S. Andoni, etj., duke ngritur dhe zgjidhur kontradikta shoqërore dhe psikologjike me mënyrën dhe mundësitë e tyre artistike, duke luftuar konceptet mikroborgjeze

dhe duke treguar poezinë e së resë, pa kontraste të forta, po me një lirizëm të hollë e, shpesh herë, me material të pasur jetësor.

Problemi i pasqyrimin të transformimeve të mëdha të jetës, i emancipimit të gruas, i luftës së saj aktive dhe i heroizmit në punë është shtruar edhe në dramën si «Cuca e maleve» e L. Papës, «Flakë në shtëpi» e Z. Cikulit, «Fisheku në pajë» e F. Krajës, «Shembja» e I. Uruçit, «Heronjtë e Linasit» e S. Pitarkës, etj. Në to ka dalë më i mprehtë problemi i të parit të jetës në prizmin e luftës së klasave, i krijimit të figurës së gruas aktive në shoqërinë tonë. Merita e tyre e parë është se u përgjigjen kohës dhe ndihmojnë për edukimin e njerëzve me idetë e partisë. Disa prej tyre arrijnë të zgjojnë edhe emocione dhe të krijojnë karaktere të plota. Po për dramaturgët tanë del problemi që të thellohen në karaktere, të na japin njerëz të ditëve tona në shumanëshmerinë e tyre, me pasurinë shpirtërore dhe jo të krijohen skema që nuk lënë gjurmë në ndërgjegje. Fenomenet janë të bukura në harmoninë dhe në luftën e tyre dhe jo në një linjë të cekët që vetëm ilustron idenë. Ne kemi nevojë për vepra të plota, të ngjeshura me mendim dhe me emocion, ku të tingëllojnë filozofia e ditëve tona, poezia e saj, mbrojtja e madhe komuniste e njeriut të thjeshtë. Nuk është çështja se për të krijuar vepra të tilla duhet menduar me vite. Veprat e mira mund të shkruhen edhe shpejt, me vrull, me një emocion të pandërprerë, që ta nxitin jeta dhe frymëzimi që zgjon partia. Niveli artistik i dramaturgjisë sonë nuk duhet të bjerë, po të ngrihet më lart, në nivelin e ideve dhe të emocioneve të reja të mëdha, në nivelin e kërkesave ideore dhe estetike të njerëzve tanë.

Tema tjetër e madhe që, natyrisht, lidhet me transformimin e shoqërisë sonë, me revolucionarizimin e saj, është tema e heroizmit, e qëndrimit të njeriut tonë në punën e përditshme, para vështirësive, para momenteve që kërkojnë forca dhe punë të jashtëzakonshme, sakrificë, që mund të arrijnë gjër në vetëmohim të plotë.

Heroizmi është një tipar i rëndësishëm moral i shoqërisë sonë, që lidhet me edukimin e njerëzve me frymë revolucionare, me mbrojtjen e fitoreve të arritura, me epërsinë morale të njeriut të socializmit, që vë interesin e përgjithshëm mbi interesin e ngushtë personal. Ne kemi plot shembuj heroizmi të masave, të individëve, që shquhen në punë e sipër. Hovi shpirtëror, pasioni revolucionar i masave, i ndezur nga partia, ka krijuar një gjendje shpirtërore sublime, heroike, veçori e qartë e guximtarëve, e njerëzve me personalitet të fuqishëm. Në vendet borgjeze dhe në vendet ku sundojnë revizionistët, bëjnë çmos për të shuar çdo ndjenjë heroike dhe në letërsinë e artet e tyre sundon një frymë deheroizimi, ndrydhjeje pasionesh të vogla dhe qëndrimesh mesquine qaramane. Prandaj estetëve borgjezë dhe revizionistë çdo vepër heroike u duket «e vjetëruar», e «modës së dikurshme».

Tek ne heroizmi ka qenë dhe është sot më shumë akoma një nga temat më të rëndësishme të letërsisë. Veprat me këtë përmbajtje do të thellohen e zhvillohen më tutje, letërsia jonë do të pasurohet me krijime që do të kenë në bazë heroizmin e masave. Thirrjeve për «deheroizim» të revizionistëve ne duhet t'u përgjigjemi me vepra të fuqishme, ku të tingëllojë mendimi me forcë, me plot gojën, me formë të re, të guximshme sipas realizmit socialist, që presupozon larminë e formave dhe që mbetet gjithmonë besnik ndaj jetës, ndaj qëllimeve të revolucionit.

Heroizmi i jetës sonë dhe transformimet socialiste janë ngritur e pasqyruar edhe në poezi, dhe veçanërisht në drama. Këto krijime kanë luajtur dhe luajnë rolin e tyre. Tanimë duhet të thellohemi në pasqyrimin e këtyre fenomeneve, në pasqyrimin e heroizmit të masave, sepse arti ynë ka në qendër të vëmendjes popullin, njerëzit e dalë nga gjiri i tij.

Paraqitja e heroizmit të masave nuk është diçka amorfë, e përgjithshme, e pakonkretizuar. Arti vepron me figura konkrete. S'ka dyshim se ky heroizëm do të jepet nëpërmjet përfaqësuesve konkretë dhe veprimit kolektiv

të masës, prandaj është i domosdoshëm një gërshetim harmonik i masës me heronjtë. Sociologjia dhe estetika marksiste na mësojnë se lidhja e ngushtë e individit me shoqërinë, me kolektivin, nuk do të thotë aspak humbje e personalitetit të tij, siç pretendojnë borgjezët, po, përkundrazi, sa më e madhe dhe më organike të jetë kjo lidhje, aq më shumë rritet personaliteti i njeriut, aq më fort qëndron ai me të dy këmbët në realitet. Prandaj ka rëndësi të madhe që në veprat tona dramatike dhe në veprat e tjera të zbulohet mirë kjo dialektikë, duke i dhënë masës rolin e saj përcaktues dhe duke krijuar personalitete dhe individualitete të fuqishme, që dalin nga gjiri i saj.

Gjithashtu është i rëndësishëm një moment tjetër lidhur me këtë problem. Kur flasim për heronjtë e vdekur, karakteri i ftohtë ilustrativ, skema, apo simbolet e tepëruara që vihen re disa herë, na largojnë nga realizmi socialist, na çojnë në një rrugë klasikexhante. Dhimbja për njeriun tonë të humbur është e madhe, ajo s'mund të minimizohet. Kompleksi i ndjenjave e vë në pah burrërinë duke mos e zbehur aspak atë. Gjithashtu, një ekzagjerim i simboleve (pa mohuar rolin e tyre në dhënjen e figurshme të idesë), i pavdekësisë, i formave anakronike me të cilat u këndohej heronjve të dikurshëm, nuk është tokësor dhe realist, pa dashur ai mund të na shpjerë në një variant të padëshëruar të konceptimit kristian.

Dramat që janë shkruar për heronjtë e ditëve tona dhe vënja e tyre në skenë janë një punë e nevojshme, po ne nuk mund të mbetemi këtu në trajtimin e tamës së madhe të heroizmit. Kur flasim për heroizmin, nuk kemi parasysh vetëm gjestet e jashtëzakonshme dhe të shquara që kanë vendin e tyre në letërsi dhe luajnë rol për edukimin e masës, po edhe punën e përditshme të njerëzve të thjeshtë, ato veprime, në dukje të zakonshme, të cilat, të mbledhura bashkë, japin tërësinë e heroizmit. Të gjithë punonjësit, në punën e tyre të përditshme, apo në veprime të shquara, janë njerëz të thjeshtë, të popullit, me botë të pasur shpirtërore dhe përbëjnë objektin kryesor të pasqyrimin në artin tonë.

Në kronikat ose dramat dokumentare, apo në krijime të gjinive të tjera, shpesh bëhet një jetëshkrim i thatë i heroit, nuk tregohet formimi i tij shpirtëror dhe nuk del lufta e botëkuptimeve, lufta për krijimin e njeriut të ri. Animi nga forma pillakateske, e cekët, i dobëson ato dhe nuk lejon të arrihet në përgjithësime të figurave për të krijuar shembuj njerëzish që duhen ndjekur në rrugën e tyre. Heronjtë e ditëve tona, ndryshe nga heronjtë kalorsiakë apo borgjezë, janë njerëz të thjeshtë, me botë të pasur shpirtërore. Arti ynë, koha jonë na krijon të gjitha mundësitë për të dhënë figura madhështore në kompleksin e vet. Është e udhës të themi se, në ndonjë nga këto drama, veprimi nuk zhvillohet në temën dhe në idenë e shtruar, po thërmohet në copëza të parëndësishme. Ne nuk marrim vesh botën e brendshme dhe pasurinë shpirtërore të heroinës. Këto tema janë tronditëse, të fuqishme dhe duan një trajtim më serioz. Në to mund të zotërojë pathosi liriko-filosofik, që kërkon, doemos, ndeshjen e botëkuptimeve dhe jo konflikte që nxjerrin kokën në krye dhe mbeten në mes të rrugës. Por, të kuptohemi, këtu nuk është fjala, ndofta, për të meta të vogla të heronjve, për të qenë «realistë», po për një konceptim më të thellë të të kundërtave, të heroizmit me meskinitetin, të trimërisë me frikën, të vetëmohimit me mbylljen në interesin e ngushtë personal.

Vëmendja kryesore duhet të tregohet për heroizmin e përditshëm, për heronjtë e gjallë, për lëvizjen heroike të masave, sado që, kuptohet, edhe shembujt e shquar të individëve të lidhur me kolektivin ndihmojnë dhe na duhen për edukimin e njerëzve.

Jeta jonë ecën me ritëm të shpejtë. Ndeshja e fuqishme e koncepteve, lufta për të renë, pasuria shpirtërore e njerëzve, faktet e gjalla të shumta, janë material i pashterur për vepra të reja më të mira. Jeta kërkon vepra me cilësi më të larta ideore dhe artistike.

NJË VIT LETËRSI NË RRUGËN E REALIZMIT SOCIALIST

Duke hyrë në vitin e ri 1965, është e natyrshme të mendojmë për rrugën e letërsisë gjatë vitit 1964, për sukseset e arritura, duke qënë plotësisht të vetëdijshëm se kemi edhe dobësi e mungesa në krahasim me kërkesat e mëdha të kohës sonë, të lexuesve; është e nevojshme që të mundohemi të përmbledhim, sa të jetë e mundur, disa nga ato mendime, biseda që kanë preokupuar, gjatë këtij viti, punonjësit e letërsisë dhe, sidomos, masat e lexuesve.

Të flasësh për letërsinë e një viti nuk është gjë e lehtë, sepse duhen studjuar mirë e përgjithësuar fenomenet; veç kësaj, disa vepra që fituan edhe çmim, në konkursin e 20-vjetorit, nuk janë botuar të plota, ato do të dalin këtë vit, po ne mund të mbështetemi deri diku në pjesët e botuara për të treguar, ndofta, manifestimet e letërsisë, disa nga prirjet e saj kryesore, që, siç kuptohet, nuk janë vetëm të këtij viti, po që kanë zënë fill prej disa kohësh dhe vijnë duke u zhvilluar.

Përqaftimi i metodës së realizmit socialist, që lindi tek ne nga kushtet tona historike e, doemos, edhe nga ndikimi i letërsisë sovjetike të themeluar prej Gorkit (duke nënkuptuar burimet e tjera kombëtare dhe ndër-kombëtare) — ka qënë dhe është sot më shumë akoma një faktor përcaktues që lidhet me përparimin ideor dhe artistik të letërsisë, me perspektivat e saj, me gjerësinë e temave, me unitetin botëkuptimor që nuk uniformizon stilet, siç pretendojnë estetët borgjezë dhe re-

vizionistë, po, përkundrazi, krijon mundësi — siç ka ndodhur e po ndodh tek ne — për lulëzimin e vërtetë dhe të gjithanshëm të individualiteteve, të mënyrave dhe të stileve të ndryshme.

Edhe viti 1964 ka treguar fare mirë se shkrimtarët tanë, me disa përjashtime që janë kritikuar, kanë përvetësuar edhe më mirë parimet e realizmit socialist, parimin kryesor të tij — partishmërinë, problemin e pasqyrimin më të thellë konkret-historik të realitetit dhe çështjen e lidhjes më të ngushtë me jetën, me popullin, megjithëse këtu ka akoma shumë për të bërë. Realizmi socialist nuk kuptohet dhe nuk është kuptuar asnjëherë tek ne si diçka e ngrirë dhe e palëvizshme, si ndonjë kanun i thatë apo si recetë e përgjithshme. Ai është kuptuar si një metodë e gjallë krijonjëse që ka lindur nga nevojat historike, që ka bazë të fortë shoqërore, që drejton shkrimtarët nga e vërteta, e interpretuar në frymë revolucionare, sipas botëkuptimit dialektik-materialist. Letërsia jonë duhet parë si një fenomen i gjallë e në zhvillim. Së bashku me veprat që nisen nga parime të shëndosha e të përcaktuara mirë, ka vepra, ku shkrimtari tregon se nuk i ka përvetësuar gjer në fund parimet e realizmit socialist ose kur mungon materiali jetësor dhe parimet mbeten si diçka e thatë, e ftohtë dhe vepra nuk ja arrin dot qëllimit. Zhvillimi i letërsisë së re duhet kuptuar gjithmonë e më shumë si një luftë aktive për të njohur sa më thellë jetën, për të përvetësuar më mirë botëkuptimin marksist, për të kuptuar dhe interpretuar shfaqjet e ndërlikuara dhe kontradiktore të jetës, për të pohuar çka është socialiste dhe për të zbuluar e luftuar mbeturinat borgjeze e mikroborgjeze, feudale e patriarkale, për të cilat u fol në plenumin e K. Q. të PPSH në korrik të 1964-ës.

Duke e shikuar në këtë prizëm të zhvillimit të gjallë dhe aktiv, ne mund të themi se viti 1964 ishte një vit me suksese në gjinitë kryesore, një vit që shënoi përparimin në kapjen dhe interpretimin e fenomeneve jetësore nga e sotmja apo nga e kaluara, në pasqyrimin e disa aspekteve të koklavitura shoqërore, në dhënjen

e pathosit patriotik dhe shpirtit luftarak të popullit si dhe në çështje të mjeshtërisë artistike, që, doemos, janë të lidhura ngushtë me përmbajtjen ideore të veprave letrare.

Veprat e mira artistike, siç dihet, lindin nga disa kërkesa e nevoja të kohës, nga bota shpirtërore e një populli, nga faktet dhe problemet aktuale, pavarësisht nga temat dhe subjektet, të cilat mund të jenë nga më të ndryshmet. Ato vepra që nuk e kanë parasysh këtë të vërtetë, që mbeten subjektiviste apo anakronike, nuk ka si të pëlqehen, sado kujdes që të tregojë autori. Me rëndësi është të shihen gjërat me syrin aktual, duke u nisur nga problemet e kohës, natyrisht, siç është thënë edhe herë të tjera, pa u shkëputur kurr nga e vërteta konkrete-historike, pa mbajtur një qëndrim subjektiv dhe të përciptë ndaj fakteve. Pikërisht gjendja në të cilën ndodhet sot vendi ynë, fryma revolucionare e popullit të udhëhequr nga partia, lufta kundër imperializmit, kundër blokadës që desh të na imponohej nga revizionizmi modern, krenaria kombëtare dhe parimet e larta të internacionalizmit proletar, — këto dhe probleme të tjera që burojnë këtej, përcaktojnë krijimin e disa veprave të frymëzuara që mbrojnë idetë e patriotizmit dhe të komunizmit, që lartësojnë shpirtin luftarak të popullit, botën e pasur shpirtërore të njeriut që nuk ka gjë më të shtrenjtë në jetë se sa idetë e komunizmit, të cilat revizionistët duan t'i zbehin dhe t'i shuajnë. Ne mund të përmendim mjaft vepra që kanë tematikë dhe ide të tilla, si «Përse mendohen këto male», të I. Kadresë, «Pranvera e madhe» të Ll. Siliqit, «Devoll, Devoll» të D. Agollit, vjersha të T. Milotit, M. Gurakuqit, Dh. Qiriazit, etj. mund të përmendim vëllimin me tregime «Kënga dhe pushka» të Dh. Shuteriqit, ku përmbledhet një periudhë e gjatë krijimtarië, po ku ka edhe tregime të kohëve të fundit, që u përgjigjen problemeve të sotme të patriotizmit dhe të karakterit të fortë të shqiptarit.

Problemi i pasqyrimit të jetës me tablo të gjera epike, pasqyrimi i epokave të rëndësishme të historisë sonë, i krijimit të personazheve tipike, i zberthimit të

subjekteve që gërshetojnë disa linja, ka lindur prej kohësh, që kur filloi të forcohet, ta ndjejë veten më të sigurt letërsia jonë e re. Ky problem shtrohet me forcë edhe sot, kur del detyra e paraqitjes me mjetet e artit të transformimeve të mëdha shoqërore ose e disa sintezave të rëndësishme për të kaluarën që t'i zbulojnë fenomenet nga pikëpamja shoqërore, klasore, duke treguar shpirtin e popullit, luftën për liri e pavarësi, ose luftën kundër fashizmit, që mobilizoi gjithë popullin kundër armikut dhe tradhëtarëve, atë periudhë aq të pasur në ngjarje e në fakte që janë akoma të gjalla, atë periudhë të lavdishme dhe heroike.

Konkursi tregoi se ky vit ishte i pasur në romane. Kjo lidhet pikërisht me ato kërkesa që zëmë ngoje më lart, me pjekurinë e shkrimtarëve tanë, me përparimin e përgjithshëm të letërsisë. Veprat kryesore që fituan çmimin, «Lumi i vdekur», i J. Xoxes dhe «Para agimit» i Sh. Musarajt publiku i njeh nga disa fragmente që janë botuar dhe që kanë zgjuar interes. Kritika dhe lexuesit do të thonë fjalën e tyre pasi të botohen të plota dhe qëllimi i këtij artikulli nuk është të bëjë vlerësime të pjesëshme. Duke gjykuar nga fragmentet e gjata të botuara, ne mund të themi se këto vepra shprehin tendencën e letërsisë sonë për ta kapur më gjerë realitetin, për t'u thelluar në tipat shoqërorë dhe në rrethanat tipike që lidhen me qëndrimin e klasave, të shtresave dhe të individëve të ndryshëm, me shpirtin luftarak të popullit. Sidomos për gjinitë epike është shumë i rëndësishëm të kuptuarit e fenomenit nga pikëpamja klasore. Idetë e autorit, fryma patriotike dhe revolucionare, sidomos në gjinitë më të gjata, mund të dalë më e fortë, më e ngjeshur me faktet dhe më konkrete, kur të shikohen me një realizëm më të thellë, duke e studjuar shoqërinë, klasat dhe individët në prizmin social, psikologjik dhe, doemos, personal, me tiparet individuale, sepse ndryshe nuk do të bëhej fjalë për art.

Krijimi i ambienteve, i tipave shoqërorë ndihet edhe në disa tregime të A. Abdihoxhës, te vëllimi i tij «Ëndërra dhe dritë», në tregime të disa të rinjve si T. Laço,

etj, ndihet në fragmentet e romanit të H. Petrelës «Kronikë e viteve të paharruara» e në vepra të tjera.

Shpeshherë temat dhe idetë e veprave, problemet që ngrenë ato, nuk mund t'i gjesh të veçanta, po të lidhura e të shkrira me tema dhe ide të tjera dhe kjo, sigurisht, ka të bëjë me karakterin kompleks të jetës, me faktin se e përgjithshmja dhe e veçanta, shoqërorja dhe individualja nuk qëndrojnë të shkëputura nga njerëjtëtra. Gjithmonë është folur tek ne për temën e punës, të klasës punëtore, të tipave që duhet të përgjithësojnë ndërtuesit e socializmit, heroikën e ditëve tona. Dhe gjithmonë ne kemi shfaqur pakënaqësinë tonë në trajtimin e kësaj teme dhe kemi vënë në dukje me gëzim ato vepra që kanë trajtuar mirë, me vërtetësinë dhe thellësinë e duhur, këtë problem. Kjo kërkesë, për temën e punës, nuk mund të kuptohet si diçka e thjeshtë dhe skematike; ajo ka të bëjë me sferën kryesore të jetës, me atë që krijon gjithshka, që përcakton shumë herë karakterin e njeriut, që e zbulon dhe e kalit këtë karakter. Kështu pra, problemi është te marrëdhënjet e njerëzve në punë, te lufta e përditshme kundër mentalitetit, rutinës, zakoneve të vjetra, për afirmimin e qëndrimit të ri në punë. Kjo temë lidhet me ndryshimet rrënjësore në lëmin shoqëror dhe psikologjik, me formimin gradual të ndërgjegjes socialiste. Fije të shumta, të panumërta e lidhin njerinë me botën e vjetër, por gjithmonë më tepër lindin dhe stabilizohen lidhjet e reja me socializmin, me shoqërinë që është në zhvillim. Kur themi për edukimin e njerëzve me qëndrimin e ri ndaj pronës, për të cilën bënte fjalë plenumi i KQ të korrikut 1964, aty për aty kjo mund të duket si diçka që u takon qendrave të punës, shokëve që punojnë atje, dhe sikur arti mund të humbiste nivelin e tij estetik sikur të merrej me tema të tilla. Ky do të ishte një interpretim i cekët ose i gabuar-i çështjes. Sa probleme, mendime, ndjenja, ç'luftë psikologjike, ç'luftë konceptesh të reja dhe të vjetra gërshetohen, kryqëzohen në qëndrimin ndaj pronës! Të mos harrojmë se, sidomos kur është fjala për prozën e gjatë, problemet e marrë-

dhënjeve ekonomike të njerëzve, e pasqyrimin të këtyre marëdhënjeve në botën shpirtërore, e kontradiktave që kanë lindur në këtë sferë, kanë shqetësuar gjithmonë shkrimtarë të mëdhenj realistë, apo të realizmit socialist. Po kuptohet qartë se që të shkruash vepra të tilla duhet studim i jetës, i karaktereve, i problemeve shoqërore dhe ekonomike. Është e qartë për të gjithë se koncepti i vjetër për shkrimtarin apo poetin si për një qëndisës të disa anëve «delikate» të jetës, apo si një grumbullues i fjalëve «poetike» dhe i psherëtimave sentimentale, që ndonjë natyrë tepër të ndieshme mund ta bëjë të qajë, ky koncept tingëllon shumë i huaj dhe anakronik tani kur vendi ynë i këndon punës, që i ka ndërruar pamjen atdheut.

Ky problem është shumë aktual dhe sigurisht që do të preokupojë letërsinë tonë në vitin 1965 e më vonë gjersa ne të shënojmë një kthesë të rëndësishme në mënyrë të njëanshme, sikur ky synim do të na largojë nga temat e tjera që janë gjithashtu të rëndësishme.

Në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë letërsia jonë i është përgjegjur deri diku kësaj nevojë edhe gjatë vitit 1964 dhe kjo përbën një nga sukseset e saj. Vepra si «Rrugë të tërthorta» e Q. Buxhelit, e cila rikrijon atmosferën e gjallë të ditëve të punës vullnetare në hekurudhë; «Doktor Aleks» e I. Uruçit, që shtron problemin e afrimit drejt partisë të intelektualëve të ndershëm dhe që tregon bukur dashurinë e madhe për punën, gëzimin që mund t'i sjellë njeriut puna; novela e V. Koçit «Jetë», e cila tregon optimizmin e një mjeku që gjen jetë interesante në një qytet të vogël; «Vargje për dritën» e F. Arapit, ku autori poetizon dritën që i japin punëtorët Shqipërisë dhe tregon vështirësitë që hasen në rrugën e përparimit, — këto vepra si edhe të tjera, janë një shenjë e mirë për pasqyrimin e këtij aspekti kaq të rëndësishëm të realitetit tonë. Letërsia jonë do të zhvillohet në këtë drejtim, duke shtuar përpjekjet për cilësi të lartë artistike, gjë që lidhet ngushtë me pasurinë e materialit jetësor, me pasurinë e përshtyp-

jeve dhe me shprehësinë e kapjes së temës, e të krijimit të subjektit.

Jeta është e shumanshme dhe problemet që shtron ajo janë të shumta. Temat e pasqyrimin të shpirtit revolucionar të popullit, e përballimit të vështirësive, nën udhëheqjen e partisë, tema e luftës për ndërtimin e socializmit, e procesit në të cilën formohet njeriu i ri, janë të lidhura edhe me temën morale dhe etike, me temën e lumtërisë në jetë, e luftës kundër paragjyqimeve apo tepërimeve, në emër gjoja të përparimit. Lufta kundër frymës mikroborgjeze dhe meskine, për mbrojtjen e moralit të ri dhe të personalitetit të njeriut, për çlirimin shpirtëror të njeriut, që jeton në socializëm, po që mund të pengohet në rrugën e tij nga ambienti konservator, nga lidhjet e shumta me botën e vjetër të struktura në ndërgjegje, — kjo luftë përbën një nga detyrat fisnike të letërsisë sonë, bartëse e ideve revolucionare, e ideve të moralit më të përparuar dhe më njerëzor, të moralit komunist.

Prej disa vjetësh, tema e familjes, e dashurisë, e jetës bashkëshortore, e mpleksur me tema të tjera, ose më vete, preokupon letërsinë tonë. Kjo është një kërkesë e kohës që lidhet me normat e shoqërisë së re, me formimin e familjes socialiste, me nevojën e përcaktimit më të mirë të qëndrimit moral dhe etik, me progresin e shoqërisë dhe me kalimin nga gjendja e prapambetur feudale e patriarkale, borgjeze e mikroborgjeze, në një gjendje të re socialiste.

Ka pasur në letërsinë tonë raste kur, në kërkim të së resë dhe duke mbrojtur moralin e ri që nuk mban erë myk, problemi është thjeshtësuar pak dhe është kalluar në ekstremin tjetër. Bukuria e ndjenjave, thellësia e tyre është tipike për shoqërinë socialiste, largimi nga sentimentalizmi, nga bota e mbyllur mesjetare, nga hipersensibiliteti i ndjenjës, nga të jetuarit romantik vetëm në emër të dashurisë dhe nga humbja e shpresave dhe e dëshirës për të jetuar, kur humbet të dashurën, — ky largim i domosdoshëm dhe kjo flakje e të tilla koncepteve që i takojnë një bote tjetër, nuk do të thotë

aspak se ndjenja e dashurisë, e kontradiktave në këtë sferë dhe e idealeve të reja që përfshijnë në vetëvete një romantikë të shëndoshë, duhet parë në mënyrë të thjeshtësuar dhe të përciptë. Ne kemi nevojë për vepra të thella me këtë temë, për gërshetimin e problemeve, për lidhjen e çështjeve familjare me çështjet më të gjera shoqërore, me probleme kombëtare.

Çështjet që përmenda, në mënyra të ndryshme dhe me stile të ndryshme, janë trajtuar gjatë vitit që shkoi. Drama «Shtëpia në bulevard» e F. Paçramit ka tërhequr vëmendjen e publikut për ngritjen e problemeve shoqërore, të lidhjeve midis prindërve dhe fëmijëve, të luftës kundër konservatorizmit, në njerën anë, dhe qëndrimit mendjehhtë, të cekët, në anën tjetër. Realiteti socialist ndihmon për farkëtimin e lumtërisë personale të njerëzve; ai rrit personalitetin e njeriut dhe të femrës. E. Kadareja në novelën «Shuaje dritën, Vera» përshkruan ndjenjat e holla të një vajze të re të ditëve tona që shkëputet, më në fund, nga ambienti konservator dhe që do ta krijojë lumtërinë vetë, midis njerëzve të rinj dhe jo e mbyllur në një ambient të ngushtë. Novela lufton kundër despotizmit të ndjenjës, së dashurisë, në mbrojtje të ndjenjave të vërteta njerëzore.

Këto probleme do të dalin edhe në të ardhmen për letërsinë tonë. Duke forcuar idenë e së resë, të moralit komunist, shkrimtarët duhet të mundohen që ta pasqyrojnë fenomenin në dialektikën e vet, në raportet e shumanshme të brezave të ndryshëm, të lidhjes me traditën e shëndoshë dhe në prizmin e forcës së realitetit socialist për të edukuar dhe riedukuar me durim njerëzit e brezave të ndryshëm.

Pasuria e stileve, larmia e veprave të ndryshme s'ka dyshim që dëshmon për vitalitetin e një letërsie. Ky tippar vihet re prej disa vjetësh tek ne. Edhe viti që shkoi na dha vepra nga më të ndryshmet për mënyrën e të konceptuarit dhe të stilit. Romani i I. Kadaresë «Gjenerali i ushtrisë së vdekur» zgjoi interesin e lexuesve, në radhë të parë, për idenë e forcës së atdheut, për mbrojtjen e mendimit kaq aktual dhe të rëndësishëm, se

kushdo që të provojë të vijë tek ne si armik do të lejë kockat. Po kjo ide tërhoqi vëmendjen, doemos, në një realizim të bukur dhe origjinal, në kompozimin e disa momenteve kulminante me forcë të përmbajtur, po të thellë, emocionale dhe të shprehur me një gjuhë të figurshme.

Viti që shkoi tregoi zhvillimin e mëtejshëm të letërsisë sonë të realizmit socialist, përparimin në thellësi dhe në cilësi, solli mbarësi në gjinitë e ndryshme dhe ndihmoi për të hapur udhën më tutje. Sukseset janë të dukshme dhe lidhen me përmbajtjen e me formën, me pasurimin e tematikës dhe me përvetësimin e mëtejshëm të mjeshtërisë.

Krahas me përparimin në përmbajtjen ideore dhe në formën artistike, përpara letërsisë sonë shtrohet detyra e ruajtjes së pastërtisë ideologjike, e luftës për të mos lejuar asnjë ndikim borgjez dhe revizionist, e luftës kundër çdo shfaqjeje mesquine, e përpjekjeve për të krijuar vepra të qarta, të thella dhe të kuptueshme nga masat, e veprave novatore, të mbështetura në traditën.

Lidhja më e ngushtë me jetën, njohja më e thellë e njerëzve të rinj, siç u shtrua me forcë në plenumin e korrikut, do ta pasurojë letërsinë tonë, do t'i sjellë nota të reja, të freskëta, një tingëllim edhe më optimist e më mobilizonjës.

Problemet e rëndësishme për një trajtim më të gjerë e më të thellë të temave aktuale, të pasqyrimin të transformimeve socialiste, të jehonës më të shpejtë e më me forcë ndaj ngjarjeve dhe fakteve revolucionare në luftën kundër imperializmit dhe revizionizmit modern, problemet e paraqitjes së jetës së sotme apo të kaluar në shumanëshmërinë e saj, me vërtetësi konkrete historike, sipas parimit të partishmërisë — do të preokupojnë edhe më tepër këtë vit letërsinë tonë. Këto probleme duhet të gjejnë një zgjidhje më të plotë më 1965.

1965.

PER NJE PASQYRIM TE SHUMANSHEM TE JETES NE PROZE

Tani ka ardhur koha qe letersia jonë, si edhe artet e tjera, të hyjnë më me guxim në një fazë të re të zhvillimit më të madh të cilësisë, në fazën e pjekurisë së tyre, të thellimit në fenomenet e jetës, në karakteret njerëzore. Lidhur me këtë problem në vendimin e KQ të PPSH «Mbi zhvillimin e mëtejshëm të letërsisë dhe arteve thuhet: «...dekadat e ardhshme do të sjellin një përparim cilësor të dukshëm, karakteristika e të cilit duhet të jetë hyrja në thellësi në proceset e ndryshimeve që po bëhen në vendin dhe në njerëzit tanë».

Synimi drejt cilësisë në art është, pa dyshim, një veçori e vetë procesit të krijimit, e vetë artit, i cili nuk mund të kuptohet pa shprehjen e duhur që mishëron idetë e shkrimtarit përmes tablosh e figurash, pa gjuhë të përshtatshme, të thjeshtë, po të pasur. Kjo veçori gjendet si diçka organike në vetë natyrën e artit dhe del në të gjitha periudhat e zhvillimit të tij, po ka faza të caktuara, kur është arritur një eksperiencë, një grumbullim i mjaftueshëm sasior i materialit dhe kjo gjë jep mundësi, krijon kushtet për të nxjerrë në plan të parë nevojën e përparimit cilësor e të zhvillimit në thellësi. Letërsia jonë ka hyrë në fazën e pjekurisë. Kjo lidhet me punën e gjertanishme të shkrimtarëve tanë: sukseset dhe dobësitë e veprave u kanë vlejtur atyre për të kuptuar më mirë rrugën ku duhet të ecin, gjininë që u përshtatet më tepër, mënyrën e të shkruarit, atë që shpreh më shumë personalitetin e secilit. Pjekuria

e letërsisë ka të bëjë me përvetësimin më të mirë të ideologjisë marksiste-leniniste nga ana e shkrimtarëve. Përveç këtyre, pjekuria e letërsisë varet nga përparimi i jetës sonë, nga fakti se ne hyjmë në fazën e ndërtimit të plotë të socializmit, ngaqë del gjithnjë më e qartë, më e përcaktuar figura shoqërore dhe morale e njeriut të sotëm. Njeriu i socializmit, duke trashëguar gjithë idetë përparimtare dhe patriotike të së kaluarës, për vetë rolin që kryen në shoqëri, i lidhur ngushtë me kolektivin, me mjete të përparuara teknike, është i pajisur me koncepte më të vërteta dhe më të thella mbi botën; në ndërgjegjen e tij hedh gjithmonë e më shumë rrinjë botëkuptimi materialist i partishëm që nuk pajtohet kurrsesi me pasivitetin, me mënjanimin prej kolektivit, me pasigurinë në jetë, me përceptimin sentimental të botës. Rritja shpirtërore e këtij njeriu që bëhet tani më i pjekur, të cilit i hapen sytë për të kuptuar më mirë jo vetëm të sotmen, po edhe të shkuarën në tërë kompleksin e vet, doemos, nuk është një proces i thjeshtë dhe i sheshuar, po arrihet me luftë, me ndeshjen e të kundërtave.

Nga kjo kohë dhe nga këta njerëz duhet të nisët letërsia jonë e sotme për t'iu përgjegjur kërkesave historike, për të siguruar një cilësi më të lartë dhe për të hyrë më thellë në fenomenet e jetës.

* * *

Po ta shohim problemin në këtë prizëm, çfarë përparimi është vënë re vjetët e fundit në prozën tonë? Çfarë tiparësh më të theksuara dalin në pah?

Shumë nga shkrimtarët tanë me eksperiencë kanë dhënë kontributin e tyre në krijimin e heronjve pozitivë të jetës sonë. Siç është thënë edhe shumë herë të tjera e siç thuhet edhe në Vendimin e KQ, kjo është një detyrë shumë e rëndësishme, që nuk ka gjetur akoma zgjidhje të plotë dhe të shumanshme. Po ka një tendencë, ndonëse ende jo aq të fortë, drejt krijimit të karaktereve më realiste, më plastike e pozitive, drejt krijimit të figurave me vërtetësi më të madhe dhe me diapazon më

të gjerë shpirtëror. Kanë pasur sukses vjetët e fundit nga kjo pikëpamje shkrimtarët Fatmir Gjata, Petro Marko. Figurat e Stavri Larës në «Kënetë» dhe të Gori Gjinlekës në «Hasta la vista» kanë botën e tyre shpirtërore, kontradiktat, dobësitë njerëzore dhe kjo i bën më të besueshëm, më realistë. (Me këtë nuk dua të them se çdo personazh pozitiv duhet të paraqitet me disa dobësi. E kam fjalën për këto raste konkrete). Rezultate të mira në krijimin e disa figurave pozitive kanë arritur edhe shkrimtarët Ali Abdihoxha e Qamil Buxheli me veprat «Një vjeshtë me stuhi» e «Kali i mbretit dhe kalorës të rinj».

Përparimi nuk vjen menjëherë dhe te të gjithë njësoj. Shpesh personazhet pozitive nuk janë ende komplekse dhe të pasura në nuanca, po dalin të veshura me një vello subjektive, që ngjall emocione te lexonjësi, po nuk krijon individualitete të qarta, të gdhëndura mirë, që të vlejné edhe më shumë akoma si shembull pozitiv për brezin e sotëm. Kjo vihet re, sipas mendimit tim, edhe te romani «Një vjeshtë me stuhi», ku ka mendime dhe karaktere të vërteta.

Sot është puna për të kaluar nga më e thjeshta te më kompleksja, nga njohja shpeshherë e përciptë e karaktereve, te njohja më e thellë. Në krijimin e personazheve pozitive, mendoj se ka dy vështirësi, që duhen kaluar nga shkrimtari: 1) njohja më e mirë e karaktereve dhe 2) një problem i llojit estetik — të shmangurit nga uniformiteti në paraqitjen e tyre, nga pasqyrimi i një linje të thjeshtësuar.

Një tipar karakteristik i prozës sonë, që ka lindur qysh me veprat e para të realizmit socialist e që tregon tani pjekurinë e tij, është realizmi që e karakterizon edhe në veprat e fundit, të cilat, ndonëse më tepër për të kaluarën, shprehin mendimet e kohës, forcën e pozitave tona dhe mprehjen e syrit realist.

Një shenjë e pjekurisë së prozës sonë është largimi në disa vepra nga skematizmi, nga karikataturizimi pa vend i tipave negativë, paraqitja më realiste e njerëzve me kontradikta të rëndësishme. Kjo ndihmon për t'iu afruar

më tepër së vërtetës, për t'i njohur më mirë fenomenet shoqërore, për të besuar se ajo që nxjerr shkrimtari si të keqe është vërtet e tillë dhe duhet urreyer e luftuar aq më ashpër, sa më e rrezikshme dhe e qëndrueshme të jetë. Ky largim nga skematizmi vihet re te romanet «Një vjeshtë me stuhi» dhe «Qyteti i fundit», si edhe te disa tregime. Në disa raste ne shohim mirë në vepra shkaqet shoqërore që shtyjnë njerëzit të marrin këtë ose atë udhë: shkrimtari nuk kufizohet në fenomenin që analizon, po këqyr prapa tij, në thellësi, dhe kështu vepra merr një karakter më përgjithësues. Shpeshherë nuk është puna te njerëzit e veçuar, po te vetë jeta që çon drejt humbjes, drejt vdekjes së të vjetrës, ndonëse për të mbase nuk flitet aq hapët. Kjo qëndron si sfond i fuqishëm, nënkuptohet fare mirë.

Po në krijimin e personazheve jo vetëm në prozë, po aq më tepër në dramë, ne vuajmë akoma nga mungesa e motiveve bindëse të veprimeve, të rrugës së heronjve. Kjo ka arsye të ndryshme: duhet njohur fenomeni, duhet aftësi mendimi dhe përgjithësimi në analizën e tij, duhet përvetësuar më mirë teknika e të shkruarit, mjeshhtëria e kompozicionit. Kritika i ka vënë në dukje këto të meta edhe për romanin e P. Markos «Qyteti i fundit», edhe për vepra të tjera.

Sot para prozës sonë, ashtu si para gjithë letërsisë dhe arteve, shtrohet çështja e dhënjes së sintezave artistike më të rëndësishme të aktualitetit, e krijimit të figurave komplekse, që të veprojnë në një ambient të caktuar shoqëror, që në aksion e sipër të zbulojnë anët e ndryshme të karakterit të tyre dhe të qëndrimit ndaj punës, ndaj familjes, ndaj shoqërisë në tërësi. Ne kemi nevojë për vepra ku të gërshetohen problemet shoqërore, politike dhe morale në një sintezë më të plotë, që do të pasqyrojë më mirë njerëzit dhe idetë e kohës. Një vështrim më i thellë i artistit ndaj jetës është i domosdoshëm jo vetëm për interpretimin dhe pasqyrimin e fenomeneve të sotme, po edhe për të krijuar vepra me vlerë më të madhe shoqërore dhe artistike mbi të kaluarën. Pasqyrimi më i thellë i realitetit, krijimi në veprat

letrare i figurës komplekse të njeriut të sotëm, interpretimi i jetës në mënyrë më realiste, më plastike, kalmi nga njohja empirike në disa raste e botës në një njohje më të saktë, më përgjithësuese, që lejon të bësh sinteza dhe të ngjeshësh veprën me mendim emocional, si dhe paraqitja e tipareve të reja në ndërgjegjen e njerëzve, e dialektikës së zhvillimit të mendimit dhe të ndjenjave, të gjitha këto, që lidhen me njera-tjetrën, përcaktojnë në fazën e sotme përparimin e letërsisë, novatorizmin e saj, kërkimet drejt së resë. Problemi i novatorizmit është, në radhë të parë, një problem esencial i brendisë, e cila përcakton edhe ndryshimet në formë, sadoqë lidhja e brendisë dhe e formës nuk mund të merret si diçka mekanike. Prandaj çështja e novatorizmit në poezi, prozë e dramaturgji nuk fillon me shfaqjet e saj të jashtme: varg i lirë, roman i shkurtër «sintetik» apo novacione të skenës, si futja e korit etj. Shfaqjet e jashtme duhen parë më thellë, në raport me brendinë, si rezultat i zhvillimit të saj, i zhvillimit të vetë jetës.

Romanet e A. Abdihoxhës, të P. Markos (po i marrim këto më tepër si dy vepra të fundit) dëshmojnë për kërkimet e autorëve, për përpjekjet e tyre që ta shohin jetën me sy realist, nga një kënd më i gjerë vështrimi. Te «Një vjeshtë me stuhi» autori ka pasur sukses në zbërthimin e botës të brendshme të njerëzve, në motivimin psikologjik të aksionit, në dhënjen e figurave komplekse. P. Markua te «Qyteti i fundit» do të thoshja se, ndofta, nuk ka pasur gjithmonë rezultate të mira pikërisht në motivimin psikologjik të veprimit të personazheve, po ka mundur të krijojë me një stil poetik figura komplekse. Interesant është në romanin e tij thjeshtësia e subjektit. Këtu nuk kemi të bëjmë me ngjarjet epike të Spanjës, po me zhvillimin e një drame shpirtërore buzë detit, me zbulimin e disa karaktereve. Zbërthimi i një subjekti të thjeshtë, detajimi artistik i ngjarjes në një kohë aq të shkurtër prej 7 ditësh, interesimi që ka mundur të ngjallë përgjithësisht autori, janë kuptimplote për zhvillimin e prozës realiste, për mundësitë e pamatura që i

hapen asaj të gjejë sa më shumë objekte dhe në ato ngjarje të përditshme, në dukje të zakonshme. Kjo shtrirje zgjeron mundësitë e njohjes dhe të pasqyrimin të jetës.

Shumë bisedohet sot në botë për stilin e kohës në letërsi. Duke mohuar karakterin shoqëror të artit, përfaqësues të estetikës, borgjeze mohojnë romanin si gjini, i quajnë të vjetëruar Stendalin, Tolstoin, etj. Ata mbrojnë «psikanalizën», renditjen e sensacioneve të shkëputura nga brendia shoqërore; të tjerë përshkruajnë vetëm anët e jashtme, një grumbullim kaotik veprimesh. Këto tendenca lidhen me shkëputjen e artit borgjez nga jeta shoqërore, me mbulimin e kontradiktave, me rënjen e personalitetit të njeriut, i cili për artistët dekadentë nuk lot më asnjë rol në shoqëri.

Tradita realiste e artit përbën një bazë të rëndësishme në zhvillimin e realizmit socialist. S'ka dyshim se edhe stili evoluon, ndodhin një sërë ndryshimesh estetike që bien ose që s'bien në sy menjëherë, po që në të vërtetë ekzistojnë. Këto ndryshime nuk janë çështje të modës dhe nuk vijnë nga dëshira subjektive. A mund të thuash se duhet të ketë sot një stil të përbashkët të kohës, se të gjithë duhet të shkruajnë pak a shumë pas këtij stili? Është e qartë që kjo s'mund të thuhet. Gjithshka varet nga pozita ideologjike, nga individualiteti i shkrimtarit, nga tema, nga ideja që ai mbron. Megjithatë, duke u nisur nga praktika e letërsisë përparimtare botërore, nga praktika jonë, nga vetë kërkesat e kushteve të reja shoqërore, mund të arrihet në pohime rreth disa veçorive të përgjithshme për stilin e sotëm, po ta marrim këtë term në kuptimin e tij të gjerë.

Sot kur mendimi njerëzor ka bërë shumë hapa përpara, edhe shkrimtari duhet të qëndrojë në lartësinë e këtyre mendimeve dhe vepra e tij të mos jetë vetëm përshkruese, rrëfenjëse, po e mbrujtur me mendim, me sinteza të jetës, të shprehura këto, natyrisht, në formë artistike, përmes figurash. Kjo detyrë ka dalë gjithmonë përpara artit, po sa kohë shkon aq më e theksuar bëhet. Përshkrimet e tepëruara të natyrës, krahasimet naive dhe primitive i japin veprës një karakter të jashtëm dhe

ato nganjëherë mund të kënaqin një kategori lexonjë-sish, po nuk u mësojnë atyre ndonjë gjë të madhe.

Edhe veprat që nuk krijojnë dot tipa, nuk ngrënë probleme, po mund të ngjallin një kënaqësi estetike me lirizmin e tyre, me gjuhën, kanë doemos vlerë dhe lozin rol te lexuesi, po kjo gjë mendoj se nuk mund të bëhet sot si metodë krijimi për një prozator, pasi do ta çojë prapa, do të shkaktojë përsëritjen e disa motiveve të njohura, kërkimin vetëm të shprehjeve dhe frazave të bukura. Shkrimtari Sotir Andoni na ka dhënë mjaft tregime të bukura, të singerta, që lexohen me ëndje dhe të ngjallin emocione. Po ka edhe tregime të tij që mbeten vetëm stilizime, rrëfime popullore, që nuk sjellin asgjë të re dhe mund të krijojnë monotoni në krijimtarinë e autorit.

Natyrisht ka prozatorë më të shtruar e më të shpejtë në stilin e tyre. Kjo është çështje individualiteti. Po mendoj se vetë ritmi më i vrullshëm i jetës së sotme, konceptimi më i zhdërvjelltë i çështjeve, vetë roli më aktiv i njeriut jo më të veçuar e të mbyllur në guaskën e vet, po të lidhur me shoqërinë, — këto duhet të përcaktojnë edhe ritmin e brendshëm të veprave letrare, dinamizmin e tyre, jo vetëm kur është fjala për të sotmen, po në mënyrën e të konceptuarit të jetës përgjithësisht. Po ky ritëm nuk mund të kuptohet si diçka e jashtme, as kur është fjala për zgjedhjen e subjektit me të papritura e efekte të shpejta.

Këto ishin disa mendime rreth prozës sonë, rreth detyrave të reja që dalin para letërsisë dhe disa veçori të stilit të sotëm. Vendimi i KQ të PPSH ngre një sërë problemesh të rëndësishme të letërsisë dhe arteve tona, të cilat po fillojnë të diskutohen dhe shpresojmë se do të marrin një karakter më konkret. Një bisedim i gjerë rreth këtyre çështjeve do të ndihmojnë në zhvillimin e mendimit kritik, në të kuptuarit e anëve të mira dhe të dobëta të veprave tona dhe kjo do të krijojë mundësinë për të vazhduar më me guxim e siguri në rrugën drejt përparimit cilësor, në rrugën e pjekurisë.

1961

TË FORCOJMË QËNDRIMIN IDEOLOGJIK NË TREGIMET TONA, TË PASUROJMË BRENDINË E TYRE

Vitet e fundit ne kemi pasur më shumë sukses në gjininë e romanit. Ishte i domosdoshëm, dhe mbetet i tillë, një përparim më i madh i romanit tonë si gjini letrare, që mund të përfshijë jetën në shumë pamje, që mund të ndjekë një rugë më të gjatë të karaktereve dhe të pasqyrojë punën dhe luftën e masave punonjëse më gjerësisht.

Po, përveç romanit, tek ne kanë marrë zhvillim edhe gjinitë e shkurtëra, si tregimi (ose novela), sukseset e të cilit vitet e fundit, ndofta, nuk kanë qenë aq të dukshme, ndonëse janë botuar disa vëllime dhe shumë tregime në shtypin tonë periodik letrar si edhe në «Zërin e Rinisë». Duke marrë parasysh edhe përvojën e mëparshme e sidomos duke u mbështetur në krijimtarinë e këtyre dy-tre vjetve të fundit në fushën e tregimit, mund të jepen vlerësime, të kuptohet se çfarë është e shëndoshë, e re, që duhet zhvilluar dhe çfarë është e dobët, e paarrirë ose me gabime e që nuk duhet zhvilluar.

Nuk do të ishte me vend të jepnim një panoramë të sipërfaqhtë të zhvillimit të tregimit shqiptar në përgjithësi. Megjithatë, me pak fjalë, për të lidhur problemin aktual, mund të themi, se tregimi ynë ka tradita të një trajtimi patriotik dhe shoqëror të realitetit. Ne mbështetemi në traditën e shkëlqyer realiste të Migjenit, i cili ishte dhe një prozator i fortë, një demaskonjës i pamëshirshëm i shoqërisë së kohës së vet, i shtypjes borgjeze dhe patriarkale. Në gjinitë e shkurtëra, qofshin

këto tregime, skica apo pamflete, kanë kontribuar, në të kaluarën, Nonda Bulka, Petro Marko, Andrea Varfi, etj.

Letërsia e re shqipe e realizmit socialist thelloi tendencën shoqërore dhe klasore të prozës sonë dhe të tregimit veçanërisht. Forma e tregimit u bë më e përcaktuar, më artistike. Shkrimtarët, duke përvetësuar një botëkuptim të ri dhe duke pasur përpara një realitet që ndryshonte në mënyrë revolucionare, u bënë në militantë, më të partishëm dhe heroi kryesor i veprave të tyre u bë populli, njerëzit e dalë nga gjiri i tij. Kështu janë marrë me tregimin tek ne përfaqësues të një brezi më të vjetër e më të ri si Dhimitër Shuteriqi, Zihni Sako, Sterjo Spasse, Shevqet Musaraj, Naum Priifti, Sotir Andoni, Miço Kallamata, Nasho Jorgaqi, Ali Abdihoxha, Moisi Zaloshnja, Theodhor Laço, Agim Cerga e mjaft të tjerë.

Tregimet e shkruara pas çlirimit kanë trajtuar temën e luftës nacionalçlirimtare, të transformimeve shoqërore, temën e familjes dhe të dashurisë. Në përgjithësi tregimet tona kanë përmbajtje të drejtë, karaktere kombëtare, zhvillohen në ambientin tonë shqiptar, dhe ka pasur përpjekje për t'u thelluar në botën e brendshme të njerëzve, për të pasqyruar më mirë ndryshimet shoqërore dhe proceset psikologjike, të lidhura me këto ndryshime.

Një vend të mirë në tregimet tona zë tema e kolektivizimit të fshatit, e brengave dhe e halleve të fshatit në të kaluarën. Ka tregime që i kushtohen punës e ndonjë klasës punëtore, por këto janë ende të pakta, bile shumë të pakta. Tregimi, si një gjini e shkathët, e efektshme, që mund t'u përgjigjet më shpejt nevojave imediate, ka mundësi të trajtojë më shpejt këtë problem, duke u nisur nga detyra që shtron plenumi i 15 i KQ të PPSH, nga nevoja e kohës, nga dëshira për ta vënë më mirë artin në shërbim të masave punonjëse.

Ndonëse fryma e përgjithshme e tregimit tonë është e shëndoshë, shpeshherë vihet re, sidomos te ndonjë i ri, një largim nga temat qendrore të jetës sonë, apasionim ndaj temash të vogla erotike, të shikuarit e dashurisë dhe të lumtërisë në një prizëm pak të ngushtë,

të palidhur sa duhet me problemet shoqërore, me realitetin e gjallë, ku personazhet me të vërtetë veprojnë. Veç asaj, vihen re vitet e fundit aty-këtu tendenca objektivistë, kur nuk mbahet një qëndrim i saktë, i partishtëm, po ku shkrimtari e përshkruan ngjarjen, kritikon në një farë mënyre dhe pastaj sikur hiqet mënjanë. Mungon në disa raste fryma e thellë revolucionare dhe shkrimtari jepet shumë pas dhimbjes, padashur kultivon këtë ndjenjë në vend që të zgjojë plotësisht atmosferën heroike dhe triumfonjëse, e cila ta mundë dhimbjen dhe dëshpërimin. Ka tregime ku ideja nuk është e qartë, kur ajo humbet në kërkimet formale, kur përdoren konvencione të tepëruara, që nuk burojnë organikisht nga brendia dhe prandaj vepra s'kuptohet nuk u shërben lexuesve.

Këto mendime të përgjithshme për tregimet e viteve të fundit, për tendencat pozitive dhe negative do të mundohemi t'i konkretizojmë në këtë artikull.

* * *

Megjithëse akoma pak dhe jo në përpjesëtimet dhe në thellësinë e duhur, disa të rinj, kanë filluar të kapin në tregimet e tyre temën e punës, ta trajtojnë drejt atë; ka edhe përpjekje për të pasqyruar vrullin e punës pas Letrës së Hapur, për të shtruar problemin e luftës kundër vështirësive në një frymë revolucionare, pa i sheshuar kontradiktat, po duke i zbuluar ato dhe duke vënë në dukje fitoren e së resë, perspektivën. Siç e thamë, ne nuk kemi akoma vepra të plota, të rëndësishme me një nivel të lartë artistik që t'i kushtohen kësaj teme aktuale. Po një erë e tillë ka filluar të fryjë në shkrimet tona dhe kësaj i takon e ardhmja. Ne mund të përmendim tregime të kohëve të fundit si «Era e tokës», «Mbarim vjeshte» dhe «Brazdat e gurta» të prozatorit të ri Teodor Laço i cili punon si agronom dhe ka mundur t'i njohë nga afër problemet që trajton. Në këto shkrime të tij shtrohet qëndrimi ndaj punës, poezia që sjell puna, kapërcimi i vështirësive dhe i pikëpamjeve të ngushta, për ta lënë gjithshka ashtu siç e kemi gjetur, këmbëngul-

ja e njeriut të ri, të socializmit për të gjallëruar edhe ato toka që duken të shkreta e të lëna djerrë. Në tregimet «Prova» dhe «Shkëlqim i rremë» Agim Cerga bën fjalë, në të parin për guximin e një shoferi që çan akullin dhe shkon përpara dhe, në tjetrin, lufton burokratizmin, shkëlqimin e rremë të «mehmurit» që është mbyllur në zyrë dhe kënaqet me jetën e tij mikroborgjeze. Këto tregime të shkurtëra, në vetvete ja arrijnë qëllimit, po autori mund të shkruajë më shumë me tema të tilla, ku të kapet më gjërë dhe më thellë problemi i qëndrimit ndaj punës, ndaj vështirësive, sepse në këto kushte, në radhë të parë, njihen karakteret e vërteta.

Këtë temë e ka rrahur edhe Sotir Andoni, si p.sh. në tregimin «Nënkryetar Nexhipi», ku ndeshet koncepti i vjetër dhe koncepti i ri për punën në kooperativë, ku bëhet fjalë për kontradikta joantagoniste, të cilat kanë mundësi të zgjidhen në shoqërinë tonë.

Shkrimtarët tanë, që kanë shkruar në bazë, kanë filluar të kapin temën e punës, të qëndrimit të masave punonjëse ndaj detyrave që shtron partia, në përshkrimet e reportazhet e tyre. Kjo, padyshim, është pozitive, vetëm mendojmë se duhet luftuar për thellësi më të madhe në këto shkrime letrare - gazetareske, për t'u përqëndruar në një problem, në disa tipa, në disa karaktere, për të treguar përpjekjet dhe sukseset reale, luftën e madhe për formimin e njeriut në punë e sipër. Duke mbledhur përshtypje, duke hyrë në jetë, ata me siguri do të kalojnë nga përshkrimi të tregimi, novela, ose të gjini më të mëdha që kërkojnë një kohë më të gjatë.

Fakti që po merren me temën e punës prozatorë të rinj, forca të reja që sapa hyjnë ose përcaktojnë më mirë fytyrën e tyre në letërsi, përveç atyre që përmendëm, edhe të tjerë si Vath Koreshi, Bedri Myftari, Faik Ballanca, — është shenjë e mirë që duhet përshëndetur. Mëdimi naiv dhe foshnjarak, që vihet re nganjëherë, sidomos te të rinjtë, se po s'pati tregimi edhe pak dashuri brenda, se po s'u lidh puna doemos me dashurinë, disa herë libeske dhe bajate, po zbehet dalngadalë, sepse jeta nuk pranon skema dhe sheqerosje që të velin. Natyrisht jeta

duhet marrë në kompleksin e vet, bukuria qëndron te harmonia e gjërave, te uniteti i tyre, po gjithmonë duhet kuptuar thelbi, duhet zbuluar ajo që përcakton karakterin njerëzor. Këtu nuk është fjala për një lidhje mekanike të gjërave, për kaq për qind punë dhe kaq për qind dashuri. Gjithshka vjen organike, e natyrshme. Plenumi i 15 i KQ të PPSH shtronte qartë problemin e temës qëndrore të punës dhe të heroizmit të popullit tonë edhe temat që lidhen me dashurinë, me familjen, me marrëdhënjet intime, pa i shkëputur nga shoqëria, nga problemet e kohës, ndihmojnë për edukimin e masave, kur trajtohen mirë, kur shihen nga një kënd vështrimi i qartë dhe i drejtë.

Po nuk zgjidhet gjithmonë drejtë problemi i dashurisë, i familjes, i luftës kundër meskinitetit. Është folur për të metat e librit të D. Agollit «Zhurmë e erërave të dikurshme». Tregimet e tij «Kur dashuroja një grua» dhe «Ajo që...» nuk edukojnë me moralin tonë; autori do të luftojë meskinitetin, po nga pozita të padrejta që, në vetvete, mbeten meskine. Nuk ka asgjë fisnike, që të pajtohet me moralin tonë, të shkosh për vizitë te një shok dhe t'i marrësh gruan. Nuk do të zgjatemi, se për këtë është shkruar gjerë e gjatë. E kishim fjalën për ta lidhur me diçka tjetër, me disa shenja që një moral i tillë mund të bëhet si «modë», në emër gjoja të përparimit dhe të luftës kundër «jetës së ngushtë». Kështu, p.sh., edhe tregimi i Agim Cergës «Dritë në fushë» nis nga tema e punës, nga vështërsitë e para të një veterineri dhe entuziazmi për të punuar, po tema e nisur zhvendoset dhe zhvillohet me historinë e dashurisë së veterinerit për gruan e një infermieri, Retin, me largimin e saj prej të shoqit. Tregimi është i dobët, libesk dhe lufta kundër meskinitetit të të shoqit të Retit mbetet vetëm diçka e zbetë, e trilluar, që nuk ka forcë jetësore. Nuk ka asgjë edukonjëse për realitetin tonë, asgjë fisnike dhe të moralshme, asgjë të domosdoshme, siç na përshkruhet në tregim, në këto «rrëmbime» ose «largime» grash! Vetëm spostohet problemi, edukohet keq lexuesi dhe largohemi nga orientimi i drejtë për të

kapur tema qendrore e për t'i parë edhe temat e dashurisë sipas moralit tonë komunist. Ndonëse më mirë e me një moral më të drejtë, edhe në tregimin tjetër të Agim Cergës «Rreze në botën time» puna nuk zë vendin e duhur, sadoqë tregimi bën fjalë për gjeologë e për sektorë pune. Njohja e paktë e jetës, ndikimi i librave e kanë çuar autorin në këto tregime drejt skemave dhe largimit nga problemet më të rëndësishme dhe reale të jetës.

Vitet e fundit janë shkruar tregime me një qëndrim të qartë ideo-emocional, tregime që i këndojnë heroizmit të luftës ose të ditëve tona. Por edhe tregime të tilla duhen shkruar më tepër; ka akoma pak në krahasim me kërkesat dhe nevojat e lexuesve.

Ne mund të përmendim disa tregime me një frymë të qartë luftarake, që tregojnë guximin e popullit tonë gjatë luftës, fytyrën e vërtetë të armikut, lidhjen e jetës së sotme me traditat luftarake, heroizmin e ushtarëve të kufirit, dashurinë e tyre për gjithshka shqiptare. Kështu, p.sh., vepra të mira me këtë temë, të përshkuara nga këto ide, kanë shkruar vitet e fundit Naum Prifti, Teodor Laço, Dritero Agolli, Ismail Kadareja, etj. Tregimi «Hendeku» i I. Kadaresë bën fjalë pikërisht për heroizmin e një kufitarii, i cili i vë minat llogores armike se nuk mund të durojë dot provokacionet, sharjet, fytyrën e pështirë të monarko-fashistit, i cili i hyn në truallin e tij. Kufitari është i lidhur ngushtë shpirtërisht me tokën e vet shqiptare, me kullën ku banojnë njerëzit e tij, me shokët. Për bjeshkët, për atë motrën e për të fejuarën, për gjithë Shqipërinë ai është gati të sakrifikojë jetën. Një temë të afërme me këte, me ngjyra të ngrohta e lirike, ka kapur D. Agolli në tregimin «Fytyra e një ushtari të përjetshëm». Edhe në fragmentin e botuar nga romani i tij i ri «Ngritja» që lidh Luftën nacional-çlirimtare me të sotmen, ndihet fryma heroike dhe popullore. Një tregim me tendencë të caktuar mirë, me ndjenjën e urrejtjes kundër armikut, ku ndihet forca morale e Luftës sonë nacional-çlirimtare është dhe «Kur u mbush kupa» i Moisi Zaloshnjës në vëllimin e tij të fundit me tregime.

Kur tregimi ka frymë militante, kur jepet me ngjyra të forta emocionale dhe ka ide të fuqishme, ai lot rol të madh në edukimin revolucionar të njerëzve. Prandaj përgjegjësia dhe detyrat e prozatorëve tanë janë të mëdha. Duhet më shumë tregime me frymë luftarake, që të përshkruajnë drejt jetën tonë, punën e masave punonjëse dhe qëndrimin e tyre heroik. Përmbajtja e shëndoshë, idetë e mëdha do të japin frymëzim, do ta bëjnë veprën tërheqëse dhe me pasione të vërteta, sepse vetëm veprat që nisen nga realiteti dhe nga idealet tona komuniste mund të hyjnë në zemrën e njerëzve, mund të vënë në lëvizje mendimin e tyre.

Është botuar tek ne ndonjë vepër që niset me qëllimin që të tregojë sakrificat e luftës, lidhjen me traditat, të cilat kanë mbetur të gjalla, po, në analizë të fundit, krijon një atmosferë të rëndë, pesimiste dhe kështu largohet nga notat heroike, ku duhet të shpinte ajo temë. Tregimi i Nasho Jorgaqit «Balada e nënës» është nisur pikërisht nga qëllime të tilla dhe ka rënë në një atmosferë ku sundon vetëm dhëmbja, dëshpërimi i nënës, ndjenja e vazhdueshme që e mundon gjatë «treginit të të vdekurve me të gjallët». Kur themi kështu, nuk kërkojmë asnjë thjeshtësim dhe varfërim të ndjenjave; nëna ndjen dhimbje për fëmijët e vrarë; plaga nuk shërohet lehtë. Po në kompleksin e ndjenjave, duhet të zotërojnë notat heroike, forca dhe guximi i nënës shqiptare për të duruar, për të gjetur ngushullim në vazhdimin e punës së të birit, për të ndjerë krenari dhe përtëritje shpirtërore. Detyrë e letërsisë sonë është të zgjojë këto ndjenja, t'i zhvillojë ato dhe jo të lëndojë plagët, të krijojë skena makabre, ku nëna nxjerr djalin nga varri, e shpie me karrocë gjer në fshat dhe ku gjithmonë flitet për të vrarët, për dhimbjen. Edhe vetë kapja e subjektit, me dy djem të vrarë njeri pas tjetrit, e rëndon mendimin dhe e çon drejt ngjyrave të errëta. Ka diçka fisnike dhe emocionante në faktin, që fshatarët duan të mbajnë pranë varrin e Kollit, djalit të madh të plakës, i cili luftoi dhe u vra pranë fshatit të tyre. Po edhe motivi pse duan ta mbajnë nuk është gjetur mirë;

Koli shpëtoi fshatin nga djegja dhe tridhjetë shpirt nga vdekja, thotë autori. Pa dashur, duket sikur fshatarët, në luftë, bënin sehir dhe ruanin fshatin të mos u digjej, gjë që nuk pajtohet me realitetin.

Kështu, me gjithë pikënisjen e autorit dhe disa momente që kanë një tingëllim të drejtë ideo-emocional, tregimi ndrydhet më tepër në një atmosferë të rëndë të dhimbjes dhe nuk krijon dot atmosferën heroike, mobilizuese.

Dihet se brenda metodës së realizmit socialist ka stile dhe mënyra të ndryshme të të shkruarit. Puna është që vepra të përshkohet nga idera të qarta, të rëndësishme dhe të jetë e kuptueshme për masat. Ne nuk mund të pajtohemi me shijet estetizante, sipas të cilave stili duhet të jetë sa më i zgjedhur, sa më abstrakt dhe i koklavitur, se arti nuk mund të kuptohet nga të gjithë. Në përgjithësi tregimtarët tanë kanë stil të qartë, gjuhë popullore, gjë që nuk do të thotë aspak se ata janë skematikë dhe me gjuhë të varfër. Veprat e mëdha, në thellësinë e tyre, janë të thjeshta dhe të kuptueshme. Tregimi ynë shkruhet me stile të ndryshme, duke filluar nga mënyra poetike e popullore e Sotir Andonit, te fraza e gdhendur dhe te stili i kulturuar i Dhimitër S. Shuteriqit, nga stili i lehtë lakonik dhe me humor i Naum Priftit, te gjuha më e figurshme dhe më poetike, që bën më tepër sinteza e Ismail Kadaresë, etj.

Është e pranueshme nga të gjithë se edhe arti realist ka konvencionin e vet, që shprehet në raportin e formës me të vërtetën reale, në nevojën e zmadhimit të disa anëve me qëllim për të nënvizuar një ide. Mund të përdoren edhe simbole, mund të shkruhen tregime fantastike, po doemos gjithë puna qëndron te ideja dhe uniteti i stilit.

Në ndonjë tregim të vetin, si «Përbindshi» dhe «Zbërthimi» Ismail Kadareja ka përdorur pikërisht simbole, konvencionalizëm të theksuar që përzihet me momente reale. Nuk do të kishte, natyrisht, asgjë të keqe, po të ishin idetë të qarta, të plota dhe po të dilnin tregimet të kuptueshme. Po kjo nuk është bërë në këto tregime dhe autori nuk ja ka arritur qëllimit. Në tregimin «Për-

bindshi» autori është nisur nga pozita politike e drejtë për të treguar rënjen shpirtërore të armiqve, karakterin e tyre grabitqar dhe vitalitetin e botës sonë. Po përpjekjeve dhe ndërmarjes së armiqve, që duket se përfaqësojnë imperializmin dhe revizionizmin, ai nuk u vë përballë, nga pikpamja filozofike dhe shoqërore, një botë të pasur shpirtërore, me ideale të mëdha dhe luftarake. Goditja me shishe e kalit, muri që ngrihet në fund për t'u izoluar etj. nuk janë momente të forta që të tregojnë mirë epërsinë tonë morale. Është pozitive fakti që në qytetin imagjinar të përparimit ka qetësi të brendshme, etje për kulturë, për të jetuar. Po a duhet të mjaftohemi me kaq? A nuk duhet treguar ndofta një betejë imagjinare më e fortë, me ngjyra të ndritura fantastike (në stilin e veprës), që sjell shkatërrimin e armiqve? Po, në përgjithësi, megjithëse ka faqe të shkruara mirë, «Përbindshi» të fut në një konvencionalizëm artificial, në përzjerjen pa vend të fantastikës me realen; në të figurat mbeten abstrakte dhe të papërcaktuara mirë nga ana shoqërore.

Natyrisht, mund të merren edhe subjekte nga lash-tësia dhe mund të ndryshohen disi për hir të idesë së sotine, të frymës aktuale, të karaktereve të kohës. Po, në raste të tilla, ruhet një farë konseguence, ruhet liria e njohur e subjektit, se ndryshe ngatërrohet edhe vetë veprimi dhe shumë kapërcime duken si lodra të autorit që vetëm sjellin konfuzion. Kështu edhe «Zbërthimi», me gjithë idenë e drejtë se partizanët hoqën nga mesi çdo të keqe, mbetet abstrakt, nuk kuptohet mirë ç'përfaqëson «e keqja» e madhe e minës që mbeti midis fshatit për disa vjet dhe fshatarët dalin tepër pasivë. Konvencionalizmi i tregimit nuk pranohet dot dhe stili nuk ka unitet.

Pa hequr dorë, siç thamë, nga larmia e stileve, edhe nga mënyra fantastike me simbole, në radhë të parë na duhet të zhvillojmë në prozën tonë një stil realist, të qartë, të kuptueshëm nga masat. Poemat e I. Kadaresë si «Ëndërr industriale», «Përse mendohen këto male» etj. janë të pasura në figura e fantazi, po pëlqehen dhe ka-

pen shpejt nga masat, sepse ideja dhe emocioni janë të qarta e të fuqishme, me gjithë figurat e guximshme. Në letërsinë tonë nuk na duhen vepra të shkruara në mënyrën e «Përbindshit», na duhen vepra të përcaktuara dhe të qarta, me forcë ideo-artistike.

Këto ishin disa probleme ideore të tregimit tonë vitet e fundit.

Ne kemi nevojë për më shumë tregime, për tregime me përmbajtje të thellë, me frymë luftarake, që të ndihmojnë në edukimin e masave, në kalitjen shpirtërore të njeriut të ri.

1966

RRUGA E NJË POETI

(Mbi librin e Ll. Siliqit «Kangët nuk mbeten kurr të pakëndueme» dhe poemën e tij «Ringjallje»)

Çdo kohë nxjerr poetët e vet që përfaqësojnë gjendjen shpirtërore të shoqërisë në një periudhë të caktuar, që shprehin idetë e kohës, dëshirat dhe shpresat e njerëzve. Periudha e lëvizjes demokratike e komuniste në Shqipëri dhe, më vonë, periudha e Luftës nacionalçlirimtare krijuan kushtet edhe për një lëvizje të gjallë letrare, për luftë rrymash të ndryshme e pastaj për lindjen e një letërsie të re, që nisej hapur nga botëkuptimi komunist. Rryma përparimtare e periudhës së independencës, që kryesohej nga poeti i madh i vendit tonë Migjeni e që përmblihte edhe poetë të tjerë, shënon në letërsinë tonë një hap përpara drejt realizmit, në luftë kundër idileve sentimentale, kundër tendencës për t'u larguar nga problemet e rëndësishme shoqërore. Tabloja e kohës që ish zhytur në mjerim e varfëri, e kohës plot dëshpërim po edhe «revoltë krenare», kur ndrydhej personaliteti i njeriut, po kur zienen në kraharorë edhe idealet e zjarrta që çonin drejt së vërtetës, drejt lirisë, idealet e njerëzve që nuk pranonin mëshirë, — kjo tablo gjeti shprehjen e vet më tepër se kudo në veprën e Migjenit, fjala e të cilit vepron me një forcë të madhe emocioni e mendimi dhe është, në përgjithësi, shembull i poezisë së re të kohës, i poezisë së fuqishme, realiste, pa lulka dhe fraza të fryra, i poezisë së vërtetë që

bashkon në vetvete jetën objektive me idetë e thella të poetit.

Vepra e Migjenit dhe gjithë letërsia përparimtare e asaj kohe ushtruan gjer diku ndikimin e vet te poeti i ri Llazar Siliqi.

Vepra e Llazar Siliqit zë sot një vend të rëndësishëm në letërsinë tonë të realizmit socialist. Ai është një poet i dalë nga Lufta nacionalçlirimtare, që shpreh në veprën e tij idetë e partisë; një pjesë e mirë e vjershave dhe e poemave të tij janë të frymëzuara, të fuqishme, pasqyrojnë forcën e njeriut të kohës sonë dhe të ngjallin në shpirt ndjenja të larta patriotike e njerëzore. Ai është kryesisht një poet i lirikës qytetare. E tërheqin më tepër problemet e mëdha politike, nganjëherë edhe shoqërore e morale. Ll. Siliqi është më shumë poet i planit të gjerë, i ngjyrave të forta, i fjalës që lavdëron e godet hapët. Këtë rrjedh kryesisht edhe prirja e tij drejt një ritmi dinamik, disa herë drejt një vargu më të lirë, ku poeti mund të marrë frymë më lirisht, mund të shfaqë më mirë, në gjininë e vet ose liriko-epike, frymën dhe mendimet e kohës.

Duke u mbështetur në vëllimin «Kangët nuk mbeten kurr të pakëndueme» si edhe në poemën e fundit «Ringjallje», mund të themi se rruga poetike e Llazar Siliqit është një rrugë interesante me vjersha e poema më shumë ose më pak të frymëzuara, po, përgjithësisht një rrugë përparimi në mjeshtërinë artistike, në kapjen e problemeve dhe përpunimin e formës. Ka pasur në rrugën e tij krijonjëse edhe periudhë rënjeje (kjo vrehet sidomos në librin «Vjersha dhe poema», mjaft vargje të të cilit nuk janë përfshirë në këtë vëllim). Po sidomos poema e fundit «Ringjallje», për të cilën do të bëjmë fjalë veçanërisht, si edhe disa vjersha të tjera, ku spikasjin kërkime interesante të poetit, tregojnë se ai ecën përpara dhe është, pa dyshim, një nga poetët më të mirë të vëndit tonë.

Të katër vjershat programatike, që — siç thotë autori në shënimin e tij — zënë vendin e parathënjes, tregojnë burimin e frymëzimit të poetit, idetë e tij kryesore dhe rrugën poetike që ai do të ndjekë. Jo më kot libri hapet me «Kangë për diellin», që i kushtohet Migjenit dhe që është shkruar me rastin e sjelljes së eshtrave të tij në Shqipëri. Me anë të figurave të njohura të Migjenit, autori jep një tablo të kohës kur jetoi e shkroi ai, duke shfaqur dashurinë e tij për poetin, duke zbuluar thelbin e veprës së Migjenit. Interesant dhe plot sinqeritet është optimizmi që përshkon këtë vjershë; ëndërrat e Migjenit janë realizuar; ja se si i drejtohet atij poeti:

*...kangët ma të bukura përmbi botë
me ne, Poet, i ngrite plot hare!*

Këngët që i vlonin në gji Migjenit dhe që ai nuk mund t'i këndonte ahere, u kënduan më vonë nga populli që luftoi e fitoi lirinë, u kënduan nga poetë të tjerë. Të këndojë këngët e kohës, ato që i nxori revolucioni, jeta në liri — kjo është detyra që i ka vënë vehtes Ll. Siliqi, i cili ka pasqyruar faza të ndryshme të zhvillimit të vendit tonë, ngjarje të rëndësishme politike, ndjenja heroike të kohës. Ll. Siliqi i ka kushtuar shumë vjersha partisë. Në vjershën «Dhuratë në ditën e lindjes» që ndodhet në hyrje të librit, ai tregon dashurinë e madhe ndaj partisë që e frymëzoi, i zgjoi këngët e reja:

*Un' kangën time të dërgoj, Parti,
Ty të përket se ti ma ndeze n'gji.*

Megjithëse kjo nuk është ndër vjershat më të mira të vëllimit, unë e përmenda këtu për idenë e saj, për vlerën programatike në krijimtarinë e poetit.

Frymëzimet e tij kanë lindur nga jeta; ato kanë, doemos, burime personale dhe të përgjithshme shoqërore. Autori kujton kohën kur ishte i vogël, kur bridhte nëpër

vreshta me babanë — poet — dhe dëgjonte vargjet e tij. Poeti ka kaluar nëpër një rrugë të pasur shpirtërore, në fillim të koklavitur e të turbullt, pastaj plot hove e flakërime. Kjo nuk është vetëm një rrugë personale; kjo është — duke e shikuar çështjen në prizmin e përgjithshëm shoqëror — rruga e shumë të rinjve shqiptarë që i ngriti lufta dhe i kaliti partia në sulme të reja. Vjersha «Frymëzimet» është shkruar me varg të bukur, thjeshtë e qartë dhe është një sintezë e mirë e burimit të frymëzimeve të poetit, i cili — i mbrujtur me optimizëm dhe dëshirë të zjarrtë për të kënduar — i thotë zemrës:

*buçit ti, zemër, përsëri
me zjarr e hov e dashuni!*

Mendimet që shfaqen në sonetin «Vargu» plotësojnë «parathënjen» e këtij libri, «credon» e autorit. Poet që gjeti frymëzimin e tij në luftën kundër fashizmit, në periudhën revolucionare, Ll. Siliqi i vuri vetes detyrë të shkruajë vargje luftarake, jo për «sytë» e bukur e për «bilbilat», po vargje që të thërrasin në sulme të reja. Është e qartë se autori këtu nuk do të thotë që të mos këndohet për këto ndjenja njerëzore. Ai flet për prirjen e tij kryesore për atë që, pa dyshim, është esenciale në gjithë poezinë tonë të realizmit socialist.

* * *

Nga vjershat e shkruara më 1940-1942, të mbledhura nën titullin «I burgosun», një pjesë e mirë botohen në këtë përmbledhje për herë të parë e, mendoj, se kjo është një **punë e mirë**, pasi tregon më qartë rrugën e poetit, ndryshimin e gjendjes shpirtërore, kërkimet e tij. Këto vjersha janë interesante për zbërthimin e botës së brendshme të autorit, që përfaqëson këtu një të ri të ndijshëm, që kërkon të gjejë të vërtetën përmes librave e jetës, një të ri, në shpirtin e të cilit rreket të zejë vend

drita e hija. Shumë nga këto vjersha, të mbledhura bashkë, përbëjnë një cikël mbi gjendjen shpirtërore të heroit lirik, mbi ndryshimin e kësaj gjendjeje. Ne e shohim këtë ndryshim nga njera vjershë në tjetrën; vargjet zbulojnë anë të ndryshme të «un-it» poetik; në to bëhen pyetje rreth problemeve shoqërore e filozofike që e mendojnë autorin, probleme që nuk janë të shkëputura nga koha, nga atmosfera politike e shoqërore, në të cilën jetonte autori. Megjithëse nga pikëpamja poetike disa nga këto vjersha janë akoma të paarritura ose nën ndikimin e drejtpërdrejtë të librave, prapë që këtu duket talenti i Ll. Siliqit, i cili fillon të formohet si një poet i mendimit, si një poet që vret mendjen për fatin e tij në shoqëri, që rreh të zgjidhë problemin e jetës e të vdekjes, të «dritës» e të «hijes», të triumfit të «agimit» e të «së vërtetës». Në vjershën «Dallgët e zemrës» autori flet për luftën e brendshme që nuk e lë të qetë, që e mundon natë e ditë dhe ai kërkon ndihmën e shokëve, u zgjat atyre dorën të shpëtojnë dhe të shkojnë të gjithë bashkë «n'lima t'sigurtë», duke çarë dallgët trimërisht. Heroi lirik që kemi përpara sysh e kupton se njerëzit mund ta shpëtojnë nga këto dallgë, po që vetë nuk është i zoti t'i ndalojë se ato janë duke e mbyllur. Këtu është vështirë të thuash se cilat janë këto valë që po e përpijnë heroin, po figura e valëve, e luftës së tyre gjendet edhe në vjersha të tjera e ne mund të kuptojmë se në krye kjo ndeshje e brendshme ka një karakter jo të përcaktuar mirë të dëshirës për të jetuar, për të shpëtuar nga mërzitja, të frikës përpara vdekjes. Është pra një luftë akoma e kufizuar, e mbyllur në vetvete. Po këtu duhet shënuar një moment i rëndësishëm: vjersha fton për t'u lidhur me njerëzit, për të mos qëndruar i shkëputur se ndryshe të mbytin «valët»; kjo ide e drejtë e lidhjes së individit me shoqërinë, që shprehet në këto vargje akoma në formë fillestare, do të përshkojë pastaj gjithë veprën e poetit, i cili nuk mund ta kuptojë veten të ndarë nga shoqëria.

Ndër këto vjersha zotëron shpeshherë një frymë romantike e sentimentale. Heroi lirik na del hera-herës

si një njeri me zemër të ndrydhur që proteston, po akoma dobët e që nisët nga disa ideale në thelb të shëndosha, po edhe të trubullta, të papërcaktuara mirë. Në shumë nga këto vepra ka nota të theksuara pesimizmi, melan-kolie. Ku e ka burimin kjo frymë? Mendoj se ajo rrjedh nga jeta, nga atmosfera e rëndë shoqërore që mbretëronte atëherë në Shqipëri, nga ajo atmosferë që e ndrydh rininë, e bën pasive, i shkakton një mërzi të theksuar dhe melankoli të pakuptueshme. Po veç bazës shoqërore, ajo ka, pa dyshim, edhe bazë personale, që ka të bëjë me karakterin pak sentimental të poetit të ri, të cilin në fillim heraherës e çarmatosnin këto anë të zymta të jetës. Kjo frymë melankolie e pesimizmi rrjedh edhe nga librat, nga poetët e ndryshëm sentimentalë e romantikë që lexonte autori. Po është e qartë se poetin e përgatiste shpirtërisht për t'undikuar nga këto lloj libra koha, jeta e ambientit të tij. Nga vjershat ku është më e theksuar kjo frymë mund të përmenden «Kam mall» dhe «Mërzija». Në të parën autori loton për shokët që kanë vdekur; në varr bashkë me veten, ata i kanë marrë edhe një pjesë të zemrës; ai ka mall për ata që s'janë më, për kohën e shkuar, për ditët e fëmijësisë. Kjo nostalgji sentimentale ka, doemos, edhe anën e vet njerëzore: këtu nuk kemi të bëjmë me fjalë të ngrira poetike, po me ndjenjat e individit që fillon të shqetësohet nga ëndërrat e trubullta. Sentimentalizmi i vjershës qëndron në karakterin e kufizuar personal të ndjenjave, në pasivitetin e njeriut ndaj dhimbjeve dhe vështirësive të jetës, në të shikuarit prapa, te kohët që s'kthehen më. Për mërzi-tjen që ka pushtuar botën, që rreh «plogësht» flatrat e saj bëhet fjalë në vjershën «Mërzija», në të cilën me figura të gjetura mirë dhe me stil të prerë, jepet një tablo e ngrysur plot hije.

Karakteristikë për shumicën e vjershave që krijojnë një figurë të plotë të heroit lirik, si thashë, është lufta e brendshme, lëvizja shpirtërore, shpeshherë të menduarit dialektik, sado që mjetet artistike janë akoma të paformuara mirë, të zbëta dhe figurat në shumë raste nuk dallohen për origjinalitet, po përsërisin figura të

njohura si «hijet që hedhin valle», «Agimi», «errësira» etj. Sidoqoftë ato paraqisin interes për brendinë e tyre, për mendimin që i përshkon. Vjersha si «Agimi», «Për të njëmijtën herë», «E vërteta», tregojnë përpjekjen e heroit lirik për të shpëtuar nga errësira, për të pushtuar agimin, dritën. Me detaje psikologjike shprehet ideja e luftës së ndjenjave në vjershën «Agimi». Natën heroinë e pushtojnë mendime të errëta; me mëngjezin bashkë vjen edhe shpresa, optimizmi. Po kjo lëvizje është si një cikël i mbyllur, si një udhë pa krye. Ai e kërkon gjithnjë shpëtimin te njerëzit, po, si duket, as ai nuk është përgatitur akoma të mbështetet realisht tek ata, as njerëzit nuk janë formuar shpirtërisht dhe të bashkuar si duhet që t'i japin dorën. Me një ide më optimiste mbaron vjersha «E vërteta». Fantazia që krijohet këtu («hijet e mnëshme» që të zëna dora-dorës hedhin vallë të bardha si dëbora) përshkohet nga një frymë mistike. Autori përdor simbolet e Hijeve, të Agimit e të Shkëlqimit që bën, më në fund, t'i rrahë zemra «hovshëm prej gëzimit».

Interesante për mendimin e saj është edhe vjersha «Përpara vdekjes». Më njerën anë ajo të tërheq me theksin psikologjik e me thellësinë e mendimit: në çdo fenomen poeti mundohet të gjejë të vërtetën; përpara tij një njeri i vdekur, i cili, kur ishte gjallë, doemos lëvizte e ndryshonte, tani nuk luan më; asgjë s'mund të fshehë, e ka kryer ç'kish për të kryer dhe ne mund të themi për të të vërtetën. Këtu shohim prirjen e autorit për t'u thelluar, për të kuptuar thelbin e shpirtit të njeriut. Ai fillon e shqetësohet jo vetëm për fatin e tij, po edhe për fatin e atyre që mund të kenë jetuar pa e njohur «të vërtetën». Ndonëse akoma në mënyrë të trullull e abstrakte, ne shohim se poeti ka filluar të përqafojë idetë përparimtare të kohës, idetë e ringjalljes shoqërore e kombëtare. Po në këtë vjershë gjejmë, nga ana tjetër, po atë frymë mistike të frikës përpara vdekjes që — përveç të tjerave — shpjegohet edhe me moshën e re të autorit, moshë kur i riu fillon e bie në mendime për jetën, për të ardhmen, për domethënjen e gjërave.

Në këtë cikël vjershash, për të kuptuar transformimin shpirtëror të poetit, janë të rëndësishme vjershat «Vehtes» dhe «Pasqyra». Zhvillimi i lëvizjes revolucionare në Shqipëri, formimi i Partisë Komuniste, lufta antifashiste filluan të largojnë nga shpirti i poetit vuajtjet dhe dyshimet sentimentale që e bënë të pafuqishëm përpara botës, filluan ta afrojnë me jetën reale, ta bëjnë të thyejë guaskën personale që e ndrydhte dhe të shohë se, përveç vetes, ka rreth e rrotull njerëz që vuajnë, — atyre u duhet dhënë dora dhe duhet ecur bashkë me ta gjithmonë «përpara». Heroi lirik është mërzitur nga lotët, nga «vaji e mjerimi», ai do të bëhet aktiv. Figura e pasqyrës në vjershën me po këtë titull është e gjetur mirë. Ajo përfaqëson botën e ngushtë ku ishte kredhur autori, botën e vetvetes; ai tani e thyen pasqyrën, del përtej kësaj bote të vogël:

*thej pasqyrën, larg shikoj
n'vllaun që vuen mendjen e çoj.*

Pikërisht kur e «çon mendjen» te «vllau», te të tjerët, kur shpëton nga egocentrizmi që nuk ishte «faj» po «fatkeqësi» e kohës, ahëre poeti ka gjetur shpëtimin, burimin e frymëzimit, ka filluar të përcaktojë rolin e tij aktiv në jetë.

I denë se si duhet hyrë në jetë, midis njerëzve, e shpreh fare shkoqur soneti «Kah turma e uritun». Të kërkosh të «vërtetën» midis librash, në dhomë, është gjë e kotë dhe prandaj hero i kupton dhe niset shpirtërisht drejt turmës së uritur. Në këtë sonet, të punuar mirë si varg, përdoren përsëri po ato figura të «Hijeve», të «Dritës» dhe të «së Vërtetës» që janë shndërruar për autorin në disa simbole poetike. Mjetet pra janë po ato të vjershave të para, po mendimet e autorit fillojnë të ndyshojnë; lindin ideale të reja të frymëzuara nga jeta, nga populli. Dhe poeti vë re rreth vetes si rrojnë njerëzia. I lënë mbresë edhe gjërat e vogla, prapa të cilave fshihet varfëria e masave të qytetit. Një fëmijë e shikon me zili nga dritarja e dyqanit gotën plot me akullore («Shikimi»). Kjo është një

vjershë interesante jo vetëm për vërtetësinë, po edhe për mjetet me të cilat është shkruar. Këtu kemi të parat detaje realiste, gjithshka është e thjeshtë dhe e qartë. Përshkrimi i anës së jashtme të fëmijës është i goditur, i saktë:

Shikova at' fytyrë:

*e verdhë e e hollë, me buz' e pezmatueme,
me pamje të trazueme.*

Shikova syt' e tij

të futun si n'dy gropa.

Përmes këtyre tipareve të jashtme autori mundohet të na japë botën e brendshme të fëmijës. Kjo është një karakteristikë e poezisë realiste të Migjenit, ndikimi pozitiv i të cilit vjen e bëhet i qartë, kur autori nuk i drejtohet vetëm vetes së tij, po edhe realitetit objektiv shqiptar, problemeve morale e shoqërore. Hidhërimi që ndjen në shpirt poeti kur sheh sytë «dëshrues» të fëmijës (në vjershën «Shikimi»), është, pa dyshim, diçka njerëzore. Po është e qartë se këtu nuk arrihet në ndonjë konkluzion me vlerë shoqërore, nuk ka protestë kundër shkaktarëve të varfërisë. Kjo, sigurisht, ka arsye të veta. Zgjidhja e vjershës — rënja e gotës që thyhet e bëhet copa-copa — tingëllon në mënyrë pak sentimentale, po sidoqoftë dhëmbja që i shkaktonte autorit varfëria është një hap përpara në zhvillimin e tij shpirtëror.

Përveç detajeve të para nga jeta e qytetit, poeti shtrihet edhe në fshat, duke përshkruar një skenë të shtërgatës dhe të varfërisë së fshatarëve, «Shtërgata në katund». Në këtë vjershë gërshetohet fantazia poetike me disa hollësi konkrete, të cilat jepen me vërtetësi e me figura që të kujtojnë prapë Migjenin. Vargu këtu është i plotë, dinamik dhe i figurshëm. Jepet vërtet një tablo plot gjallëri dhe këtu njeriu fillon e mendon se ka të bëjë tashmë me një poet të pavarur, që po e gjen rrugën e vet poetike. Duke e drejtuar nga jeta, vepra e Migjenit vepron te Ll. Siliqi në mënyrë pozitive, ajo

ndihmon që ai të bëhet një poet i pavarur, i lidhur me jetën. Edhe në vjershat e para nuk mund të themi se s'ka pasur fare ndikim Migjeni: poezia e mendimit, vargu kanë diçka të përbashkët me këtë poet, po, në përgjithësi, fryma romantike e sentimentale ka pak afrim, qoftë edhe me vargjet e dëshpëruara të Migjenit, sepse dëshpërimi, melankolia e tij nisej më tepër nga jeta dhe përmbante në vetvete më tepër nota zemërimi e proteste.

Ndikimi i Migjenit është i qartë në vjershat «I burgosun» (e cila bile nuk dallohet për originalitet, për nota personale, sadoqë, doemos, ajo nuk është krejt e njëjtë me «Të burgosunin» e Migjenit), në vjershën shumë të bukur e të thellë «Nderim», në vjershën «Revolta» etj. Tema e varfërisë dhe e mjerimit, tema e revoltës dhe protestës, duke pasur një bazë të vërtetë nga jeta dhe nga idetë përparimtare të kohës, kanë njëkohësisht edhe si burim letrar veprën e Migjenit. Çështja e ndikimit të një poeti te një tjetër dhe konkretisht e Migjenit te Ll. Siliqit në rastin tonë nuk mund të studjohet menjëherë dhe, sidomos, në këto përpjekje të para për të dhënë disa mendime rreth veprave kryesore të Ll. Siliqit. Po mendoj se mund të thuhet që, përgjithësisht, në mënyrën e të shkruarit të Ll. Siliqit, në intonacionin e tij poetik, pjesërisht në vargun e lirë, në vargun e kombinuar, në shkrimet e tij më të mira, — ka lojtur rol poezia e Migjenit. Ky ndikim duket sidomos në vargjet e tij të para, që përmenda, me tema shoqërore e morale. Çështjen e ndonjë ndikimi tjetër në veprën e poetit do ta shohim edhe më tutje.

Vjersha «Nderim» të kujton ironinë therëse të Migjenit, urrejtjen e tij ndaj hipokrizisë. Po kjo është një vjershë krejt e pavarur, një vrojtim personal nga jeta e gjallë. Fjalët këtu janë thënë me kursim, tabloja është konçize dhe e fortë. Varrosin një të varfër. Dikur ai u shkonte mbrapa njerëzve dhe ata e shanin. Po tani që po kalon karroca mortore, ata e nderojnë. «Përvajshëm» e përdredh zërin meshtari. Atmosfera krijohet me mjeshtëri.

Vjersha «Revolta» është shumë e përparuar nga ideja: ajo zbulon kontradiktat shoqërore: prindërit e të varfërve kanë krijuar me duart e tyre «lojnat, petkat, kpuçet», dhe të varfërit e rrahin nga inati djalin e të pasurit. Nga pikëpamja artistike vjersha është pak naive dhe si e sajuar, po ajo vlen për të treguar rritjen shpirtërore të autorit, i cili në këtë kohë duket se ka filluar të përqafojë idetë komuniste. Veç asaj, ka në këtë vjershë edhe vargje të thella përgjithësonjëse:

*Me vjet ndër zemra t'skamit vuejtja piqet,
e piqet përulsiya e vdes guximi,
por n'fund të zemrës thellë një flakë veç digjet,
që kur t'shpërthejë do t'jetë i botës pshtimi.*

Ide të reja, të avancuara përshkojnë vjershat «E shoh për ditë», «Duerët tuaja», «Për një copë bukë». Ato nuk kanë ndonjë vlerë të madhe poetike, sadoqë ndër to gjen vargje të goditura e të fuqishme, po janë interesante për të kuptuar botëkuptimin e poetit. Këtë po e rrëmbejnë gjithnjë më shumë idetë revolucionare, komuniste. Ai fillon të marrë mësimet e para marksiste dhe t'i shprehë ato në veprën e tij. Në njerën flet për energjinë e punëtorit, e cila shkon më kot, dhe bën pyetjen:

*Po kur, o popull, vuejtjet do t'mbarojnë?
Kur krahët tuej çeliku, o puntorë,
Botën e re do të ndërtojnë? (E shoh për ditë)*

ndërsa në tjetrën mundohet të zbulojë kontradiktat e fshatit të mjeruar dhe të hedhë dritë në të ardhmen, tek e cila ka besim të madh:

*Dhe syt' e mij porsì n'vegim shikojnë
Katunde t'bukura e t'frytshme
Me shpija t'bardha e t'ndritshme
(Me duerët tueja)*

Vjersha «Atit tim», e shkruar pak më vonë (maj 1943) mund të konsiderohet si sinteza e kërkimeve poetike, e mundimeve të brendshme dhe e daljes në rrugë të drejtë. Kjo është një nga vjershat më të bukura, më të thella të Ll. Siliqit, ku personalja shkrihet me shoqëroren, ku ndjenjat tregohen në dinamikën e tyre, ku ka meditacion dhe figura të vërteta poetike. Fytyra e atit të tij, e poetit dhe patriotit Risto Siliqi, është për autorin burim force dhe frymëzimi. Me mjeshtëri është përshkruar vdekja e t'et, gjurmët që i ka lënë në shpirt kjo dhembje. Kur poeti kërkonte shpëtim nga vuajtjet e tundimet shpirtërore, i kthente sytë nga fytyra e t'et: ndryshe e shikonin sytë e tij ahëre, ndryshe e shohin tani, ndërsa buzët duken sikur i thonë:

*guxueshëm, bir' i em, vazhdo udhëtimin!
guxueshëm, bir' i em, nis sot luftimin!*

Edhe vargu i kombinuar 11-rrokësh, 7 e 5 rrokësh, pothuaj me të njejtën kadencë e me rima të shpeshta, sikur i shkon për shtat ideve të vjershës, karakterit të saj meditativ e elegjiak, pak të shtruar po të thellë.

Mendoj se kjo vjershë do të ishte më e përshtatshme për të mbyllur kapitullin «I burgosun». Kjo të duket sikur mbyll një periudhë e hap periudhën tjetër të vargut të hapët luftarak, të një rruge të qartë e konsekuente.

II

Pjesëmarrja e Ll. Siliqit në lëvizjen nacionalçlirimtare përcaktoi edhe tematikën e veprave të tij të mëvonshme, frymën e tyre. Në kapitullin që titullohet «Ndër beteja» ka vjersha që shprehin gjendjen e përgjithshme shpirtërore të popullit tonë në ditët e luftës antifashiste, që tregojnë si duhet të lidhet e si lidhet në të vërtetë kjo luftë me traditat patriotike e revolucionare; vjersha që japin tablo të gjalla nga lufta partizane, ose që pasqyrojnë çaste të vështira të ditëve të okupacionit. Një

vend të rëndësishëm zënë në këtë kapitull vargjet kushtuar shokëve të rënë, atyre që njëjtte autori e që kishin lënë gjurmë në zemrën e tij. Këtu ka vjersha të mira të ndjera. Poeti i ri fillon të pasurojë tematikën, të përdorë edhe vargje të tjera përveç 11-rrokshit dhe derivateve të tij që zakonisht përdorte gjer atëhere, gjë që — me sa duket — diktohet nga larmia e temave dhe lidhet me përpjekjen e poetit për të ecur më tutje në mjeshtërinë e tij artistike. Vjershat janë optimiste; ato shfaqin vështirësitë dhe dhëmbjet që shkakton lufta, po perspektiva është gjithmonë e qartë, besimi në fitore i palëkundshëm. Pak vargje ndër to, siç dihet, kanë qenë botuar në organe ilegale si «Kushtrimi i Lirisë» e «Liri». Në këto organe debuton për herë të parë Ll. Siliqi si një poet i ri luftarak.

Si thashë, në këtë kapitull ka vjersha të ndjera, të shkruara vërtet nën përshtypje të drejtpërdrejta, sadoqë nga ndonjëherë me mjete-figurative jo të pasura, të thjeshta në shprehjen e tyre, ato shpesh mallëngjejnë më tepër se ndonjë vjershë e shkruar me aftësi më të madhe profesionale.

Çasti përpara dhe pas betejës, atmosfera e luftës partizane jepen bukur në vjershën «Ndër beteja» që është një tablo e goditur poetike. Këtu fjalët janë të thjeshta, me përjashtim të ndonjë figure simbolike të përdorur me vend, përgjithësisht nuk ka figura; vargjet rrjedhin të natyrshme dhe me ritmin dinamik, që i përshtatet sidomos momentit të betejës. Autori ja del të komunikojë ndjenjat e tij të sinqerta dhe entuziazmin e luftës partizane që e ka pushtuar atë vetë:

*Armë kreshnike! Ligjëroni
për fitoren që ju korrët!
Gaz' e luftës na tregoni!*

Vjersha fillon me një figurë që krijon atmosferë pak fantastike, magjike, po që mendoj se këtu është spontane dhe e bukur për të treguar se ç'momente ishin ato, kur kudo kërciste lufta dhe vendosej fati i vendit tonë:

*Erë baroti rreth nuhatet, —
lidhen fatet e Shqipnisë!*

Dhe motivi i dëshmorëve të rënë, i shokëve të dashur që nuk do të kthehen më, motiv që do të përshkojë pothuaj tërë poezinë e Ll. Siliqit, spikat edhe në këtë vjershë. Simbolet, si mjet i njohur në vjershat e para të poetit, përdoren edhe këtu. Duke folur për ato plagë që i sollën vdekjen Asimit, Atanasit, ai shkruan:

*Fshiji lotët,
Qëndro, vlla!
T'kanë gënjye, s'asht e vërtetë
se ndër plagë gjak t'kuq kanë pa,
asht veç puthja e Lavdisë,
që len gjurmat e dashtnisë,
kur me mall puth bijt e vet.*

Vargu 8-rrokësh trokaik me 4-rrokshe të papritura, po që krijojnë një ritëm dhe harmoni të pasur, është i përshtatshëm për të dhënë idenë, gjallërinë e momentit. Mund t'i bëhej vërejtje autorit për ndonjë varg të ndrydhur me shumë monosilabe që e prishin muzikalitetin si p.sh. «se ndër plagë gjak t'kuq kanë pa».

Portretet e shokëve të vranë, Vojos, Brankos, Xhavitit e Gjikës janë portrete luftëtarësh trima nga ata që rriti partia: ata dalloheshin për guximin e tyre, ndokush ishte i urtë e fjalëmbël, ndokush shquante për mendimin e thellë, për thjeshtësi. Vjershat kushtuar Gjikës dhe Xhavitit janë më të ndjerat e ruajnë edhe sot vlerën e tyre poetike. Ato ngjallin në shpirtin e lexonjësit mallëngjim dhe krenari; ato janë të thjeshta në mjetet e tyre artistike, si kujtime dhe ndjesi konkrete, të lindura nga jeta. Autori i njihte, i donte dhe i pa me sy kur shkuan të vdisnin duke buzëqeshur. Portreti i Gjikës jepet me vërtetësi e në mënyrë të njerëzishme. Kujtimet janë të gjalla; poeti nuk ka nevojë të vrasë mendjen shumë se si do ta thurë vjershën: ajo del vetiu:

*T'kujtoj krrusun mbi letra,
kur dufin tand ti shfrefshe n'poezi,
kur fjalën tande endshe për liri*

Dhëmbja është e thellë: 23 tetori, dita kur u vra Gjika me shokë në kampin e Prishtinës, kanë lënë vrage në shpirtin e poetit:

*Njëzet e tre tetuer!
Si rrin ti, zemra ime, në krahnuer?
Si mundesh me durue pa shfrye në vajë?*

Po poeti i thotë zemrës të mos qajë se ëndërrat e Gjikës u bënë të vërteta. Kjo është një kthesë e natyrshme e të rinjve që i kaliti lufta, që nuk i thonë këto fjalë pa i menduar, po që me vështirësi, ndofta, gëlltitin lotët dhe vazhdojnë udhën përpara.

Në vjershën kushtuar «Brankos» ka thellësi mendimi dhe zbërthehet gjer diku bota e brendshme e heroit. Brankua ka pasur një bindje të patundur në çështjen e fitores, një urrejtje organike kundër tiranisë dhe dashuri të pakufishme për njerëzit:

*Ma fort se jetën tande aq të re
njerzimin dashunove.*

Po vende-vende kjo vjershë është e zgjatur, pohon dëshira e mendime në mënyrë pak prozaike, të rëndomtë, pa nerv poetik, pa dhënë një portret më konkret të heroit, gjë që do ta gjallëronte poezinë dhe do të na mallëngjente më shumë. Po kështu, pak e jashtme, deklarative është edhe vjersha «Heroit Vojo Kushi».

Nga pikëpamja e mjeshtërisë është interesant se vjersha «Vojo Kushit», ku përshkruhet më tepër episodi i luftës, ngjarja, është shkruar me varg 12-rrokësh amfibrak, me një ritëm që e jep më mirë atë situatë epike; ndërsa të tjerat, ku bëhet fjalë për kujtime, ku shfaqen mendime, dhëmbje — me vargun e zakonshëm

për poetin, 11-rrokësh ose me derivate të tij që ruajnë po atë theks ritmik.

Ndër vjershat e tjera të këtij kapitulli mund të përmenden për vlerën e tyre relative «Bje, oh bje», ku shprehet zemërim i ndjerë, «Në kujtim të 4 shkurtit», sidomos për ndonjë strofë, ku jepet atmosfera e rëndë e atyre ditëve të përgjakshme, «Ylli», «Për atdhe të dy u vranë», pjesërisht «Dy minuta heshtje» e ndonjë tjetër. Si në këto që përmenda ashtu edhe në «S'flen ma Shqipnija», «Agoi sot viti i ri» ka momente deklarative, ku mendimet thuhën pa nerv poetik, në mënyrë shumë të theksuar agjitative:

*Ne s'jemi vetëm. Popujt me ne janë,
Ushtria e kuqe sot sulmon me ne
dhe hekur shkrin mbi monstren hitlerian
që paqë e drejtësi të ketë mbi dhe!*

Ky pohim, sigurisht, është shumë i vërtetë, po nuk ka këtu asgjë poetike që të të emocionojë. Karakteri deklarativ i disa vjershave të para të Ll.Siliqit shpjegohet pjesërisht edhe nga momenti kur janë shkruar. Ahere çdo gjë lidhej me propagandën e çastit antifashiste. Kjo është një arsye objektive, e cila, doemos nuk përjaton edhe arësyt subjektive.

* * *

Veprimtaria poetike e Ll. Siliqit zhvillohet më shumë pas çlirimit, kur ai bëhet një poet mjaft prodhues dhe i njohur në vendin tonë. Poezia e tij merr një karakter të theksuar politik e qytetar: ai shkruan vargje me ide të përgjithshme kushtuar atdheut e partisë, ngjarjeve të rëndësishme ndërkombëtare, luftës për paqen; vargje që shprehin miqësinë me Bashkimin Sovjetik. Pas çlirimit ai shkruan pesë poemat e tij (për të cilat do të bëjmë fjalë veçanërisht), të botuara në përmbledhjen «Kangët nuk mbeten kur të pakëndueme» si dhe

poemën e fundit «Ringjallje». Një pjesë e mirë e vjer-shave dhe e poemave të kësaj periudhe kanë një nivel të ngritur artistik dhe frymëzim të vërtetë prej poeti qytetar, që e kupton poezinë si diçka të lidhur ngushtë me vijën e partisë, me politikën e saj, me punën e madhe të popullit tonë në ndërtimin e socializmit. Autori gjatë kësaj periudhe ka bërë disa përpjekje për të pasqyruar punën, ndryshimet që kanë ndodhur në vendin tonë. Ai nis të zgjerojë fushën e tij të krijimit, interesat si poet; shkruan edhe vargje për dashurinë, lirika më të lehta, të përshtatshme për këngë.

Në këtë kohë poeti përpunon më mirë gjuhën dhe vargun e tij dhe bëhet tek ne një ndër mjeshtërit më të mirë të vargut. Ai përdor tani më shumë poezinë stro-fike, duke pasur si më të pëlqyer 11-rrrokshin ose ko-mbinimet rreth këtij vargu; përdor gjithashtu në disa vjersha e poema edhe vargun e thyer që mbështetet në thekse të caktuara ritmike e në rima; ndarja e fjalëve bëhet për efekt të mendimit që autori do të nënvizojë ose të paузës që pasuron sistemin ritmik të vargut. Vargu i thyer shpeshherë i jep poetit mundësi për t'u shprehur më lirisht, për të krijuar harmoni të reja, efekte të papritura që ushtrojnë forcë emocionale te lexuesi:

Në det

po lahet

hana flokëartë.

Ranën

një kambë lakuriqe e shklet.

Gjurmët sa shpejt që zhduken!

Po sa qartë

heshtja sonte flet!

(«Heshtja që flet»)

Me përjashtim të disa rasteve të rralla, poezitë e Ll. Siliqit kanë rimë dhe ato ndihmojnë për muzika-litetin e poezisë, organizojnë vargun, i japin atij formë dhe e lidhin me vargjet e tjera.

Duke folur në përgjithësi për vargun dhe gjuhën

e poezisë së Ll. Siliqit duhet vënë re evoluimi i poetit në këtë pikëpamje. Në krijimet e tij të para ka më shumë vargje të dobëta, gjuhë heraherës të ndrydhur, apostrofe të tepërta; më vonë zëvendësohen dalgadalë me vargje më të punuara, me një gegërishte më të përgjithshme, me gjuhë më të qartë e, në shkrimet më të mira, edhe më të pasur. Po doemos të bie në sy vargu i dobët, gjuha e varfër, përsëritja e po atyre fjalëve dhe figurave në vjershat pa ndonjë vlerë artistike ose me një vlerë të kufizuar. Në këto raste edhe ritmi del i sforcuar e vargu nuk rrjedh lirisht.

Ndër lirikat qytetare të Ll. Siliqit dallohen ato që, përveç pathosit të përgjithshëm, krijojnë edhe tablo konkrete ose ku jepen detaje interesante, ku autori nisat nga një rast konkret, nga një njeri i caktuar dhe arrin në përgjithësimet poetike. Këtu do të shohim edhe vjersha të përgjithshme që i drejtohen atdheut, partisë etj. Ndër to, doemos, ka edhe figura konkrete, po ato janë më tepër vargje retorike, pak solemne, hera-herës të ftohta. Gjejmë në këtë periudhë vargje deklarative në poezinë e Ll. Siliqit, figura të përgjithshme, standarde, të cilat nuk ngjallin emocione te lexonjësit. Poezi të tilla kanë shkruar pothua të gjithë poetët tonë.

Të mërzitur nga vargjet deklarative, disa poetë e lexonjës, sidomos të rinj, filluan të mohojnë pothua çdo poezi të llojit retorik (në kuptimin jo të keq të kësaj fjale) **që shpreh hapët dhe me vija të forta mendimet e ndjenjat, dhe të çmojnë vetëm lirikën intime, me vija të holla e delikate.** Zgjerimi i sferës poetike tek ne është një gjë pozitive dhe e domosdoshme, po kjo nuk mund të shpjerë në heqjen dorë nga temat e mëdha, nga poezia e fortë politike, qytetare, nga fjala e fuqishme që lavdëron e godet hapët. Çështja është te zhvillimi i mëtejshëm i lirikës qytetare, e cila do të eci përpara duke u nisur edhe nga shembujt më të mirë të poezive që janë krijuar gjer tani, duke bashkuar idetë e mëdha me fakte konkrete, duke zbuluar figura të reja, interesante, që mund të emocionojnë lexonjësit, të zgjojnë fantazinë e tyre. Një pjesë të vjershave të tij retorike ose thjesht

të porealizuara artistikisht Ll. Siliqi nuk i ka botuar në këtë përmbledhje. Mund të hiqeshin edhe të tjera që janë lënë në vëllim, pasi këtu botohen veprat e tij të zgjedhura.

Për të vërtetuar mendimin se poeti ka, përgjithësisht, më tepër sukses në ato vjersha ku idetë politike, patriotike, idetë e shoqërisë së re jepen të lidhura me fakte nga jeta, që shprehen në formë detajesh poetike ose me anë tablosh të vogëla, që lejojnë më mirë autorin të shfaqë lirizmin e tij, — si edhe për të vlerësuar disa nga poezitë karakteristike të kësaj periudhe, po merremi me disa shembuj.

Ndër vjershat ku trajtohet tema e përgjithshme e dashurisë për atdhe e parti, tema e rrugës heroike të popullit tonë, bie në sy vjersha «Rruga e lumtunisë». Buzë vatrës nëna pret vitin e ri. Ai nuk i sjell asaj asnjë të mirë: veç era fryn e ashpër dhe bie me vete ftohtësinë që ndjell të keqe, uri. Po nëna e di se «dashtnija nuk fiton veç me vajë», prandaj duron e pret vitin tjetër të ri. Këtu dimri, të ftohtit përfaqësojnë kohën e vështirë të okupacionit. Viti i ri që troket në derë disa herë me radhë është një figurë e gjetur bukur që tregon nocionin e kohës, të rritjes, të durimit. Dhe Viti i Ri, që merr një kuptim të veçantë figurativ, i vjen nënës jo në dimër, po bashkë me agimin pranveror. Figura (personifikimi i vitit të ri) zhvillohet më tutje në mënyrë spontane:

*Këpucë partizane
ndër kambë mbathë ai kishte
edhe në dorë pushka
si dielli i shëndriste*

Një vjershë tjetër, ku krijohet tablo konkrete, nga e cila autori arrin në ide emocionale, është «Vetmija e nanës» botuar vitet e fundit. Autori këtu ka gjetur një moment jo të rrallë e të stërholluar, po mjaft të thjeshtë: është festë; nëna bisedon me fotografinë e të birit që ka rënë në luftë trembëdhjetë vjet më parë. Fjalët janë

të përmallshme, ato të mallëngjejnë. Përpara syve të del figura e nënës së dhemshur shqiptare. Dhëmbja është njerëzore, po fjalët të thjeshta, pa asnjë pozë poetike. Fytyra e qeshur e të birit nuk ja ndrydh zemrën nënës, ajo e fton të dalin së bashku jashtë, ku njerëzia gëzojnë e hedhin valle:

E n'atë lum të gjallë njerëzor,
t'lumtun,
gazmor,
at' ditë njerëzija panë
tue ecë pranë e pranë:
bir
edhe nanë!

Ndër vjershat që ka shkruar autori për partinë, ka disa të goditura, me figura më konkrete e me mendime më interesante. Vjersha «Thirrja e zemrës», sadoqë ka në të edhe strofa të rëndomta, është një ndër poezitë e këtij lloji që dallohet. Vjersha lë përgjithësisht përshtypje të mirë, sepse, krahas mendimeve e figurave të njohura, poeti këtu ka gjetje origjinale, të reja; veç asaj poezia përbën një shkrirje të «un-it» poetik me idetë e përgjithshme për partinë. Figura e minatorit që thotë:

...«Sot nën tokë
ma shumë se atje ndër male shoh un' diell,

portreti i tij i jashtëm, i krijuar me mjeshtëri, e gjallërojnë vjershën, e bëjnë më konkrete dhe ndihmojnë për të dhënë idenë e forcës së partisë, e cila mbështetet te këta njerëz. Lumtëria që ndjen poeti, frymëmarrja e qetë e «vocrrakëve», ëndërrat për fëmijët janë të lidhura me partinë. Kurse vjersha tjetër, kushtuar partisë, «Parti» duket që është diçka e rastit, ndonëse ka në të një strofë origjinale:

Ndër dej të vlon, Parti, e shtrenjtë
ty zjarri i rinisë,

*e pesmbdhjet vjeç ti arsyeton
me urtinë e pleqënisë.*

Është e qartë se vlera e çdo vepre qëndron pikërisht në atë të renë që artistikisht do të shfaqësh, në atë që nuk është bërë tashmë e njohur dhe standarde. Kurse, strofa tjetër e po kësaj vjershe ka mendime të thëna shumë herë:

*Parti, Parti! Ti bij na ke
e na të kemi nanë!
Me ty flamurin leninist
e ngrej m' në qiejt e gjanë.*

Vjersha si «Atdheu» e «Me sytë katër» që trajtojnë po këto tema të përgjithshme, në solemnitetin e tyre pak të ftohtë, kanë një vlerë relative. Në to ka pak mendime, figura të reja, me gjithë vargun e punuar me kujdes. Në vjershën «Atdheu» flitet për Adriatikon, për bukuritë e vendit tonë, për malet. Autori i drejtohet shqipes e i thotë të fluturojë «në qiej të rinj» etj. Të gjitha këto figura janë të njohura e të përsëritura edhe nga vetë poeti:

Gjithashtu pa ndonjë ide origjinale më duket edhe vjersha «Gëzojnë sot» ku, me ngjyra pak të thata, jepet figura e përdorur shumë herë e dëshmorëve, që ngrihen nga varri e gëzohen me ditët e bukura që jetojmë sot. Këtu poeti mendoj se nuk e ka gjetur dot atë kënd origjinal shikimi poetik që është i domosdoshëm edhe në një vjershë të veçantë. Ndryshe është vjersha kushtuar Naimit («Fletët e blerta»). Ajo është më e thjeshtë, më e ngrohtë; Shqipëria u bë vërtet zonjë siç ëndërronte Naimi dhe fletët e librave të tij do të mbeten gjithmonë të blerta, të freskëta.

Mendoj se mund të mos ishte vënë në vëllim cikli «O male» i shkruar, ndofta, për t'u muzikuar. Këtu ka vargje që përshkohen nga ndjenja e krenarisë e që japin idenë e madhështisë së vendit tonë. Të tilla janë, p.sh. vargjet e titulluara «Fjala e poetit». Po në tërësi mënyra

e të shkruarit është pak e vjetëruar, anakronike. Një herë këndojnë malet:

*Male, male, male jemi,
vapë e t'ftohtë kurr nuk kemi,
male jemi...*

Pastaj dëgjohet zëri i dëshmorëve, flet zemra e nënës, flet poeti e më në fund përsëri malet. Më duket se formave të tilla konvencionale e standarde në poezi, ashtu siç dalin në këtë cikël, u ka ikur koha.

Ll. Siliqi e ka ndjerë, me sa duket, nevojën e kërkimeve poetike për të dhënë idetë e mëdha të kohës sonë. Ndër disa vjersha vihet re se ai i pasuron mjetet e tij artistike. Po të jepej, p.sh., ideja e forcës së atdheut me vargje të zakonshme deklarative, po të thuhej shumë troç, ose me figura të rrahura ideja e lashtësisë së popullit tonë, e trashëgimit të vetijave të larta, e lidhjes së të kaluarës me të sotmen, vjersha nuk do t'ja arrinte atij qëllimi që është realizuar bukur në poezinë e shkruar vitet e fundit «Rrapi». Rrapi mund të merret këtu si simbol i atdheut: ai ka parë trimat e Skënderbeut dhe trimat partizanë. Nën hijen e tij tani fëmija lozin të shkujdesur. Dikur, në luftë, deshën ta digjnin dhe degët e tij, si krahë të përflakura, u ndrinin udhën njerëzve nëpër borë. Ai është dëshmitar i ngjarjeve të ngjethshme e të gëzuara dhe lidh të kaluarën me të sotmen:

*Dhe kur fletët e rrapit shushurijnë,
të ngjet
thue bisedojnë, gju më gju kah rrijnë,
i pesëmbëdhjeti shekull
me shekullin njëzet.*

Kjo është një vjershë e pasur në mendime e fantazi poetike; e pasur sepse gërshetohen idetë e rëndësishme me krijimin e detajeve konkrete, sepse nëpërmjet përshkrimit të jashtëm të një rrapit të zakonshëm ne shohim figurën simbolike të tij.

Temës që lidhet me Bashkimin Sovjetik, me figurën e Leninit, me paqen dhe miqësinë e popujve në botë, Ll. Siliqi i ka kushtuar vëmendje, duke krijuar disa vjersha të frymëzuara e të fuqishme. Siç do t'i shohim, ka ndër to edhe vjersha tepër të përgjithshme e të zakonshme, ku nuk gjejmë mendim origjinal, sado që ato mund të ruajnë në vetvete një farë dinjiteti.

Të tërheq vëmendjen vjersha «Në Mauzole» për forcën e saj, për mendimet që e përshkojnë. Këtu frymëzimi është konkret, poeti ka përpara syve Leninin me dorën e mbledhur grusht dhe turmat e panumërta që shkojnë në mauzole. Figurat nuk janë të stërholluara e të kërkuara, ato vijnë vetiu si verb i ashpër dhe tingëllonjës politik; nëpërmjet poetit këtu shprehet dashuria e madhe e popullit tonë për këtë gjeni të Revolucionit, adhurimi përpara mendjes së tij të ndritur dhe zemrës së madhe. Dhe autori gjen figura spontane, të papritura:

*Dhe dora e tij,
që botës drejtimin tregoi,
e ngrime nga akulli i vdekjes,
si grusht,
do mbesë ndër shekuj
mburoj' e liris' së fitueme,
si grusht i njerzis' që kërkon
tiranët përjet' me vorrue
dhe botën e re me naltue.*

Edhe ritmi i vjershës (me kombinimet metrike të zakonshme për poetin) është i zhdërvjelltë: mendimi dhe fjala rrjedhin. Si në këtë poezi, ashtu edhe në mjaft të tjera e në ndonjë poemë të Ll. Siliqit, fillon e ndjehet në periudhën pas çlirimit ndikimi pozitiv i Majakovskit, të cilin ai e ka studjuar dhe e njeh mirë.

Vjershë e fuqishme është edhe «Kujtimi i Leninit» që mbështetet në faktin historik se si në Kuvendin Kushtetues, më 1924, Avni Rustemi kërkoi që të nde-

rohej kujtimi i V.I.Leninit. Është ky një fakt me të vërtetë burrnor e mallëngjenjës nga historia e luftës së popullit tonë për liri. Vjersha e krijon mirë atmosferën, vende-vende fjala është e fuqishme dhe e prek lexonjës, duke i ngjallur krenari për figurën e shquar të patriotit luftëtar, Avni Rustemit dhe duke i treguar se lidhjet tona me idetë e Leninit dhe me atdheun e revolucionit kanë rrënjë të thella.

Nga vjershat e përgjithshme, retorike, që bëjnë përshtypje të mirë, mund të zemë ngoje «Përshtëndetje», ku shfaqen ndjenjat e dashurisë së poetit, që ndodhet në Moskë, për vendin e tij. Këtu shprehen ndjenja të ngrohta dhe të sinqerta. Interesant është se edhe dashuria për vendin, edhe lidhja me Bashkimin Sovjetik konceptohen nga poeti nëpërmjet nocionesh të mëdha, të rëndësishme, në një plan të gjerë dhe jo me detaje intime, personale. Kjo ka të bëjë me llojin e poezisë dhe natyrën e poetit, po edhe me kohën. Në ato vjete, të rinjtë e dalë nga lufta kështu i konceptonin më tepër këto ide: Moskë — është Kremli me yjtë e rubinit; atdheu: malet e larta ose «jeta e re» që «farkëtohet». Është koha kur individi me dëshirat e tij personale, më ndjenjat e holla, sikur hiqet mënjanë për t'u lënë vendin çështjeve të mëdha shtetërore, që i takojnë gjithë popullit ose që janë shndërruar në simbole të përbashkëta. Kështu që vargje të tilla janë të ndjera në mënyrën e vet me gjithë solemnitetin dhe frymën pak ceremoniale. Duke u zhvilluar më tutje jeta jonë dhe letërsia që e pasqyron atë, duke u formuar më tepër individi, duke u pasuruar ndjenjat dhe kërkesat e tij, bëhet më e nevojshme lidhja në veprat letrare të së përgjithshmes, me të veçantën, të lirikës intime me lirikën qytetare, pa injoruar, doemos, profilin e çdo poeti, mënyrën e tij të krijuarit. Një fenomen i tillë zhvillimi vihet re në poezinë e ditëve tona dhe në kërkesat e lexonjësve.

Ndër vjershat me tematikën që u përmend më lart ka edhe vargje shumë të përgjithshme, si, p.sh., te «Përmendorja», një vjershë ku autori thotë gjëra të zakonshme, ku mendoj se nuk e ka gjetur dot frymëzimin.

Ka vargje që tingëllojnë si pohime të thjeshta prozaike. Duke iu drejtuar Ushtrisë Sovjetike, që çliroi botën nga fashizmi, autori thotë:

Rrugët pagzuen
për nder të emnit tand,
me të përshëndetë
njerzit gzueshëm dolën
në sheshet e Evropës,
për ty folën,
e u ngritën
përmendore
anekand.

Ideja e vjershës — luftënxitësit rrëzojnë përmendore për të hapur varre — është e mirë, po nuk është zhvilluar bukur poetikisht dhe vjersha nuk ja arrin qëllimit. Po ashtu e zakonshme, e rastit, me pak frymëzim më duket edhe vjersha «Në rrugët e Phenianit dielli ndrin.»

Tema e punës, e ndryshimeve socialiste, që duhet të zërë një vend shumë të rëndësishëm në letërsinë tonë të re, e ka preokupuar edhe Ll. Siliqin. Në disa raste ai ka ditur të vëjë re e të shprehë ato që kanë ndryshuar në jetën e sotme dhe t'i japë nëpërmjet detajesh artistike:

*Edhe banori i ksaj lugine
s'dëgjon ma qenin kur angullin,
dëgjon si vinça e eskavatorë
zhurmojnë thell' pa me një orë.*

Në këtë vjershë që i kushtohet hidrocentralit, ka vargje që tregojnë si kanë ndërruar faqe ato vise, si në vend të pishës së zbehtë tani ndrit elektriku. Po vjersha «Kur nata zbret» vende-vende të le përshtypjen se është shkruar në mënyrë pak cerebrale, me ndonjë pasthirmë që vjen si e papritur për ritmin e shtruar e të qetë të poezisë dhe prish njësinë e stilit:

*Mbi shkamb mendueshëm rrij ket' natë.
Lumi vrapon thue tue dihatë.
me te me u matë kem rrâ,
o puntor' — krenoniu, pra!*

Strofa do të ish e goditur (sidomos vargu për lumin që vrapon duke dihatur) po thirrja «krenoniu, pra!» duket pa vend. Do të shohim edhe në ndonjë rast tjetër, kur autori bën thirrje të tilla edhe atje ku tingëllojnë të tepërta, thirrje që lënë përshtypjen e një pathosi të kërkuar e jo të natyrshëm.

Lidhja e poetit me fshatarët, me kooperativën e tyre, dashuria që tregojnë ata për të është një tipar karakteristik i kohës sonë, që dëshmon ngritjen e nivelit kultural të masave, nderimin që u bëjnë tek ne intelektualëve. Për këtë bëjnë fjalë strofat e para të vjershës «Në Lumalas», të cilat vijjnë të rrjedhshme e të natyrshme. Pastaj nga pikëpamja e thurjes, vjersha merr një drejtim tjetër: nga kjo tablo e përgjithshme e gëzimit, e mikpritjes autori kalon në përshkrimin e takimit dhe të njohjes me një të ri fshatar, figurën e të cilit ai do të na e krijojë. Po jeta e tij jepet në mënyrë shumë të përgjithshme, pa asgjë të veçantë dhe individuale, ajo përdoret vetëm si mjet për të treguar gjendjen e fshatit në të kaluarën dhe luftën që është bërë kundër armikut. Sadoqë këtu kemi të bëjmë me poezi e jo me prozë, prapë mendoj se kur poeti do të krijojë figura njerëzish, ne si lexonjës s'mund të mos pretendojmë që ata të jenë të gjallë, që t'i shohim përpara syve. Po këtu djaloshi përshkruhet shumë thatë, në mënyrë skematike dhe nuk të lë ndonjë përshtypje:

*Djaloshi qe njëherë partizan,
veç pushkë e minë e mitroloz e bombë
kishte në mendje, sot në gojë mban
kultivator, kombajnë e motopompë.*

Nuk është fjala për të përdorur hollësi të prozës, po për të gjetur te ky djalosh diçka të gjallë, poetike që të bëhet edhe për ne i dashur e i afërm.

Me pathos politik, polemizonjëse është vjersha «Rrëh zemra e tokës sonë» ku poeti e gjen poezinë pikërisht në punën fisnike të njerëzve, në burimin e pa-surisë së naftës që i rrit atdheut tonë «mall e gjanë». Ritmi është i zhdërvjellët, kombativ, ai të kujton fjalën e fuqishme të Majakovskit. Nocioni i së bukurës dhe i të dobishmes lidhet këtu në një të vetme:

Ma të bukur pamje

syni mos më paftë!

Thirrja e gazmendit

le të buças' mbi atdhe:

Naftë!

Naftë!

Naftë!

Ndër vjershat që lidhen me temën e punës ose me figurën e punëtorit mund të përmendim edhe «Që t'i këndosh pranverës», e cila shtron njëkohësisht edhe problemin e paqes. Shumë e menduar, e montuar dhe artificiale më duket kjo vjershë! Punëtori ka nënshkruar atë ditë për paqen në botë dhe i bën një letër së shoqes, që ndodhet larg bashkë me fëmijën. I nxitur nga dëshira për paqen, nga urrejtja kundër atyre që duan të hapin një luftë të re, ai i tregon gruas historinë e jetës së tij. Po si është e mundur që gjer në atë kohë ai të mos ja kishte thënë gruas këto gjëra, as për babanë që i kishin varur, as për luftën që kish bërë ai? Kaq indiferentë ishin këta të dy, burrë e grua, ndaj jetës së mëparshme të njëri-tjetrit? U desh nënshkrimi për paqen që ai t'i thoshte të gjitha këto! Kjo nuk ta mbush mendjen; mendoj se vjersha «Që t'i këndosh pranverës» është skematike, e dobët dhe artificiale.

Ll. Siliqi ka shkruar fare pak lirika kushtuar dashurisë. Edhe në këtë vëllim ato pothua se nuk lozin ndonjë rol në krijimin e profilit të poetit, në zhvillimin e krijimtarisë së tij. Disa janë këngë të thjeshta lirike, të shkruara jo pa dinjitet, të këndshme, po që nuk dallohen

për origjinalitet ose merita të veçanta. Të tilla janë, p.sh., «Këngë për besnikërinë», «Erdhe ti», «Adriatik, o i bukri det», «Drita, Shpresa, Bukurija». Interesante për ndjenjën e hollë, për të treguar kompleksin e ndjenjave njerëzore është vjersha «Letra e padërgueme». Kjo vjershë ka vërtetësi psikologjike: heroi lirik ruan në sirtar një letër shkruar një vajze që deshte dikur. Jeta e solli ashtu që letrën nuk e dërgoi; ata të dy shkuan udhëve të ndryshme: që të dy më vonë, ndofta, u bënë të lumtur, po kujtimet e vjetëra mbetën në një kënd të shpirtit. Po një ndër vjershat shumë të bukura të vëllimit është, pa dyshim, «Heshtja që flet» e cila është shkruar me shumë ngrohtësi, në mënyrë koncize, me figura të reja edhe për vetë krijimtarinë e autorit. Me pak fjalë, këtu tregohet historia e dashurisë, e martesës, e lumturisë familjare. Dhe çdo varg ka një nëntekst lirik, të bën të mendosh dhe të shohësh të gjallë përpara syve fytyrën e vajzës, sytë e saj; lexonjësi ndjen se ç'lidhje të forta, të sinkerta janë vendosur midis dy të rinjve që dashurohen. Detajet janë të bukura e plot kuptim nga pikëpamja psikologjike; vjersha është e thellë, plot mendim. Figurat nuk janë të harxhuara, standarde, përmes të së pjesëshmes, shpesh jepet e tëra:

*E syve të gështenjt
flaka e gjallë
a pikëllimi i bebzavet,
rrudha hirplote në të gjanin ballë
në heshtje flet!*

Vargu, i zakonshëm për poetin, me rima të shpeshta, tingëllon këtu bukur; ndarja e fjalëve dhe pauzat ndihmojnë ritmin, i japin atij një harmoni më të lirë, i shtojnë forcën e ndjenjës.

Veçoritë e talentit të Llazar Siliqit duken edhe më qartë në poemat e tij. Këtë gjini autori e zhvillon me sukses dhe ka arritur të japë disa krijime me të vërtetë të frymëzuara, të fuqishme që, sikundër edhe vjershat e tij më të mira, pasurojnë letërsinë tonë të realizmit socialist.

Lloji i poemës që, ndofta, i përshtatet më tepër talentit të Ll. Siliqit, — duke u nisur nga krijimet e tij të deritanishme, — është lloji liriko-epik, kur ndjenjat dhe mendimet personale janë të ngjeshura me fakte emocionante, të marra nga realiteti, me tablo të dhëna më tepër si sintezë, si rezultat i përpunimit të tyre në botën e brendshme të poetit. Sikundër edhe në pjesën tjetër të krijimtarisë ashtu edhe në poema, autori përdor kryesisht ngjyra të forta, planin e gjerë, fjalën e drejtpërdrejtë. Po për vetë llojin e poezisë së Ll. Siliqit, atij i shkojnë fare bukur figurat, krahasimet, simbolet, hiperbolat, antitezat. Këto e pasurojnë shprehjen poetike dhe, nganjëherë, kur ndihet mungesa e tyre ose kur përdoren figura të njohura që s'bëjnë më përshtypje, vargu humbet, efekti emocional dobësohet.

Në poemat e tij, po t'i shohim nga ana e tematikës, Ll. Siliqi ka pasqyruar ngjarje të rëndësishme, tipike, që tregojnë gjendjen shpirtërore të popullit tonë në çaste të caktuara historike. Në disa raste ai i ka kushtuar vëmendje momenteve ose ngjarjeve që i ka jetuar vetë, që i ka ndjerë thellë dhe kjo gjë ka dhënë rezultate shumë të mira. Luftës i kushtohet poemthi «Të njëzet e shtatët» dhe poema «Prishtina». Që të dyja këto poema janë shkruar me një ndjenjë të thellë, me një lirizëm të fuqishëm qytetar dhe me forcë epike. Në këto dy vepra del shumë e qartë edhe prirja e Ll. Siliqit drejt epizmit, drejt pasqyrimit jo vetëm të «un-it» lirik, po edhe të botës objektive, të detajeve të jashtme, të lidhura me historinë, me përshtypjet konkrete nga jeta. Ato, sigurisht, nuk janë identike për vlerën e tyre dhe për mënyrën e të shkruarit, po ka në to diçka të për-

bashkët: është pasioni për t'i kënduar akteve heroike të popullit tonë, besimi në fitore, pasqyrimi i realitetit me ngjyra të vrazhdëta. Si në njërën ashtu edhe në tjetrën ka pasuri figurash të lindura vetiu; mendimi është i ngjeshur me emocion; ngjarja nuk tregohet në mënyrë të detajuar, po nëpërmjet sintezash, përgjithësimesh, që bën vetë autori. Po «Prishtina» është sigurisht vepër më e plotë, e shkruar me më tepër temperament e forcë; me përgjithësimë më të rëndësishme.

Poemthi «Të njëzeteshtatë» që ka për bazë një fakt të vërtetë, është një vepër pak më e shtruar, meditative. Vargjet vijnë të rënda dhe pak të zymta, pa llustër. Me vargje të ngjeshura jepet mirë atmosfera e kohës, vështirësitë që duhet të kalojnë të burgosurit:

*E randë edhe e turbullt atmosfera
jashtë mbi qytete e fshatra, n'zemra t'njerzve.
Po mbrend' në burgun e Tiranës trimë
kanga shpërthen. Aty n'qelitë e errta
kang' lufte lejné që mandej përhapen
tej hekrash t'burgut e me zjarr këndohen...*

Nocioni abstrakt «e Vërteta» këtu, përmes figurës që krijohet, gjallërohet, merr një formë konkrete:

*...mbrend' ndër pranga
e lidhun kamb' e duer asht e vërteta*

Poemthi është shkruar me realizëm. Të burgosurit që duan të dalin jashtë, në punën e tyre heroike e plot durim për të çarë burgun, hasin në vështirësi të mëdha, po ata ja dalin në krye qëllimit të tyre. Ideja e poemthit është forca morale e komunistëve të rritur nga partia, e komunistëve që i kanë rrënjët thellë në popullin që, jashtë mureve të errëta të burgut, heq e vuan nën thundrën armike. Kontrastet, të thjeshta, të pakërkuara, i japin gjallëri poemthit. Këtu nuk ka fraza të përgjithshme; mendimi poetik vjen i lidhur me një përshkrim konkret të luftës së përditshme që bëjnë të burgosurit

të zhytur në ujë gjer në brez. Të njëzet e shtatët ja arrijtën qëllimit: dalin nga burgu, duke e lënë atë prapa si «hije e vdekjes» dhe bashkohen me shokët në luftë kundër fashizmit.

Vargu, sikundër thashë, më duket i përshtatshëm në tërësi. Po mendoj se ka raste kur ai lexohet pak më vështirësi, ka shumë monosilabe; ngadonjëherë apostrofe të tepërt:

*Dhe zhytun n'uj' përgjysëm rrshqan' tue u ngrehë
me brryla të përgjakun, t'ngrimët n'palc...*

Gjithashtu tingëllon pak me retorizëm (që nuk është karakteristik për këtë poemth) vargu i përsëritur disa herë: «a ka kala që s'marrin komunistët». Do të ishte më mirë që kjo të thuhej më pak e të kuptohej vetë nga lexonjësi.

Ndofta edhe po të kish rimë «Të njëzeteshtatët» do të tingëllonte bukur, po këtu nuk ndjehet fare mungesa e rimës (sadoqë ka ndonjë rimë të rallë). Është vështirë të pohosh me plot gojën, po, ngadonjëherë, ndofta rima është po aq e parëndësishme për një vepër të caktuar poetike sa edhe ngjyrat për një film artistik, që mund të bënte edhe pa të. Vargu i bardhë sikur ndihmon këtu për zhdukjen e konvencionit, për të treguar ashpërsinë e momentit, se mjafton vargu i rregullt 11-rrokësh për të dhënë ritmin e ngjarjes dhe të përgjithësimeve poetike.

Poema «Prishtina» është një ndër veprat më të bukura të Ll. Siliqit dhe përgjithësisht të veprave tona poetike. Ajo është shkruar me forcë, me një frymëzim të vërtetë spontan; ajo godet dhe hymnizon me fjalë që të tronditin dhe të ngashërejne thellë. Kjo poemë është një nga shembujt më të mirë të lirikës sonë qytetare, ku pathosi është i vërtetë e i ndjerë, ku heroi lirik shkrihet e bëhet një me të vërtetën e përgjithshme, me ndjenjat e shoqërisë së re, me sigurinë dhe forcën e saj. Autori e ka shkruar këtë pas çlirimit, kur armiqtë e paqes e të lirisë filluan të ndezin urët për t'i vënë zjarrin përsëri botës dhe për të mohuar luftën tonë për liri, për të lënë në heshtje heroizmin e popullit shqiptar. I inçji-

njuar thellë, poeti, që kishte kaluar vetë tmerret e luftës, duke shprehur ndjenjat dhe mendimet e popullit tonë, krenarinë dhe trimërinë e tij, i ve përballë shpifjeve dhe poshtërsisë së imperialistëve të vërtetën e ashpër e të lavdishme të atdheut tonë. Ai e bën këtë më tepër duke përshkruar kampin e Prishtinës, ku ka qenë edhe vetë i internuar, ku ka parë masakrën dhe qëndresën e shokëve të tij, ku i ka ndjerë vetë të gjitha.

Pjesa e parë e poemës është një evokim i së kaluarës, i ngjarjeve të rëndësishme nga lufta nacionalçlirimtare. Poeti arrin në përfundimin se kjo e kaluar nuk mund të errësohet, se ajo flet vetë me forcë të madhe dhe tronditëse. Faktet janë të forta; duke u mbështetur tek ato, autori krijon figura të fuqishme:

*Po t'ngrihej sot
zani i të vramve
njëzetetmijësh,
një kor i stuhishëm,
nën kambë do t'dridhej gjith dheu.*

Duke përdorur karakteristikat konkrete të disa dëshmorëve, të çastit kur ata u vranë, poeti krijon tablo të shpejta që e mallëngjejnë lexonjësën. Perlati thërret «Ende jemi gjallë». Fjalët e tij do të ushtojnë në shekuj! I dërmuar në tortura, Manush Alimani ngrë lart si flamur këinishën e larë në gjak. Kemi përsëri një moment të bukur të konkretizimit, të gjallërimit të nocionit abstrakt të «Fitores». Kjo bëhet për lexonjësën si diçka e qartë, që shihet me sy:

*Fitorja
që dergjej ndër burgjet e lagshta,
që ecte
ndër gjurmët
që lan' mbi dëbor' partizanët,
me gjakun e shokve që u ngjye,
fitorja që rrahi nga Peza,
fluturoi n'Labinot...*

Ky përfytyrim vizual, simbolik i «Fitores» e pasuron poemën me figura interesante që japin në mënyrë sintetike dhe emocionale historinë e përpjekjeve për të fituar lirinë.

Pjesa e dytë përshkruan me pasion e dhimbje, përmes faktesh konkrete e ngjethëse dhe fjalësh të zjarrta poetike, kampin e Prishtinës, me gjithë llahtaret e veta. Po përshkrimi nuk mbetet i jashtëm, i përciptë; autori tregon gjendjen shpirtërore të të internuarve, qëndresën e tyre të heshtur. Pasi bën fjalë si rronin çdo ditë të internuarit:

Të zbetë,
të ndytë,
të smutë,
me kokat e qethuna,
në dorë me tasa
të gjetun ndër plehna
të ndryshkun,
mbrendë
lang neverije...

ai thotë:

*Nji dhomë me njerëz të shuem? Jo!
Nji depo me zjarr e barot!*

Dhe ky nuk është një pohim deklarativ: nga gjithë fryma e poemës, nga faktet që rikrijohen njeriu bindet për vërtetësinë e këtyre fjalëve.

Vlera e «Prishtinës» qëndron në lidhjen e fakteve të gjetura mirë, të figurave konkrete, që mbështeten në detaje konkrete, me pathosin lirik të poetit që, plot temperament, pohon ose mohon në emër të idealit të partisë. Në këtë poemë Ll. Siliqi ka shkruar, ndofta, vargjet më të bukura të tij kushtuar partisë. Ato janë të lidhura me frymëzimin konkret, me emocionin që rrjedh nga përshkrimi i ngjarjeve reale, ato vargje tre-

gojnë forcën e partisë që është burim i vetijave të larta morale të njerëzve të rrethuar nga zinxhirët e nazistëve:

Parti!

E shtrenjtë Parti!

*Sa shpresë
e guxim*

edhe zjarr

na ngjall e na ndez ti në gji!

Ti i rrite dëshmorët,

që ran' tue këndue!

Ti i msove

me kang' me jetuem,

në luft' me sulmues, —

në kangën e ashpër

si jeta e puntorve të gjorë,

në kangën e zjarrtë

si flaka ndër gjokset rinorë...

Këtu edhe ritmi është i zhdërvjellët, dinamik, edhe fjala e thjeshtë, po e fuqishme.

Poema «Pristina» është një vepër e fortë, e ndjerë. Poeti ja ka arritur qëllimit të vet.

Llazar Siliqi, me poemat «Mësuesi», «Miku» dhe «Erë pranverore» tregon një prirje drejt krijimit të poemës narrative, drejt poemës me figura njerëzish të kohës sonë. Shtrirja në këtë fushë të re, për mënyrën e përgjithshme të të shkruarit të Ll. Siliqit është një dëshirë për ta kapur realitetin nga anë të ndryshme, për të hyrë më thellë në shpirtin e njeriut të kohës, për të zbuluar edhe konflikte të realitetit të sotëm.

Në poemthin «Miku» krijohet një skenë konkrete, bisede të gjallë, që mbushet me përshkrimin e poetit dhe me ndjenjat e tij lirike. Kjo vepër është më tepër narrative me një subjekt të caktuar, sadoqë subjekti është i thjeshtë dhe poeti nuk i ka shtruar vetes detyrën që të krijojë një vepër të gjatë me situata që të lidhen me njera-tjetrën, me fabulë më të pasur etj. Këtë detyrë ne e ndjejmë në dy poemat e tjera të tij «Mësuesi» dhe

«Erë pranverore», në të cilat duken më shkoqur edhe të mirat edhe të këqijat e këtij lloji në trajtimin e Ll. Siliqit. «Miku» është një vepër e realizuar, e këndshme, e shkruar me vërtetësi dhe thjeshtësi. Ideja e saj është e rëndësishme për kohën tonë: autori tregon lidhjen e ngushtë, të natyrshme, me rrënjë të thella, që egziston midis udhëheqësve dhe popullit, e këtu konkretisht, midis shokut Enver Hoxha dhe një fshatari të thjeshtë. Figura e Hasan Fanit është përshkruar me realizëm: ai flet me bindje për rrugën e vështirë të luftës, për besimin që ka në të arthmen e Shqipërisë. Fjalët e tij duken të zakonshme, të thjeshta dhe pikërisht për këtë ato të prekin dhe të bindin. Ambienti është dhënë me ngjyra realiste, me ashpërsinë e tij, dhe këtu, merr hov vende-vende fjala lirike e poetit që tregon qëndrimin ndaj asaj që përshkruan:

*Pranë oxhakut rri Hasani,
pi duhan edhe mendon,
jashtë bumbllon e fryn murlani,
tymi sytë t'i verbon...
Hej ti, tym, o tym i zi,
shum' ke ndej' n'kësollat tona,
por ka ardh' një vakt i ri
e nuk duem në tym të zi
ta çojm' jetën...*

Dhe bukuria është se në atë dhomë fshatare ende me «tym të zi», nga goja e fshatarit ende të veshur keq (poemthi është shkruar në një kohë kur pas reformës agrare gjendja e fshatarësisë sapo kish filluar të përmirësohej) tingëllojnë fjalë optimiste, që dalin nga zemra. Dhe e vërteta është kurdoherë më e bukur. Figura e shokut Enver gjallërohet në poemth, sidomos kur përshkruhen me lirizëm ndjenjat që poeti mendon se mund t'i lindin atij pasi ka biseduar me fshatarin, ndërsa dëgjon një këngë në fshat:

*Ndoshta Enveri për një ças
t'arthmen vet' do jet' tue pa...*

*camerdhokët, ndoshta, t'rritun,
agronomë e inxhinjerë,
asht tue pa shoku Enver.*

Duke lexuar poemthin mund të të lindë, ndofta, vetëm një dëshirë: në thjeshtësinë e vet biseda mund të kishte pasur një karakter pak më të thellë, mund të shprehë, edhe filozofia e fshatarit tonë me mendime më interesante që kanë lindur nga jeta, nga përvoja e gjatë e vuajtjes, nga mençuria popullore.

Në dy poemat e gjata narrative «Mësuesi» dhe «Erë pranverore» autori ka dashur të rikrijojë momente të rëndësishme heroike e shoqërore nga jeta jonë e pasqirimit.

Mund ta them që në fillim se «Mësuesi», sipas mendimit tim, qëndron shumë më lart nga «Era pranverore», po midis tyre ka diçka të përbashkët që lejon të bësh një konsideratë të përgjithshme. Në këto poema narrative zotëron konceptimi lirik i ngjarjes. Hovet lirike spikatin në qëndrimin e autorit ndaj heronjve të tij, në pasqyrimin e anëve romantike të jetës. Ngjarja, zhvillimi i subjektit nuk krijon këtu sa duhet një gjini epike në kuptimin që i japin teorikisht kësaj fjale, d.m.th. në kuptimin e pasqyrimin të botës objektive, të karaktereve të pavarura, sadoqë ka figura edhe çaste të realizuara në këtë vështrim. Në prirjen lirike, qoftë edhe kur është fjala për poema narrative, mund të shohim vetëm veçorinë e talentit të një poeti, i cili përdor mjete të ndryshme për pasqyrimin e atyre anëve të jetës që e tërheqin më shumë. Prirjet dhe mjetet poetike janë të ndryshme, po vlera e një veprë duket nga rezultati që ka arritur poeti, nga fakti sa i shërbejnë mjetet qëllimit të tij, sa në harmoni është forma me përmbajtjen. Mendoj se krijimi i një subjekti të caktuar, i situatave të ndryshme nëpër të cilat kalojnë heronjtë, i invencionit të fabulës, i dramacitetit të nevojshëm për zberthimin e temës — të gjitha këto nuk i shkojnë fort — të paktën gjer tani — talentit të Ll. Siliqit. Bota e tij poetike kërkon të dalë nëpërmjet tregimit, subjektit; vende-vende

ajo shpërthen bukur, po hera-herës pathosi e humbet forcën, nuk vjen i natyrshëm e në vendin e duhur. Nganjëherë ke përshtypjen se poeti dhe tregimtari nuk janë fort në harmoni me njeri-tjetrin. Kuptohet se autori në këto poema kërkon në rrugën e tij; ai do të përfshijë në një formë më të përshtatshme ngjarjet e kohës, karakterin epik të tyre, po jo gjithnjë shkon atje ku mund të ecte më lirisht, ku mund të zhvillonte më mirë talentin e vet. Kërkime të këtilla janë normale në rrugën e çdo poeti. Le ta shohim konkretisht këtë ide në të dy poemat, duke folur më me hollësi për vlerën e tyre poetike.

Poema «Mësuesi», me gjithë të metat e saj, është një vepër e mirë, në tërësi e frymëzuar, shkruar mbi një temë shumë të bukur, heroike, që jep mundësi për të krijuar një figurë të paharrueshme të mësuesit që dha jetën e tij për të çuar në malet tona diturinë dhe përparimin. Vepra ka përpjestime të gjëra, momente me të vërtetë realiste, skena që zërthejnë botën e brendshme të mësuesit; ajo është shkruar në përgjithësi me varg të punuar e me gjuhë të mirë. Poeti ja arrin gjer diku qëllimit për të treguar forcën morale të heroit të vet dhe botën e shëmtuar të armiqve, të atyre që e luftojnë, që tremben nga dituria, sepse ajo do të përhapë komunizmin.

Me ngrohtësi dhe forcë poetike tingëllon hyrja e poemës, natyra që e nxit poetin të shkruajë, kujtimi i mësuesit, Dritanit, që do të mbetet për të i paharruar:

*Ti ishe komunist, për ty nuk kishte
në botë gja ma t'naltë se njeriu,
s'u ndale kurr në rrugën komuniste,
kur hasmi ndej në pritë a shfryu veriu.*

Ndihmojnë për të krijuar figurën e Dritanit momentet kur përshkruhen shqetësimet e tij për shkollën, gëzimi e mallëngjimi që i zgjon atij lahuta, e, sidomos, për zbulimin e botës së tij të brendshme, kapitulli i fundit i shkruar me ngrohtësi, me forcë lirike e me detaje të zgjedhura bukur. Ai rri e qorton hartimet. Mendimet i shkojnë tek e shoqja, te fëmija; pastaj enden

larg në Moskë, në Kremlin, për të cilat ai ka ëndërruar gjithë jetën. Këto shqetësime e ëndërra janë humane dhe tipike për kohën tonë e veçanërisht për atë periudhë për të cilën bëhet fjalë në poemë. Paraqitja e ambientit, e ndjenjave të heroit — ndjenja të vërteta e të thella, — puna e palodhur që bën ai, — i kërrusur mbi fletoret e nxënësve, — e japin më të qartë se kudo në faqet e tjera të poemës figurën e Dritanit. Ai i do nxënësit me gjithë shpirt dhe mendon për të ardhmen e tyre:

*O vijëza të dashuna
ende të pasigurta,
me ju ma von' do shkruajnë ata
mendimet ma të urta!*

Të mbetet në mend edhe figura simpatike e gjyshit, që ofron kasollen e tij për shkollë sa kohë që nuk është ngritur ndërtesa. Për të nuk flitet shumë, po figura bëhet e gjallë: gjyshi i bie ziles, gëzohet kur vijnë fëmijët, hidhërohet kur ata largohen. Sa pak fjalë duhen nganjëherë për t'i arritur qëllimit!

Një ndër sukseset e autorit në këtë poemë është edhe krijimi i figurës së kulakut Tare Gremçi, armik i egër e konsekuent. Portreti i tij skalitet mirë. Kjo figurë i jep mundësi autorit për të arritur në një moment me të vërtetë të thellë, lirik e mallëngjenjës: Tare Gremçi, i tmërruar, kalon pranë varrit të një partizani që e ka varrosur vetë të gjallë. Në një mënyrë romantike, duke shfrytëzuar edhe një motiv folkloristik, autori të mallëngjen me përgjithësimin e figurës së komunistit që bën gojë e flet nga varri:

.....
«Nëna e shkret' në çdo varr të panjohun më qan,
motërza më loton në çdo varr partizan!
Asht i shkurtë e i thjeshtë, o shqiptarë, emni im
dhe për njerzit kudo ai gjëmon si kushtrim!...
Drit'n e syve të mi ju, anmiq, terratistë.
Porsi djelli ndriçon emni im: komunist!»

Në poemë ka mjaft vargje të ndjera lirike që i japin asaj temperament dhe ndihmojnë për zbërthimin e idesë së autorit. Në përshkrimin e fshatit, te kasolleve gjen nota realiste. Po mendoj se një temë e tillë mund të trajtohej më mirë, mund të krijohet një figurë më e thellë, më interesante e mësuesit me zemër të madhe. Te kjo figurë mund të pasqyroheshin, ndofta, me forcë e thellësi, idealet e njeriut të sotëm, mund të dilte më qartë dhe në mënyrë më poetike bukuria e ndjenjave, mendimeve, ëndërrave të këtij njeriu me «Nj» të madhe. Këtu dua të dal më konkretisht te ideja e përgjithshme që e shfaqta më lart për të metën themelore të poemave narrative të Ll. Siliqit. Duke dashur të zgjerojë sferën e realitetit që pasqyron, autori këtu ka shkuar më tepër duke u shtrirë e duke ndërlikuar subjektin, se sa duke u thelluar e duke nënvizuar prirjen e tij lirike, ose liriko-epike. Subjekti është menduar më tepër si në prozë: autori shtron përpara nesh shumë çështje që do t'i përshtateshin një novele apo tregimi: ai na flet për vështirësitë e hapjes së shkollës, për mbledhjet e luftën e armiqve që duan të pengojnë diturinë e përparimin (për një konflikt të rëndësishëm që këtu mbetet i sipërfaqshëm), na shtron, sadoqë shkarazi, çështjen e zhdukjes së armiqësive që lindnin në të kaluarën nga hakmarrja (rasti i Mirushit), problemin e grumbullimit të arësimtarëve për të përhapur në ato vise arësimin, e ndesh heroin me mikun e tij të luftës dhe tregon historinë e tyre etj. Veprimi pra shtrihet mjaft; ai nuk vjen aq i lidhur e në mënyrë spontane dhe me të drejtë njeriut shumë faqe mund t'i duken të përcipta, të padetajuara dhe, duke pasur përpara një zhvillim të tillë të subjektit, mund të kërkojë aksion më të thelluar, më të justifikuar, karaktere më të plota, gjë që do t'i takonte më tepër prozës se sa poezisë. Kështu pra mendoj se subjekti është i ngarkuar, i shtrirë, më tepër i përshtatshëm për prozën ose për një trajtim më epik të temës, gjë që nuk i shkon aq për shtat talentit të autorit. Kjo mënyrë trajtimi, ky zhvillim subjekti sjell një dëm konkret: poema nuk bëhet aq interesante, veprimi shpeshherë nuk vjen i rrjedh-

shëm dhe ndërhyrjet e poetit nganjëherë e humbasin rëndësinë dhe efektin e tyre ose poeti humbet fillin e frymëzimit dhe pathosi nuk vjen gjithnjë i natyrshëm. Veç kësaj, figura e Dritanit, sikundër thashë, nuk del e gjallë aq sa mund të dilte, shpesh mbetet e zbetë. Lidhur me Dritanin, subjekti vende-vende duket tepër i sforcuar, jo spontan: ai rri në shpellë se e zë furtuna (një moment ky pak arkaik) dhe atje mendohet; pastaj hidhet në lumë e shpëton një fëmijë që ishte duke u mbytur. Ke përshtypjen se ky çast është vënë si me dorë nga autori për të treguar fytyrën morale të heroit.

Moment i papërshtatshëm për poemën përgjithësisht realiste më ngjan edhe kënga e druvarëve, të cilët duken si ndonjë kor operistik, ndërsa punojnë duke kënduar:

*Oh maleve, oh maleve
sa trima eshtnat lanë!
Ndër male ne, ndër male ne
kushtrimin sot kem' dhanë!*

Ka mendime se «ndërhyrjet» e autorit në një poemë janë të panevojshme, se ato pengojnë aksionin, etj. Përmisht unë nuk jam i këtij mendimi, sepse këtu nuk merret parasysh përpara së gjithash karakteri i poezisë, që fundja është diçka e ndryshme nga proza. Po doemos, si në çdo gjë, edhe këtu duhet ruajtur sensi i masës e duhet parë sa lidhen artistikisht këto pasazhe. Le ta shohim në disa shembuj se si shpesh «ndërhyrjet» janë pa vend, të tepërta, me një pathos të sforcuar. Ka raste kur në këto «ndërhyrje» autori bën didaktikë të hapët:

*Eni, fëmijë, eni, vocrrakë,
të rij, të reja, eni me ne;
të gjithë mësoni, me plak e plakë,
t'lexoni ligjin e jetës s're!*

Ose, duke iu drejtuar mësuesve që shkojnë vullnetarisht nëpër fshatra:

*Merrni malin, merrni fushën,
o msues vullnetarë.
Sot me shkolla duhet t'mbushen
malet tona mbarë!*

Ka gjithashtu «ndërhyrje» me fjalë të përgjithshme, që nuk bëjnë përshtypje:

*Rrug' të mbarë, o bij të popullit,
ju pishtarë, ju përhapës drite
Këtë ushtri, që rritet për çdo ditë,
krahëhapët ti, o popull, prite!*

Vargje të këtij lloji mund të ishin më të pasura në mendime, në fantazi, sikundër ato që përmenda nga hyrja e poemës, të cilat, ndonëse pa figura, peshojnë, zënë vend:

*Ti ishe komunist; për ty nuk kishte
në botë gja ma t'naltë se njeriu.*

Në poemën «Mësuesi» ka strofa prozaike, ku vargu nuk rrjedh, sadoqë në përgjithësi është i goditur. Polimetri që përdoret këtu nganjëherë duket me vend e i përshtatet ritmit që do të krijojë autori, po kjo nuk bëhet gjithnjë me kriter e të lë përshtypjen se nuk është gjithmonë e justifikuar dhe e domosdoshme.

Poema tjetër narrative «Erë pranverore» kap edhe ajo një anë të rëndësishme të realitetit tonë: atje poeti i ka vënë vetes për detyrë të tregojë fatin e një vajze të thjeshtë, të dalë nga gjiri i popullit, Shpresës, e cila mëson në Bashkimin Sovjetik për endëse dhe kthehet në atdhe bashkë me shumë shoqe të tjera dhe ja fillon punës në kombinatin «Stalin». Këtu bëhet fjalë edhe për jetën e saj personale, për dashurinë dhe lumtërinë që arrin ajo. Si ide edhe si linjë kryesore e subjektit poema do të jepte mundësi për krijimin e një figure të plotë të vajzës shqiptare që del në jetë, me ëndërra e entuziazëm për botën e re që çelet përpara syve të saj, të një vajze në shpirtin e së cilës lind për herë të parë ndjenja e dashurisë.

Qëllimi i autorit është të japë disa tablo lirike nga jeta e endëses, nga kontakti i saj me atdheun e socializmit, nga puna, dashuria e lumtëria familjare. Këtu as që shtrohej detyra për të krijuar situata të ndërlikuara, momente dramatike ose për të zbuluar konflikte të paqëna. Autori pra ka zgjedhur një temë që kërkonte më shumë lirizëm, sinteza poetike, përshkrime, krahasime etj. Po vetëm se lirikat e tij të gjertanishme kanë pasur një karakter pak të ndryshëm nga lirizmi më i butë, më psikologjik që të dikton vetë tema e «Erës pranverore», Veç asaj, linja e subjektit, qoftë edhe në thjeshtësinë e saj, gjë që mendoj se i përshtatet më shumë poezisë me subjekt, ndryshe nga proza që mund të jetë më e ndërlikuar, me zikzake më të shumta, — linja e subjektit pra duhet të jetë e menduar jo në mënyrë standarde, skematike, po të vijë e natyrshme, bindëse.

Poema «Era pranverore», me gjithë ndërhyrjet poetike të autorit, shpesh të frymëzuara, me gjithë disa detaje që gjallërojnë tablotë, mendoj se edhe në përpunimin që i ka bërë autori, duke e përgatitur për këtë vëllim, mbetet një poemë e dobët, skematike, ku shumë gjëra kalojnë shkarazi, përciptas, ku nuk krijohet dot një figurë e gjallë e endëses së re, ku pothua gjithshka është e menduar në mënyrë cerebrale. Këtu skenat kalojnë njera pas tjetrës me një shpejtësi të madhe, pa lënë gjurmë të rëndësishme të lexuesi.

Lindja e dashurisë së Shpresës për Agronin tregohet në mënyrë skematike, nuk të bind e të duket se autori e ka krijuar artificialisht për të dhënë një kuadër më të plotë të heroinës së vet, të lumtërisë së saj. Nuk të duket kjo si një ngjarje e vërtetë, nuk të rrëmben dashuria e të rinjve: ti, si lexonjës, mbetesh i ftohtë ndaj fjalëve të autorit. E kjo ka të bëjë me zhvillimin e përciptë të subjektit, me figurën anemike të endëses, me precipitimin në përshkrimin e ndjenjave dhe sidomos me mungesën e thellimit në psikologjinë e vajzës së re, gjë e domosdoshme për karakterin e kësaj poeme. Edhe, fundi, pushimi në kamp, fëmija që presin, më du-

ken shumë standarde, ato vazhdojnë po atë linjë skematike që përshkon pothuaj tërë poemën.

Mendoj se në këtë poemë mungojnë detajet emocionjese të domosdoshme për këtë lloj, figurat e reja, të holla që do t'i shkonin për shtat frymës lirike të saj. Këtu kishte nevojë për të zbuluar me mjetet poetike skajet e fshehta shpirtërore të endëses, të botës së saj; ndofta nuk duhej treguar medoemos një «cikël i mbyllur i lumtërisë», duhej më tepër invencion poetik për të krijuar bindje të vërteta emocionale te lexonjësi.

Duhet thënë se edhe «Erën pranverore» polimetri nuk vjen gjithnjë si një nevojë e domosdoshme e duket si qëllim në vetvete.

Meqënëse autori shpesh nuk e gjen frymëzimin, nganjëherë, edhe vargu del i dobët, i varfër ose tepër i zakonshëm:

*Ma fort shoqnohem me j'vajzë ruse,
emnit i thonë Zoja;
ajo përhera thotë për mue se
do bahem endse e zoja.*

Ja edhe disa vargje të tjera tepër të zakonshme:

*Tokë e shejtë sovjetike,
o Odes', Qytet martir,
t'fala nga Shqipnia mike,
nga atdheu ynë i lirë!*

Ose:

*Drejt Odesës treni ynë
sulet me shpejti...
Sot në jetë fillon Shpresa
kapitull të ri.*

Theksova atë që është kryesore për këtë poemë — skematizmin e saj, e metë që sjell edhe dobësi të tjera poetike. Dobësia e kësaj poeme lidhet edhe me disa

dobësi të përgjithshme të poezisë sonë, sidomos në periudhën kur është shkruar kjo vepër.

* * *

Me poemën «Ringjallje», Ll. Siliqi ecën në rrugën e vargjeve të tij më të mira, në rrugën e «Prishtinës», të lirikave më të forta politike, se, në vijat kryesore, ai shpëton nga një prirje deklarative, ose nga përsëritja e disa figurave standarde që u shfaqën në disa vjersha ose poema të tij. «Ringjallje» është një poemë e shkruar me freski, me forcë poetike, me varg e gjuhë të bukur, me një ritëm të zhdërvjellët që i shkon për shtat brendisë së saj. Ashtu si edhe në krijimet e tjera më të mira të Ll. Siliqit, edhe këtu faktet konkrete përzihen me ndjenjat e autorit, ato shprehen nëpërmjet të heroit lirik, lidhen me sintezat poetike të autorit. Duke u nisur nga tablotë, nga detajet konkrete apo nga episodet, poeti rikrijon disa aspekte të rëndësishme të jetës në vendin tonë, të forcës shpirtërore të shqiptarit, të karakterit të tij, aspekte që lidhen me ndjenjën e dashurisë e me bukurinë e natyrës dhe të shpirtit njerëzore; ai tregon sukseset e mendjes njerëzore në kohën tonë, bën përgjithësimet të fuqishme poetike për shekullin XX dhe u drejtohet njerëzve të atdheut të tij me thirrje të zjarrtë për të ecur përpara. Këto thirrje, fjalë të thëna hapët, nuk tingëllojnë në mënyrë deklarative apo të sforcuar, po vijnë të natyrshme dhe të bëjnë entuziast, optimist.

Gjë e re në poemën «Ringjallje» është për autorin gjerësia e tablove, të cilat përfshijnë dhe lidhin aspekte të shumta; lirizmi që gërshetohet edhe me karakterin epik të poemës, fiton nuanca më të pasura; vetë tema, koha përcakton nota më të qeta, më të ëmbla. Autori përdor këtu më shumë detaje konkrete që gjallërojnë. Kështu, p.sh., i gjetur është detaji i shtëpisë së ndër-

tuar më tridhjetë e shtatë, që ka mbetur tani si qyqe në një kënd të qytetit, sepse e mbulojnë ndërtesat e reja të Tiranës, ose — po nga pjesa e parë — çasti kur flitet për punën vullnetare:

*Me kaçurrela n'erë,
apo me thinja
kur shkojmë në punë së bashku,
na përherë*

*themi:
marshon rinija.*

• Poema kap anët heroike, të bukura të realitetit tonë. Mendoj se kjo nuk është një vepër, e cila me një kompozicion të plotë, me tablo që vinë me konsekuencë njëra pas tjetrës, duke pasqyruar si duhet fazat kryesore të punës dhe të përparimit të atdheut tonë, të mund të jep-te një pasqyrë të gjithanshme të rrugës së Republikës, të përpjekjeve dhe vështirësive të saj. Nga mënyra si është shtruar, mendoj se poema nuk e pretendon një gjë të tillë. Me gjithë karakterin e saj liriko-epik, unë do të thoshja se në këtë poemë zotëron më tepër prirja lirike, se poeti ka shprehur ato momente, episode, ndodhi ose edhe atë legjendë që i ka lënë atij përshtypje, duke u tërhëqur vetvetiu pas një çasti të caktuar që ai e ka më afër zemrës, pa u menduar shumë për kompozicionin e veprës. Kështu pra këtu kemi të bëjmë me disa aspekte të caktuara të jetës dhe të forcës shpirtërore të Republikës sonë. Këto momente lidhen me anë të heroit lirik, të figurës së poetit, që del si një pjesëmarrës aktiv i jetës së vendit, po edhe si një nxitës për të shkuar përpara. Autori ka qenë i predispozuar për një trajtim të tillë të temës (kjo duket nga frymëzimi që e përshkon poemën, nga fryma spontane e saj) dhe mendoj se ka vepruar drejt. Kështu mund të shpjegohet fakti që ai i kushton shumë vend legjendës së Shkumbinit p.sh., e cila mund të duket pak e tepëruar, po ta konceptojmë ndryshe karakterin dhe gjininë e poemës.

Në «Ringjallje» ngrihen disa tema të rëndësishme që shndërrohen zakonisht në himne. Pjesa e parë i kushtohet burimit që e frymëzon poetin, lidhjes së heroit lirik me partinë. Autori thotë se çdo i ri pat ëndërruar të bënte gjëra të mëdha, të tregohej i zoti para së dashurës dhe atdheut. Po dikur realiteti i thyente ëndërrat dhe njerëzit mund t'i mbërthente mërzitja. Ky është motiv i njohur i poezive të para të Ll.Siliqit, që përseritet këtu me vend dhe me figura të reja. Ai falënderon partinë që nuk la të këputen këto ëndërra, që zgjoi ëndërra të reja, që forcoi personalitetin e njeriut. Kjo është një e vërtetë e shprehur bukur poetikisht, pa fjalë të përgjithshme. Dhe poeti shkon midis njerëzve, lufton dhe gëzohet bashkë me ta:

Puntorë,
 nëpunës,
 nxanës, —
 andrrat e tyne, —
 shkojnë përpara meje.
 Të trembun,
 të uritun,
 ecnin anës,
 tani —
 me sytë
 të ndezun prej hareje.

Me detaje konkrete autori jep pastaj një tablo të punës vullnetare. Vështirësitë e asaj periudhe, të cilat duhet thënë se përshkruhen mjaft shkarazi, krahasohen me kohën partizane, me traditat revolucionare.

Një himn të zjarrtë i këndon poeti ushtarit të kufirit, të cilit armiku nuk i nxori dot asnjë fjalë; ai, me shpirt në dhëmbë, shkon drejt atdheut që ndodhet në perëndim, në «perëndimin-lindje».

Pjesa e dytë e poemës fillon me vargje mjaft të frymëzuara e muzikale që shprehin dashurinë për atdheun, dëshirën për të jetuar me te, për ta njohur sa më

mirë. Me disa detaje të shkurtëra jepet një tablo e punës që bëhet sot, e pamjes së re që ka marrë atdheu, e bukurisë dhe veçorive të qyteteve tona, pastaj tregohet një episod mallëngjenjës që ngre lart karakterin e shqiptarit, i cili duron edhe dhimbjen më të madhe, vdekjen e të birit, kur është puna për të pritur në shtëpi të tij miqtë. Poeti bën konkluzionin se vetëm një popull me cilësi të tilla burnore mundi të kalojë një rrugë të lavdishme heroike. Ambienti i fshatit është përshkruar bukur; ndjehet tamam atmosfera shqiptare, fshati i veçantë tonë.

Plot lirizëm, ëmbëlsi janë vargjet e pjesës së tretë, e cila është një himn për bukurinë e natyrës, për gjerësinë e saj që krahasohet me bukurinë dhe gjerësinë shpirtërore të njeriut. Që të triumfojë në botë dashuria, lumtëria njerëzore, njerëzve u duhet liria, paqja.

E fuqishme dhe me mendime përgjithësuese është pjesa e katërt e poemës, një himn për kohën tonë, për shpikjet e mëdha të mendjes njerëzore. Këtu jepet më me forcë ideja e ringjalljes, e vitalitetit të botës socialiste. Poema përfundon me thirrjen që bën poeti për të ecur përpara dhe me vargjet që shprehin dëshirën e tij që kjo poemë të jetë një himn Republikës sonë.

Këto që thashë më duket se janë kryesore për poemën «Ringjallje», për vlerën dhe llojin e saj. Po më duket e nevojshme t'i bëhet poemës një vrejthe për një të metë që përsëritet edhe në raste të tjera. Autori i drejtohet shpesh vargut, poezisë së tij. Kjo mënyrë është e njohur dhe në disa raste shumë e përshtatshme, emocionante. Po, siç dihet, çdo gjë e tepërt e humbet vlerën. Unë nuk e them këtë se jam i mendimit që po të flasë për vete poeti gjoja i jep rëndësi vetes, bën autoklamë. Është e qartë se poetit i duhet «un-i» poetik, se ai shpreh të përgjithshmen përmes së veçantës, konkretes. Këtë e dinë të gjithë. Po unë këtu e kam fjalën te teprimet, te shfrytëzimi me vend e pa vend i po atij mjeti artistik, i cili shpesh ndërpret tablonë, varfëron mendimin, e çon poemën drejt një rruge standarde. E të këtilla teprime, kur autori i drejtohet vargut të tij,

vetes, ka shumë në poemën «Ringjallje». Kjo është e qartë dhe nuk besoj se ka nevojë për ilustrim të rasteve kur këto vargje janë pa vend ose kur përdoren me vend.

Më në fund desha të them se në këtë poemë ndjehet ndikimi pozitiv i Majakovskit, të cilin autori nganjëherë e ka si mësonjësin e vet. Pjesërisht nga ndërtimi i saj e nga stili kjo të kujton poemën «Mirë!» të Majakovskit. Po këtu ambienti, fryma janë krejt shqiptare. S'ka dyshim që edhe problemet e idetë janë të kohës sonë. Autori ka mësuar, nga Majakovski, po kjo më duket se nuk i ka sjellë dëm, po përkundrazi i ka ndihmuar.

Duke shkruar këtë poemë në prak të 15-vjetorit të çlirimit, Ll. Siliqi ka dhënë një vepër të frymëzuar që himnizon bukurinë dhe forcën e Republikës sonë.

* * *

Siç e përmenda që në krye, Ll. Siliqi ka qenë dhe mbetet një ndër poetët më të mirë të vendit tonë. Vargjet e tij kanë forcë dhe bukuri poetike, ato shërbejnë për edukimin e njeriut të kohës sonë me ndjenja patriotike, me ndjenjën e dashurisë për partinë; ato zgjojnë emocione estetike. Temat kryesore të Ll. Siliqit janë lufta e popullit për liri, nën udhëheqjen e partisë, rruga e lumtërisë së atdheut tonë, lufta për socializëm e për paqe, aktet heroike të ditëve tona. Poezia e tij ka më tepër karakter liriko-epik; ajo mbështetet në fakte të rëndësishme dhe shpesh arrin në përgjithësime që përshkojnë lirikën e tij qytetare.

Duke u mbështetur në librin «Kangët nuk mbeten kurr të pakëndueme» dhe në poemën «Ringjallje», m'u desh të ndiqja rrugën e poetit dhe të shkruaja në fakt një artikull për rrugën e tij krijonjëse. Ndonëse këtu nuk përfshihen disa vjersha që autori nuk i ka botuar në përmbledhje, mendoj se në vëllimin «Kangët nuk mbeten kurr të pakëndueme» ka mjaft vjersha tipike për të treguar anët e mira dhe të dobëta të krijimtarisë së

poetit. Nuk desha të përsëris disa përgjithësime që i bëra qysh në fillim. Për të sqaruar më mirë mendimet e mia do të them vetëm se rruga poetike që ka dhënë rezultate më të mira në krijimtarinë e poetit, është ajo që gjejmë në vëllimin «Rruga e lumtunisë» në «Prishtinën», në «Të njëzeteshtatët» dhe në «Ringjallje».

Vargjet deklarative me figura shpesh standarde, në një periudhë të caktuar kanë qenë karakteristike jo vetëm për Ll. Siliqin po pothuaj për gjithë poetët tonë. Ishte një periudhë tjetër kalimtare kur poetët, me një stazh më të vjetër, e kuptonin dobësinë e këtyre vargjeve, po nuk e kishin të lehtë të shkëputeshin nga disa forma e koncepte që u ishin bërë shprehi. Kjo fazë është duke u kapërcyer. Për këtë ndihmuan jeta, eksperiencia e, ndofta, edhe disa poetë të rinj, të cilët piqeshin në kushte të reja, kur jeta nxirrte përpara poezisë kërkesa të reja. Në larminë e stileve, mënyrave të ndryshme poetike, sot poezia jonë duhet të jetë më e thellë, të përshkohet nga më shumë mendime, të japë më tepër nuanca, të hyjë më shumë në shpirtin e njeriut të kohës sonë, të pasurojë mjetet e saj gjuhësore dhe artistike.

Ll. Siliqi e ka nisur veprimtarinë e tij më tepër si një poet i mendimit. Në përgjithësi mjetet poetike tek ai janë pasuruar, diapazoni i temave është zgjeruar, po poezia e tij duhet të ketë edhe sot më tepër mendime origjinale, të reja. Kjo i përshtatet poezisë së tij luftarake, po njëkohësisht edhe meditative.

Rruga poetike e Ll. Siliqit, me gjithë ngjitjet e zbritjet e veta normale për çdo njeri që krijon, flet qartë për ndihmën që ka dhënë dhe po jep ky autor, në poezinë tonë, për zhvillimin e poezisë tek ne!

1960.

VARGJE PËR SHEKULLIN DHE PËR SHQIPËRINË

(«SHEKULLI IM» vëllim me poezi i I. Kadaresë)

Qëllimi i këtyre shënimeve kritike është vlerësimi i përgjithshëm i vëllimit të I. Kadaresë «Shekulli im», dhe shtrimi i disa prej problemeve ideore që dalin në këtë vepër. Në artikujt e botuar rreth këtij libri janë shfaqur mendime të ndryshme dhe kjo, pa dyshim, ndihmon për të mbajtur një qëndrim të caktuar, për të theksuar më tepër disa anë të rëndësishme që tërhoqën vëmendjen e kritikës.

I. Kadareja është një poet i njohur në vendin tonë, një poet që e ka krijuar tashmë personalitetin e tij. Vargjet e tij priten me interes nga lexonjësit dhe, në përgjithësi, pëlqehen, sadoqë mund të ngjallin diskutime. Kështu ndodh pothuajse gjithnjë, kur kemi të bëjmë me vepra të vërteta artistike, vepra në të cilat poeti vë shpirtin e tij dhe ku — duke kërkuar poezinë — mund të ketë edhe teprime, pasaktësi të figurave etj., po ku ka thujse gjithmonë diçka tërheqëse, poetike, të gjallë, me frymëmarrje të lirë.

Po të shikojmë rrugën krijuese të I. Kadaresë, do të vëmë re një ecje përpara drejt një arti me më shumë ngjyra dhe, ç'është më e rëndësishme, me më shumë probleme e ide që kapin thelbin e kohës sonë. Nga një lirikë intime, nga zbërthimi thujse krejtësisht lirik edhe i temave shoqërore, poeti ka shkuar drejt trajtimit më të gjërë epik të temave të atdheut, të shekullit tonë, të problemeve të luftës dhe të paqes, drejt një poezie me

më shumë mendime. Në poemat e këtij vëllimi, ku në radhë të parë duket përparimi në rrugën krijuese të autorit, bëhen përgjithësime të rëndësishme, shfaqen me forcë poetike, me një pasuri të madhe figurash origjinale mendime të njeriut të sotëm, të shikuara më tepër në prizmin psikologjik të brezit të poetit.

Krijimtaria e I.Kadaresë nuk është e shkëputur, inorganike, sadoqë vëllimi «Shekulli im» nga forma mund të duket, në vështrimin e parë, si diçka krejt e re, si një eksperiment që bën poeti në punë të vargut dhe të figurave. Megjithatë, këtu ka shumë gjëra të reja, të pashprehura më parë, kërkime poetike, të cilat në tërësi janë arrirë. Kjo flet në dobi të autorit dhe në bindemi për përparimin e tij. Po t'i shikojmë me kujdes vëllimet e I.Kadaresë, ka disa motive që i përshkojnë ato dhe që vijnë duke marrë një tingëllim më të plotë. Kështu, p.sh., tema e atdheut, e dashurisë për të, fantazia që i zgjon poetit e tanishmja dhe e kaluara e vendit gjenden të shprehura thuajse në tërë krijimtarinë e tij. Lirika intime, ndonëse nuk tregon ndonjë përparim të madh, po të krahasojmë «Endërrimet» me «Shekullin tim», ajo përbën një vazhdë. Karakteristike është nga kjo pikëpamje poema e llojit liriko-filosofik «Endërrime», e cila me trajtimin e temës së brezit të poetit, të qëndrimit të tij ndaj atdheut, ndaj problemit të paqes etj. megjithëse jo plotësisht e realizuar, përbën, si të thuash, një prak për zhvillimin e mëtejshëm të disa ideve dhe ndjenjave të rëndësishme të poetit që dolën më të qarta, më të fuqishme dhe të formuluar më mirë logjikisht në poemat e «Shekullit tim». Edhe për formën poema «Endërrime» është si një pikë kalimi të mënyra me të cilën janë shkruar përgjithësisht vargjet në vëllimin e ri.

Vëllimi «Shekulli im» ka edhe disa vjersha të dobëta e poema të porealizuara sa duhet, mendime të pashprehura mirë, ndonjë qëndrim të pakristalizuar e që mund të tingëllojë si i padrejtë, disa figura të pagoditura etj., po në vlerësimin e një vëllimi kurdoherë nisemi nga kryesorja, nga tingëllimi i përgjithshëm emocional dhe ideor. Prandaj mund të themi me plot gojën se këtu

kemi të bëjmë me një poet shumë të talentuar, me një vëllim të rëndësishëm, me një nga veprat tona më të mira poetike të shkruara pas çlirimit. Duke lexuar vargjet e I. Kadaresë njeriu ndjen një kënaqësi të vërtetë estetike, shpesh zbulon diçka të re, të freskët; figurat poetike ta zgjojnë fantazinë dhe, në shumë raste, e përgjithëshmja shkrihet aq mirë me të veçantën, me të thjeshtën, të natyrshmen sa ti ndjen thellë atë kënaqësi të papritur, atë emocion që mund të zgjojë arti.

Prej disa vjetësh është ndjerë me shumë nevoja e një ngritjeje në cilësi të letërsisë sonë dhe të poezisë veçanërisht, e cila për vetë specifikën e saj reagon, ndoshta, më shpejt dhe u përgjigjet më parë kërkesave të kohës. Procesi i krijimit poetik duhet parë në lidhjen e vet, në përgjithësi, si një proces rritjeje, po, megjithatë, ka periudha të një lulëzimi më të dukshëm ose periudha kur del si nevojë më e ngutshme një kapërcim përpara, një rifreskim i poezisë, kërkim i formave të reja, kur trajtohet ky problem gjerësisht, në lidhje të ngushtë me përmbajtjen. Është thënë edhe herë të tjera se poezia jonë duhej ta kapërcente mënyrën e deklarativizmit, të trajtimit disa herë standard të temave qytetare, duhej të zhvillonte një lirikë më të hollë, intime, pa e shkëputur «un»-in poetik nga jeta e sotme, nga e përgjithshmja. Kështu, pra, para poezisë lindi më qartë detyra e trajtimit më të thellë dhe me sinteza më të rëndësishme të realitetit, lindi detyra e thellimit në botën e ndjenjave, e një shprehjeje më të natyrshme në nuanca të stileve më të ndryshme të problemeve themelore të kohës sonë. Poeti duhej ta shkrinte më mirë, më organikisht «un»-in e vet me botën që e rrethonte, duke i konceptuar fenomenet jo me madhështi imponante, po me një ndjenjë më të brendshme, më njerëzore, pa u shkëputur aspak nga idetë e mëdha, të fuqishme që sjell me vete gjithmonë shoqëria në rritje. E them këtë sepse pati një periudhë, sidomos të disa të rinj, kur, duke dashur të shpëtojnë nga deklarativizmi, ata filluan të shkruajnë vjersha me ide të vogla, vjersha sentimentale që nuk e pasuronin poezinë tonë me diçka të re.

Kjo periudhë tani është kapërcyer dhe konceptet «poet» dhe «botë» i gjejmë më të lidhura, më unike, sadoqë kjo është gjithmonë detyrë për poezinë tonë.

Kështu që nevoja për një përparim të tillë u ndje dhe u shpreh nga një grup poetësh të brezave të ndryshëm, pavarësisht se shkruajnë me varg tradicional apo me vargje më të lira. Kjo u shfaq në disa poema që japin një sintezë të gjerë të jetës sonë, që hyjnë më thellë në shpirtin e njeriut si edhe në lirika të ndryshme që sjellin freski në zbërthimin e botës së brendshme të poetit dhe në zgjerimin e sferës së materialit jetësor, që pasqyrohet në to.

Në këtë përparim ka lojtur dhe po lot një rol të rëndësishëm poezia e I. Kadarese, e cila në asnjë mënyrë nuk mund të merret e shkëputur nga prirja e përgjithshme e poezisë sonë, që përpiqet të përmbajë më shumë mendime, më shumë ndjenja të holla. Po të shohim rrugën e tij krijonjëse, do të vëmë re se ai ka ardhur duke e shkrirë organikisht «un»-in poetik me problemet, me ngjarjet e rëndësishme të kohës; në krijimet e tij më të mira poeti dhe bota, e përgjithshmja dhe e veçanta, janë të lidhura ngushtë me njera-tjetrën dhe kjo i bën ato jo vetëm të rëndësishme, me forcë poetike, po edhe të këndshme, njerëzore. Në shprehjen e qartë, të plotë artistike të kësaj tendence qëndron e reja, e freskëta që solli I. Kadareja.

Metaforat që përdor më shumë poeti në vëllimin e tij janë një mënyrë origjinale të shkruari; në përgjithësi në veprën e tij ato ndihmojnë për gjallërimin e tablove, të ideve, po, doemos, ne do të tregoheshim të njëanshëm, po të mendonim se vetëm nëpërmjet një sistemi të theksuar metaforik mund të krijohej poezi e vërtetë. Disa shembuj në vetë vëllimin e I. Kadarese, ku fjala poetike është e thjeshtë, ku poezia në tërësi përbën një figurë, po ku nuk është e ngarkuar me figura stilistike (metafora) e hedhin poshtë këtë mendim. Mënyrat janë të ndryshme dhe prirja drejt një ngritjeje cilësore vihet re në gjithë poezinë tonë.

Qëndrimi i brezit të ri, i brezit që lindi me luftën dhe u rrit në kushtet e ndërtimit të socializmit, ndaj republikës, ndaj së ardhmes, bota shpirtërore e këtij brezi, që është një pjesë përbërëse e botës së popullit tonë, po që ka nuancat dhe veçorinë e vet — këto shprehen me bukuri poetike, nëpërmjet sintezës dhe konceptimit figurativ të jetës në poemën «Shënime për brezin tim». Këto ide si edhe të tjera të patriotizmit, të historisë sonë i plotësojnë edhe vjersha si «Atdheu», «Armiqtë», «Varrimi i Skënderbeut», «Ikja e Moisi Golemit» dhe «Komunizmi».

*S'lindëm ne princa,
Megjithatë
Mijra topa salutuan ardhjen tonë.
Ish kohë e hekurt kur në qiej
Më shumë bombardonjës
Se sa zogj fluturonin.*

Kjo figurë e gjetur bukur krijon menjëherë atmosferën dhe me pak fjalë jep gjendjen e kohës. Brezi i poetit lindi në luftë. Lufta ishte e vështirë. Atij i ka mbetur në mend si diçka e trubullt lufta; ajo nuk ka mundur të lozë rol të madh në botën e tij shpirtërore. Bile rrallë e gjejmë këtë motiv në krijimtarinë e poetit dhe kjo është e natyrshme: ndërgjegjja e tij u formua në një kohë tjetër. Prandaj ndjehet aq shumë tek ai e reja, ajo që ndërtohet, prandaj shprehet me forcë të madhe, në shumë raste, urrejtja kundër paragjykimeve, kundër mbeturinave feudale dhe patriarkale. Me këtë nuk dua të them se dhe breza të tjerë nuk janë në gjendje t'i ndejnë këto gjëra, po çdo brez sjell të vetën, diçka më të theksuar, më të veçantë. Në gjithë vëllimin e I. Kadaresë ndjehet aftësia për të kapur shpejt të renë në çdo fushë, për ta lartësuar atë, me forcë poetike.

Shqipëria industriale, me telat e tensionit të lartë që ndehen si «nervat» e saj, me dritat elektrike, që ndri-

tin si «një qiell me yje», Shqipëria që ngrihet kundër vjetërsive dhe perëndive — është objekti i frymëzimit të poetit. Shqipëria ka historinë e saj të fitoreve dhe të një rruge plot mundime; ajo kurrë nuk do të mposhtet, sepse tani është më e fortë se asnjëherë, e lidhur me metal, me betonarme. Autori i këndon me gjithë shpirt triumfit të socializmit në vendin tonë, forcës së partisë, të ardhmes. Në kohërat e vështira të shekullit tonë, kur ne rretohemi nga armiq dhe kur kërcënon rreziku i luftës, ndërsa flet për atdheun, për brezin e ri plot ëndërra, mendja të vete, doemos, te problemi i luftës dhe i paqes. Autori, si në këtë poemë ashtu edhe në të tjerat, e ka zgjidhur drejt këtë problem, duke u mbështetur në një bazë të shëndoshë ideologjike. Brezi i ri i Shqipërisë është për paqen, kundër luftës, po ai nuk trembet në qoftë se ajo do të na imponohet, në qoftë se duhen mbrojtur fitoret e arritura. Besimi në fitoren tonë është i fuqishëm te poeti dhe ai shprehet në mënyrë të vetvetishme, me bukuri poetike:

Armiku këndej s'kalon.

Një pengesë të madhe do ngremë

Me armë, bajoneta, këngë

.....

Një të madhe, të tmerrshme

Pengesë.

Brezi i ri do të luftojë për të zhdukur çdo gjë të shëmtuar, të poshtër, për të zhdukur kapitalizmin dhe kolonializmin, për të shpëtuar brezat e ardhshëm. Dhe poeti do të jetë i lumtur sikur vargjet e tij t'i shërbejnë popullit, ushtarëve.

Këto janë idetë kryesore që shfaqen në «Shënime për brezin tim» një poemë e shkruar lirisht, me frymëzim dhe plot fantazi origjinale.

Vjersha «Atdheu» është interesante për konceptimin realist dhe të thellë të atdheut. Me këtë lidhet rruga e vështirë, plot mundime e popullit; atdheu janë të rënë në luftë refugjatët me nofullat e shtrënguara,

atdheu është «betonarmeja e ëndërrave të vjetra dhe të reja». Këtu idetë nuk janë zhvilluar gjerësisht po edhe kjo vjershë konçize jep një sintezë të atdheut dhe të ngjall ndjenja të vërteta. Me një frymë romantike dhe me ndjenja janë shkruar vjershat «Varrimi i Skënderbeut» dhe «Ikja e Moisi Golemit». Ndonëse është e ngarkuar me shumë epitete, ka ndjenjë dhe forcë në vjershën e shkurtër «Armiqtë». Kështu tema e atdheut, e rrugës së tij, e së sotmes dhe e së ardhmes trajtohet nga disa aspekte dhe merr një kuptim të gjerë, të plotë në vëllimin «Shekulli im».

Ndryshimeve të mëdha të realitetit tonë, përparimit ekonomik që sjell me vete edhe përparimin shoqëror e moral i kushtohet poema «Ëndërr industriale». Ideali i poetit është qyteti i ardhshëm industrial, qyteti punëtor, që nuk do të ketë asgjë të përbashkët me mesjetën, me mbeturinat e saj në jetën e përditshme dhe në ndërgjegje, që do të ngrihet kundër paragjykimeve, kundër patriarkalizmit dhe sentimentalizmit mikroborgjez. Ky qytet do të jetë i fuqishëm me furmaltat e tij, me forcën e njerëzve dhe të metalit. Këtu flitet për të ardhmen, sepse atëhere do të rrënjosen edhe më thellë, me ndërtimin e plotë të socializmit e të komunizmit, botëkuptimi i ri punëtor, ndërgjegjja e shoqërisë së re. Nga kjo pikëpamje qyteti i ardhshëm në poemë përfaqëson diçka simbolike, po tiparet, për të cilat flitet atje, kanë lindur që sot në realitetin tonë dhe vijnë duke u zhvilluar. Romantika që përshkon «Ëndërrën industriale» është e lidhur ngushtë me realitetin, me planet, me fytyrën e sotme morale të njerëzve më të përparuar.

Idėja e kësaj poeme është shumë e rëndësishme dhe e fortë. Romantika e së ardhmes shkrihet organikisht me një konceptim realist të kontradiktave të jetës, të luftës së ashpër për kalimin e këtyre kontradiktave. Dihet se Shqipëria filloi ta ndërtojë socializmin në një truall të prapambetur; duhet luftuar jo vetëm kundër ideologjisë borgjeze dhe mikroborgjeze, po edhe kundër mbeturinave feudale e patriarkale që akoma edhe sot i pengojnë njerëzit të jetojnë të lirë shpirtërisht, të pu-

nojnë dhe të krijojnë lumtërinë e tyre. Socializmi, me dorën e vet të fuqishme, me vrullin dhe energjinë krijonjëse i zhduk dhe do t'i zhdukë marrëdhënjet e vjetra, jetën e përgjumur, të amullt; njerëzit nuk do të kridhen në pizhame mbrëmjeve «duke pirë çaj». Dhe këtu nuk ka rëndësi se do të pinë çaj apo kafe; puna është që të luftohet mikroborgjezizmi, ndjenja e rahatllëkut, si diçka meskine, që nuk mund të pajtohet me ritmin aktiv të shoqërisë së re.

Ndeshja e dy botëve në këtë poemë të shkurtër tregohet jo vetëm përmes fjalës së drejtpërdrejtë poetike po edhe me anë të disa tablove si ajo e malësorit që kërkon të vrasë çupën, sepse ka ikur me një punëtor. Po forca e së resë është e madhe: pamja rreth e rrotull, ulurima e sirenave, gjithshka e bën me vete edhe malësorin, dhe ai hedh revolen që shkrihet në metalin e përbashkët të qytetit. Dikush mund të thotë se atëhere, kur të ndërtohet një qytet i tillë metalurgjik, nuk do të ketë më fshatarë aq primitivë. Unë mendoj se poezia që ka një theks të tillë romantik, ku gjithshka shndërrohet në një simbol, nuk mund të analizohet në këtë mënyrë. Kjo nuk është vetëm e ardhmja, kjo është edhe e sotmja që ka filluar të lindë e të hedhë rrënjë; këtu është fjala për ndeshjen e dy botëve, karakteristikë e periudhës së ndërtimit të socializmit. Natyrisht tema e ndryshimeve rrënjësore ekonomike e shoqërore është shumë e madhe; ajo mund të trajtohet edhe më gjerë e më thellë, doemos me mjetet poetike, pa bërë fjalë për prozën që ka shumë mundësi në këtë vështrim. I. Kada-reja me këtë poemë mundi të na japë diçka të re në poezinë tonë, një sintezë të shkurtër po të fuqishme, me vizione të qarta, me ide të vërteta.

Pathosi i luftës kundër paragjykimeve, patriarkalizmit nuk mund të merret si një mohim i traditave, si një përbuzje e normave morale. Përsa i takon problemit të moralit, autori niset nga një qëllim i drejtë, nga diçka e vërtetë. Po në shprehjen artistike të këtyre ideve (e kam fjalën në këtë poemë) ka diçka të cunguar, jo të plotë, që nuk e sqaron problemin gjer në fund.

(Po trajtimin e çështjes së moralit që ngrihet aty-këtu në vëllim dhe për të cilën është folur mjaft desha ta shikoj në mënyrë të veçantë kur të vijë radha).

E ardhmja e qytetit nuk mund të përfytyrohet si diçka e idealizuar. Siç dihet, gjithmonë do të ketë disa kontradikta dhe autori, që sidomos në këtë poemë tregon një konceptim të drejtë filosofik të gjërave, thotë me pak fjalë se do të ketë edhe «gra me buzëqeshje prej kaproni» etj. Këtu s'ka asgjë të çuditshme. Ai menjëherë thekson se kudo do të zotërojë morali i pastër proletar.

Progresi sjell ndryshime të thella në jetën e njerëzve:

*Në kafenetë e këtij qyteti
S'do të kapardiset gjakmarrësi
Me kobure në brez
Mustaqet të zeza mbi gojë;
Korrenti
Çdo kalbësirë dhe ndryshk do përcëllojë.
Si çelik i shkrirë, i ndritshëm,
I pastër
Nderi proletar do rrezëllojë.*

Pikërisht për pathosin kundër prapambetjes në të kaluarën, kundër mbeturinave feudale dhe patriarkale, për të dalë sa më shpejt prej tyre në një vend si Shqipëria që nuk pat qenë i zhvilluar në të kaluarën, për entuziazmin që i ngjall e ardhmja industriale përfaqësuesit të një brezi të rritur në periudhën e ndërtimit të socializmit, — pikërisht për këtë poema «Ëndërr industriale» ka frymë shqiptare në kuptimin më të thellë dhe më të gjerë të kësaj fjale.

Shumë vargje të vëllimit «Shekulli im» i kushtohen kohës sonë, të shikuar në aspektet e rëndësishme të ndryshimeve të mëdha shoqërore, të përparimit të mahnitshëm në fushën e shkencës. Çështja e ndarjes së botës në dy kampe, e forcës së ideve revolucionare, e komunizmit, të cilit «i përket shekulli» janë shtruar drejt nga autori dhe japin tonin kryesor në poemën «Shekulli XX. Shekulli ynë merret në gjithë kompleks-

sin e problemeve të veta: ai solli qytetërimin, u ngrit përmbi aristokracinë dhe kishat; ai është shekulli i shpërthimeve, i revolucioneve; ai është lidhur edhe me portretin e njeriut të sotëm, që ecën me kohën, që hidhet në jetën e gjallë, e cila nuk duhet të mbajë erë vjetërsi dhe myk. Sikur shekulli XX të ishte shikuar vetëm me shpikjet, televizionet dhe me faktin se ai është bartësi i revolucioneve, i ndryshimeve të mëdha, — ahëre çështja do të zbërthehej përciptazi dhe poema nuk do të kishte forcë përgjithësuese.

*Unë zhvidhos vargje,
Ti regjime dhe qeverira,
Me vinqat e revolucioneve i shkël,
I ngre mbi gërmadhat e zeza,
Mbi shkatarrinat,
Me ulurima e kuje
I flak në rrëpira.*

Në këtë poemë ngrihet përsëri problemi i luftës dhe i paqes sikundër edhe në poema e vjersha të tjera të vëllimit dhe ai shtrohet drejt përmes fjalës së fuqishme poetike. Në Shqipëri shekulli XX (duke e marrë në atë kuptim të brendshëm, esencial që i jep autori gjatë poemës) nuk na zbriti nga qielli:

*Ti fryve nga thellësi e këtij dheu
Furtunë e furishme.*

Kjo poemë është e ngjeshur me mendime që shprehen me anë figurash, përgjithësisht të gjetura mirë, megjithëse ka raste kur ato janë të tepëruara dhe të pakapshme.

Idetë e poemës «Shekulli XX» sikur plotësohen, zhvillohen nga vjersha të goditura si «Razliv». «Afrika» «Pejzazh gjeneral», «Yjet jo vetëm bijen» «Statujë pa krahë». Idetë e Leninit përshkojnë shekullin tonë; ai është bërë element i këtij planeti. Me lirizëm dhe fan-

tazi origjinale, pa ngarkim figurash është shkruar vjersha «Razliv». Figura e Leninit krijohet këtu në një aspekt të ri, të lidhur me ambientin, me detajet që të ngjallin ndjenja të ngrohta, të përzemërta për udhëheqësin e madh të proletariatit. Vjersha «Afrika» është shkruar me ndjenjë dhe me ritëm të brëndshëm: ajo arrin ta shprehë bukur idenë e dhëmbjes shekullore të popujve të robëruar dhe të revoltës së tyre.

Afrikë,

Kaçurrelja Afrikë!

Negrit e tu duket sikur lëkurën e natës shqyen

Në mijra copa të zeza,

Midis tyre e ndanë,

Mbuluan trupat me to,

U sulën nën tufane.

Origjinale është edhe vjersha «Statujë pa krahë», ku tregohet lidhja e kohërave, madhështia e shekullit tonë, përpara të cilit mahniten statujet, ku shfaqet urrejtja kundër luftës që varros monumentet e kulturës.

Problemi i luftës dhe i paqes ngrihet gjithashtu edhe në poemën «Paqen do ta imponojmë». Për forcën e luftës sonë kundër fashizmit, për pasojat e saj që i tronditin armiqtë tanë të dikurshëm dhe të sotëm, për rrezikun e Gjermanisë së rimilitarizuar bën fjalë poema tjetër e vëllimit «Vdekja e turistit». Megjithëse edhe këto dy poema kanë vlerën e tyre ideore dhe artistike, megjithëse edhe në to autori mban një qëndrim të drejtë, krijon figura dhe fragmente të bukura, arrin të ngjallë herë-herës një gjendje shpirtërore të caktuar, — prapëseprapë mendoj se ato mbeten të dobëta dhe ideologjikisht të cekëta.

Në poemën «Paqen do ta imponojmë», përmes një ëndërre, tregohet rreziku real i luftës; autori synon të nxjerrë në shesh forcën e kampit të socializmit, të komunistit, të popujve që mblidhen bashkë dhe i përzënë njerëzit e kapitalit, të cilët shkojnë e hidhen në yje të vdekur dhe sulmojnë që andej. Toka është e

fuqishme, yjet e vdekur sprapsen dhe paqja fiton. Ka vepra e poema ku mendimi mund të shprehet përmes një kompozimi të fuqishëm që flet vetë, përmes figurash, shumë të forta, kontrastesh që ta zgjojnë fantazinë dhe të bindin artistikisht. Po kjo poemë nuk është një vepër e menduar mirë. Gjithshka shikohet më tepër nga ana e jashtme, krijohen situata plot zhurmë e rrëmujë dhe, ndonëse flitet për forcën e popujve, të komunizmit, autori mbetet në sipërfaqe të fenomeneve; nuk krijohet dot një gjendje e atillë shpirtërore që të ndjehet forca e brendshme e popujve, idetë e mëdha që do t'i shtynin ata në luftën për mprojtjen e gjërave më të shtrenjta, për të cilat do ta vlenste të jepje jetën. Në këtë poemë ka më shumë efekte, figura pas figurash, saqë mund të mendosh se jo ideja përfiton figurën, po ndodh e kundërta. Mos vallë ajo lumtëria e përciptë, kalimtare me Brigitën, me atë «të panjohur» është një nga idealet për të cilat na është e shtrenjtë paqja? Ky fakt që lidh subjektin e poemës, është paraqitur këtu si një moment kyç, i rëndësishëm. Veç asaj, fantazia me yjet e vdekur, lufta kundër qiellit, nuk më duket se ka logjikën e vet (sepse edhe fantazia ka logjikë). Qielli do të përfaqësonte perënditë, idhujt, po kapitali, në esencën e vet, i ka zhdukur idhujt dhe s'ka sepse të mbahet kryesisht prej tyre. Tani gjithshka është tokësore, edhe në një kuptim figurativ të kësaj fjale, dhe prandaj kjo zgjidhje në poemë është e papërligjur.

«Vdekja e turistit» ka momente të goditura dhe nga pikëpamja e idesë do të kishte dalë një poemë e fuqishme, po të mos kishte edhe kjo disa të meta poetike, sidomos të vargut, që shpeshherë bëhet prozaik. Ky lloj vargu i lirë që përdor, përgjithësisht, poeti në vëllimin e tij, nuk i ka shkuar për shtat, me sa duket, mënyrës narrative të «Vdekjes së turistit», me gjithë rimat relativisht të shpeshta që përdor autori në këtë poemë. Veç asaj njeriu mund të pranojë si konvencion artistik faktin që pikërisht ai partizan i torturuar prej turistit, ish-esses, është shndërruar tani në monument, po vdekja e tij pikërisht tani pas kaqë vjetësh, kur ish-essesët janë

egërsuar përsëri dhe duan ta futin botën në luftë, vdekja e tij përpara kryqeve, përpara monumentit nuk mund të jetë bindëse dhe as tipike. Në pjesën e dytë të poemës krijohet atmosferë interesante, me detaje të gjetura, po, edhe atje, shfaqja në gjirin e familjarëve e filmit të xhiruar nga turisti që vdiq, menjëherë pas vdekjes, të krijon përshtypjen e montimit artificial, nuk vjen në një moment të përshtatshëm dhe e dëmton realizmin e poemës. Vërtet arti poetik ka veçorinë e tij që e dallon nga proza, po kur kemi të bëjmë me subjekt, me ngjarje nuk mund të lemë në harresë vërtetësinë e ngjarjes.

Krahas me poezinë qytetare, prej disa vjetësh tek ne po zhvillohet edhe lirika intime, gjë që tregon se shtohet vëmëndja ndaj njeriut, ndaj ndjenjave të tij të holla, fisnike. Edhe në dy vëllimet e para, sidomos në «Ëndërrime» I. Kadareja ka dhënë diçka të tijën, origjinale dhe të freskët në fushën e lirikës intime që është pritur mirë nga lexuesit. Përveç poemave, disa prej të cilave janë sinteza të rëndësishme të gjendjes shpirtërore, sidomos të brezit të ri dhe të problemeve të kohës, në vëllimin «Shekulli im» ai na ka dhënë edhe mjaft vjersha delikate, me vlera poetike, jo aq për mendimin se sa për krijimin e një atmosfere të caktuar shpirtërore, për zgjimin e një ndjenje të hollë poetike. Ndjenjat kanë zikzaket, nuancat e tyre dhe cilido poet, sipas natyrës dhe përshtypjeve që ka nga jeta në një periudhë të caktuar, mund të zgjedhë një tematikë të caktuar me një prirje të caktuar. Kështu, p.sh., mund të këndohet, pa rënë në pesimizëm, për ndjenjën e ndarjes, të largimit nga njeriu i afërm dhe vjersha të tilla mund të pasurojnë lexonjësën me një botë më të pasur shpirtërore. Poezia jonë e realizmit socialist nuk ka sepse të ndruhet nga vargje të tilla, sidomos kur tingëllimi i përgjithshëm i një vëllimi është i shëndoshë, optimist. Megjithatë ne duhet të dimë të ndajmë të tërën nga e pjesshmja, atë që është organike, nga ajo që nuk është e tillë dhe ta kritikojmë në masën që i takon, pa e përgjithësuar gështjen.

Lirika intime në këtë vëllim, mendoj se, për vlerën

e saj, nuk zë vend aq të rëndësishëm dhe nuk peshon sa lirika qytetare, sa vargjet e llojit epik ose liriko-epik. Dhe kjo është një gjë e mirë për poetin, për zhvillimin e tij. Po megjithatë edhe këto, siç thashë, në përgjithësi kanë vlerën e tyre. Kështu, p.sh., vjersha «Malli i Shqipërisë» është e thjeshtë dhe e sinqertë, bile në të nuk ka as figura, po krijohet një tablo intime e atdheut. Autori e kujton Shqipërinë me muzgjet dhe bukuritë e saj, me rrugët e ngushta, me kuajt e lokomotivat dhe përfundon me vargjet e ndjera:

Ata që shpikën shpejtësinë reaktive.

Larg atdheut, sigurisht, do kenë qenë ndonjëherë.

Në disa vjersha intime autori arrin të zbulojë një figurë, një gjendje shpirtërore dhe këtë e bën në mënyrë sintetike. Kështu, p.sh., e bukur është vjersha «Alpeve» të larta, madhështore, ato lëkunden në gjirin e një lere të vogël, sylarme, ballëkaltër.

Në qoftë se në vjershën «Këngë e millonait» bëhet fjalë për një njeri që nuk pati fat në dashuri, nuk do të thotë se në vjershë zotëron ndjenja e trishtimit. Kjo është një vjershë e goditur që krijon figurën e një njeriu zemërbardhë. Autori i drejtohet atij me këto fjalë:

Drit' e llambave

Zbehet, fërfërin.

Fill i vetëm ti

Natën ç'po e gdhin;

Kot mërzitesh, plot

Vajza bota ka...

E trokashkave

Kënga fund nuk ka.

Nuk dallohen për thellësi ndjenje, po megjithatë janë të këndëshme vjersha që kanë lindur në kohën kur autori ishte në Moskë si «Si ta harroj», «Edhe kur kujtesa», «Dallgët me rrëmujë», «Kështu u ndamë» e ndonjë tjetër.

Vjersha «Ardhja e tij», jo vetëm që është e pa shprehur mirë, po mendimi subjektiv i autorit për të qenë i gjerë, i njerëzishëm, zbehet nga fakti se ai nuk mban asnjë qëndrim ndaj atij që shkon larg, që tregohet egoist dhe e le vajzën shtatzënë. Atmosferë të rëndë, të errët krijon vjersha «Tunelet» që bën fjalë përsëri për ndarjen:

*Dhe si gojë të zea të Harrimit
Tunelet e zez na gëlltitën.*

Është e qartë se kushdo mund të ketë ndjenja të tilla të forta, po kur këto riprodhohen në art kanë një qëllim të caktuar dhe nuk mjafton për t'i dhënë vetëm gjetja e figurës, apo regjistrimi i ndjenjës. Vjersha «Qieël dim-ri», ku dëbora i duket autorit si mijëra letra që nuk i mori, duket se është shkruar për hir të figurës, sepse ndjenja është shumë e trubullt, abstrakte. Edhe dëbora që i ngjan bishtave të cigareve të fikur («Edhe kur kujtesa») krijon një atmosferë të sëmure që nuk është organike për autorin, po që i shpëton më të rrallë. Ndonjë vjershë nga cikli i ndarjes mund të mos ishte botuar për vlerën e saj të pakët dhe për faktin se ka një monotoni që vjen nga përsëritja e po asaj gjendjeje shpirtërore.

Fryma e përgjithshme e lirikës intime ka tingëllim të drejtë, vetëm aty-këtu vrehet ndonjë shfaqje jo e shëndoshë, të cilën autori duhet ta shmangë në të ardhmen.

* * *

Është folur mjaft për qëndrimin e autorit ndaj problemeve të moralit. Në disa nga poemat dhe vjershat e tij autori bën fjalë për këtë çështje. Qëndrimi ndaj dashurisë, ndaj martesës është diçka e pandarë nga koha, nga botëkuptimi i njeriut të sotëm. Socializmi lufton për t'i zhdukur marëdhënjet e vjetëra morale; ai nuk duron dot hipokrizinë, interesin material, paragjykimet e stru-

kura në ndërgjegje nga shoqëritë e kaluara, sikundër nuk duron, dhe as pajtohet dot me asketizmin, me ndrydhjen morale të njerëzve, me ruajtjen e përciptë të disa normave që gjoja mbrojnë «nderin», «traditat» dhe nuk shohin shpirtin e njeriut, zhvillimin e personalitetit të tij. Të luftojë kundër këtyre tipareve të shëmtuara — është detyrë e shoqërisë sonë, pra edhe e artit që është thirrur për t'i shërbyer shoqërisë. Po, duke luftuar këto mbeturina, duhet caktuar njëkohësisht në mënyrë të qartë, të kristalizuar qëllimi drejt të cilit shkojnë njerëzit e sotëm, duhet ngritur lart morali socialist, që mbështetet në ndjenjat e lira, të mëdha, që zgjon te njerëzit dashurinë e vërtetë, pa interes, pa hipokrizi, sigurisht një dashuri jo sentimentale si «frazë albumi», po sidoqoftë të thellë dhe të bukur. Letërsia jonë ka për detyrë të mbrojë këtë ideal duke luftuar me forcë ngushtësinë e ndjenjave dhe të paragjyqimeve.

I. Kadareja e ka ndjerë këtë anë të jetës dhe, megjithëse nuk është marrë posaçërisht me të, duket që kjo gjë e shqetëson. Në disa raste pasioni i tij kundër së vjetrës është i fortë dhe i kuptueshëm, po mendimi i autorit për problemet morale nuk është i formuar mirë, (ashtu siç na paraqitet në vëllim); ai nganjëherë kalon në ekstremin tjetër, e thjeshtëson çështjen, sa që mund të krijohet përshtypja se në kohën tonë nuk ka nevojë për pastërti morale (p.sh. në «Ëndërr industriale» kur thuhet se qyteti i ri nuk do të ketë nevojë për virgjërinë si «flamur të kuq» etj.) Ai ngrihet me të drejtë kundër hesapeve në martesë, kundër hipokrizisë, po nuk ndjehet ideali i tij («Rrugëve të Moskës»). Kjo vjen jo vetëm se mendimi është ndodhur këtu në një fazë kalimtare, po edhe për mungesë shtjellimi të idesë, si, p.sh., në «Pizhamet dhe aerodromet» që niset nga mendime për të lavdëruar dashurinë e madhe, po kjo nuk kuptohet mirë, sepse fjalët vijnë si të palidhura, figurat e pizhameve dhe të mizave, të aeroplanëve dhe të aerodromeve për të dhënë, në rastin e parë, idenë e jetës së ngushtë dhe në të dytën të një jete më të gjerë, nuk më duken të sakta. Autori i drejtohet «botës së madhe» me thirr-

jen pasive: «Mos më lërë kurrë, o moj botë e madhe!» Kurse duhet të ndodhte ndryshe: poeti duhet të lëshojë thirrjen e krijimit të kësaj bote të madhe në mënyrë aktive nga vetë njeriu. Me gjithë luftën kundër sentimentalizmit, kundër mykut, nuk mund të kuptohet dashuria e kohës sonë ashtu siç thuhet nga autori në poemën «Shekulli XX»:

*Dhe si kujtim nga vajzat të mbaj, më the.
Jo një lule të tharë,
A një frazë albumi plot psherëtimë,
Po numrin e saktë të telefonit
Me katër shifra
Të përcaktuara mirë.*

Mos vallë ky qëndrim «i mekanizuar» është karakteristikë e shekullit XX? Mos vallë ndjenjat janë shuar dhe ja kanë lënë vendin një praktike të ftohtë? Më tepër se sa bindje të autorit, këto janë fjalë të pamenduara thellë, po që, si thashë, shprehin gjithashtu gjendjen e një mendimi të paformuar mirë. Idetë e mëdha të socializmit, kontakti me realitetin e gjallë, me problemet morale të vendit tonë duhet ta frymëzojnë autorin për ide poetike më të qarta dhe më të thella edhe në këtë vështrim.

Nuk desha të zgjatem rreth vjershave që i kushtohen poezisë, që tregojnë qëndrimin e autorit ndaj saj, ndaj poetëve. Unë pajtohem me kritikën e drejtë që i është bërë autorit për vjershën «Poetëve të dekluar», për një kuptim të kufizuar të formës në poezi, për talljen pa kuptim të atyre që gëzohen nga rimat, që vazhdojnë të shkruajnë me sonete etj. Faktet po tregojnë se në botë shkruhet në mënyra të ndryshme, se vargu tradicional mund të shprehë një brendi të re, se puna duhet parë në esencë dhe jo në sipërfaqe.

Ky artikull kishte për qëllim të merrej me disa gështje ideore në vlerësimin e veprës së I. Kadarese «Shekulli im» duke përmendur aty-këtu edhe gështje të mjeshtërisë. Vetëm desha të them se tashmë thuajse

pranohet nga të gjithë se vargu i lirë që përdor I. Kadareja, në përgjithësi, e justifikoi vetveten. Ka vende jo ritmike, ka raste kur rima mund të përdoret më shumë për ta organizuar vargun e tij. Gjithashtu tani është e qartë se I. Kadareja është një poet me fantazi të pasur, me aftësinë e krijimit të figurave, në tërësi, të bukura, të freskëta. Duke kërkuar në këtë fushë, ai shpeshherë nuk e gjen dot figurën ose bëhet rob i saj. Kjo gjë dëmton edhe idenë. Ka raste kur ajo vjen edhe nga mungesa e frymëzimit. Po tepërimi, pasaktësia e figurave ka të bëjë edhe me disa ndikime të huaja dhe mendoj se autori ka për ta gjetur më mirë rrugën, duke u zhvilluar më tutje në krijimtarinë e tij.

* * *

Duke e parë në tërësinë e vet, «Shekulli im» është një vepër e bukur, që sjell diçka të re, të freskët në poezinë tonë. Në të ngrihen probleme, shprehen ndjenja poetike të lidhura me kohën tonë. Vepra e gjertanishme e I. Kadaresë tregon se ai do të ecë përpara, do të zhvillohet edhe më tutje në rrugën e vet krijonjëse.

1962

LIRIZËM DHE NATYRSHMËRI POETIKE

(«HAPAT E MIA NË ASFALT», Vëllim me vjersha nga D. Agollit)

Me të dy vëllimet e tij «Në rrugë dolla» dhe «Hapat e mia në asfalt» poeti Dritëro Agolli zuri një vend të dukshëm në poezinë tonë të re, duke sjellë përshtypje dhe ide interesante, duke kristalizuar personalitetin e vet poetik.

Pa marrë përsipër të bëjmë krahasimin e të dy vëllimeve, prapë mund të themi se të «Hapat e mia në asfalt» tingëllojnë më qartë e më lirisht disa motive dhe ide të preferuara të autorit; në një pjesë të mirë të librit përshtypjet nga jeta jonë shqiptare janë të gjalla, më direkte dhe nuk ndjehet një frymë libeske që vihej re aty-këtu në vëllimin e parë. Ndonëse në atë vëllim ka vjersha shumë të bukura si «Poema e udhës» etj. mendoj se të «Hapat e mia në asfalt» gjejmë një unitet më të madh të ideve dhe të stilit. Është vështirë të thuash se cili vëllim është më i mirë. Në këtë rast kjo nuk më duket e lehtë; fjala ishte për disa merita të përgjithshme të rritjes së personalitetit të autorit.

Vëllimi «Hapat e mia në asfalt» është një vepër e mirë, e ngrohët, që të ngjall kënaqësi estetike. Në shumicën e rasteve vargu i poetit rrejdh lirisht, natyrshëm; poeti bisedon me shokët ose me vetveten duke hapur zemrën; thotë ato që ka parë, që i kanë bërë përshtypje e që e shqetësojnë çdo ditë. Nuk ka në vargjet e tij poza, sforcim, llustro të jashtme. Ana më e fortë e poe-

zisë së Dritero Agollit mendoj se është lirizmi i tij, që përshkohet nga ide të njeriut të kohës sonë, të rritur në periudhën e ndërtimit të socializmit, të kalimit në një shoqëri të re, ku zotëron dashuria për njerëzit punëtorë, për jetën e natyrën, urrejtja për çdo gjë meskine e të lyer me bojë të rreme.

Si poet ai përdor me sukses detajin artistik, që i vjen vetvetiu e që ndihmon për zbulimin e idesë. Thuhet se në çdo vjershë ai mundohet të gjejë diçka të veçantë, konkrete, qoftë në përmbajtjen kryesore, qoftë në detajet që rifresokjnë këtë përmbajtje. Mënyra e tij për t'i trajtuar fenomenet thjeshtë, me lirizëm e hera-herës me humor, duke manovruar shpesh me detajin, është e këndshme, po, doemos, nuk është e vetmja mënyrë në poezinë tonë. Dihet së sa më të ndryshme të jenë stilet, aq më e pasur bëhet poezia.

Po të përcaktonim profilin e poetit, do të thoshnim se atij, ndoshta, i shkojnë më tepër për shtat ato vjersha që japin gjendje shpirtërore të caktuara, që — pa u shkëputur nga idetë kryesore të lirikës qytetare — hedhin dritë në kënde intime të shpirtit të njeriut. Poezia e D. Agollit shpreh një prirje të rëndësishme të poezisë sonë sot drejt pasqyrimin më të thellë të ndjenjave, të nuancave të tyre përmes un-it poetik, përmes disa portreteve, ku autori mund të zbulojë më mirë vetveten dhe jetën e sotme dhe përmes natyrës, të shikuar me një sy të ri.

* * *

Në vëllimin e D. Agollit ka disa tema dhe ide kryesore që përbëjnë, si të thuash, boshtin e veprës. Autori kthehet herë pas here tek ato duke i shikuar nga anë të ndryshme, duke përdorur material të ri.

Një ide e rëndësishme që përshkon mjaft vjersha të vëllimit është ideja e transformimit të shoqërisë sonë, e ndryshimeve rrënjësore që kanë ndodhur e ndodhin në ndërgjegjen e njerëzve, e sigurisë në të ardhmen. Këtë përmbajtje të re autori e shfaq përmes përshtyp-

jeve konkrete që ka pasur nga jeta, duke lidhur poetikisht faktet me ndjenjat e tij. Transformimi që jepet me anë portretesh poetike («Karmeni», «Baladë optimiste», «Kurbatka», «Ëndra» etj.) ose tablosh më të gjera («Hapat e mia në asfalt») nuk bëhet aq lehtë, pa pengesa; poeti krijon situata realiste, mundohet ta kapë të vërtetën në mënyrë sa më të plotë për të pasqyruar me besnikëri kohën tonë. Gjithë jetën kurbatët enden poshtë e lart duke kërkuar fatin e tyre dhe me vështirësi e pranojnë jetën e re. Ndaj punës së lodhshme, ndaj fatit të rëndë të kurbatkave autori shfaq simpatinë e tij që tingëllon këtu me nota njerëzore:

*Ti me djep në krahë brodhe shumë,
Kur korriku gurët përvëlonte,
Kur dhjetori derdhte shiun lumë,
Kur në mal laureshëza këndonte.*

Kurbatka i bleu të birit një gërnetë; ai, pas ca kohe, si erdhi në kontakt me shokët e rinisë, shkoi në estradë se s'mund ta vazhdonte më jetën e mëparshme. Atmosfera e krijuar në vendin tonë i fton ata drejt kolektivit, drejt jetës së përbashkët. Po kurbatka vazhdon akoma të endet dhe hera-herës bie në mendime për të birin.

Kushtet e jetës së sotme janë të atilla, sa që të rinjve të thjeshtë po u ndodhin e do t'u ndodhin gjëra që u duken të pabesueshme: njëra bëhet këngëtoze dhe me siguri do të lozë Karmenin; një vogëlushe tjetër, që ka zbritur në fushë, mund të bëhet mjeke: poeti i thotë asaj fjalë të ngrohta dhe e mbush me besim «Ëndra»). Një skenë realiste e qytetërimit që po ndodh në vendin tonë krijohet në vjershën «Baladë optimiste», në të cilën bëhet fjalë për një shtëpi, ku plakat grinden për një leckë dhe nuk e kuptojnë dot se ç'është ajo shtyllë që vendoset pranë shtëpisë së tyre. Ajo shtyllë e tensionit të lartë përfaqëson këtu përparimin dhe jetën e gjerë të lirë, — jetë që bën me vete vajzën e re të asaj shtëpie. Te poemthi «Hapat e mia në asfalt» tingëllon

më gjërësisht tema e ndryshimeve shoqërore dhe politike. Në këtë poezi ka disa momente të goditura, që na parafytyrojnë ditët e para të çlirimit, «hapat» e fshatarëve të ardhur nga lufta në qytet dhe ndryshimet e mëvonshme të pamjes së qytetit, i cili ka ngjyrën e vet origjinale, tiparet dhe kontrastet e veta.

Dashuria për njerëzit e thjeshtë, për heroizmin dhe punën e tyre të përditshme, për ata që ngrinë në dëborë duke ruajtur kufinë, për metalurgët ose gruan që lan këmishët e punëtorëve është një ndjenjë e autorit që e pushton edhe lexonjësën kur lexon baladën «Dhjetë sy», «Këmishët», «Yjet», «Leni, Leni!», «Nga fletorka e shënimeve» etj.

«Dhjetë sy», është një poezi shumë e ndjerë, nga më të mirat në vëllim, e shkruar me frymëzim e pathos, një poezi e thellë, ku ideja e përgjithshme politike lidhet me përshkrimin konkret të ngjarjes, të botës së brendshme të secilit kufitar në çastet e fundit përpara vdekjes. Vendosmëria e të pestëve nuk del nëpërmjet fjalëve të përgjithshme, po me anë të ndjenjave konkrete, të romantizmit të ngjarjes dhe të njerëzve nga vetë autori, me anë të parentezeve lirike që e përgjithësojnë idenë dhe që ngjallin emocione të vërteta. Hidhërimi i poetit për shokët e rënë është i brendshëm; ai nuk qanë me lot sentimentalë, po dhëmbja të ther në zemër, sepse ata ishin njerëz të vërtetë. Njëri prej tyre ishte shumë i ri; asnjëherë nuk kishte dashuruar; bënte vjersha dhe poetit, tani që ka marrë vesh për vdekjen e tij, i vjen keq që nuk i pat thënë fjalë të mira për ato vjersha.

Pse lotët më bien?

Pse them: «mund të këndonte?»

Ai këndoi

Baladën më të bukur

Për atdhenë...

Një figurë e thjeshtë, po mjaft poetike e bën vjershën «Yjet» të ngrohtë, emocionante. Autori kujton

një nga shokët e luftës që kishte qenë si «astronomi» i çetës, sepse vëzhgonte dhe shpjegonte yjet. Kur u vra, ai mbeti me vështrimin të ngulur te yjet. Edhe vjersha «Këmishët» është shkruar plot me dashuri për gratë tona të thjeshta që, kur lajnë këmishët e punëtorëve, bëjnë një punë fisnike. Autori vë re në jetë gjëra interesante dhe shpeshherë zbulon poezi atje ku tjetërkujt, ndofta, nuk do t'i bënte përshtypje. E përshkruar nga dhëmbja dhe nga një ndjenjë e thellë dashurie është edhe vjersha «Leni, Leni», që tregon shkurtimisht për djegjen e vajzës pesëvjeçare në Borovë. Ky fakt i njohur tingëllon këtu në mënyrë të re, sepse autori ka ditur të sjellë një brendi të tijne, të shprehë ndjenjat e veta poetike.

Ç'të them për ty?

Ti sot mund të ishe

Edhe artiste,

Edhe kooperativiste,

Mund të ishe edhe gruaja ime, Leni,

Sikur mos kishte hyrë me urë zjarri

Ai që dinte dhe sonata nga Bethoveni,

Leni, Leni!

Një vend të rëndësishëm zënë në vëllim vjershat, ku luftohet kuptimi i ngushtë i jetës, meskiniteti, mikroborgjezimi i atyre që e kalojnë kohën kot pa vrarë mendjen, ndërsa minat hedhin në erë male, kufitarët ruajnë kufinë, njerëzit ndeshen me vështirësitë. Këtu nuk është fjala për një thjeshtësim të problemit. Kur flet në këtë mënyrë poeti lufton ata që bien në amulli, që i merr jeta zvarrë, që nuk janë të zotë të ecin me ritmin e kohës. Kështu kuptohen, p.sh., vargjet:

Shpeshherë qahemi e themi:..

Mungon ajo,

mungon dhe kjo,

Apartament sikur të kemi,

Do jemi mirë,

Po ç'e do!...

*Kurse atje në breg të Matit
Kazermën era ment e prish
Dhe shoku ynë që me natë
Me shkëmb e lumë
luftën nis.*

Përbuzja dhe ironia që shfaq autori për «gaga-relat», për llustron e jashtme, për atë që lot foks-trot mbi asfaltin e nxjerrë nga i ati, — janë legjitime për njerinë e ri të kohës sonë, i cili duhet ta shikojë jetën në thelbin e saj, pa hequr dorë edhe nga qytetërimi i vërtetë, nga kultura e shëndoshë. Qëndrimin e vet ndaj njerëzve që, më të rrallë, po, mbahen akoma si qëmoti, autori e shpreh në vjershën «Gruas me çarçaf», së cilës i thotë se i ka hije fustani i bukur sipas kohës, etj... Në vjershat «Jubilare», «Malësori», «Në kafe» (nga cikli «Rrugëve të Vjenës») luftohet gjithashtu kundër dukjes së jashtme, kundër artificializmit.

Nga vetë jeta, nga zhvillimi i mendimit dhe i poezisë sonë, autorit i kanë lindur disa ide për qëndrimin estetik ndaj botës dhe ndaj vetë poezisë. Kjo temë nuk ka marrë përpjesëtim të gjerë në vëllim, po është karakteristike për poezinë tonë. Qëndrimi estetik ndryshon bashkë me kohën; një rreth më i gjerë fenomenesh që gjer dje mund të dukeshin antipoetikë, sot hyjnë në sferën e poezisë, në sferën e së bukurës, sepse lidhen me poetizimin gjithnjë më të madh që i bën njeriu natyrës dhe shoqërisë. Nga kjo pikëpamje nuk janë pa interes vjersha si «Kllaniku», «Për sputnikun», «Romantika». Vjersha të këtij lloji nganjëherë paraqesin në vëllim një interes të kufizuar, sepse autori është mjaftuar me shprehjen e zbetë të një mendimi, në esencë, të drejtë.

Plotësojnë vëllimin me vargje lirike të frymëzuara, me nota optimiste dhe delikate vjershat për natyrën e për dashurinë. Ato zbulojnë botën e brendshme të poetit, që përfaqëson, në këtë rast, diçka të përgjithshme, tipike për njerëzit e kohës sonë. Atij i bën përshtypje natyra e bukur e vendin tonë dhe nuk e sheh atë përmes vellos së zbetë e melankolike të romantizmit të kaluar.

Detajet e jashtme zgjojnë përfytyrimin, sjellin në mend dashurinë, ngjallin gëzim ose të venë në mendime. Të tilla vjersha janë «Kur bie dëborë», «Malli», «Në shtëpinë e vjetër», «Natë» etj. Në vjershat «Vjeshtë» dhe «Mendime në vjeshtë», që ngjajnë me njera-tjetrën, autori e sheh këtë stinë jo me trishtim e melankoli, siç ndodh nganjëherë edhe në ndonjë poezi të sotme e siç shihej shpesh nga romantikët, po me një sy tjetër, e sheh të lidhur me punën e njeriut, me frytet e kësaj pune. Qëndrimi estetik i autorit në këtë rast është qëndrimi i njeriut të tanishëm, që e ndryshon jetën me duart e tij dhe që zgjeron sferën e së bukurës në natyrë. Ne ndjejmë aromën e vjeshtës sonë, hijeshinë e saj, shohim ngjyra të bukura e të holla.

Kujt fletët e verdha ja shtojnë mërzinë?

Më flak,

Er' e vjeshtës, melankolinë!

Më hidh,

Er' e vjeshtës, në pyjet pa fund,

Ku pisha e gjelbër kurorën lëkund....

* * *

Duke u nisur nga mënyra e thjeshtë e të shkruarit, duke u munduar të gjejë poezi edhe ku gjithshka duket «e thjeshtë» dhe «jo poetike», duke qëndruar besnik i parimit se faktet, detajet flasin vetë, — disa herë poeti D. Agolli në vëllimin e tij nuk arrin të krijojë poezi të vërtetë dhe mjaftohet vetëm me disa hollësi interesante, me konstatime që nuk shprehin ndonjë ide të rëndësishme ose që e shprehin atë zbetë. Kështu, p.sh., në vjershën «Kënetat» autori ka dashur të na japë me «katër kapituj» idenë e tharjes së kënetës. Po këto katër strofa, ku gjithshka kalohet përciptazi, janë shumë pak për të dhënë këtë ide të madhe. Vjersha ka mbetur e ftohtë, nuk arrin të krijojë tablo konkrete dhe emocionante. Vargjet janë prozaike:

Unë poeti
Shoh varkën, që mbeti
Mes arës së qetë;
Dhe rri e vras mentë:
Ta kthejmë në qerre
Varkën e rëndë.

Në vjershën «Zilja» poeti ka dashur të thotë se si njeriu duhet të punojë, të mos jetë përtac dhe ata njerëz që bënë sahatin, «Zilen e tij shamatore» të ftojnë: «Çohu!». Mendimi, sigurisht, nuk mund të kundërshtohet, po tepër i thjeshtësuar për të arrijtur në një krijim poetik!

Vjersha si «Mëngjez në port», «Motivet», «Thirrje» (motiv i udhëve — shfrytëzuar nga autori edhe më parë), si edhe ndonjë tjetër, kanë një vlerë të kufizuar, nuk janë në nivelin e vjershave të mira të vëllimit.

Nga një ide interesante është nisur autori në vjershën «Kjo grua». Siç kuptohet, gruaja ka hequr dorë nga dashuria për hir të «apartamentit» etj, po prapëseprapë, thotë autori, apartamenti i del në ëndërr, nuk e lë të qetë. Vjersha ka mbetur e përciptë, e lehtë, në të nuk merret ky problem si diçka e rëndësishme, nuk luftohet me forcë si një ndjenjë meskine që i shëmton njerëzit shpirtërisht. Duke u dhënë pas detalit nganjëherë poeti nuk arrin të japë ide të fuqishme në vjersha, ku një gjë e tillë do të ishte e domosdoshme.

Poemthi «Hapat e mia në asfalt» ka momente të bukura, siç u tha dhe më lart, po në tërësi poeti nuk ja ka arritur plotësisht qëllimit. Detajet janë gjetur bukur në shumë raste, po nuk shkrihen në një pathos të vetëm; poemthi — ashtu siç është shkruar — kërkonte, ndofta, një trajtim më të fuqishëm liriko-epik, ku përshekrimi i detajeve të lidhej me më shumë përgjithësime, mendime interesante. P. sh. momenti kur flitet për tymin e barutit, që ka hyrë kudo, edhe në kutitë e brisqeve të berberëve etj. ka për qëllim të na flasë se si lufta i përfshiu të gjitha skutat, preku me forcën e vet edhe hotelet, edhe dyqanekat e vogla, po kjo ide nuk del aq e qartë ose, më

mirë, në disa raste kemi të bëjmë me një renditje të thjeshtë detajesh që na emocionojnë pak. Plani i poem-thit është shtruar gjerësisht; përfshihet në të koha e luftës dhe e pasluftës, dhe prandaj ne pretendojmë të shohim tablo më të plotë, mendim përgjithësonjës, kurse poezia mbetet ca e shkëputur. Vargu më i lirë që përdor këtu autori vende-vende është i goditur, po ka edhe momente mjaft prozaike. Përshtypje të tillë të lënë, p.sh., vargjet:

*Dhe atij
që lëpiu buzët përtej detit,
përtej maleve tona
dhe zgjat dorën
drejt qytetit,*

*ku unë jetoj,
ku unë ngre mur,
ku unë shtroj
rrugën me asfalt,
ku unë shkoj në teatër
ku unë ngre flamur...*

Në pjesën më të madhe të vjershave D. Agolli përdor vargun e rregullt, ose pak më të lirë, po që i nënshtrohet një kriteri. Në disa raste, në pamjen e parë, vjershat duken si të shkruara pa kujdes për formën po, ç'është e vërteta, ato kanë një harmoni të brendshme. Po ka edhe disa vjersha ku mungon puna për të arritur një formë të përkryer, për të kërkuar një gjuhë të pasur poetike. Forma e lirë, e vetvetishme, nuk ka të bëjë me pakujdesinë gjuhësore, me shprehjen e thjeshtësuar dhe prozaike që hasim nganjëherë te D. Agolli. Në pak raste autori ka përdorur këtu vargun e lirë, duke mos hequr dorë, veçse më të rrallë, nga rimat, të cilat i lidhin, i organizojnë vargjet. Kështu p.sh. te «Mendime në vjeshtë», «Këmi-shët» mungesa e metrit klasik nuk e dëmton vargun; ndërtimi sintaktik i përshtatet mendimit dhe vargu nuk bëhet prozaik. Po ka raste të tjera kur autori nuk e gjen

dot ritmin, nuk thotë as mendime e figura interesante dhe vargu nuk ja arrin qëllimit. I tillë është shëmbulli që sollëm nga «Hapat e mia...» Mund të citonim edhe vargje të tjera.

*Me buzëqeshje të bukura
Kërkoni flutura,
Kurse ne,
Etrit tuaj,
Le të merremi me ekonomi e politikë,*

(«Vizatime në pranverë»)

Në përgjithësi D. Agolli nuk përdor shumë figura artistike, ai është i lehtë e i thjeshtë. Kjo është një veçori e talentit të tij dhe një meritë. Prandaj më duket se për te nuk janë organike disa figura të një stili tjetër, pak estra-vagante, si «e këta njerëz me krahët e gjatë si paralelet e tokës» («Metalurgët») «Zabeli skuq i përgjakur si flamur divizioni» e ndonjë tjetër. Po këto nuk janë të shpeshta.

* * *

Dobësitë e librit «Hapat e mia në asfalt» janë më të pakta në krahasim me meritat. Këto të meta i vumë në dukje, duke menduar se, ndofta, mund t'i shërbejnë autorit në të ardhmen. Me rëndësi për këtë vëllim është lirizmi i tij i hollë dhe i ngrohtë, dashuria për jetën tonë të re, për njerëzit e thjeshtë, lufta për pastërtinë shpirtërore. D. Agolli është një poet i talentuar. Kemi besim se ai do të zhvillohet edhe më tutje në rrugën e tij poetike.

1962

AROMË E FUSHAVE DHE E MALEVE TONA

(Mbi vëllimin me tregime «Maleve në Shënëndre» të S. Andonit)

Vëllimi me tregime «Maleve në Shënëndre» i Sotir Andonit, me sa duket, është pritur mirë nga lexonjësit. Tek ne presin me gëzim e dashamirësi çdo vepër të re, që pasqyron jetën e vërtetë të popullit, shpirtin e tij, që jep karaktere shqiptare, që sjell aromën e fushave dhe të maleve tona, çdo vepër që e përshkruan jetën tonë me një gjuhë të pasur dhe tingëllonjëse shqipe.

Merita kryesore e tregimeve të Sotir Andonit është se në to, përgjithësisht, ndjehet jeta e vërtetë, ambienti shqiptar; përshkrimi është i vetvetishëm e i frymëzuar, përshtypjet janë të freskëta dhe personale, gjuha mjaft e pasur me një ritëm të zhdërvjellët e vende-vende poetik. Tregimet dallohen më tepër për forcë përshkronjëse, për mbresa që shprehen më shpesh me mjete figurative të jashtme, lirizëm e hov poetik. S. Andoni, si duket, e njeh mirë luftën nacional çlirimtare dhe jetën e fshatit, «gazet dhe helmet» e tij. Për fshatin është shkruar mjaft tek ne, po ka akoma shumë anë të këtij realiteti të pangritura në art me mjeshtëri artistike, të pazbuluara thellësisht: Çështja e plagëve shoqërore në të kaluarën, e transformimeve të mëdha shoqërore e psikologjike të fshatit gjatë luftës e në ditët tona jep material të pashtetur për vepra interesante. Pastaj në art shpeshherë nuk është puna aqë te temat e reja, te subjektet krejt origjinale, sa te materiali konkret që ka në qendër të

vemendjes shkrimtari, te përshtypjet e reja, të freskëta që sjell ai nga jeta. Kështu, p.sh., është shkruar tek ne për temën e mërgimit, temë kjo që është e rrahur në folklorin tonë, ku gjejmë vargje të mrekullueshme që shprehin me të vërtetë brengën dhe hidhërimin njerëzor. Po kjo nuk pengon aspak që ne të lexojmë me endje dhe me mallëngjim tregimin «Gazet dhe helmet e fshatit tim» që i kushtohet ndjenjës së pastër të dashurisë fshatare dhe temës së mërgimit. Ky tregim dhe mjaft të tjera të S. Andonit nuk janë aq interesante nga pikëpamja e problematikës, e mendimit, sa nga mbresa emocionale që shkaktojnë, nga ndjenjat poetike që të ngjallin.

Në «Gazet dhe helmet e fshatit tim» përshkruhet me ngjyra të gjalla dhe të ngrohta dashuria e dy të rinjve, e Sekes me Katerinën. Kjo bëhet e këndshme edhe sepse autori e shikon dashurinë me sytë e një të vogli, që e shpjegon çdo gjë fare thjeshtë dhe me naivitet fëmënor. Era e barit, fërfërima e pemëve, zogjtë, ambienti i vërtetë fshatar — i dhënë me mjaft hollësi origjinale dhe konkrete — janë sfondi ku e vendos autori ngjarjen e vet të thjeshtë që nuk dallohet për fabulë të koklavitur. Ne, si lexonjës, e ndjejmë poezinë e kësaj dashurie dhe i duam heronjtë e tregimit. Sekua është një djalë i shkathët dhe i rrëmbyer, i zoti të ndjejë thellë dhe të luftojë për të arritur qëllimin e vet. Gjyshi, njeri jo i keq në shpirt, po i rreptë e me zakone të vjetra, në fillim e pengon, po pastaj pajtohet edhe ai me të. Nga episodet e bukura të tregimit është çasti kur Sekua, që ka marrë tani lejën e gjyshit për t'u martuar me Katerinën, hyn në shtëpinë e saj si i çmendur dhe, në sy të një të vogli, e ngre atë në duar dhe e përqafor. Del në këtë tregim problemi i «të rinjve» dhe i «të vjetërve», konflikti midis tyre, thyerja e rregullave patriarkale nga brezi i ri, po edhe ndryshimi në psikologjinë e «të vjetërve» që tashmë e kanë kuptuar se s'ja dalin dot me rininë.

Po gëzimi dhe poezia e dashurisë prishet nga një nevojë që në shumë fshatëra tona ish bërë e domoshme: Sekua duhet të largohet në kurbet së bashku

me shumë fshatarë të tjerë. «Kaluan fluturimthi ata muaj të ëmbël — thotë autori — dhe ja, po afrohej Shëmitri. Ishte koha kur iknin burrat në kurbet. Kështu ngjiste mot për mot se toka ishte e pakët e nuk na mbante dot» (f. 25). Mërgimi ka qenë plagë e rëndë për popullin tonë. Për këtë s'duhën shumë fjalë që zemra e lexonjësit të preket dhe fantazia e tij të marrë me mend vuajtjet shpirtërore të heronjve. Prandaj edhe pse autori këtu nuk na flet shumë e nuk analizon botën e brendshme të dy të porsamartuarve, ne mund të hymë fare bukur në shpirtin e tyre. Tregimi i disa ngjarjeve që kanë të bëjnë me mërgimin, përshkrimi i jashtëm i çastit të ndarjes, «Lëndina e lotve», «retë e zeza katran që mbulonin qiellin» nga perëndimi, na ngjallin hidhërim dhe na vënë në mendime për fatin e zi të nënave dhe mo-trave tona, ahëre kur njerëzit duhej të duronin ndofta për tërë jetën brengën e ndarjes, me shpresë se do të siguronin një jetë më të mirë. «Gazet dhe helmet e fshatit tim» është nga tregimet më të mira të vëllimit.

Një tregim tjetër që kap një anë morale e shoqërore është tregimi i shkurtër «Teto Limiadha». Limiadha pat ikur dikur me një grek dhe më nuk i qe dëgjuar emri. Dashuria e saj ka qenë e fortë dhe, ndofta, e pamenduar gjersa nuk gjeti aprovimin e njerëzve të fshatit. Në kohën e luftës italo-greke vijnë në Shqipëri refugjatë. Ndërmjet tyre kthehet edhe teto Limiadha bashkë me të bijat. Ajo ish dëshëruar për vendin dhe kthimi në atdhe e gëzoi, po pas pak kohe vdiq: njeri nuk e bekoj martesën e saj — arësyetonte i ati i Limiadhës — dhe «dheu i huaj nuk e mbante brenda», prandaj vdiq me t'u kthyer në tokën e saj.

Ky tregim, sado i shkurtër e i pazhvilluar si duhet, na flet për lidhjen e njeriut me vendin e tij, për dhëmbjen që shkakton ndarja nga atdheu. Po kjo ide kryesore e tregimit nuk merr përpjesëtimet e duhura dhe lexonjësi nuk di ku ta përqëndrojë më tepër vëmendjen: te kthimi i refugjatëve, te pasojat e luftës, apo te fati i teto Limiadhës. Sidoqoftë këtu ka një copë jete dhe kjo e bën tregimin interesant.

Të gjitha tregimet e tjera të vëllimit janë të lidhura me luftën nacionalçlirimtare, ose e përfshijnë edhe atë periudhë. Karakteristikë e këtyre tregimeve nuk është aq zotësia për të krijuar tipa, karaktere (ato herë-herë shpikatin me forcë në disa momente të caktuara të përshkrimit), sa zotësia e krijimit të atmosferës së luftës, e dhënjes së episodeve prekëse, të forta si edhe të shikuarit e luftës, të njerëzve dhe të ngjarjeve me sytë e të voglit, me sytë e vet autorit; karakteristikë është lirizmi që përshkon shumë faqe të librit.

Tregimi më i goditur për luftën, si nga ana e kompozicionit, ashtu edhe nga ana e forcës krijonjese, është «Maleve në Shënëndre». Një korrier partizan duhet të kalojë nëpër male natën, për të kryer me çdo kusht detyrën që i kanë ngarkuar. Subjekti është shumë i thjeshtë: partizani ndodhet pothuaj vetëm me natyrën; ai kalon nga njera vështirësi në tjetrën, duke kujtuar gjithnjë misionin e lartë dhe ja merr këngës:

*Ngritëm flamurin e kuq
gjer përtej në oqean.*

Kjo i jep zemër, e gjallëron. Këtu autori ka merita më të mëdha se sa kur tregon ndonjë ngjarje të gatshme, ndonjë episod që në vetvete është interesant. Këtu ka më tepër krijim, fantazi prej shkrimtari realist. Bukuria qëndron në këmbimin e sensacioneve të ndryshme të partizanit, në paraqitjen e ambientit, në pasurinë gjuhësore e, mbi të gjitha, në nënvizimin e qëllimit të lartë. Ideja: forca morale e partizanit, karakteri i kalitur në luftë, organizon tregimin dhe e bën më të mirin në gjithë vëllimin nga pikëpamja e kompozicionit. Pak më lart thashë se S.Andoni përgjithësisht nuk dallohet për krijimin e karaktereve unike, të tipave që të gdhenden mirë në mëndjen e lexonjësit; po, mendoj, se në tregimin «Maleve në Shënëndre» ai ka arritur në këtë krijim një sukses të shënuar dhe këtu, pa dyshim, i ka ndihmuar ideja qëndrore që lidh mirë subjektin, fakti se ai është nisur nga njeriu dhe jo nga përshtypje të shkëputura.

Në «Pusia anës lumit» lufta kundër armikut tregohet e lidhur me luftën e klasave. Kjo ka qenë një e vërtetë historike që letërsia jonë duhet ta nxjerrë në shesh. Dilikua, një partizan plak, urren Dalipin, beun që e ka bërë të vuajë gjithë jetën. Ndërsa partizanët i kanë zënë pusi beut dhe e presin të kalojë, Diliku tregon, në mënyrë bindëse dhe interesante, historinë e jetës së tij. Po tregimi rëndohet me përshkrime shpesh të panevojshme, me hollësi që nuk lidhen organikisht dhe ajo që është më e rëndësishme, kulmi i tregimit, çasti kur Dilikua vret beun, përshkruhet shumë zbetë, përciptazi. Këtu duhej që autori të shprehte më tepër se kudo ide në kryesore të tregimit të tij dhe të mos kalonte shkarazi.

Edhe «Pjetër Prenga prej Iballe» është një tregim me vlerë, sidomos për faktin e llahtarshëm që na tregon shpirtin vetmohonjës të partizanit, mbi dashurinë që kishin partizanët për njëri-tjetrin (Qemali i thith plagën Pjetrit, pasi ajo ka zënë krimba dhe shoku është në rrezik). Fakti është i ashpër, po e tillë ka qenë shpesh edhe lufta që kërkonte sakrifica të mëdha. Bukur përshkruhet burrëria e Pjetrit, miqësia e tij me Qemalin. Tregimi është i fortë nga pikëpamja e paraqitjes së partizanëve në një moment të caktuar edhe jo për pasqyrimin e zhvillimit të karakterit; megjithëse mundohet të na përshkruajë historinë e Pjetrit, si erdhi ai me partizanët, prapë, nga kjo anë, tregimi mbetet i zbetë, i përciptë dhe jo bindës.

Bukur jepet atmosfera e luftës në tregimin «Mihali». Këtu kemi të bëjmë më tepër me disa kujtime interesante, të shkruara me mjeshtëri, se sa me një tregim në kuptimin e vërtetë të fjalës. Miqësia e Mihalit me djalin e vogël, Todin, është një histori e këndshme dhe e njerëzishme. Tregimi lexohet me ëndje, po autori duhet të ishte munduar ca më tepër për të krijuar një karakter më të plotë, për të hyrë më thellë në shpirtin e tij.

Me ëndje lexohet edhe tregimi «Nën shelgjet te mulliri», që përmbledh gjithashtu disa kujtime të autorit, po këtë radhë pak më të shkëputura se te «Mihali». Përshkrimet këtu janë shumë të bukura, me gjuhë të

rrjedhshme, poetike. Momenti i përlëshjes së mullisit, Kolës, me ballistët, paraqitet mirë dhe këtu gdhendet karakteri i tij. Po tregimi vuan nga fragmentarizmi, nga mungesa e një ideje qëndrore që duhej ta organizonte, nga një qëllim i caktuar. Njëherë përshkruhet natyra, pastaj dashuria, më vonë mullisi, ballistët... Po megjithatë «Ndën shëlgjet...» ka shumë freski dhe nuk lë përshtypje të keqe.

Tregimet «Kur isha e vogël dhe «Balashi» janë shumë të bukura. Ato mbështeten në ngjarje të thjeshta, po që tregojnë fare mirë si e ndjenin okupacionin edhe fëmijët, si lëndohej zemra e tyre bashkë me gjithë popullin. Gjuha është e pasur në shprehje e humor. Autori e përshkruan aqë bukur balashin sa nuk mund të mos prekesh edhe ti bashkë me fëmijët, kur atë e vrasin fashistët. «Zhurma e huaj që tej nga livadhet ngrinte një potere që të çante veshët» thotë autori duke shprehur urrejtjen kundër armikut.

Edhe «Zjarr në folenë time» është një tregim shumë i bukur, lirik, me forcë emocionale, me një ritëm të zhdërvjellët e gjuhë të pasur që lë mbresë të thellë te lexonjësi.

Tregimet më të dobëta të vëllimit janë «Një ndodhi e jetuar» dhe «Byk e kashtë nga fshati im». I pari ka momente të bukura nga fillimi, pastaj ngarkohet me një përshkrim të gjatë nga lufta që s'ngjall interesa, që nuk lidhet me karakteret, po mbetet si i veçuar. Historia e operacionit jepet më tepër si informacion dhe nuk është tërheqëse. Tregimi i dytë ka pretendimin të satirizojë një kryetar komuneje, njeri pa parime dhe pa moral. Megjithëse ka shprehje të goditura popullore, momente komike, prapëseprapë figura e Seferit mbetet shumë e përcipët; jepet vetëm një portret i thatë; në përgjithësi nuk e urrejmë kryetarin e komunes dhe mbetemi ca të ftohtë kur e rrahin fshatarët, sepse tipi i tij nuk tregohet sa duhet në aksion e sipër; ato kyçe të subjektit që ka gjetur autori (çështja e pullave etj.) nuk janë të mjaftueshme dhe bindëse. Tregimi është edhe i ngarkuar me shprehje jo kurdoherë të nevojshme. Duket si-

kur kërkon t'ja arrijë qëllimit të vet me anë të tyre dhe jo të materialit, të situatave të vërteta komike.

Këto ishin vlerësimet e mia kryesore rreth librit në përgjithësi dhe çdo tregimi veçanërisht.

Veç anëve pozitive që zotërojnë në këtë vëllim, vërehen të meta që dëmtojnë realizimin, ashtu siç u mundova të vë në dukje, duke bërë fjalë për tregime të veçanta.

S. Andoni disa herë ja del të krijojë figura që mbeten në mendje; të tillë janë korrieri partizan, Katerina e Sekua dhe ndonjë tjetër. Po ai, përgjithësisht, vuan nga mungesa e krijimit të karaktereve të plota, nga mungesa e depërtimit në psikologjinë e tyre.

Autori i «Maleve në Shënëndre» ka shumë përshtypje interesante nga jeta, nga lufta dhe nga fshati, po shpesh ai nuk i mendon tregimet në punë të ndërtimit, të idesë kryesore që do të nënvizojë. Për këtë do t'i ndihmojë shumë kultura, të lexuarit e mjeshtërive të novelës.

Është e qartë se shkrimtari duhet të thotë fjalën e tij, të përpiqet vetë ta zbulojë jetën, të ndihmojë për përparimin e saj. Duke u mbështetur në ideologjinë socialiste, shkrimtarët tanë kanë për detyrë të ndihmojnë në edukimin e masave, në ngritjen e tyre morale. Vëllimi i S. Andonit kryen një detyrë të tillë, po jam i mendimit se ai duhet të bëjë më tepër përpjekje për të pasur në veprat e tij më shumë mendime, ide të caktuara e unike (me këtë s'dua të them aspak se këto tregime s'kanë ide!). Kjo, ndofta, është arsyeja që tregimet e tij vuajnë nganjëherë si kompozicion e si subjekt.

Gjuha e S. Andonit është shumë e pasur, po shpesh ai e ngarkon prozën me shprehje që të lodhin dhe bëhen si qëllim në vetvete. Le të marrim nja dy shembuj:

«Është e bukur dhe veç të tjerave Katerina. E pinte ujin veç shoqeve, i thosh diellit ja dil, ja të dal. Syfilxhan e qafëgjatë, gushëbardhë e vetullhollë... (f. 16-17).

Ose:

«Dyfekun e kam të vajosur, opingat shtrënguar, këmbët rrufe, syrin pishë, sherrit t'armikut i them lepe... (f. 44).

Shumë i kërkuar e artificial ky grumbullim shpreh-
jesh dhe epitetesh!

Nganjëherë autori përdor fjalë dialektale, që s'është
e nevojshme të përdoren në gjuhën letrare, si p.sh. **ne**
për **te**; **e njojt**i për **e njohu**; **janë tëndet** për **janë të tuat** etj.

Po, në përgjithësi, vepra «Maleve në Shënëndre»
është e bukur, e freskët, me material të pasur nga jeta.

1958

MENDIME PËR NJË PROZATOR TË TALENTUAR

Kur lexon librin e fundit të Sotir Andonit «Dasmë e çuditshme», njeriu shpesh herë ndjen atë kënaqësi që të japin zakonisht shkrimet e tij — ngrohtësinë lirike, ngjyrat e gjalla romantike të jetës së fshatit, pasuria e gjuhës dhe e detajeve. Bindesh edhe një herë për talentin e këtij prozatori, për aftësinë e rikrijimit të atmosferës së fshatit, të vizatimit të natyrës me ngjyra emocionante dhe, në disa raste, prekesh nga forca e fakteve që ka zgjedhur e përpunuar shkrimtari, e fakteve kuptimplotë që gërshetojnë në vetvete çështje patriotike, çështje të ndryshimeve morale dhe shpirtërore në periudhën e luftës nacionalçlirimtare.

Po, pasi lexon këtë libër, si edhe disa tregime të mëparshme të këtij autori, duke simpatizuar, në tërësi, mënyrën e të shkruarit, stilin e tij, mendoj se nuk do të gabohem po të them se ndjen edhe një shqetësim, për rrugën e mëtejshme të zhvillimit të tij, për nevojën e domosdoshme të një përparimi më të madh. Në këtë libër ka disa tregime të bukura, dhe, në përgjithësi, vepra nuk le përshtypje të keqe. Po e kam fjalën te përtema të reja, për të mos përsëritur vetveten, për të të bëjnë përshtypje të mirë, po pastaj, po u tepërua me to, po u përdorën vend e pa vend, nuk e lozin më rolin e tyre dhe, hera-herës, mund të duken si një stoli e tepërt. Kështu nuk mund të kënaqemi as me subjekte që duken në vetvete interesante, që kanë diçka të jashtë-

zakonshme, akute po që në të vërtetë nuk sjellin ndonjë mendim të ri dhe nuk e zbulojnë jetën nga ndonjë aspekt interesant.

Është e qartë, se mund të shqetësohesh vetëm atëhere kur je i bindur se një shkrimtar ka dhënë dhe mund të japë me të vërtetë vepra të bukura, të ndjera, që kanë në vetvete një copë jetë të gjallë, që nisen nga populli, nga shpirti i tij.

Shkrimet më të mira të Sotir Andonit, nga ato që ka krijuar gjer tani, mund të themi se të japin mundësi të përcaktosh, pak a shumë, ku qëndron ana më pozitive e tij, ku e ndjen më tepër forcën ky autor, megjithëse nuk kemi pretendimin që të godisim doemos në shenjë dhe, aq më pak, të bëjmë ndonjë profeci për të ardhmen. Kur është duke u formuar, duke kërkuar tema, duke hapur rrugë, artisti mund të dalë para lexuesit në një aspekt të ri, pak të zhvilluar prej tij më përpara.

Mendoj se S. Andoni, në shumicën e rasteve, kapet pas disa temave që kanë në vetvete diçka emocionante, poetike, hera-herës të jashtëzakonshme; tërhiqet shpesh nga një mënyrë romantike e të shkruarit. Them romantike, duke pasur parasysh disa veçori të stilit, sepse kjo mënyrë ka të bëjë me ngjyrat e forta, me koloritin e theksuar lokal, me prirjen ritmike të frazave, me përshkrimin e shqetësuar të natyrës dhe të bukurisë femërore.

Në tregimet më të mira të S. Andonit si «I handakosuri», «Maleve në Shënëndre», «Në qershor kur kositet bari», «Dasmë e çuditshme», etj. vihet re kjo prirje romantizimi, pa u shkëputur nga jeta, nga konceptimi realist i saj, gjë që në këto tregime përcakton, në radhë të parë, edhe suksesin e tyre.

Kjo tendencë nuk është vetëm një veçori e stilit dhe dihet se sa më të shumta dhe më origjinale të jenë stilet, aq më e pasur dhe më e gjallë është një letërsi. Kjo veçori, pra, është krejt normale sidomos për një shkrimtar të ri dhe i përshtatet natyrës shqiptare, temperamentit dhe mënyrës së konceptimit të jetës, sidomos nga ana e fshatarit. Duke ecur në rrugën e vet, sipas aftë-

sive dhe mënyrës së tij, megjithatë shkrimtari duhet të zhvillohet më tutje, duhet të thellojë më tepër konceptimin realist të jetës, të niset jo vetëm nga ngjarja e jashtme, nga «bukuria» e subjektit në vetvete, po ta kombinojë lehtësinë, rrjedhshmërinë e krijimit me qëllimin që i vë vetes, me ide më të rëndësishme që burojnë, doemos, nga koha, nga shoqëria jonë, nga kërkesat dhe gjendja shpirtërore e njerëzve të përparuar të ditëve tona. Pasurimi me ide, me mendime, përcaktimi i pozitave të shkrimtarit si një «inxhinier i shpirtit» nuk e frenon fantazinë e vetvetishme, po përkundrazi i jep asaj kuptim dhe domethënje më të madhe. Krahas shkrimeve të mira, ku nëpërmjet ngjarjes del një ide emocionante, ku ka një konceptim artistik të fakteve, me gjithë dobësitë kompozicionale, të Sotir Andoni gjejmë edhe tregime me efekt të jashtëm, tregime të sipërfaqshme si «Portokallet» e ndonjë tjetër dhe, ajo që është më e rëndësishme, me një tingëllim arkaik, me një konceptim naiv dhe primitiv të jetës. Arkaizmi i të kuptuarit të fenomeneve sjell edhe arkaizmin e formës, apasionimin pas «qëndizmave» gjuhësore, në qoftë se mund t'i quajmë kështu, pas idileve fshatarake që dikur mund të ishin të freskëta dhe të reja për letërsinë tonë, po sot, me gjithë sinqeritetin e përshkrimit dhe poezinë, nuk mund të tingëllojnë më në atë mënyrë. Dhe meqë jemi të ky mendim, jo sepse kjo e metë është kryesore për vëllimin «Dasmë e çuditshme», po sepse mund të bëhet problem për autorin, do të marr ndonjë shëmbull. Tregimi «Kënga e rinisë së parë» ka nota poetike të ëmbla mbi një dashuri të sinqertë. Po përshkrimi krejtësisht idilik i ambientit, frazat shabllone, folkloristike, konceptimi primitiv i natyrës, i qiellit, ku duket «sikur perëndia ka ndehur tej e ndanë një cergë mavi e pastaj mbi të i është derdhur shiniku me misër...» me ato besimet thuajse supersticioze që autori i jep si pa të keq për ujin «...Ku mblidhen të Bardhat dhe lajnë leshrat e gjata,» apo për shtojzavallet dhe, mbi të gjitha, mungesa e një sfondi shoqëror, sado të lehtë, — të gjitha këto i japin tregimit një ngjyrë arkaike dhe krijojnë vetëm një

bukuri të jashtme, të rënduar me detaje që kanë një shkëlqim të zbehtë. Nuk besoj të jetë fort e nevojshme të shtoj se çdo autor ka të drejtë të flasë për një përfytyrim naiv femënor ose rinor të zanave dhe shtojzovallëve, të krijojë me këto ambientin, atmosferën. Po nga mënyra e të shkruarit, nga tingëllimi i stilit, autori sikur shkrihet me personazhin dhe i lind një nostalgji krejtësisht romantike. Dihet se asnjëherë frazat e bukura, të tingëllueshme nuk mund të përcaktojnë artin, se përdorimi i tepërt, i pavend i folklorit, i shprehjeve të goditura në vetvete, po jo në funksion të mendimit, largon vëmendjen nga karakteret, nga njeriu, dhe krijon një retorikë të re të veshur me fjalë «të rralla». Desha të insistoj për këtë dobësi jo vetëm për këtë autor, po sepse kjo shfaqet në disa raste në letërsinë tonë, e cila ka nevojë t'u hyjë më thellë fenomeneve të jetës, ta thotë të vërtetën pa shumë fjalë, të pasurohet me mendim, cilido qoftë stili dhe mënyra e një autori, natyrisht, pa hequr kurrë dorë nga pasurimi i formës, i gjuhës, i fjalorit, i mjeteve shprehëse.

Fraza si këto «në kam një brengëzë në zemër e më lëndohet shpirti këtij çasti...kjo vjen se nuk mund ta shkruaj dot në kartë...» tashmë janë bërë shabllone dhe nuk ndihmojnë, p.sh., që portreti i Vani Kapedanit të gjallërohet, sepse materiali që zotëron shkrimtari këtu është i varfër dhe nuk ka ndonjë mendim interesant; nxitja për të shkruar duket e jashtme, nga një njohje, nga një përshtypje dhe nuk arrihet dot një e vërtetë artistike.

Po pavarësisht nga këto të meta të rëndësishme për krijimtarinë e shkrimtarit, në vëllim ka tregime të mira që sjellin diçka të re, qoftë nga ana e tematikës, e zgjerimit të saj me aspekte të reja nga lufta nacionalçlirimtare, qoftë nga një pikëpamje më e ngushtë estetike. Kështu, p.sh., tregime të tilla më duken «Dasmë e çuditshme» dhe «Ballë për ballë me errësirën». Këtu shkrimtari është nisur nga fakte interesante, të rëndësishme, në rastin e parë, të bukura në vetvete, e të përmbledhura në diçka unike, në të dytin, nga fakte më të shumta që

lidhen me një aspekt shumë të rëndësishëm, me fillimin e revolucionit kultural në vendin tonë. Tregimi «Ballë për ballë me errësirën» dëshmon një punë më të madhe e të ndërgjegjshme të autorit në grumbullimin e fakteve, në lidhjen e episodeve që t'i nënshtrohen një ideje, në trajtimin realist të jetës. Autori këtu mundohet ta pasqyrojë atë në anët e saj të ndryshme. Këtu bëhet fjalë për punën e një mësuesi gjatë luftës në një fshat të humbur, të prapambetur, ku kish hedhur rrënjë errësira, injoranca. Gjatë luftës nacionalçlirimtare atje u hap shkollë, po nuk ishte aq lehtë t'i mblihdje fëmijët. Mësuesi ja arrin qëllimit duke luftuar çdo ditë me ballistët, me ngurimin e fshatarëve, me ata që u besojnë magjive, duke zbutur me shembullin e tij vrasës profesionistë, që kishin dalë malit për hakmarrje dhe ishia kantandisur në kriminelë. Në këtë tregim vizatohen edhe tipa interesantë si sekretari i këshillit që bënte çmos për shkollën sadoqë vetë nuk dinte shkrim e këndim, Merushja delikate, e etur për të mësuar etj.

Duke u kthyer në një stil pak më të qetë, realist, i mbështetur në material të detajuar jetësor, autori këtu ka përfituar, po edhe ka humbur nga pikëpamja e forcës emocionale, tipike për të. Disa herë tregimi (mjaft i gjatë) mbetet pak i thatë, i shkëputur dhe autori nuk hyn sa duhet në botën shpirtërore të njerëzve, nuk jep me forcën e duhur gjendjen shpirtërore të asaj kohe, përmbysjet e mëdha që po sillte revolucioni. Megjithatë tregimi është interesant, lexohet me kënaqësi dhe ndihmon për pasqyrimin në letërsinë tonë të aspekteve pak të njohura të luftës nacionalçlirimtare.

Kalitja e ndërgjegjes patriotike dhe revolucionare gjatë luftës, rritja e personalitetit të njeriut, si pasojë e revolucionit popullor, solli me vete edhe ndryshime në jetën morale dhe shoqërore, atë botëkuptim të ri që zuri fill atëhere dhe që po bëhet gjithmonë më i qëndrueshëm sot.

Në tregimin «Ballë për ballë me errësirën» ka një episod dasme. I ati i vajzës e kthen fjalën se ishte me

Ballin, dhe s'deshi ta jepte vajzën në atë fshat ku ishin partizanët. Lufta i pengonte krushqit të shkonin atje. Të mbetur në mes të udhës, ata marrin nuse një vajzë tjetër, mjaft sa të mbulohej turpi. Ky fakt është i vërtetë, i hidhur dhe mendimet e perparuara të mësuesit, Bardhos, për fatin e grave, fjalët e tij nuk e ndryshojnë dot rrjedhën e ngjarjeve. Kështu ndodh në këtë rast, po ja, në tregimin «Dasmë e çuditshme» ndodh ndryshe. Është kohë lufte. Partizanët çojnë për te burri një vajzë fshatare, meqë ua ka lënë amanet i ati, shoku i tyre i vrarë në luftë. Vajza s'e kish parë ndonjëherë burrin të cilin as partizanët nuk e njihnin. Dhe kjo mund të ndodhte. Ishte luftë; pastaj fenomenet janë të ndërlikuara: i ati ish luftëtar, po ruante zakonet e vjetëra të martesës dhe të familjes. Kështu, ata e çuan vajzën po burri ishte plak. Vajza u tmerrua, u bë një heshtje e dhëmbshme dhe atë e muarën me vete partizanët. Subjekt i bukur, i romantizuar, po me një ide të fuqishme: revolucionin e çliron njerinë nga paragjykimet, i jep zemër, guxim dhe vajza nuk bëhet skllave e zakonit.

Tregimi është konçiz, pa fjalë shumë, pa frazeologji të tepërt, me gjuhë të gjallë e me kolorit. Ja si ndodh kur puqet frymëzimi dhe domethënja jo e sforcuar, e gjetur me pahir, po që buron nga vetë jeta.

Sotir Andoni është nga tregimtarët tanë më të mirë. Konceptimi më i thellë i jetës, interpretimi më realist, më aktual, lidhja e fakteve me idetë, pasurimi me mendime, me kulturë, të domosdoshme si ajri për një shkrimtar sado talent që të ketë, do ta zhvillojnë më tej krijimtarinë e S. Andonit.

1964

PASQYRIM I TIPAREVE TË KOHËS

(Rreth vëllimit me tregime «Çezma e floririt» të Naum Priftit)

Vitet e fundit tregimi tek ne ka marrë një zhvillim të konsiderueshëm. Kjo është një gjini që mund t'u përgjigjet mirë dhe më shpejt kërkesave të kohës për të pasqyruar në letërsi njerëzit e sotëm në shfaqjet e rëndësishme të jetës së tyre, për të pasqyruar — duke u nisur nga botëkuptimi socialist, nga niveli i sotëm i të gjykuarit të botës, — edhe fenomene të së kaluarës. Vihet re përpjekja e prozatorëve për të përmirësuar mjeshtërinë artistike në krijimin e tregimit, përpjekja për t'u thelluar në karakteret njerëzore dhe për të kapur tema të reja që zbulojnë anë të ndryshme të realitetit tonë, jo aq të rrahura në letërsi.

Një vend të rëndësishëm ndër këta prozatorë të vjetër e të rinj zë shkrimtari Naum Prifti, i cili ka shkruar mjaft tregime të këndshme dhe me tema të rëndësishme.

Vëllimi me tregime «Çezma e floririt» dëshmon për zhvillimin e autorit në rrugën e tij krijonjëse. Përparimi vihet re, para së gjithash, në realizimin e karaktereve më të plota në krahasim me tregimet e mëparshme të tij, në krijimin e tablove më të gjera dhe më realiste, të marra sidomos nga jeta e sotme, në përpunimin e stilit dhe në pasurimin e mjeteve artistike. Naum Prifti është, në përgjithësi, një prozator i ëmbël, i natyrshëm, që pasqyron, në mënyrën e vet, njerëzit e thjeshtë të

fshatit, tiparet e tyre shoqërore dhe morale, ndryshimet që kanë ndodhur në ndërgjegjen e tyre, një prozator që me një stil të shtruar, pa llustro ose fraza «të bukura» priret më tepër nga ngjarjet e zakonshme, të thjeshta, të cilat zbulojnë ide shoqërore, ide që lidhen me çështjen e botëkuptimit socialist, me çështjen e patriotizmit. Në shumicën e rasteve atë nuk e tërheq ana e jashtme e fenomeneve; njerëzit — ata që simpatizojnë ai — nuk janë doemos me sy të bukur apo flokë të dredhur, po ashtu, siç mund të qëllojnë vërtet në jetë. Simpatia për njerëzit e mirë, që përshkruan prozatori, është diçka më e thellë, e brendshme, që zbulohet në veprim e sipër, që del në shesh nëpërmjet detajeve artistike dhe lirizmit të ngrohtë që përshkon hera-herës tregimet.

«Çezma e floririt» është një libër i mirë, i shkruar me frymëzim, ndonëse — është e natyrshme — tregimet nuk janë të gjitha të një niveli. Ajo që të bie në sy në këtë vëllim është përpjekja serioze e autorit për të pasqyruar jetën e sotme, sidomos në fshat, për të treguar qëndrimin e njeriut të thjeshtë, për të ngritur edhe probleme të rëndësishme aktuale. Kjo vihet re në tregimet «Brazda e fundit», «Shoferi i autoambulancës», «E fejuara». Duke lexuar këto tregime, ne ndjejmë atmosferën e kohës, tiparet morale të njeriut të ri, mbeturinat individualiste në ndërgjegjen e njerëzve, ndeshjen e dy psikologjive, dy botëve, ndonëse kjo nuk shprehet gjithmonë ashpër dhe nuk thellohet sa duhet. «Brazda e fundit», që është ndër tregimet më të mira të letërsisë sonë të sotme, për shprehjen e idesë së madhe të forcës së kolektivitetit përmes një fabule të thjeshtë, kallëzimi të natyrshëm, njerëzor e plot poezi, bën fjalë për fshatarin Sterjo Papuli dhe të shoqen e tij Irinin, që nuk kishin hyrë në kooperativë e që punonin arat të veçuar. Çasti kur Irini, e lodhur nga puna e ditës, dështon fëmijën dhe (ndërsa ata e ndejnë veten pa njeri, nën atë qiell të pamatur, përmbi tokën e heshtur) kooperativistët vijnë, bëjnë një vig dhe e shpien në fshat, tregon bukur se si u hoq «brazda e fundit» në jetën e veçantë të Sterjos

dhe të familjes së tij; për njerinë tani përgjigjet gjithë kolektivi, nuk ka më asnjë kuptim të jetosh larg tij: duhet të ecësh me kohën, me fshatin e kolektivizuar. Këtu ideja zbulohet nëpërmjet veprimit, situatës që krijohet. Tregimi ka mjaft nëntekst, e vë lexonjës in në mendim dhe, ndonse nuk flitet veçse fare pak për kooperativën, kjo qëndron në sfond, prapa këtyre du njerëzve të veçar, si një forcë e madhe, e re, si një forcë që ka të ardhmen përpára.

Qëndrimi plot dashuri i njerëzve të thjeshtë del në shesh edhe në tregimin tjetër të bukur «Shoferi i autoambulancës», ku tregohet se si, pas shumë përpjekjesh, shoferi i një qyteti të vogël gjen mundësinë të çojë, së bashku me doktorin, në spitalin e një qyteti tjetër, një grua që do të lindë. Subjekti është shumë i thjeshtë dhe gjithë puna qëndron te detajizimi i tij, te lidhja e natyrshme e çasteve nga më të zakonshmet. Karakteret zbulohen gjatë zhvillimit të subjektit. Në fillim shoferi duket vetëm i muhabetit e i këngës, po pastaj del pak nga pak përpara nesh si një njeri me zemër të artë. Edhe doktori, pasioni më i madh i të cilit, siç thotë autori, ishte tani të lonte tavllën, kur u gjend përpara një rasti ku duheshin «shpëtuar dy njerëz», u vu në lëvizje i tëri. Qyteti i vogël me jetën e tij, që në sipërfaqe mund të thuhet monotone, merr për ne një pamje tjetër: atje punohet për njerëzit, bëhet çmos për shëndetin e tyre, për të sjellë në jetë një njeri më shumë.

Tregimi të bën për vete, se është i rrjedhshëm, se autori nuk bërtet, nuk pozon në ato momente që janë vërtet të rëndësishme dhe që fshehin në vetvete një ide fisnike. I goditur është fundi i tregimit. Shoferi, Xhemili, asqë mendon se ka bërë ndonjë heroizëm, se, duke pasur maqinën të prishur, mbushi kopertonat me kashtë e me lecka dhe shpuri të sëmurën me mundim 50 kilometra larg. Fjalët e fundit, që duket sikur nuk lidhen me tregimin, e plotësojnë edhe më mirë portretin e Xhemilit dhe të ngjallin gëzim e dashuri për këta njerëz: «**Xhemili, pasi ndezi një cigare, u ul në sedilje, vuri duart në timon dhe filloi të mendohej, se erdhi që erdhi në qytet,**

do ishte mirë t'u blente fëmijëve ndonjë peshqesh, mirëpo ishte në hall se nuk dinte çfarë të zgjidhte».

Problemin e martesës dhe të dashurisë trajton tregimi i gjatë «E fejuara». Këtu zbërthehet konflikti i vjetër, po që ka lënë akoma gjurmë, midis «etërve» dhe «bijve». I ati do ta martojë çupën me një njeri të shkuar nga moshë, të shëmtuar. Vajza ka rënë në dashuri me fqinjin, konflikt ky shumë i njohur, tradicional. I ati i Sadetes, Myrtezai, po ta martojë vajzën atje ku do ai, do të martohet edhe vetë, pasi i ka vdekur gruaja. Do të bëhet kështu këmbim: një udhë e dy punë. Dhe kështu fillon ndeshja.

Gjëja më e mirë në këtë tregim është pasqyrimi i disa tipareve të reja të rinisë së sotme fshatare. Sadetja, ndonëse e ndrojtur, e mbyllur, nuk bie viktimë e patriarkalizmit dhe e egoizmit të tet, siç do të ndodhte përpara tek ne: shoqëria po e pajis atë me ide të reja, kolektivi është një forcë e madhe që e mbron dhe, më në fund, kjo vajzë e turpshme shkëputet nga i ati në mënyrë të bujshme.

Tregimi nuk lexohet pa interes, po nuk është ndër më të realizuarit e këtij vëllimi, ndonëse ka momente mjaft poetike, gjendje shpirtërore të dhëna me vërtetësi. Mendoj se figura e babait të Sadetes, Myrtezait, nuk paraqet si duhet mbrojtësin tipik të patriarkalizmit, njerinë që e do me gjithë shpirt të bijën, po që, për hir të zakonit, të fjalës së dhënë, të disa bindjeve të tij, qoftë edhe patriarkale, do që t'i shkojë fjala. Ai është më tepër një njeri antipatik, egoist, që, duke dashur të martohet vetë, ngul këmbë edhe për Sadeten. Veç asaj, dashuria e dy të rinjve, e Sadetes dhe Raifit, është përshkruar përciptazi, sadoqë ka skena të bukura të takimeve të tyre. Ndjenjat e brendshme të vajzës mund jepeshin më thellë: kështu konflikti do të zbulohet më mirë dhe do të dilte më i qartë shkaku i brendshëm që e shtyti vajzën të jetë e bindur në të sajnë, do të dilte pasuria shpirtërore e të rinjve të sotëm. Tregimi nuk le aq përshtypje të mirë, ndofta edhe sepse ritmi është pak i ngadalshëm, subjekti nuk zhvillohet me shka-

thtësi e ka skena të tepërta që mund të përmblihdeshin. Interesant është ta kapësh temën e martesës në fshatin e sotëm duke paraqitur ndryshimet që kanë pësuar në psikologjinë e tyre edhe «etërit». Ky është një fenomen, ndofta, më i përgjithshëm dhe më i rëndësishëm për prozën e sotme.

Temë të rëndësishme trajton edhe tregimi «Minatori plak». Në të ka faqe të bukura, që të bëjnë për vete, por mendoj se veprimi i personazheve nuk është aq i përligjur, sidomos në kthesën e tyre. «Minatori plak» mbetet më tepër si një përshkrim ku autori përpiqet t'ja arrijë qëllimit me mjete jo aq artistike.

Ndërsa në këto tregime autori e përqëndron vëmendjen në tipare karakteristike të realitetit, duke u munduar, ku më shumë e ku më pak, të lidhë të veçantën me të përgjithshmen, të shohë prapa ngjarjeve dhe njerëzve arësyet shoqërore që i shtojnë të vepronë — në tregimin «Lakmia» përshkruhet një njeri i veçuar, ziliqar e shpirtlig dhe ky përshkrim, do të thoshja, mbetet si qëllim në vetvete. Nuk arrihet në një përgjithësim: autori kufizohet me konstatimin e këtij fakti. Letërsia gjithmonë zbulon, sheh diçka tjetër më të rëndësishme prapa asaj të zakonshmes, prapa faktit që, në vështrimin e parë, ndofta, nuk bën përshtypje. Këtë gjë ne e shohim qartë në tregimet e tjera të Naum Priftit.

Tregimi «Çezma e floririt» është shkruar bukur, me ndjenjë dhe zë vendin e tij në vëllim. Ai duhet të ishte, ndofta, pak më i ngjeshur, me figura më të forta që do t'i shkonin për shtat kësaj teme, me më shumë mendime të vetë autorit, që, në të tilla raste, shprehen hapur, duke ruajtur gjithmonë një formë të figurshme. Edhe tregimi «Letra e turkut» është realizuar mirë.

Prozat poetike të vëllimit kanë vlerën e tyre: ka në to fantazi dhe ndjenjë. Po duhet thënë se disa momente mbajnë erë vjetërsi, sentimentalizëm, gjen në to figura të shfrytëzuara, që u ka ikur koha. Më e mirë më duket «Drita e yllit», e cila ka një ide politike dhe origjinale.

1961

DRAMA «HIJET E NATËS»

Desha ta them që në fillim, se drama «Hijet e natës» e shkrimtarit Vedat Kokona, përgjithësisht, mua më duket realiste. Në këtë dramë nuk ka aksion të madh, nuk ka ndonjë fabulë të jashtëzakonshme, as çaste të papritura. Po në vlerësimin e çdo vepre duhet marrë parasysh tema, detyra që i ka vënë vetes autori dhe veçoria e stilit të tij.

«Hijet e natës» është një dramë më tepër psikologjike, e brendshme, ku bëhet fjalë për gjendjen shpirtërore të njerëzve, për qëndrimin e tyre në një situatë të caktuar. Meqenëse jepen karakteret në një moment të caktuar, meqenëse përshkruhet bota e brendshme e personazheve në një çast vendimtar, në dramë nuk shtrohet detyra e lëvizjes së karaktereve, e rrugës së forcimit të tyre, po, në më të shumtat e rasteve, e zëbrthimit të karaktereve tanimë të formuara.

Ngjarja zhvillohet brenda një nate. Është koha kur në Tiranë forca të ushtrisë nacionalçlirimtare luftojnë për të çliruar qytetin. Ç'mund të bëhej gjatë kësaj kohe, do të mendonte njeriu, në një familje borgjezi, tregëtari. Dhe autori i kësaj drame na fut dalëngadalë në një botë të tillë, ku marrëdhënjet midis pjesëtarëve të familjes nuk janë aq të thjeshta sa mund të duken, ku shprehën mendime të ndryshme mbi luftën, mbi fatin që i pret këta njerëz. Përgjithësisht autori tregohet realist. Ai zbulon një të vërtetë historike-shoqërore që të bind, të mbush mendjen. Tërë puna në këtë dramë qëndron te forca e krijimit të karaktereve, te ndryshimi

që kanë ata nga njëri-tjetri, te individualiteti i tyre. Gjithë këto «hije të natës» janë mbyllur në një dhomë dhe po qajnë hallet, gjithkush në mënyrën e tij. Drama zhvillohet nëpërmjet bisedimeve që bëjnë pjesëtarët e familjes e tregëtarët e ardhur atje për të lojtur poker, nëpërmjet qëndrimit që mbajnë ata kundrejt luftës e, sidomos, nëpërmjet kontaktit të herëpashershëm që kanë ata me botën jashtë mureve të shtëpisë. Lufta për çlirimin e Tiranës, gjendja që ndryshon gjithnjë lot rol përcaktonjës në zbulimin e karaktereve, që dalin para nesh gjithnjë e më qartë. Kështu, p.sh., partizani që ka rënë pranë shtëpisë, dukja e dy ushtarëve gjermanë janë hallka të rëndësishme që ndihmojnë në dramë për të kuptuar karakteret.

Drama nxjerr në shesh degjenerimin shoqëror të borgjezisë sonë, botën e saj të ngushtë që kufizohet te paraja, te plotësimi i dëshirave personale; nxjerr në shesh se ç'frikë u ka hyrë në palcë njerëzve të borgjezisë, të cilëve po u afrohet fundi.

Të tilla personazhe janë Tefiku, Selimi, Tefiku është përfaqësonjës tipik i borgjezisë tregëtare të lidhur kokë e këmbë me mallin, me paranë. Ai thotë se nuk e do as jetën pa mallin. Tefiku ka humbur pothuajse çdo ndjenjë njerëzore. Ai i bërtet së shoqes dhe djalit, të cilët kërkojnë të sjellin brenda në shtëpi partizanen e shtrirë pranë portës së tyre. Qëndrimi i tij është i prerë: ai nuk i sheh dot me sy partizanët e i quan ata fajtorë për gjithë ngatërresat që bëheshin. Realist tregohet autori kur vë në gojë të tij fjalët:

«Ti ke punuar gjithë jetën tënde me djersën e ballit, njeri s'ke vjedhur, njeri s'ke vrarë, të vjen një birbo, një zuzar dhe të thotë: «Bjere mallin ta ndajmë bashkë».

S'duron dot Tefiku t'i marrin mallin. Ai është armik i rreptë i jetës së re që do agojë të nesërmen në qytet. Po njerëz të tillë do përpiqen të dredhojnë. Ata janë munduar qysh gjatë luftës të marrin me të mirë partizanët duke iu dhënë të holla. Të holla jepnin më të dy anët (sigurisht shumë më tepër njerëzve të tyre); këtë e bënin jo sepse donin të fitonin partizanët, po se, kushedi,

ndonjëherë, po të vinte puna, mund t'i kujtonin me fjalë të mira.

Qartë del në shesh fytyra e Tefikut, kur kërkojnë letrën me firmën e Xhafer Devës si dokument për të mbajtur armë. Me mjeshhtëri e ka përshkruar autori këtë moment që është, ndofta, më i godituri në dramë dhe që satirizon bukur «hijet e natës». Sa qesharakë bëhen këta njerëz në këto çaste, kur kërkojnë një copë letër për të treguar, në rast se do të hyjnë, në rrëmujë e sipër, dy ushtarët gjermanë që janë dukur afër shtëpisë, se Selimi ka të drejtë të mbajë armë. Gjermanët, sigurisht, nuk shkuan. Ata s'dinin ku të futnin kokën e jo të kontrollonin të tjerët.

Selimi është oficer besnik i fashizmit, që ka bërë kundër lëvizjes ç'i ka ardhur për dore, ç'ka mundur. Ai e di se nuk shpëton dot nga pushteti i ri, prandaj mendon të ikë. Po edhe kaq trim nuk është: ka frikë të largohet; rruga nga të gjitha anët është e prerë: më mirë të rrijë në shtëpi pranë gruas e të ëndërrtojë për ditë që s'kthehet më. Plot kuptim është bisedimi i Selimit me të shoqen, Nafijen. Edhe figura e saj jepet në mënyrë realiste. Ajo është me të shoqin, ëndërron për një jetë komode, me lukse, po është një grua naive që s'i kupton mirë punët, që çuditet pse trembet Selimi nga partizanët. Dhe kur Selimi i numëron të gjitha ato që ka bërë, asaj i del përpara më e qartë e vërteta. Në perëndimin e jetës së tyre, ata rrinë e kujtojnë të kaluarën. Në dhomë qëndron varur një kuadër: Sheshi San Marko në Venecje. Aty kanë qenë ata të dy, pasi u martuan. Dhe tani flasin me nostalgji për atë kohë: «Oh, sa hije që të kishte ajo uniformë e shkretët!» i thotë Nafija Selimit. Bukur përshkruhet romantika e këtyre njerëzve, të cilët s'kanë ç'të kujtojnë tjetër nga jeta e tyre përveç disa ditëve të këndshme që kanë kaluar në Venecje.

Drama shquhet për realizëm, ajo nuk vuan nga skematizmi. Tregëtarët janë tregëtarë. Ata kanë diçka të përbashkët që i lidh, po kanë edhe tiparet e tyre të veçanta. Thanasi, në qëndrimin e tij, ngjan me Tefikun, po Sotiri është njeri më objektiv.

Aj e kupton se «rusët» fituan, se ata u dhanë dërmën fashistëve që në Stalingrad. Këto, me sa duket, i kuptojnë mirë edhe dy tregëtarët e tjerë, po ata tërbohën nga fjalët e Sotirit, nuk duan ta shohin të vërtetën në sy. Duke iu drejtuar atij Tefiku thotë: «më mirë mos i thuaj, mor lumëmadh, se kështu i jep guxim armikut». Një figurë si e Sotirit është krejt e mundshme realiste. Të tillë tregëtarë ka pasur.

Për realizmin e dramës dëshmon edhe figura e Zehrasë. Autori nuk na e tregon qëndrimin e saj në lëmin politik, po më tepër në atë moral ose etik. Grua e pazhvilluar siç ishte, ajo rronte me familjen e saj, i i pëlqente t'i kishte të gjithë pranë e, sigurisht, të ruante floririn për të siguruar të ardhmen. Po ajo është e njerëzishme. Asaj i dhimbset partizanja e vrarë, çuditet me histerizmin e burrit, tregon e kënaqur se si atë e ndihmoi një partizan, kur ish matanë, në zonën e çliuar të qytetit. E guximshme kjo nënë: ajo nuk pati frikë të shkonte në anën e partizanëve që të shihte njerëzit e saj.

Figura e gjyshes është e goditur, ajo krijon atmosferë jete, e gjallëron dramën. E mësuar t'i ketë të gjitha ç'i duhen, ngjallën për t'u shëruar nga reumatizmat, dritën, — ajo çuditet si mungojnë këto gjëra, si është e mundur të luftojnë njerëzit kaq shumë, nuk e kupton dot ç'e duan «këtë luftë të shkretë». Duke vënë një figurë të tillë të një plake që ankohet nga pleqëria, nga mungesat e gjërave kaq elementare, krahas njerëzve të shqetësuar, që jetojnë ndoshta çastet më të vështira të jetës së tyre, autori ja del të tregojë më mirë ndryshimin që ka pësuar jeta në këtë familje, gjendjen shpirtërore të pjesëtarëve të saj. Gjyshja është në këtë shtëpi një fazë e kaluar, një hije edhe ajo, po më e zbetë se të tjerat. Ajo nuk jeton më, kurse hijet e tjera përpëlitën në minutat e fundit. Ajo është konservatore në krahasim me fëmijët e saj (gjë e natyrshme!). Nuk e kupton plaka ç'duhet lulet për të festuar përvjetorin e martesës dhe, bile, të festosh përvjetorin e martesës për të është e pakuptueshme. Ajo është mësuar

t'i shërbejnë, ajo e ndjen veten «Zonjë» dhe shërbëtores i tregon vendin; këto janë format e jetës së saj: dikush duhet të urdhërojë e dikush të bindet.

Pothua të gjitha këto personazhe megjithëse dallojnë vga njëri-tjetri, janë vërtet «hije» pa personalitet, që s'dinë ku të futin kokën, ose të pazotë të dalin nga kjo gjendje.

Kundër tyre autori vë djalin e Tefikut, Halitin, profesor i gjuhës dhe i letërsisë. Ky personazh mbron në shumë pikëpamje mendimin e vetë autorit, tregon qëndrimin e tij karshi këtyre njerëzve. Ideja për një figurë të tillë është e drejtë dhe realiste. Ç'përfaqëson Haliti? Ai është një intelektual patriot në mënyrën e tij, ka folur në shkollë për Shqipërinë, për historinë dhe letërsinë shqipe. Po, sigurisht, ai ka qenë një njeri pasiv, i pavendosur. Në një kuptim ai është njeri i dështuar: ka ëndërruar të bëhet poet, prozator, po nuk doli gjë. Nuk u bë dot as mbrojtës i thjeshtë i ideve të veta. Po në shpirt diçka pozitive i ka mbetur: ai vuan nga gjendja në të cilën ka rënë. Këto çaste vendimtare e shqetësojnë edhe më tepër; ai tani njeh më mirë rrethin e tij dhe del në reliev më tepër se asnjëherë patriotizmi që ka në shpirt. Haliti është një humanist abstrakt, me një botëkuptim të ngushtë, po ta marrësh në krahasim me patriotët dhe humanistët më konseguentë të kohës, me komunistët: ai thërret për mëshirë, për dritë. Në botë ka të varfër dhe të sëmurë që lëngojnë, thotë ai: «I ndihmoj që drita ime të shkëlqejë edhe më tepër, kështu që jeta të të duket edhe më e ëmbël akoma. Kjo dritë është mëshira, kjo dritë është dashuria». Ka dashur apo s'ka dashur autori ta thotë këtë, po ndihma që do t'u japë njerëzve Haliti është ndihma e një njeriu egoist, që mendon për qetësinë e vet shpirtërore, që mendon t'u bëjë të mirë të tjerëve në mënyrë që atij jeta t'i duket më e ëmbël. Me këtë desha të theksoj tiparet e Halitit dhe jo të qortoj autorin: një personazh me një botëkuptim të tillë ka të drejtën e ekzistencës.

Kështu, pra, thelbi i këtij tipi është i qartë, i kuptueshëm, në të nuk ka pothuajse asgjë jorealiste, johisto-

rike. Po figura, pas mendimit tim, nuk ka gjetur shprehjen e duhur artistike, nuk arrin të bëhet simpatike dhe, në pjesën më të madhe, nuk e justifikon qëllimin e autorit. Është fjala për mënyrën si flet ai, për tonin e tij emfatik e që duket qesharak në momentet në të cilat zhvillohet ngjarja. Profesori i letërsisë mund të flasë më ndryshe se të tjerët, ai është i nxitur nga ngjarjet dhe kjo ndikon edhe në gjendjen e tij shpirtërore, po, pranë seprapë, me tiradat e tij «poetike», me shprehjet e kërkua «artistike», ai nuk qëndron dot përballë njerëzve që, megjithëse «hije», janë realistë për hesap të tyre dhe flasin me një gjuhë të thjeshtë njerëzore. Disa thënë të tij janë të vërteta dhe nganjëherë godisin atje ku duhet, po shumica tingëllojnë të fryra, me pozë. «Si lum ai që me shkëlqimin e fitores sheh se vdekja ja kurorëzon ballin me dafina të përgjakura». Ose «Pyete dritën e yllit që shkëlqen në thellësitë e kulluara të qiellit!» Pyetjes që i bëri Selimi se ç'mund të bënte ai, Haliti ja kthen me vjershë «Të vdisje! Me gjakun tënd atdheut flamurin t'ja stolisje!» Ai, nga gjithë fjalët e tij nuk duket i zgjuar dhe i mprehtë, siç do të donim të shikonim një njeri që, në shumë pikëpamje, qëndron përballë «hijeve të natës».

A është bindës dhe konsequent fundi i figurës së Halitit? A mund të shkonte ai, qoftë edhe darkën e çlirimit, të luftonte? Përgjegje shumë e prerë këtu s'mund të jepet, po në këtë dramë, nga mënyra si shtrohet problemi, më duket se do të qe më me vend një përfundim tjetër. Është shumë vështirë që një njeri i drejtë, po kaq i pavendosur, tek i cili rëndon pesha e gjithë ngurrimeve dhe lëkundjeve në të kaluarën, të shkojë partizan natën e fundit të luftës. Kjo, në dramë tingëllon teatrale, nuk është bindëse. Do të ishte më mirë të lihej e hapët perspektiva, të merrej me mend se ky njeri shpejt ose vonë do ta kuptojë jetën e re dhe do ta përqafojë.

Kështu figura do të dilte më realiste dhe më bindëse.

Përgjithësisht simpatike është edhe figura e Tushes, shërbëtores. — njeriut të thjeshtë të popullit, që lufta e ka zgjuar dhe e ka bërë të fitojë pak nga pak personali-

tetin e vet. Ajo është shumë më e zgjuar nga zotërinjtë e saj. Po edhe fundi i Tushes (ajo ikën partizane) nuk më duket tepër i logjikshëm dhe i përgatitur. Përveç kësaj, autori ka kërkuar mjete artistike shumë të lehta për të individualizuar këtë tip: që nga fillimi deri në fund ajo flet tirançe. Kjo krijon një efekt të jashtëm komik jo shumë të nevojshëm. Përdorimi i dialektit të Tiranës bëhet këtu si një qëllim më vete dhe jo si mjet i domosdoshëm për individualizimin e personazhit. Efekti komik në lidhje me figurën e Tushes nuk është i domosdoshëm, se tjetër gjë është e rëndësishme në tipin e saj: zgjuarësia popullore, të kuptuarit e marrëdhënjeve të reja që po lindin. E kjo mund të jepet edhe me gjuhë të zakonshme. Mendoj se fundi i dramës s'është aq i goditur. Ndofta një fund i mirë është gjetur për gjyshen që kalon si hije me qiri në dorë. Po Tefiku rri në kolltuk me sy mbyllur, Zehraja i përkëdhel flokët Nafijes. Mund të gjendeshin detale më të goditura, më kuptimplote. Një fund i tillë mezi kapet dhe nuk bën dot një sintezë të idesë së dramës. Kënga «Po ngrihet flamuri i çlirimit», që dëgjohet nga dritarja, nuk është përfundim origjinal (shpesh dramat mbyllen me këngë).

Po, megjithatë, «Hijet e natës» është një dramë e goditur realiste, një dramë me vlerë psikologjike. Figura përgjithësisht e porealizuar e Halitit dhe, në disa raste, mungesa e individualizimit të gjuhës së disa personazheve janë të meta që e dobësojnë në një farë shkalle realizmin e veprës. Po këto të meta mund të ndreqen dhe, për mendimin tim, drama nga kjo do të përfitonte mjaft.

1957

«KËNGA DHE PUSHKA»

(Tregime të Dh. S. Shuteriqit)

Libri i Dh. S. Shuteriqit përfshin një periudhë krimtare prej më se dhjetë vjetësh, me tregime, disa prej të cilave janë botuar edhe më parë në vëllime, po pjesa më e mirë përmbledhet për herë të parë te «Kënga dhe pushka». Përveç tregimeve, ka edhe një numër përshkrimesh, të shkruara vjetët e fundit, që trajtojnë aspekte nga jeta e sotme, dhe e lidhin këtë me historinë, e me kulturën tonë të së kaluarës.

Kur i lexojmë rrjesht tregimet e Dh. S. Shuteriqit, që kemi parë të botuara në organe të ndryshme, mund të krijojmë një ide më të plotë për punën e tij si tregimtar, mund të kuptojmë më mirë mendimin, që i bashkon krijimet e tij, apo stilin e autorit.

Duke lexuar pra këtë vëllim, mendoj se kontributin kryesor si shkrimtar, Dh. S. Shuteriqi e ka dhënë me tregimet e tij, pa mohuar edhe vlerat në gjini të tjera. Ky libër është i rëndësishëm në prozën tonë të realizmit socialist dhe shquhet për mendimin që sjell autori, për rikrijimin e ambienteve shqiptare, për gdhendjen e disa tipave që mbajnë erë nga toka jonë, për stilin e punuar dhe gjuhën e pasur dhe për aftësinë në thurjen, në përgjithësi, realiste të tregimit, si një gjini shumë e nevojshme që po zhvillohet tek ne.

Është e qartë se një vëllim me tregime mund të mos arrijë gjithmonë të ketë një njësi mendimi, ashtu siç mund të ketë një njësi estetike; po, sidoqoftë, uniteti

ideo-estetik është një gjë e mirë dhe ja rrit vlerën librit. Kështu, mendoj se «Kënga dhe pushka», në një pjesë të mirë të tregimeve, ka një lidhje ideore, ka mendimin e rëndësishëm dhe kryesor të Këngës dhe të Pushkës shqiptare, që kanë jehuar dhe krisur nëpër shekuj e që dëshmojnë për trimërinë, zemrën e madhe dhe ndjenjën e thellë të shqiptarit. Kjo ide që shpeshherë në libër ka gjetur shprehje artistike, gjuhë emocio-nonjëse, i jep atij një tingëllim aktual dhe kështu vepra ndihmon në edukimin e lexuesve me dashurinë për atdheun, për të kaluarën dhe të sotmen e tij, ndihmon për të forcuar krenarinë kombëtare dhe në përgatitjen shpirtërore të brezit të ri, që duhet të njohë e të kuptojë gjithnjë më mirë vendin, shpirtin e popullit, potencialin e madh moral të Republikës sonë, që ka një të kaluar e të sotme të lavdishme dhe heroike.

Është e tepërt të themi se idetë e përgjithshme dhe të thata, sado të larta qofshin, nuk lozin rolin e tyre në art, po të mos jenë ngjeshur në faktet, në subjektin e veprës, në karakteret, në stilin. Kur flasim për sukses të një autori, kemi parasysh pikërisht mendimin, konceptimin artistik të jetës, faktin se sa arrin ai autor të zgjojë emocion, ose më mirë, mendim emociononjës te lexuesi.

Ide të tilla mbi forcën dhe bukurinë e vendit tonë, mbi ruajtjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të traditës, si në këngë ashtu edhe në pushkë, mbi kujtimet e pahirruara të luftës nacionalçlirimtare që kanë hedhur rrënjë në zemrat e njerëzve, gjejmë të shprehura në tregime të gjata ose më të shkurtpëra si «Ditët e sprasme të Gjorg Golemit», «Fyelli i Tanës», «Kujtim i paharruar», «Dy letra», ku krahas temës së burrisë dhe të fisnikërisë shpirtërore të malësorit, trajtohet edhe problemi i ndjenjës internacionaliste dhe i urrejtjes për ata që duan ta njollosin këtë ndjenjë. Tregimi «Shtatë vjet pas», me një gjuhë koncize e me ritmin e nevojshëm, mbron gjithashtu idenë e forcës së Republikës, të komunistëve, që ditën t'i çarmatosin shpirtërisht dhe t'i

bëjnë të dorëzohen pjesëtarët e një bande, e cila qëndronte shtatë vjet nëpër pyje.

Ndër tregimet që përmenda, mendoj se shquhen më tepër për realizim artistik «Fyelli i Tanës» dhe «Ditët e sprasme të Gjorg Golemit». Këto tregime, si edhe ndonjë tjetër në libër, pasurojnë novelistikën tonë, shquhen për gjuhën e bukur dhe për emocionin e vërtetë që zgjojnë. Vetë temat që ka pasur parasysh autori, (pa mohuar predispozitën e tij në trajtimin e tyre), kanë përcaktuar, ndofta, një stil poetik dhe një formë romantike në të treguar. Ky romantizim i materialit jetësor, duke u nisur nga kënga popullore apo nga faktet historike, këtu vjen me vend dhe nuk ka të bëjë, në këto raste, me stil të demoduar ose arkaik. Ideja e lidhjes së legjendës me të vërtetën, e fyllit që kalon dorë më dorë e vjen gjer në ditët tona, ka përcaktuar edhe njëthurje të gjetur mirë e, në tërësi, një subjekt të këndshëm dhe i ka dhënë historisë së njohur të Tanës e të fyllit të çobanit një domethënje aktuale.

Megjithëse ndihet dora e një autori, në tregimet e gjata e të rëndësishme të vëllimit «Xha Demit» dhe «Zot e rob» kemi të bëjmë me një mënyrë më realiste në të treguar (e kam fjalën për stilin, sepse detyra që i ka vënë vetes shkrimtari është e një lloji tjetër. Këto tregime të ndryshme nga ideja dhe nga brendia, mendoj se diçka i bashkon estetikisht: trajtimi realist i ndryshimeve në shpirtin e njeriut, që vijnë si rezultat i ndryshimit të kohës, të shoqërisë, i bashkon krijimi i karaktereve të marra nga realiteti shqiptar. Dh. S. Shuteriqi, në përgjithësi nuk krijon subjekte të ngatërruara, me skena të shumta e të papritura; ngjarja zhvillohet shtruar, me qetësi dhe kthesat vijnë logjikisht. Përveç motivit të përgjithshëm shoqëror, në këto dy tregime, p.sh., gjendet mirë edhe motivi i veçantë, individual, që shkakton kthesën shpirtërore. Tregimi «Zot e rob» është konceptuar mirë artistikisht, ka një gjuhë të figurshme. Jeta e ngrysur e dy pleqve — zot e rob — jepet në një ngjyrë të errët; reforma agrare, takimi me të mbesën,

hedh dritë në shpirtin e robit, të Uanit, i cili më në fund shpërthen në një revoltë. Në këto dy tregime kemi të bëjmë me raste tipike për letërsinë, kur autori niset nga karakteret dhe jo nga ngjarja që mund të duket plot efekte, po që nuk çon në rezultate artistike.

Në tregimin «Venusi i alpeve» autori shtron një problem të llojit estetik, të lidhur me kujtimet e tij, me jetën në Francë. Po ta shohim këtë tregim si disa kujtime të rinisë mbi jetën e një vendi tjetër, mbi marrëdhënjet e pastëra shoqërore e mbi përpjekjet e artistëve francezë për të krijuar artin e tyre realist duke u ndeshur me vështirësitë, me varfërinë, — ndofta do të kufizohej kuadri i tregimit, po ai mund të qëndronte më mirë në këmbë. Autori ka dashur t'i japë tregimit një ide më të rëndësishme: në Francën e sotme, në shoqërinë kapitaliste, edhe artistët të ndershëm, të shtyrë nga moda, nga nevoja e, pa dyshim, edhe për arësye të karakterit të tyre, mund të degjenerojnë në artin e vet, të krijojnë modele të shëmtuara dhe të përçudnojnë njerinë. Do të ishte e tepërt të pohonim se sa e rëndësishme është kjo ide. Po në këtë tregim ajo del e zbetë dhe nuk të bind. Karakteri i piktorit nuk jepet në mënyrë të atillë, (përveç një momenti kur ai deziluzionohet dhe e humbet durimin) që ne të besojmë në degjenerimin e tij si artist. Një mendim të afërt me këtë ka shfaqur edhe J. Malua në kritikën po për këtë libër. Problemi estetik që trajtohet këtu është themelor dhe tregimi nuk mund t'ia arrijë qëllimit, në qoftë se ky trajtohet shkarazi. Mbyllja vjen mjaft e kërkuar, një mbyllje që duket si e vënë me dorë për të arritur në idenë e caktuar nga autori.

Po të flasim, në përgjithësi, Dh. S. Shuteriqi shquhet për kulturën e të shkruarit, për frazën konçize, larg shabllonit dhe mënyrave libreske. Me përvojën e gjatë, ai e ka krijuar tashmë stilin e tij. Menjëherë bie në sy kujdesi për fjalën, zgjedhja e saj. Nga ky «merak» për të shkruar pastër, me gjuhë të punuar shqip, i disa shkrimtarëve tanë me përvojë, kanë për të mësuar mjaft më të rinjtë.

Nuk do të gabohehim, besoj, po ta quanim stilin e këtij autori, si një stil me prirje intelektuale. Kjo është një veçori dhe një meritë, sepse tregon kulturën e shkrimtarit. Po, në anën tjetër, në disa raste, ky stil mund të bëhet pak i ftohtë, cerebral, fraza mund të tingëllojë mirë në vetvete, po tregimi nuk të zgjon gjithmonë mendim të pandarë nga ndjenja. Ndodh që ritmi i tregimeve të Dh. S. Shuteriqit ngadalësohet, humbet ajo pikë nevralgjike që e zgjon dhe e mban gjallë interesin e lexuesit. Më tepër kujdes duhet t'i kushtojë autori veprimit, pikave emocionjese në historinë e karaktereve ose në ngjarjet, duke ruajtur stilin dhe mënyrën e tij të të treguarit.

Dh. S. Shuteriqi, që zotëron mjeshhtërinë e kësaj gjinie, mund të krijojë më shumë tregime për jetën e sotme, për ndryshimet shoqërore tek ne, për njeriun e ditëve tona. Siç dihet, kjo detyrë shtrohet para gjithë letrarëve tanë dhe aq më tepër para atyre që kanë më shumë përgatitje dhe përvojë.

1965

LËNDA

Faqe

I

Probleme ideore dhe artistike të poezisë sonë	5
Zhvillimi i mëtejshëm i poezisë, forcimi i përmbajtjes së saj	41
Letërsia dhe realiteti ynë	56
Përmbajtje e thellë dhe formë e lartë.	63
Temat e mëdha të aktualitetit.	69
Një vit letërsi në rrugën e realizmit socialist.	75
Për një pasqyrim të shumanshëm të jetës në prozë.	84
Të forcojmë qëndrimin ideologjik në tregimet tona, të pasurojmë brendinë e tyre.	91

II

Rruga e një poeti	103
Vargje për shekullin dhe për Shqipërinë	152
Lirizëm dhe natyrshmëri poetike	170
Aromë e fushave dhe e maleve tona	180
Mendime për një prozator të talentuar	188
Pasqyrim i tipareve të kohës	194
Drama «Hijet e natës»	199
«Kënga dhe pushka»	206

48248

BLIOTEKA E SHITES
GJURASISE

Tirazhi 3000 kopje

Format 78x109/32

Stash: 2204-65

Shtyp NISH Shtypshkronjave «MIHAL DURI»
Stabilimenti «8 NENTORI» — Tiranë, 1968